



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË



Viti: 2024 – Numri: 182

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Tiranë – E hënë, 28 tetor 2024

PËRMBAJTJA

	Faqe
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 665, datë 24.10.2024	Për zbatimin e pasojave të shfuqizimit të ligjit nr. 13/2016, “Për mënyrën e ofrimit të shërbimeve publike në sportel në Republikën e Shqipërisë” 20587
Dekret i Presidentit nr. 364, datë 24.10.2024	Për lejimin e lënies së shtetësisë shqiptare..... 20588
Udhëzim i ministrit të Financave nr. 12, datë 18.10.2024	Për disa shtesa dhe ndryshime në udhëzimin nr. 7, datë 28.2.2018, “Për procedurat standarde të përgatitjes së Programit Buxhetor Afatmesëm” 20588
Udhëzim i ministrit të Brendshëm nr. 198, datë 18.10.2024	Për procedurat për pajisjen me autorizim për veprimtarinë e lejuar me armë, regjistrimin e armës, administrimin e gëzhgjës në një bankë të dhënash dhe procedurat që kryhen pas dorëzimit në policinë shkencore..... 20592
Urdhër i ministrit të Brendshëm nr. 202, datë 18.10.2024	Për delegim të kompetencave..... 20624
Urdhër i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 831, datë 21.10.2024	Për ndalimin e peshkimit në liqenin e Ohrit dhe grumbullimin e vezëve të koranit për inkubim..... 20624
Vendim i Gjykatës Kushtetuese nr. 61, datë 19.9.2024	Me objekt shfuqizimin e vendimit nr. 00-2023-1811 (299), datë 7.11.2023, të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, si të papajftueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.. 20625
Vendim i Gjykatës Kushtetuese nr. 64, datë 1.10.2024	Me objekt shfuqizimin e vendimeve të Këshillit të Lartë të Prokurorisë nr. 356, datë 3.11.2021, “Për miratimin e listës së kandidatëve për prokurorë pranë Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar, të cilët plotësojnë kushtet ligjore”; nr. 385, datë 13.12.2021, “Për miratimin e shkallës së vlerësimit të kandidatëve për ngritjen në detyrë pranë Prokurorisë së Posaçme”; nr. 386, datë 13.12.2021, “Për miratimin e listës me

renditjen e kandidatëve për prokurorë pranë Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar”; nr. 387, datë 13.12.2021, “Për emërimin si prokuror në Prokurorinë e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar të kandidatit Elvin Gokaj”; nr. 388, datë 13.12.2021, “Për emërimin si prokuror në Prokurorinë e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar të kandidatit Alfred Shehu”; vendimeve gjyqësore nr. 83, datë 1.12.2022, dhe nr. s’ka, datë 4.5.2023, të Gjykatës Administrative të Apelit; nr. 5, datë 10.7.2023, të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë; nr. 00-2023-4083, datë 25.9.2023, të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

Detyrimin e Këshillit të Lartë të Prokurorisë të riçelë procesin e vlerësimit të kandidatëve për SPAK-un në fazën fillestare..... 20633

Vendim i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë nr. 00-2024-1611 (125), datë 22.5.2024

Me objekt miratimin e kërkesës për dhënien e pëlqimit për ekstradim nga Shqipëria në Itali të shtetasit shqiptar Bledar Bedini *alias* Bledar Imami..... 20643

Vendim i Entit Rregullator të Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura nr. 32, datë 23.9.2024

Për disa ndryshime në vendimin e Komisionit Kombëtar Rregullator nr. 6, datë 22.2.2023, “Për licencimin e Shoqërisë Rajonale Ujësjiellës-Kanalizime Durrës” 20682

Vendim i Entit Rregullator të Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura nr. 35, datë 7.10.2024

Për miratimin e përqindjes së pagesës rregullatore vjetore..... 20683



VENDIM

Nr. 665, datë 24.10.2024

**PËR ZBATIMIN E PASOJAVE TË
SHFUQIZIMIT TË LIGJIT NR. 13/2016,
“PËR MËNYRËN E OFRIMIT TË
SHËRBIMEVE PUBLIKE NË SPORTELE
NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të ligjit nr. 7961, datë 12.7.1995, “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, të neneve 14 e 15, të ligjit nr. 100/2024, “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 43/2023, “Për qeverisjen elektronike”, e të neneve 13 e 15, të ligjit nr. 8743, datë 22.2.2001, “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, të ndryshuar, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Mbyllja e ADISA-s, si pasojë e shfuqizimit të ligjit nr. 13/2016, “Për mënyrën e ofrimit të shërbimeve publike në sportel në Republikën e Shqipërisë”, shoqërohet me kryerjen e të gjitha procedurave për zgjidhjen e kontratave të punës të punonjësve të saj, sipas parashikimeve të nenit 14, të ligjit nr. 100/2014, si dhe të dispozitave të Kodit të Punës.

2. ADISA të kryejë procedurat në funksion të përfundimit të marrëdhënieve të punës së punonjësve të saj, në përputhje me përcaktimet e Kodit të Punës, duke u paguar atyre të gjitha detyrimet e parashikuara nga dispozitat e tij për punonjësit në rrethanat përkatëse, sipas rastit.

3. Pasuritë e paluajtshme, aktualisht në përgjegjësi administrimi të ADISA-s, së bashku me të gjitha të drejtat dhe detyrimet e tjera që lidhen me to, në përputhje me legjislacionin në fuqi, i kalojnë në përgjegjësi administrimi Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit (AKSHI), si më poshtë vijon:

a) pasuria me nr. 6/6-ND2/1, vol. 34, fq. 17, në zonën kadastrale 8531, (prona me emërtim “Shtëpia e Ushtarakëve”, mjediset e katit përdhes Fier);

b) pasuria me nr. 3/703, në zonën kadastrale 8621 (lagjja nr. 1, Krujë);

c) pasuria me nr. 25/2, në zonën kadastrale 8525 (prona me emërtimin “Gjykata e Rrethit Gjyqësor

Elbasan, me vendndodhje në lagjen “5 Maji”, Elbasan);

ç) pasuria me nr. 16/51-1, në zonën kadastrale 8571, dhe pasuria 16/51-2, në zonën kadastrale 8571 (lagjja “Kongresi” Lushnjë);

d) mjediset e katit të parë, me sipërfaqe 412 (katërqind e dymbëdhjetë) m², të ndërtesës me emërtim “Shtëpia e Ushtarakëve”, Gjirokastrë, pjesë e pasurisë me nr. 24/15, zona kadastrale 8541.

4. Sendet e luajtshme në administrim të ADISA-s i kalojnë në administrim AKSHI-t, me përjashtim të:

a) sendeve të luajtshme që gjenden në katet e pestë dhe të gjashtë të godinës, e cila identifikohet në bazë të pikës 9, të këtij vendimi. Këto sende i kalojnë përkatësisht Shkollës Shqiptare të Administratës Publike (ASP) dhe Agjencisë së Menaxhimit të Burimeve Ujore (AMBU);

b) 2 (dy) automjeteve “Toyota”, me targa AA 043 PL dhe AA 046 PL, të cilat do të kalojnë në përgjegjësi administrimi tek Agjencia Shtetërore e Programimit Strategjik dhe Koordinimit të Ndihmës (SASPAC);

c) 2 (dy) automjeteve: *SKODA Yeti* me targa (AA 539 NN) dhe furgoni me targa (AA 953 XM), të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi Shkollës Shqiptare të Administratës Publike (ASP).

Për këtë qëllim, ADISA përgatit inventarët e sendeve të luajtshme, si dhe kryen të gjitha procedurat, në përputhje me legjislacionin përkatës në fuqi. Institucioneve përkatëse u kalojnë edhe të gjitha të drejtat e detyrimet që lidhen me këto sende, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

5. Drejtori i Përgjithshëm i ADISA-s njofton Kryeministrin për përfundimin e të gjitha procedurave të parashikuara në këtë vendim. Pas marrjes së këtij njoftimi, Kryeministri miraton urdhrin për lirim nga detyra të drejtorit të përgjithshëm të ADISA-s, i cili përbën çastin e mbylljes së ADISA-s. Kryeministria përcjell për botim në Buletinin e Njoftimeve Zyrtare njoftimin për mbylljen e ADISA-s, pas miratimit të këtij urdhri.

6. Dokumentacioni arkivor dorëzohet sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi për arkivat.

7. Efekti financiar, sipas këtij vendimi, përballohet nga fondet e parashikuara për ADISA-n në ligjin “Për buxhetin e shtetit të vitit 2024”, të ndryshuar. Fondet e mbetura të papërdorura rikthehen në buxhetin e shtetit, sipas parashikimeve



të legjislacionit në fuqi për menaxhimin e sistemit buxhetor.

8. Për ambientet, që ADISA-s i janë dhënë më parë në përdorim nga bashkitë, AKSHI mund të bashkërendojë me këto bashki, në funksion të marrjes në përdorim, në përputhje me parashikimet e legjislacionit në fuqi, të atyre ambienteve që janë të nevojshme për ecurinë e veprimtarisë së saj, nëse ka dakordësi nga bashkitë përkatëse.

9. Në vendimin nr. 276, datë 1.4.2015, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, pika 3, ndryshohet, si më poshtë vijon:

“3. Kati i pestë dhe i gjashtë i godinës, sipas planimetrive, që i bashkëlidhen këtij vendimi dhe janë pjesë përbërëse të tij, u jepen në përdorim të përkohshëm, përkatësisht, Shkollës Shqiptare të Administratës Publike (ASP) dhe Agjencisë së Menaxhimit të Burimeve Ujore (AMBU) për sistemin e administratave të tyre.”.

10. Ngarkohen Kryeministria, ADISA, Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit (AKSHI), Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore (AMBU), Agjencia Shtetërore e Programimit Strategjik dhe Koordinimit të Ndihmës (SASPAC) dhe Shkolla Shqiptare e Administratës Publike (ASP) për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku

DEKRET
Nr. 364, datë 24.10.2024

PËR LEJIMIN E LËNIES SË
SHTETËSISË SHQIPTARE

Në mbështetje të nenit 92, shkronjës “c”, nenit 93 të Kushtetutës, neneve 13, 20 e në vijim të ligjit nr. 113/2020, “Për shtetësinë”, i ndryshuar, me propozim të Ministrisë së Brendshme,

DEKRETOJ:

Neni 1

I lejohet lënia e shtetësisë shqiptare, me kërkesë të saj, shtetases:

1. Greta Murat Shamkh (Matoshi)

Faqe | 20588

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj

UDHËZIM
Nr. 12, datë 18.10.2024

PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME
NË UDHËZIMIN NR.7, DATË 28.2.2018,
“PËR PROCEDURAT STANDARDE TË
PËRGATITJES SË PROGRAMIT
BUXHETOR AFATMESE”

Në mbështetje të nenit 24, të ligjit nr. 57, datë 2.6.2016, “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9936, datë 26.6.2008, ‘Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë’”, ministri i Financave

UDHËZON:

Në udhëzimin nr. 7, datë 28.2.2018, “Për procedurat standarde të përgatitjes së PBA-së” bëhen shtesat dhe ndryshimet e mëposhtme:

1. Në kreun 1, pika 8, shkronja “g” ndryshon, si më poshtë:

“g) një relacion shoqërues për kërkesat buxhetore i cili përmban por nuk kufizohet, informacion mbi:

a) një përmbledhje të shkurtër të performancës të njësisë së qeverisjes qendrore të vitit paraardhës buxhetor në terma financiar dhe jofinanciar;

b) një përmbledhje të performancës të njësisë së qeverisjes qendrore për periudhën e raportimit, brenda vitit korrent buxhetor në terma financiar dhe jofinanciar;

c) prioritetet afatmesme që planifikohen të arrihen brenda tavanit të alokuar për njësinë e qeverisjes qendrore mbështetur në dokumentet strategjike të fushës së njësisë së qeverisjes qendrore, dokumentin e politikave prioritare dhe programin e qeverisë;

d) prioritarizimin dhe argumentimin respektiv të kërkesave buxhetore mbi tavanin e alokuar për njësinë e qeverisjes qendrore, në fazën strategjike;



e) një analizë të situatës gjinore dhe masat e marra për adresimin e pabarazive gjinore;

f) një analizë të situatës, të lidhur me ndryshimet klimatike dhe masat e marra për adresimin e tyre.”.

2. Në kreun 2, në nënkreun 2.1, pika 2 hiqet fjala “përgatitore”.

Pas pikës 2, shtohen pikat 2/1 dhe 2/2 me përmbajtje si më poshtë vijon:

“2/1. Në çdo cikël të përgatitjes së Programit Buxhetor Afatmesëm, ministri i Financave shqyrton kërkesat shtesat të paraqitura nga NjQQ dhe propozimin për akomodimin e tyre të përgatitura nga nëpunësi i parë autorizues.

2/2. Ministri i Financave paraqet në Këshillin e Ministrave projektvendimin e taveve përgatitore të shpenzimeve të programit buxhetor afatmesëm për fazën strategjike të PBA-së dhe taveve përfundimtare të shpenzimeve për fazën teknike të PBA-së.”.

3. Në kreun 2, në nënkreun 2.2, pas pikës 3, shtohet pika 3/1, me përmbajtje si më poshtë:

“3/1. Në çdo cikël të përgatitjes së Programit Buxhetor Afatmesëm, nëpunësi i parë autorizues rishikon kërkesat shtesë të NjQQ të analizuar nga struktura e programit buxhetor, si dhe listën eventuale të kërkesave shtesë të prioritarizuara të përgatitur nga kjo strukturë, në përputhje me hapësirën fiskale që mund të rezultojë nga Kuadri Makroekonomik dhe Fiskal Afatmesëm i miratuar. Nëpunësi i parë autorizues i paraqet ministrit të Financave kërkesat shtesë të NjQQ, si dhe propozimin për akomodimin eventuale të kërkesave shtesë të prioritarizuara në përputhje me hapësirën fiskale që mund të rezultojë nga Kuadri Makroekonomik dhe Fiskal Afatmesëm.”.

4. Në kreun 2, pas nënkreut 2.2 shtohet nënkreu 2.2/1 me përmbajtje si vijon:

“2.2/1 PËRGJEGJËSIA E STRUKTURAVE PËRGJEGJËSE BREDA MINISTRISË PËRGJEGJËSE PËR FINANCAT NË PËRGATITJEN E DOKUMENTIT TË PROGRAMIT BUXHETOR AFATMESËM

1. Strukturat përgjegjëse brenda ministrisë përgjegjëse për financat në përgatitjen e dokumentit të PBA-së janë:

a) struktura përgjegjëse për programimin buxhetor;

b) struktura përgjegjëse për menaxhimin e buxhetit;

c) struktura përgjegjëse për menaxhimin e investimeve publike;

d) struktura përgjegjëse për financat vendore;

e) struktura përgjegjëse për parashikimet makroekonomike dhe fiskale.

2. Struktura për programimin buxhetor është përgjegjëse për:

a) analizon kërkesat buxhetore të përcjella nga NjQQ në fazën strategjike dhe fazën teknike të përgatitjes së PBA-së, duke u fokusuar në respektimin e procedurave dhe metodologjisë së përgatitjes së këtyre kërkesave;

b) analizon propozimet e bëra për financimin e politikave ekzistuese ose të reja, të financuara nga shpenzimet e personelit dhe/ose shpenzimet korrente për çdo program buxhetor të NjQQ;

c) analizon për çdo program buxhetor respektimin e procedurave të përcaktuara në këtë udhëzim për buxhetimin e përgjigjshëm gjinor dhe buxhetimin e masave të marra në kuadër të ndryshimeve klimatike;

d) evidenton dhe përgatit një përmbledhje të kërkesave shtesë mbi tavanin buxhetor të alokuar për çdo NjQQ;

e) mbështetur në prioritarizimin e kërkesave buxhetore të kryera nga NjQQ dhe hapësirën fiskale në dispozicion, paraqet tek nëpunësi i parë autorizues një propozim për akomodimin e tyre, në përputhje me pikën 3/1, të nënkreut 2.2;

f) jep rekomandime në rast se gjykohet e arsyeshme për përmirësimin e mëtejshëm të cilësisë së kërkesave buxhetore, përshtirë dhe çështjet e buxhetimit të përgjigjshëm gjinor, dhe agjendës së ndryshimeve klimatike;

g) koordinon procesin e finalizimit të analizës së kërkesave buxhetore të NjQQ me strukturat e tjera të përcaktuara në pikën 1, të nënkreut 2.3;

h) dërgon për shqyrtim dhe miratim analizën e finalizuar të kërkesave buxhetore të NjQQ tek nëpunësi i parë autorizues;

i) përgatit draftin e projektdokumentit të PBA-së për fazën strategjike, draftin e dokumentit të rishikuar të PBA-së për fazën teknike dhe ja paraqet Nëpunësit të Parë Autorizues për shqyrtim dhe miratim;

j) përgatit dokumentin përfundimtar të PBA-së, mbështetur në ligjin vjetor të miratuar dhe ja paraqet për miratim Nëpunësit të Parë Autorizues.

3. Struktura për menaxhimin buxhetor është përgjegjëse për:



a) paraqitjen e raporteve, komenteve dhe rekomandimeve mbi raportet e monitorimit të NjQQ të vitit pararendës dhe të vitit korrent, në fazën strategjike dhe në fazën teknike të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm;

b) paraqitjen e të dhënave historike të shpenzimeve buxhetore në nivel programi buxhetor dhe artikulli buxhetor për çdo NjQQ, minimalisht për 5 vitet e fundit, përfshirë dhe vitin korrent në fazën strategjike dhe në fazën teknike të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm;

c) paraqitjen e të dhënave historike në nivel produkti në sasi dhe kosto respektive, për vitin korrent dhe për tri vitet pararendëse në fazën strategjike, dhe në fazën teknike të përgatitjes së projektbuxhetit;

d) paraqitjen e të dhënave historike në nivel treguesish performance, objektivash dhe qëllimi në nivel programi buxhetor për çdo NjQQ, minimalisht për dy vitet pararendëse në fazën strategjike të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm;

e) paraqitjen e informacionit mbi rialokimet/rishpërndarjet buxhetore të çdo NjQQ, si edhe përdorimet e Fondit Rezervë, për vitin pararendës dhe për vitin korrent në fazën strategjike, dhe në fazën teknike të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm;

f) paraqitjen e të dhënave historike të numrit të punonjësve në nivel njësie shpenzuese për çdo NjQQ, për dy vite pararendëse përfshirë dhe vitin korrent në fazën strategjike të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm.

4. Struktura përgjegjëse për menaxhimin e investimeve publike:

a) analizon kërkesat buxhetore të përcjella nga NjQQ në fazën strategjike dhe fazën teknike të përgatitjes së PBA-së, duke u fokusuar në respektimin e procedurave dhe metodologjisë së përgatitjes së projekteve të investimeve publike;

b) analizon propozimet e bëra për financimin e politikave ekzistuese ose të reja të financuara nga shpenzimet kapitale për çdo program buxhetor të NjQQ;

c) analizon çdo program buxhetor për të verifikuar respektimin e procedurave të menaxhimit të investimeve publike, në lidhje me parimet kryesore të vlerësimit të projekteve të investimeve publike;

d) evidenton dhe përgatit një përmbledhje të kërkesave shtesë mbi tavanin buxhetor të alokuar për çdo NjQQ për shpenzimet kapitale;

e) mbështetur në prioritarizimin e kërkesave buxhetore të kryera nga NjQQ dhe hapësirën fiskale në dispozicion, paraqet tek nëpunësi i parë autorizues një propozim për akomodimin e tyre, në përputhje me pikën 3/1, të nënkreut 2.2;

f) jep rekomandime në rast se gjykohet e arsyeshme për përmirësimin e mëtejshëm të cilësisë së kërkesave buxhetore në drejtim të respektimit të procedurave të menaxhimit të investimeve publike.

5. Struktura përgjegjëse për financat vendore:

a) përgatit një analizë të performancës financiare dhe jofinanciare, sipas funksioneve për NjVQV;

b) përgatit një analizë për funksionet e transferuara në nivel vendor;

c) përgatit një aneks, i cili përfshihet në dokumentin e Programit Buxhetor Afatmesëm dhe përfshin informacion mbi:

- mënyrën e llogaritjes dhe shumën e transfertës së pakushtëzuar të njësisë të qeverisjes vendore;

- shumën dhe qëllimin e transfertës së kushtëzuar, që buxheti i shtetit jep për njësitë e qeverisjes vendore;

- taksat kombëtare, të ndara me qeverisjen vendore dhe pjesën e ndarë për tri vitet pasardhëse buxhetore.

6. Struktura përgjegjëse për parashikimet makroekonomike dhe fiskale është përgjegjëse në fazën e përgatitjes së dokumentit të PBA-së për përgatitjen e:

a) një përmbledhëse të treguesve kryesorë makroekonomikë dhe buxhetorë;

b) një raport përmbledhës të politikave ekonomike dhe fiskale për tri vitet e ardhshme.”.

5. Në nënkreun 2.4, “Përgjegjësitë e nëpunësit autorizues të njësisë së qeverisjes qendrore”, në pikën 6 shtohet shkronja p) me përmbajtje si më poshtë vijon:

“p) sigurimin që për secilin program buxhetor, në përgjegjësinë e tyre, aty ku është e mundur, të përfshijë një qëllim të politikës që adreson ndryshimet klimatike;”.

6. Në nënkreun 2.5, në pikën 5, shtohet shkronja “l”, me përmbajtje si më poshtë:

“l) Sigurimin që për secilin program buxhetor, në përgjegjësinë e tyre aty, ku është e mundur, të përfshijë një objektiv të politikës që adreson



ndryshimet klimatike. Këto objektiva duhet të jenë të shoqëruara me tregues të përshtatshëm dhe të matshëm performance, ku do të synohet që të identifikohen një ose disa produkte me kostot përkatëse që do të kontribuojnë në realizimin e tyre.”.

7. Në kreun 7 “Planifikimi i projekteve të investimeve publike”, shfuqizohen nënçështjet 7.1, 7.2 dhe 7.3, dhe zëvendësohen me fjalinë “Planifikimi i projekteve të investimeve publike dhe kostimi i tyre bëhet në përputhje me vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 887/2022, “Për procedurat e menaxhimit të investimeve publike”, i ndryshuar”.

8. Në kreun 8, në fund të shtojcës nr. 5 shtohen paragrafët:

“Analiza gjinore është:

- një dimension i pandashëm i analizës së politikave (socio-ekonomike);
- identifikon në mënyrë specifike se si politikat publike ndikojnë ndryshe tek gratë dhe burrat;
- tregon se politikat dhe zbatimi i tyre nuk mund të jenë neutralë nga perspektiva gjinore në shoqëritë e ndikuara nga gjinia;
- mbështetet nga mjete specifike analitike

Analiza gjinore përbën një shumëllojshmëri metodash të përdorura për të kuptuar marrëdhëniet midis burrave dhe grave, qasjen e tyre në burime, aktivitetet e tyre dhe kufizimet që ata përballen në raport me njëri-tjetrin. Analiza gjinore ofron informacion të rëndësishëm që na ndihmon të kuptojmë se si përkatësia gjinore, ndërthurur me racën, etninë, kulturën, klasën, moshën, aftësinë e kufizuar dhe/ose statuse të tjera, është e rëndësishme për të kuptuar modelet e ndryshme të përfshirjes, sjelljes dhe aktiviteteve që gratë dhe burrat kanë në strukturat ekonomike, sociale dhe ligjore.


Analiza gjinore përfshin:

- Njohjen e pabarazive historike dhe sociale me të cilat janë përballur gratë dhe synon të informojë hartimin e politikave, programeve dhe projekteve për të adresuar këto pabarazi;
- Marrjen në konsideratë të përvojave, roleve dhe përgjegjësisë të veçanta të grave, dhe nivelin e tyre të qasjes në burime dhe vendimmarrje.

Qëllimi është të sigurohet që perspektiva e barazisë gjinore të integrohet plotësisht në politika, programe dhe buxhete nëpërmjet instrumenteve që mundësojnë:

- të njihen dallimet gjinore;
- nevojat dhe përparësitë e ndryshme të grave dhe burrave, vajzave dhe djemve të identifikohen dhe të njihen;
- politikat publike të hartohen duke marrë parasysh këto dallime dhe përparësi;
- buxhetet publike të ndahen në përputhje me to;
- buxhetet publike të shpenzohen për të përmbushur nevojat e grave dhe burrave, vajzave dhe djemve në mënyrë që ata të përfitojnë njësoj nga fondet dhe shërbimet publike.

Hapat që duhet të ndiqen nga ekipet e menaxhimit të programeve për të përfshirë analizën gjinore dhe të dhënat e saj në hartimin e buxheteve trevjeçare:



9. Në kreun 8, pas shtojcës 7, shtohet shtojca nr. 8, “Udhëzime mbi integrimin e ndryshimeve klimatike në procesin e buxhetimit”, me përmbajtje si më poshtë:

“Ndryshimi i klimës i referohet zhvendosjeve apo ndryshimeve afatgjata në temperaturë, reshje, modele të erërave dhe aspekte të tjera të sistemit klimatik të Tokës. Kjo çon në ngrohjen globale, rritjen e niveleve të deteve, ngjarje më të shpeshta ekstreme të motit dhe ndërprerje në ekosisteme dhe biodiversitetin.

Për të lehtësuar dhe parandaluar ndikimet e ndryshimeve klimatike në ekosisteme e biodiversitetin qëllimi 13, i Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm (SDG), bën thirrje për veprime urgjente për të trajtuar ndryshimet klimatike dhe ndikimet e tyre, si më poshtë:

- Forcimi i qëndrueshmërisë dhe kapacitetit adaptues ndaj rreziqeve klimatike dhe fatkeqësive natyrore në të gjitha vendet;
- Integrimi i masave për ndryshimin e klimës në politikat, strategjitë dhe planet kombëtare;
- Përmirësimi i edukimit, ndërgjegjësimit dhe kapacitetit njerëzor dhe institucional për zbutjen e



ndryshimeve klimatike, adaptimin, reduktimin e ndikimit dhe paralajmërimin e hershëm;

- Zbatimi i Konventës Kuadër të OKB-së për Ndryshimet Klimatike; dhe

- Promovimi i mekanizmave për të rritur kapacitetin për planifikim dhe menaxhim.

Për këtë qëllim, është i domosdoshëm të kryhet integrimi i ndryshimeve klimatike, i cili i referohet përfshirjes së përshtatjes ndaj ndryshimeve klimatike në politikat e qeverisë në disa sektorë. Integrimi nënkupton që përshtatja ndaj ndryshimeve klimatike do të përfshihet drejtpërdrejt kur bëhet planifikimi për zhvillimin e qëndrueshëm dhe në zhvillimin e politikave sektoriale, si me poshtë:

- Çdo institucion buxhetor duhet të përfshijë në programet e tij buxhetore, aty ku është dhe për sa është e mundur, objektiva të qartë dhe tregues performance që tregojnë përpjekjet për të lehtësuar apo parandaluar ndikimet e ndryshimeve klimatike;

- Për të bërë të mundur këtë, institucionet e përfshira në aktivitete të ndryshimeve klimatike, duhet të mbledhin, mbajnë dhe përdorin të dhëna shkencore ose administrative që ndihmojnë në hartimin e objektivave dhe treguesve SMART, për matjen e performancës së përpjekjeve të tyre në lehtësimin/parandalimin e ndikimeve të ndryshimeve klimatike;

- Ekipet e menaxhimit të programeve duhet të diskutojnë dhe vendosin për përcaktimin e të paktën një objekti të lidhur me ndryshimet klimatike, aty ku dhe kur është e mundur.”.

Udhëzimi hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I FINANCAVE
Petrit Malaj

UDHËZIM
Nr. 198, datë 18.10.2024

**PËR PROCEDURAT PËR PAJISJEN ME
AUTORIZIM PËR VEPRIMTARINË E
LEJUAR ME ARMË, REGJISTRIMIN E
ARMËS, ADMINISTRIMIN E GËZHOJËS
NË NJË BANKË TË DHËNASH DHE
PROCEDURAT QË KRYHEN PAS
DORËZIMIT NË POLICINË
SHKENCORE**

Në mbështetje të nenit 102, të Kushtetutës, të nenit 11, pika 2, të nenit 22, shkronja “dh”, të nenit

Faqe | 20592

34, pika 2, të ligjit nr. 74, datë 10.7.2014, “Për armët”, të ndryshuar,

UDHËZOJ:

KREU I
PROCEDURAT, DOKUMENTACIONI DHE
AFATET E SHQYRTIMIT PËR PAJISJEN
ME AUTORIZIM PËR ARMË TË
PERSONAVE JURIDIKË E FIZIKË

A. Të përgjithshme

1. Autorizimi për veprimtarinë e lejuar me armët është akti administrativ që i lëshohet personit juridik ose fizik nga Policia e Shtetit për blerje/mbajtje arme, pjesë arme dhe municionet përkatëse, në përputhje me kushtet e përcaktuara në të.

2. Autorizimet që lëshon organi përgjegjës i Policisë së Shtetit janë:

- autorizim për blerje arme;
- autorizim për mbajtje arme;
- autorizim për përdorim skenik të armës;
- autorizim për koleksionim armësh.

3. Autorizimi për blerje arme ndahet në:

- autorizim për personat fizikë;
- autorizim për personat juridikë.

4. Autorizimi për mbajtjen e armës ndahet në:

a) autorizim për mbajtjen e armës së zjarrit në vendbanim;

b) autorizim i posaçëm për mbajtje arme;

c) autorizim për mbajtje arme gjahu, sportive dhe armë të tjera të këtij lloji;

ç) autorizim për mbajtjen e armës së zjarrit në shërbim dhe në lëvizje;

5. Kanë të drejtë të pajisen me autorizim për blerje arme, personat fizikë si më poshtë:

a) personat që plotësojnë kriteret për pajisjen me autorizim, sipas nenit 34, të ligjit nr. 74/2014, “Për armët”, i ndryshuar;

b) personat që u njihet e drejta e mbajtjes së armës me ligj të veçantë;

c) personat që vërtetojnë qenien e tyre si koleksionistë;

ç) personat që për shkak të veprimtarisë shtetërore ose të rrethanave personale të veçanta, janë të ekspozuar ndaj rrezikut për jetën dhe u njihet e drejta e mbrojtjes së veçantë, sipas legjislacionit në fuqi;

d) qitësit sportivë;

dh) gjuetarët.



6. Kanë të drejtë të pajisen me autorizim për blerje/mbajtje arme zjarri e municionet përkatëse, në përputhje me përcaktimet ligjore, persona juridikë:

- a) subjektet e licencuara për shërbimin e sigurisë private;
- b) subjektet e licencuara për poligon civil qitjeje;
- c) Autoriteti Portual për sigurinë e porteve;
- ç) Banka e Shqipërisë për sigurinë e brendshme;
- d) subjektet që vërtetojnë qenien e tyre si koleksionistë;
- dh) subjektet juridike publike, të cilave me ligj të veçantë u jepet e drejta e mbajtjes së armës.

7. Autorizimet për veprimtarinë e lejuar me armët lëshohen për një afat 5-vjeçar (pesëvjeçar), me të drejtë ripërtëritje, përveç rasteve ku është përcaktuar ndryshe, si:

- a) autorizimit të posaçëm për mbajtje arme zjarri, i cili lëshohet nga DREJTOR I PËRGJITHSHËM I POLICISË SË SHETËTIT, me afat vlefshmërie bazuar në vlerësimin e ekzistencës së kërcënimit dhe rrezikut për jetën;
- b) autorizimi ditor për ushtrimin e veprimtarisë së qitjes sportive, apo për shkak të kryerjes së shërbimeve teknike të riparimeve të armës;
- c) autorizim të përkohshëm për shtetasit e huaj.

8. Kanë të drejtë të pajisen me autorizim të përkohshëm për mbajtje arme, autoritetet e huaja, mbi bazën e përcaktimeve ligjore, marrëveshjeve ndërkombëtare dhe parimit të reciprocitetit.

B. Procedurat dhe afatet e shqyrtimit për pajisjen me autorizim për armë të personave fizikë/juridikë

1. Procedurat për pajisjen me autorizim për blerje/mbajtje arme, ndahen në procedura për persona fizikë dhe në procedura për persona juridikë.

2. Personi fizik ose juridik, privat/publik, shtetasi shqiptar ose shtetasi i huaj rezident në Republikën e Shqipërisë, që kërkon të pajiset me autorizim të lëshuar nga Policia e Shtetit, sipas përcaktimeve të ligjit nr. 74, datë 10.7.2014, “Për armët”, të ndryshuar, aplikon në portalin unik qeveritar *e-Albania*, dhe dorëzon në formë elektronike dokumentacionin e përcaktuar në kreun II të këtij udhëzimi.

Krahas dokumentacionit të dorëzuar në rrugë elektronike, aplikanti dërgon edhe në rrugë postare dokumentacionin në origjinal ose të njëjësuar me të si:

a) certifikatë mjekësore për veprimtarinë e lejuara me armët, sipas udhëzimit në fuqi për llojet e vizitave dhe përmbajtjen e raportit mjekësor për veprimtarinë me armët, lëshuar nga autoriteti përkatës, brenda 6 (gjashtë) muajve të fundit, që vërteton se është i aftë nga ana mendore dhe fizike;

b) dëshminë “Për aftësimin teorik dhe praktik për përdorimin e armës”.

3. Struktura përgjegjëse në Policinë e Shtetit për pranimin e aplikimeve për pajisje me autorizim, është Zyra e Shërbimeve për Qytetarët (ZSHQ), e cila është e vendosur në komisaritet e policisë.

Punonjësi i ZSHQ-së është përgjegjës për verifikimin e aplikimeve ditore në portalin unik qeveritar *e-Albania*, si dhe për administrimin e dokumentacionit shoqërues të aplikimit, origjinal apo të njëjësuar me të.

3.1 Zyra e Shërbimit për Qytetarët në Komisaritetin e Policisë pranon aplikimin, shqyrton nga ana formale nëse dokumentacioni i paraqitur është në përputhje me kërkesat ligjore/nënligjore.

Në rast se punonjësi i ZSHQ-së konstaton se dokumentacioni i bashkëngjitur në sistem nuk është konform akteve ligjore/nënligjore, i komunikon nëpërmjet portalit *e-Albania* aplikuesit problemet e konstatuara, me qëllim korrigjimin e tyre dhe plotësimin e dosjes me gjithë dokumentacionin e duhur.

3.2 Punonjësi i ZSHQ-së, nxjerr nga sistemet ku Policia e Shtetit ka akses, certifikatat familjare dhe dëshmitë e penalitetit dhe ia bashkëngjijt dosjes së aplikantit, si dhe kërkon nga institucionet e tjera dokumente me nënshkrim elektronik nëpërmjet sistemit të SQDNE-së.

3.3 Punonjësi i ZSHQ-së pas inventarizimit të dokumentacionit kryen regjistrimin e aplikimit në regjistrin e shërbimit ndaj qytetarëve, sipas rubrikave përkatëse dhe brenda ditës bën regjistrimin e dosjes së aplikimit në sekretarinë e Komisaritetit të Policisë.

4. Dokumentacioni i regjistruar i kalon për procedurë strukturës përkatëse në Komisaritetin e Policisë, e cila bën verifikimin dhe plotësimin me dokumente plotësuese, si: dokumentin e vërtetimit të besueshmërisë, verifikimin e shlyerjes së gjobave për kundërvajtjet administrative (nëse ka), verifikimin e revokimit të autorizimit me një afat jo më të vogël se 3 (tre) vjet, aktin e konstatimit për verifikimin e masave për sigurimin e armës në vendbanim (për kërkesat e aplikantëve për pajisje me autorizim për blerje/mbajtje arme zjarri e



municionet përkatëse), si dhe dërgon dosjen e plotësuar në strukturën përkatëse në Drejtorinë Vendore të Policisë.

4.1 Për kërkesat e aplikantëve për pajisje me autorizim të posaçëm për blerje/mbajtje arme zjarri e municionet përkatëse për në lëvizje, dokumentacioni i vërtetimit të besueshmërisë dhe relacioni për rrezikshmërinë e jetës së aplikantit, duhet të përgatitet me përparësi dhe të përcillet nga Komisariati i Policisë në DVP.

5. Struktura përkatëse për shërbimin ndaj të tretëve në Drejtorinë Vendore të Policisë, pasi vlerëson dokumentacionin nëse është i plotësuar në përputhje me kërkesat ligjore, përgatit relacionin vlerësues, ku shpreh mendimin e saj mbi plotësimin ose jo të kriterëve ligjore për pajisjen me autorizim të aplikantit dhe e përcjell për shqyrtim në komisionin përkatës vendor/qendror të ngritur sipas kompetencave për lëshimin e autorizimit, mbi bazën e llojit të armës që do të blihet/mbahet.

6. Për shqyrtimin e kërkesave për pajisje me autorizim për blerje arme të kategorisë B dhe të kategorisë C2 me vjaska, komisioni qendror ngrihet dhe funksionon pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit, ndërsa për blerje arme të kategorisë C e D, si dhe armë të tjera të këtij lloji që njihen si të tilla nga aktet ndërkombëtare të ratifikuara me ligj, komisioni vendor ngrihet dhe funksionon në Drejtorinë Vendore të Policisë.

6.1 Pas shqyrtimit të dokumentacionit, komisioni përkatës përgatit vendimin dhe ia paraqet për nënshkrim drejtorit të përgjithshëm të Policisë së Shtetit/drejtorit të Drejtorisë Vendore të Policisë.

7. Struktura e Shërbimit ndaj të Tretëve në Drejtorinë e Rendit Publik, në Departamentin për Sigurinë Publike, në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit, administron dokumentacionin e dërguar nga drejtoritë vendore të policisë kryen verifikimet mbi dokumentacionin e paraqitur dhe nëse dokumentacioni është me mangësi, kërkon plotësimin e tij nga strukturat përkatëse në DVP.

7.1 Struktura e Shërbimit ndaj të Tretëve kërkon verifikime plotësuese pranë Departamentit të Policisë Kriminale për aplikantin, nëse është i evidentuar ose jo për veprimtari kriminale dhe me marrjen e përgjigjes, përgatit relacionin vlerësues dhe e paraqet dosjen për shqyrtim në Komisionin Qendror për veprimtarinë e lejuar me armët, i cili mblidhet jo më pak se 2 (dy) herë në muaj.

Për kërkesat e aplikantëve për pajisje me autorizim të posaçëm për blerje arme zjarri e municionet përkatëse për në lëvizje, dokumentacioni duhet të shqyrtohet nga Komisioni Qendror brenda afatit 10 ditor nga aplikimi.

7.2 Për kërkesat e aplikantëve për pajisje me autorizim për blerje arme zjarri e municionet përkatëse për në vendbanim, si dhe armë gjahu me vjaska, dokumentacioni duhet të shqyrtohet nga Komisioni Qendror brenda afatit 60-ditor nga aplikimi.

8. DREJTOR I PËRGJITHSHËM I POLICISË SË SHËTETIT, miraton pajisjen/refuzimin me autorizim për blerje arme të kategorisë B dhe C2 me vjaska të personave fizikë/juridikë, bazuar në propozimin e Komisionit Qendror për veprimtarinë e lejuar me armët.

9. Drejtori i Drejtorisë Vendore të Policisë, miraton pajisjen/refuzimin me autorizim të kategorisë C dhe D dhe armë të tjera të ndryshme nga armët e zjarrit, për të cilat kërkohet autorizim, të personave fizikë/juridikë, bazuar në propozimin e Komisionit Vendor për dhënien e autorizimeve për veprimtarinë e lejuar me armët.

10. Përbërja, detyrat dhe mënyra e funksionimit e komisionit përgjegjës për pajisjen e subjekteve me autorizim për veprimtarinë e lejuar me armët, përcaktohet me urdhër të ministrit të Brendshëm.

11. Akti i miratimit/refuzimit të autorizimit prodhohet në dy kopje, ku njëra i përcillet DVP/Komisariatit të Policisë, ku aplikanti ka vendbanimin dhe është administruar kërkesa, kurse kopja e dytë, së bashku me dokumentet që kanë shërbyer për pajisjen me autorizim, mbahet në sekretarinë e DVP/Departamentit për Sigurinë Publike.

12. Refuzimi i dhënies së autorizimit, bëhet me vendim të arsyetuar të Komisionit për veprimtarinë e lejuar me armët. Në çdo rast vendimi i refuzimit të dhënies së autorizimit arsyetohet në përputhje me përcaktimet e Kodit të Procedurës Administrative.

13. Komisariati i Policisë që ka pranuar aplikimin *online*, pasi merr aktin e miratimit/refuzimit të autorizimit nga DVP-ja, përfundon procedurën e ofrimit të shërbimit *online* nga Policia e Shtetit dhe ia përcjell aktin aplikuesit nëpërmjet portalit unik qeveritar *e-Albania*, kundrejt mandatpagesës të ngarkuar në sistem.

14. Pas përfundimit të afatit 5-vjeçar të autorizimit për mbajtjen e armës, personit fizik apo



juridik i lind e drejta të pajiset me autorizim të ri për mbajtje arme.

15. Procedurat për ripërtëritjen e autorizimit për mbajtje arme të personave fizikë/juridikë, është e njëjtë me procedurën që kryhet për rastet e aplikimit për blerje arme.

16. Kërkesa për ripërtëritje të autorizimit bëhet 90 (nëntëdhjetë) ditë para përfundimit të afatit të vlefshmërisë së autorizimit që ka në përdorim personi fizik ose juridik.

17. Mosparaqitja e kërkesës për ripërtëritjen e autorizimit brenda afatit 90-ditor para përfundimit të afatit të vlefshmërisë, sjell mosripërtëritjen e tij, si dhe detyrimin për bllokimin e armës nga Komisariati i Policisë ku personi ka vendbanimin.

18. Afatet e shqyrtimit për pajisjen me autorizim për armë të subjekteve juridikë e fizikë janë:

a) afati i lëshimit të autorizimit për blerje arme zjarri të kategorisë B dhe C2 me vjaska është 60 ditë nga dita e aplikimit;

b) afati i lëshimit të autorizimit për blerje arme gjahu/sportive/armë të ftohta, si dhe armë të tjera të këtij lloji, që njihen si të tilla nga aktet ndërkombëtare të ratifikuara me ligj, është 30 ditë nga dita e aplikimit;

c) autorizimi për mbajtje arme zjarri/gjahu/sportive/të ftohta, lëshohet brenda 15 ditëve nga dorëzimi i dokumenteve të blerjes së armës;

ç) ripërtëritja e autorizimit për mbajtje arme zjarri, arme gjahu/të ftohta, si dhe armë të këtij lloji që do të njihen si të tilla nga aktet ndërkombëtare të ratifikuara me ligj, bëhet brenda 30 ditëve nga dita e aplikimit.

19. Në rastet e ndryshimit të kriterëve e kushteve ligjore për mbajtjen e armës të personit fizik/juridik të pajisur me autorizim nga Policia e Shtetit, struktura përgjegjëse e policisë që bën konstatimin, merr masa për bllokimin e armës së brezit/gjahut dhe armëve të tjera të dhëna në zbatim të ligjit nr. 74/2014, “Për armët”, të ndryshuar, bën magazinimin e armës, përpilon dokumentacionin përkatës dhe e paraqet për shqyrtim në Komisionin Vendor pranë Drejtorisë Vendore të Policisë.

20. Komisionin Vendor për dhënien e autorizimeve për veprimtarinë e lejuar me armët, bën shqyrtimin e dokumentacionit brenda 30 ditëve nga momenti i bllokimit të armës dhe merr vendimin për shfuqizimin e autorizimit të mbajtjes

së armës, të cilin ia bën me dije me shkrim personit fizik/juridik brenda 5 ditëve nga marrja e vendimit.

KREU II

DOKUMENTACIONI QË DORËZOJNË PERSONAT FIZIKË E JURIDIKË PËR T’U PAJISUR ME AUTORIZIM PËR BLERJE/ MBAJTJE ARME ZJARRI, PJESË TË TYRE DHE MUNICION NË ORGANIN PËRKATËS TË POLICISË

A. Autorizim për blerje/mbajtje arme nga personat fizikë

1. Për t’u pajisur me autorizim për blerje arme zjarri, pjesë të tyre dhe municion përkatës për në vendbanim, personat fizikë duhet të aplikojnë *online* në portalin unik qeveritar *e-Albania*, të plotësojnë të dhënat specifike në formularin elektronik të aplikimit, si dhe të ngarkojnë dokumentacionin e përcaktuar, si më poshtë:

a) Certifikatë mjekësore për veprimtaritë e lejuara me armët, sipas udhëzimit në fuqi për llojet e vizitave dhe përmbajtjen e raportit mjekësor për veprimtaritë me armët, lëshuar nga autoriteti përkatës, brenda 6 (gjashtë) muajve të fundit, që vërteton se është i aftë nga ana mendore dhe fizike (përfshihen shtetasit të cilët janë të punësuar në struktura shtetërore të armatosura);

b) Dëshmi “Për aftësimin teorik dhe praktik për përdorimin e armës” (përfshihen shtetasit të cilët kanë qenë apo janë të punësuar në struktura shtetërore të armatosura);

c) Akti i pronësisë së banesës ose kontrata e zënies me qira të banesës;

2. Për t’u pajisur me autorizim të posaçëm për blerje arme e municionet përkatëse, personat fizikë, që për shkak të veprimtarisë shtetërore ose të rrethanave personale të veçanta janë të ekspozuar ndaj rrezikut për jetën, duhet të aplikojnë *online* në portalin unik qeveritar *e-Albania*, të plotësojnë të dhënat specifike në formularin elektronik të aplikimit: deklaratë e rrezikut për jetën dhe shpjegimi i arsyeve përkatëse për pajisje me autorizim të posaçëm, kopje kallëzimi nëse ka, vërtetim nga institucioni ku punon (rrezikshmëria për shkak të funksionit që kryen), si dhe ngarkojnë dokumentacionin e përcaktuar:

a) Certifikatë mjekësore për veprimtaritë e lejuara me armët, sipas udhëzimit në fuqi për llojet e vizitave dhe përmbajtjen e raportit mjekësor për



veprimtaritë me armët, lëshuar nga autoriteti përkatës, brenda 6 (gjashtë) muajve të fundit, që vërteton se është i aftë nga ana mendore dhe fizike;

b) Dëshmi “Për aftësimin teorik dhe praktik për përdorimin e armës” (përfshihen nga germa “d” shtetasit të cilët kanë qenë apo janë të punësuar në struktura shtetërore të armatosura);

3. Për t’u pajisur me autorizim për blerje arme gjahu e sportive, pjesë të tyre dhe municion përkatës, personat fizikë që plotësojnë kriteret e ligjit për pajisjen me armë, duhet të aplikojnë *online* në portalin unik qeveritar *e-Albania*, të plotësojnë të dhënat specifike në formularin elektronik të aplikimit, si dhe të ngarkojnë dokumentacionin e përcaktuar si më poshtë:

a) Certifikatë mjekësore për veprimtaritë e lejuara me armët, sipas udhëzimit në fuqi për llojet e vizitave dhe përmbajtjen e raportit mjekësor për veprimtaritë me armët, lëshuar nga autoriteti përkatës, brenda 6 (gjashtë) muajve të fundit, që vërteton se është i aftë nga ana mendore dhe fizike (përfshihen shtetasit të cilët janë të punësuar në struktura shtetërore të armatosura);

b) Dëshmi “Për aftësimin teorik dhe praktik për përdorimin e armës” (përfshihen shtetasit të cilët kanë qenë apo janë të punësuar në struktura shtetërore të armatosura);

4. Për t’u pajisur me autorizim për blerje arme me vjaska gjatë/sportive pjesë të tyre dhe municion përkatës, personat fizikë/juridikë duhet të aplikojnë *online* në portalin unik qeveritar *e-Albania*, plotësojnë të dhënat specifike në formularin elektronik të aplikimit, si dhe të ngarkojnë dokumentacionin e përcaktuar si më poshtë:

a) vërtetimin anëtarësie nga Federata Kombëtare Shqiptare për Gjueti dhe Konservim ose nga Federata Shqiptare e Qitjes Sportive;

b) certifikatë mjekësore për veprimtaritë e lejuara me armët, sipas udhëzimit në fuqi për llojet e vizitave dhe përmbajtjen e raportit mjekësor për veprimtaritë me armët, lëshuar nga autoriteti përkatës, brenda 6 (gjashtë) muajve të fundit, që vërteton se është i aftë nga ana mendore dhe fizike (përfshihen shtetasit të cilët janë të punësuar në struktura shtetërore të armatosura);

c) Dëshmi “Për aftësimin teorik dhe praktik për përdorimin e armës” (përfshihen shtetasit të cilët kanë qenë apo janë të punësuar në struktura shtetërore të armatosura).

5. Personat të cilët janë mbajtës të armëve të kategorive B, që kërkojnë të blejnë një armë të kategorisë C apo D apo një lloj tjetër arme, duhet të aplikojnë *online* në portalin unik qeveritar *e-Albania*, të plotësojnë të dhënat specifike në formularin elektronik.

6. Personi i pajisur me autorizim për mbajtje arme gjahu, në rastet kur kërkon të blejë një armë gjahu tjetër, paraqet *online*, në portalin unik qeveritar *e-Albania*, të gjithë dokumentet e përcaktuara në pikën 3 të këtij udhëzimi.

7. Shtetasit e punësuar në struktura shtetërore të armatosura, që u njihet e drejta e mbajtjes së armës me ligj të veçantë, në rastet kur kërkojnë të pajisen me autorizim për blerje arme të kategorive B, C dhe D, apo një lloj tjetër arme, duhet të aplikojnë në portalin unik qeveritar *e-Albania*, të plotësojnë të dhënat specifike në formularin elektronik të aplikimit, si dhe të ngarkojnë dokumentacionin e përcaktuar si më poshtë:

a) vërtetim nga institucioni ku ai kryen detyrën;

b) Dëshmi “Për aftësimin teorik dhe praktik për përdorimin e armës” (përfshihen shtetasit të cilët kanë qenë apo janë të punësuar në struktura shtetërore të armatosura).

8. Shtetasi i huaj, rezident në Republikën e Shqipërisë, për të blerë armë të kategorisë B/C, në vendin tonë, duhet të aplikojë në portalin unik qeveritar *e-Albania*, të plotësojë të dhënat specifike në formularin elektronik të aplikimit, si dhe ngarkojë dokumentacionin e përcaktuar si më poshtë:

a) fotokopje të pasaportës;

b) fotografi personale të 6 (gjashtë) muajve të fundit, 4 copë;

c) kopje e autorizimit për mbajtje të armës, të shtetit të tij;

ç) miratimi i shtetit të origjinës për blerjen e armëve të zjarrit të kategorisë B/C.

Një autorizim i tillë i jepet një shtetasi të huaj rezident me miratimin paraprak të vendit të tij.

Dokumentet e huaja duhet të jenë me vullë apostile ose të legalizuara.

9. Dokumentacioni që dorëzojnë personat fizikë që janë të punësuar pranë subjekteve juridikë, për t’u pajisur me autorizim për mbajtje arme zjarri dhe municione në shërbim, ndjek këtë procedurë:

Drejtuesi teknik, punonjësi i shërbimit në SHPSF, punonjësi në port, në poligon qitje, në subjekt të aftësimit teorik, në bankë, për t’u pajisur me armë nga subjekti, duhet t’u miratohet e drejta e



mbajtjes së armës së zjarrit në organin përgjegjës të policisë ku ka vendbanimin. Aplikimi kryhet *online* në portalin unik qeveritar *e-Albania* duke ngarkuar dokumentet si më poshtë:

a) vërtetim nga subjekti ku ai kryen detyrën/institucionin;

b) certifikatë mjekësore për veprimtaritë e lejuara me armët, sipas udhëzimit në fuqi për llojet e vizitave dhe përmbajtjen e raportit mjekësor për veprimtaritë me armët, lëshuar nga autoriteti përkatës, brenda 6 (gjashtë) muajve të fundit, që vërteton se është i aftë nga ana mendore dhe fizike;

c) fotografi personale të 6 (gjashtë) muajve të fundit: 4 copë;

ç) dëshminë “Për aftësimin teorik dhe praktik për përdorimin e armës”;

d) përjashtohen nga germa “d”, shtetasit të cilët kanë qenë apo janë të punësuar në struktura shtetërore të armatosura;

dh) mandate pagesash.

B. Personat juridikë

1. Subjekti i licencuar për Shërbimin Privat të Sigurisë Fizike për t’u pajisur me autorizim për blerje arme zjarri, pjesë të tyre dhe municion përkatës, duhet të aplikojë *online* në portalin unik qeveritar *e-Albania*, të ngarkojë dokumentacionin e përcaktuar (mandatpagesë), si dhe të plotësojë të dhënat specifike në formularin elektronik të aplikimit, në të cilin të përcaktohet:

a) lloji/kategoria e armëve;

b) numri i armëve dhe i municionit;

c) emri i personit përgjegjës të SHPSF-së/drejtuesit teknik për administrimin e armëve.

2. Subjekti i licencuar për poligon civil qitjeje për t’u pajisur me autorizim për blerje arme zjarri, pjesë të tyre dhe municion përkatës, duhet të aplikojë *online* në portalin unik qeveritar *e-Albania*, të ngarkojë dokumentacionin e përcaktuar (mandatpagesë), si dhe të plotësojë të dhënat specifike në formularin elektronik të aplikimit në të cilin të përcaktohet:

a) lloji/kategoria e armëve;

b) numri i armëve dhe i municionit;

c) emrin e personit përgjegjës/drejtuesit teknik për administrimin e armëve.

3. Autoriteti portual dhe Banka e Shqipërisë, për t’u pajisur me autorizim për blerje arme zjarri, pjesë të tyre dhe municionin përkatës, duhet të aplikojë *online* në portalin unik qeveritar *e-Albania*, të ngarkojë dokumentacionin e përcaktuar (dëshmi e kursit të aftësimit teorik dhe praktik për përdorimin e armës,

mandatpagesë), si dhe të plotësojë të dhënat specifike në formularin elektronik të aplikimit, në të cilin të përcaktohet:

a) lloji/kategoria e armëve;

b) numri i armëve dhe municionit;

c) emri i personit përgjegjës për administrimin e armëve, të pajisur me dëshminë për kryerjen e kursit të aftësimit teorik dhe praktik për përdorimin e armës;

4. Subjektet juridike publike, të cilave me ligj të veçantë iu jepet e drejta e mbajtjes së armës, në rastin kur armën do ta blejë institucioni, duhet të aplikojnë *online* në portalin unik qeveritar *e-Albania*, të ngarkojnë dokumentacionin e përcaktuar (mandatpagesë), si dhe të plotësojnë të dhënat specifike në formularin elektronik të aplikimit në të cilin të përcaktohet:

a) lloji/kategoria e armëve;

b) numri i armëve dhe i municionit;

c) emri i personit përgjegjës për administrimin e armëve, të pajisur me dëshminë për kryerjen e kursit të aftësimit teorik dhe praktik për përdorimin e armëve.

5. Federatat sportive të qitjes sportive, për t’u pajisur me autorizim për blerje të armëve sportive duhet të aplikojnë *online* në portalin unik qeveritar *e-Albania*, të ngarkojnë dokumentacionin e përcaktuar (mandatpagesë), si dhe të plotësojnë të dhënat specifike në formularin elektronik të aplikimit në të cilin të përcaktohet:

a) lloji i armëve me të dhënat identifikuese;

b) numri i armëve e i municionit;

c) emri i personit përgjegjës për administrimin e armëve, të pajisur me dëshminë për kryerjen e kursit të aftësimit teorik dhe praktik për përdorimin e armës.

6. Subjekti për t’u pajisur me autorizim për import të armëve të gjahut dhe sportive, pjesëve kryesore dhe municioneve të tyre, duhet të aplikojë *online* në portalin unik qeveritar *e-Albania*, të ngarkojë deklaratën paraprake që ka lidhur me subjektin ku ka porositur për të blerë armë, pjesë të tyre dhe municion, të identifikuara specifikisht me: kategori, model, numër dhe sasi, si dhe të plotësojë të dhënat specifike në formularin elektronik të aplikimit, në të cilin të përcaktohet:

a) emri i subjektit të licencuar për veprimtarinë e import-tregtimit të armëve të kategorisë C dhe D;

b) vendin nga ku do të kryhet importi;



c) vendi eksportues të ketë autorizuar importin përkatës;

ç) vendin ose vendet e treta nga të cilat armët do të kalojnë tranzit;

d) njoftimin me shkrim nga vendet e treta të tranzitit, nëse ka, se nuk kanë asnjë kundërshtim në lidhje me tranzitin;

dh) kohën e dërgesës;

e) të dhënat e identifikimit të armëve të kategorisë C dhe D, si dhe sasinë e armëve;

ë) të dhënat e identifikimit pjesëve dhe të komponentëve kryesorë të tyre, si dhe sasinë e tyre;

f) sasinë e municioneve, llojin e tyre;

g) markimin e vendosur në armët e zjarrit;

gj) marrësin;

h) përdoruesin fundor, nëse dihet në kohën e dërgesës;

i) emri i personit përgjegjës për administrimin e armëve.

7. Autorizimi për koleksionim armësh të kategorive B e C, që plotësojnë kriteret për t'u quajtur armë zjarri dhe që plotësojnë kriteret e armëve për koleksion, lëshohet në favor të subjekteve të njohura për këtë qëllim.

Subjektet koleksionistë, për t'u pajisur me autorizim, duhet të aplikojnë *online* në portalin unik qeveritar *e-Albania*, të ngarkojnë dokumentacionin e përcaktuar (kopje të dokumentit që e njeh si koleksionist, mandatpagesë), si dhe të plotësojnë të dhënat specifike në formularin elektronik të aplikimit në të cilën të përcaktojnë llojin/kategorinë e armëve, tipin, kalibrin, modelin, fabrikën e prodhimit të armës ose të dhëna të tjera, të shoqëruara me fotografi, ku të dallohet numri serial i armës.

8. Pajisja me autorizim për përdorim skenik dhe kinematografik të armës nga personat juridikë në vendin tonë, bëhet nëpërmjet aplikimit në portalin unik qeveritar *e-Albania*, plotësimit të të dhënave specifike në formularin elektronik të aplikimit, në lidhje me arsyen për përdorimin e armës, data e fillimit të përdorimit, së bashku me numrin e armëve, data e përfundimit të përdorimit të tyre, personi përgjegjës për armët i përcaktuar nga subjekti juridik kërkues, institucioni/subjekti i licencuar për veprimtari me armët/SHPSF, ku do të merrem armët për përdorim, si dhe e ngarkimit të dokumentacionit si më poshtë:

a) autorizim nga subjekti juridik kërkues për personin përgjegjës për sigurinë e armëve;

b) kontratë me subjektin ku do të merren në përdorim armët;

c) mandatpagesë.

9. Për ripërtëritjen e autorizimit për mbajtjen e armës, duhet të aplikojë në portalin unik qeveritar *e-Albania*, të plotësojë të dhënat specifike në formularin elektronik të aplikimit, si dhe ngarkojë dokumentacionin e përcaktuar si më poshtë:

a) certifikatë mjekësore për veprimtaritë e lejuara me armët, sipas udhëzimit në fuqi për llojet e vizitave dhe përmbajtjen e raportit mjekësor për veprimtaritë me armët, lëshuar nga autoriteti përkatës, brenda 6 (gjashtë) muajve të fundit, që vërteton se është i aftë nga ana mendore dhe fizike (përjashtohen shtetasit të cilët janë të punësuar në struktura shtetërore të armatosura);

b) fotografi personale të shtetasit/personit fizik, tregtarit të pajisur me NUIS/administratorit të personit juridik të pajisur me NUIS, të 6 (gjashtë) muajve të fundit: 2 copë;

c) mandatpagesë.

KREU III

PROCEDURAT DHE DOKUMENTET PËR PAJISJEN ME AUTORIZIM TË PÛRKOHSHËM PËR MBAJTJE ARME

1. Autoritetet e huaja, për t'u pajisur me autorizim të përkohshëm për mbajtje të armës së zjarrit në vendin tonë, mbi bazën e marrëveshjeve ndërkombëtare dhe të parimit të reciprocitetit, duhet të aplikojnë *nëpërmjet Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe strukturave me të cilat kanë marrëveshje bashkëpunimi*, të plotësojë dokumentacionin e përcaktuar si më poshtë:

a) kërkesë për t'u pajisur me autorizim provizor mbajtjeje arme në rezidencë të personit fizik;

b) vërtetim me të dhënat e plota të personit fizik dhe detyra që kryen;

c) të dhënat e armës së zjarrit, lloji, kategoria që do të mbajë;

ç) fotografi 2 copë.

I njëjti dokumentacion plotësohet edhe nga shtetas shqiptarë të punësuar mbi bazën e kontratës së punës me këto autoritete, që plotësojnë kriteret për mbajtje arme.

2. Shtetasit e huaj, të cilët kërkojnë të pajisen me autorizim të përkohshëm për mbajtje të armës së gjahut në vendin tonë, duhet të aplikojnë në portalin unik qeveritar *e-Albania*, të plotësojnë të dhënat



specifike në formularin elektronik të aplikimit, si dhe ngarkojnë dokumentacionin e përcaktuar, si më poshtë:

- a) fotokopje të pasaportës;
- b) fotografi personale të 6 (gjashtë) muajve të fundit: 4 copë;
- c) kopje të lejes së qëndrimit në Republikën e Shqipërisë;
- ç) kopje të autorizimit për mbajtje arme gjahu, me vulë apostile, ose të legalizuar.

3. Personat juridikë dhe fizikë shqiptarë dhe të huaj, për t'u pajisur me autorizim të përkohshëm për hyrje-dalje në Republikën e Shqipërisë me armë gjahu dhe municione për gjueti, për veprimtarinë e gjuetisë turistike, duhet të aplikojnë në portalin unik qeveritar *e-Albania*, duke ngarkuar dokumentacionin e përcaktuar si më poshtë:

- a) deklarata e posaçme që identifikon saktë personat dhe armët e gjahut;
- b) ftesën nga subjekti legjitim për pjesëmarrje në një veprimtari gjuetie turistike;
- c) autorizimit për mbajtje arme gjahu (me vulë apostile, ose të legalizuar për personat e huaj);
- ç) mandatpagesë.

Si dhe të plotësojnë të dhënat specifike në formularin elektronik të aplikimit ku të përcaktohen:

- personat pjesëmarrës;
- armët me të dhënat identifikuese;
- koha, pika kufitare hyrje-dalje nga RSH-ja;
- vendi ku do të zhvillohet veprimtaria;
- vërtetim i shoqatës/federatës ku është anëtar.

4. Për pajisjen me autorizim të përkohshëm për federatat e qitjeve sportive, subjektet e licencuara, të huaja, për të hyrë apo tranzit nëpërmjet vendin tonë me armë sportive/gjahu dhe municionet e tyre, duhet të aplikojnë në portalin unik qeveritar *e-Albania*, duke ngarkuar dokumentacionin e përcaktuar si më poshtë:

- a) deklarata e posaçme që identifikon saktë personat dhe armët e gjahut;
- b) fotokopje dokumenti identifikimi;
- c) autorizimi për mbajtje arme gjahu;
- ç) ftesën nga subjekti legjitim për pjesëmarrje në një veprimtari gjuetie turistike.

Si dhe të plotësojnë të dhënat specifike në formularin elektronik të aplikimit, ku të përcaktohet:

- personat pjesëmarrës;
- armët me të dhënat identifikuese;
- vendi ku do të zhvillohet veprimtaria;
- koha, pika kufitare hyrje-dalje nga RSH-ja.

5. Personat juridikë dhe fizikë për t'u pajisur me autorizim ditor për ushtrimin e veprimtarisë së qitjes sportive, apo për shkak të kryerjes së shërbimeve teknike të riparimeve të armës pranë subjekteve të autorizuara për këtë qëllim, sipas legjislacionit në fuqi, duhet të aplikojnë në portalin unik qeveritar *e-Albania*, të plotësojnë të dhënat specifike në formularin elektronik të aplikimit, ku të përcaktohet saktë:

- a) data dhe itinerari i lëvizjes;
- b) ora e saktë;
- c) poligoni ku do të kryhet qitja sportive;
- ç) subjekti ku do të marrë shërbimin me armë;
- d) çdo e dhënë tjetër e vlefshme.

6. Formatet e autorizimeve për blerje arme i bashkëlidhen këtij udhëzimi dhe janë pjesë përbërëse e tij:

a) autorizim për blerje arme zjarri të kategorisë B – model 1;

b) autorizim për blerje arme të kategorisë C/D gjahu/sportive dhe armë të këtij lloji, që njihen si të tilla nga aktet ndërkombëtare të ratifikuara me ligj – model 2;

c) autorizim për blerje arme zjarri të kategorisë C2, me vjaska – model 3;

ç) autorizim i posaçëm për blerje arme zjarri – model 4;

d) autorizim për blerje arme zjarri për personat juridikë – model 7;

dh) autorizim për blerje të armës nga shtetas i huaj rezident në RSH – model 8.

7. Formatet e autorizimeve për mbajtje arme i bashkëlidhen këtij udhëzimi dhe janë pjesë përbërëse e tij:

a) autorizim i posaçëm për mbajtje arme zjarri – model 4/a;

b) autorizim për mbajtje arme zjarri të kategorisë B në vendbanim – model 5;

c) autorizim për mbajtje arme të kategorisë C/D gjahu/sportive dhe armë të këtij lloji – model 6;

ç) për mbajtje e armës së zjarrit në shërbim për punonjësin e SHPSF-së/autoriteti portual/Banka e Shqipërisë – model 9;

d) për mbajtjen e armës së zjarrit në shërbim dhe lëvizje për drejtuesin teknik/punonjësin e SHPSF-së (truprojë) – model 10;

dh) për koleksion – model 11;

8. Formatet e autorizimeve të përkohshme i bashkëlidhen këtij udhëzimi dhe janë pjesë përbërëse e tij:



- a) për përdorim skenik dhe kinematografik – model 12;
- b) për transferim të përkohshëm të armëve të gjahut dhe sportive – model 13;
- c) mbajtjen e armës nga misionet e huaja – model 14;
- ç) hyrje-daljen/tranzit të armëve të gjahut dhe sportive – model 15;
- d) importin e armëve të gjahut dhe sportive pjesëve të tyre dhe municioneve të tyre – model 16;
- dh) nxjerrjen e armës nga vendbanimi – model 17.

KREU IV

LLOJET E ARMËVE PËR TË CILAT LËSHOHET AUTORIZIM PËR MBAJTJE ARME

1. Subjektet e shërbimit privat të sigurisë fizike pajisen me autorizim, për mbajtje:
 - a) armë zjarri të kategorive A16, A17;
 - b) armë zjarri të shkurtra të kategorisë B5;
 - c) armë zjarri të gjata të kategorisë B;
 - ç) municion për armë zjarri të shkurtra deri në 50 fishekë për armë;
 - d) municion për armë zjarri të gjata deri në 200 fishekë për armë.
2. Në rast nevojë për fishekë shtesë, me kërkesë të subjektit dhe me arsyetim të policisë, jepet autorizim për 20 dhe 100 copë fishekë për armë.
3. Subjektet juridike dhe fizike, të cilave sipas ligjit nr. 74/2014, “Për armët”, të ndryshuar, u lind e drejta e pajisjes me autorizim për mbajtje arme, pajisen me autorizim për mbajtje arme zjarri të shkurtër, të kategorisë B dhe deri në 50 copë fishekë për armë.
4. Subjektet e licencuara për poligon civil qitjeje, të hapur ose të mbyllur, lejohet të mbajnë:
 - a) armë zjarri të shkurtra të kategorisë B;
 - b) armë zjarri të gjata të kategorisë B4, B7;
 - c) armë pneumatike të kategorisë C8;
 - ç) municion sipas kërkesës, vetëm për përdorim në poligon, i cili (municioni) regjistrohet në autorizimin e blerjes;
 - d) municioni për poligonet dhe federatat sportive të jepet në varësi të dinamikës së tyre;
5. Subjekteve të licencuara për poligonin civil të qitjes me pjatel u lejohet vetëm mbajtja dhe përdorimi i armëve të gjahut të kategorisë C.

6. Subjektet juridike dhe fizike, të cilave sipas ligjit nr. 74/2014, “Për armët”, të ndryshuar, u lind e drejta e pajisjes me autorizim për mbajtje arme, pajisen me autorizim për mbajtje arme të kategorive C dhe D, sipas përcaktimeve të mëposhtme:

a) subjektet juridike dhe fizike pajisen me armë të kategorisë C2, me autorizim të lëshuar nga DREJTOR I PËRGJITHSHËM I POLICISË SË SHQITËT;

b) subjektet juridike dhe fizike pajisen me armë të kategorisë C1, C3, C4, C5, C7, C8 dhe D3, me autorizim të lëshuar nga drejtori i drejtorisë vendore të policisë;

c) subjektet juridike dhe fizike pajisen me armë për alarm dhe sinjalizim, me autorizim të lëshuar nga drejtori i drejtorisë vendore të policisë.

7. Subjektet juridike dhe fizike të licencuara për koleksion armësh, lejohet të koleksionojnë:

a) armë zjarri të kategorisë A, që plotësojnë kriteret e armëve për koleksion, përjashtuar municionet, me autorizim të lëshuar nga struktura përgjegjëse e Policisë së Shtetit;

b) armë zjarri të kategorisë B dhe C, që plotësojnë kriteret e armëve për koleksion, përjashtuar municionet, me autorizim të lëshuar nga struktura përgjegjëse e Policisë së Shtetit;

c) armë të çaktivizuara, të certifikuara nga organi përgjegjës i Policisë së Shtetit.

8. Muzetë lejohet të koleksionojnë:

a) armë zjarri të kategorisë A, që plotësojnë kriteret e armëve për koleksion, përjashtuar municionet, me autorizim të lëshuar nga struktura përgjegjëse e Policisë së Shtetit;

b) armë zjarri të kategorisë B dhe C, që plotësojnë kriteret e armëve për koleksion, përjashtuar municionet, me autorizim të lëshuar nga struktura përgjegjëse e Policisë së Shtetit;

c) armë të çaktivizuara, të certifikuara nga organi përgjegjës i Policisë së Shtetit.

KREU V

FORMATI I REGJISTRIT PËR ARMËT, PËR SUBJEKTIN E LICENCUAR, PËR VEPRIMTARI ME ARMËT

1. Regjistrimi i armëve të kategorive B, C dhe D, në pronësi të personave juridikë dhe fizikë, bëhet në organin përgjegjës të policisë vendore në databazën elektronike, brenda 5 ditësh nga data e blerjes.



2. Regjistrimi i armëve të kategorive B, C dhe D, në pronësi të personave juridikë dhe fizikë, bëhet në organin përgjegjës të policisë vendore, duke paraqitur dokumentet si më poshtë:

a) vendimin e organit përgjegjës të Policisë së Shtetit për pajisje me armë zjarri;

b) dokumentin fletëdalje të subjektit që ka shitur armën ose aktin noterial të shitjes midis personave privatë, nëse janë brenda së njëjtës njësi të policisë vendore;

c) dokumentin fletëdalje të lëshuar nga njësia e policisë, kur shitësi dhe blerësi i armës së zjarrit nuk janë brenda së njëjtës njësi të policisë vendore, e shoqëruar me dokumentacionin sipas pikës “b”;

ç) përveç dokumenteve, sipas pikave “a”, “b” dhe “c”, paraqitet fizikisht edhe arma së bashku me municionin.

3. Regjistrimi i armës nga subjekti i licencuar për tregtimin, import/eksportin e armëve bëhet në organin përgjegjës të policisë. Armët regjistrohen nga specialisti përkatës, pasi të ketë në dispozicion në formë të shkruar, këto dokumente:

a) licencën e lëshuar nga institucioni përgjegjës i licencimit;

b) kur armët janë blerë jashtë vendit:

i. dokumentin fletëdalje të origjinës;

ii. dokumentin fletëhyrje të subjektit të firmosur nga titullari i licencës;

c) kur armët janë blerë brenda vendit:

i. dokumentin fletëdalje të subjektit të licencuar vendës, shoqëruar me fletëdaljen e organit përgjegjës të policisë që administron subjektin shitës;

ii. dokumentin fletëhyrje të subjektit blerës të firmosur nga titullari i licencës.

ç) kur subjekti i licencuar regjistron armët e kategorisë B1 (pistoletë) dhe B4 (pushkë), dhe armët me vjaska të gjuetisë dhe ato të qitjes sportive, pronari i subjektit, përveç dokumenteve të rasteve në pikën “b” dhe “c”, dorëzon dhe dokumentin e qitjes eksperimentale, sipas procedurës së përcaktuar në udhëzimin e ministrit për këtë qitje prove (numrin unik të armës).

4. Regjistrimi i armëve të koleksionit dhe ato të muzeut kryhet në organin përgjegjës të policisë, kur në dispozicion të tij janë:

a) autorizimi i lëshuar nga komisioni për personin koleksionist apo personi i ngarkuar nga institucioni për administrimin e armëve të muzeut;

b) lista e armëve në pronësi të koleksionistit apo të institucionit. Armët që nuk janë paaftësuar

regjistrohen me të dhënat standarde: tipi, kalibri, fabrika, numri i serisë. Armët e paaftësuar vetëm tipi i armës dhe sasia në copë;

c) autorizimin për blerje arme koleksioni të lëshuar nga komisioni me dokumentet shoqëruese, si në rastet e tjera të blerjes jashtë vendit ose në subjekte private.

5. Për çregjistrimin e armëve të kategorisë C, subjekti i licencuar për tregtimin e armëve, kur arma shitet jashtë vendit, subjektit të huaj i kërkohet të ketë dokumentacion të plotë nga vendi i tij, të përkthyer e noterizuar për blerje arme.

Në rastin kur subjekti vendës, i licencuar për tregtimin e armëve të gjahut, shet armë të kategorisë C një personi të huaj të pajisur me autorizim për blerje, veprohet si në rastin e shitjes së armëve, në pikën 6 të këtij kreu.

6. Personi fizik, i cili ka në pronësi armë gjahu të kategorisë C, lejohet t’ia shesë një shtetasi të huaj, me autorizim të veçantë të lëshuar nga drejtoria vendore e policisë. Autorizimi për shitjen e armës është sipas formatit përkatës, bashkëlidhur këtij udhëzimi. Procedura për shitblerjen është si më poshtë:

a) shtetasi i huaj paraqet dokumentin e përkthyer dhe të noterizuar, që e autorizon të blejë armë;

b) personat fizikë që bëjnë shitjen e armës, paraqesin në organin përgjegjës të policisë vendore aktin noterial dhe armën e gjahut fizikisht për veprimet e heqjes së armës nga regjistri;

c) shtetasi i huaj, që ka blerë armën e gjahut, paraqet, në pikën e kalimit kufitar, autorizimin e lëshuar nga policia vendore dhe dokumentet shoqëruese;

ç) veprimet për ndryshimin e pronësisë së armës kryhen në zyrat noteriale.

7. Armët e municioni i blerë nga subjektet e licencuara, pasi regjistrohen në organin përgjegjës të policisë, të dhënat e tyre regjistrohen edhe në regjistrat e subjektit. Modeli i regjistrave do të jetë sipas aktivitetit që kryen subjekti.

8. Detyrimin për sigurimin dhe administrimin e armëve të zjarrit dhe të municionit në subjekte e ka personi që është përgjegjës sipas ligjit.

9. Subjektet e licencuara për shërbimin privat të sigurisë fizike mbajnë këta regjistra:

a) regjistri me numra serie, i cili duhet të përmbajë të dhëna të armëve të zjarrit, tipi: kalibri, marka, modeli, prodhimi, numri serial i armës, viti i prodhimit (nëse nuk është pjesë e numrit). Për



municionin kalibri, partia e prodhimit. Regjistri 37 (shtojca I);

b) regjistrin e daljes së përkohshme të armëve e municionit ku regjistrohen të dhënat e armës, municioni, personi që merr armën, ora dhe data, firma e përgjegjës të autorizuar për regjistrimin e armëve. Regjistri 34 (shtojca I).

10. Regjistrat mbahen nga përgjegjës/rojat e vendeve të shërbimit të caktuar nga drejtuesi teknik dhe janë subjekt i inspektimit të tij të paktën njëherë në muaj. Çdo inspektim duhet të përfundojë me raportin e nënshkruar nga drejtuesi teknik i subjektit të licencuar.

11. Personi juridik mund të modelojë dhe të përdorë regjistrin elektronik për armët dhe për punonjësit e shërbimit. Format i elektronik duhet të përmbajë të dhënat e regjistrit të shkruar.

12. Subjektet e licencuara për import/eksport dhe tregtim për armët e përcaktuara në ligj mbajnë regjistra për armët, si më poshtë:

a) regjistër llogarie i dyqanit për armët dhe municionet, ku në të pasqyrohen veprimet hyrje-dalje në bazë të dokumenteve. Regjistri 9 (shtojca I);

b) regjistri i shitjes së armëve me numër serie dhe sasia e municionit, personave të autorizuar. Regjistri 10 (shtojca I);

c) dosjen e certifikatës së qitjes eksperimentale për armë të kategorisë B dhe C, të firmosur nga policia shkencore. Procedurat e marrjes së mostrave të municionit, përcaktohen në udhëzimin e ministrit të Brendshëm.

13. Subjektet për transportin brenda dhe jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë mbajnë dosje me dokumentet e armëve të transportuara, për llogari të subjekteve të licencuara për veprimtari me armë.

14. Subjekti i aftësimit praktik në poligon civil qitjeje ka detyrimin ligjor të mbajë këta regjistra për armët:

a) regjistër për daljen e përkohshme të armëve e të municionit, për aftësim teorik e praktik, nga vendi i ruajtjes ku regjistrohen të dhënat e armës, municioni, personi që merr armën, ora dhe data, firma e përgjegjës të autorizuar për regjistrimin e armëve: regjistri 34;

b) regjistër i personave që kryejnë qitje në poligon dhe sasinë e fishekëve të përdorur, me armët në pronësi të poligonit.

Regjistrohen edhe armët e personave që do të kryejnë qitje me armë në pronësi të tyre. Ky i fundit duhet të ketë me vete autorizimin për mbajtje arme.

Regjistrohet personi me të dhënat personale, lloji i armës, numri i serisë së armës dhe i autorizimit që disponon, sasia e fishekëve të përdorur: data dhe ora e qitjes.

15. Subjekti i pajisur me autorizim për mbajtjen e armëve për përdorim kinematografik e skenik, ka detyrimin ligjor të mbajë regjistra për armët: regjistër me numra serie për armët e zjarrit luftarake (nëse ka) me të dhënat, tipin, kalibrin, markën, fabrikën, numrin e serisë dhe armët e paaftësuara regjistrohen në copë: regjistri 37.

16. Subjekti juridik ose fizik i pajisur me autorizimin për koleksionimin e armëve apo për armët e muzeut ka detyrimin ligjor të mbajë regjistër për armët me numër serie, për çdo kategori me të dhënat: tipi, kalibri, marka, fabrika, numri i serisë, ndërsa armët e paaftësuara regjistrohen në copë: regjistri 37.

17. Formatet e regjistrave të përcaktuara në këtë udhëzim i bashkëlidhen dhe bëhen pjesë e tij.

KREU VI

RREGULLAT, PROCEDURAT DHE FORMULARI QË PLOTËSOHET NË KOHËN E REALIZIMIT TË QITJES EKSPERIMENTALE DHE ADMINISTRIMI I GËZHOJËS NË NJË BANKË TË DHËNASH

1. Subjektet e licencuara për tregtimin / importin / eksportin e armëve kryejnë qitjen eksperimentale për gjitha armët e importuara të kategorisë B dhe kategorisë C, duke marrë 2 plumba dhe dy gëzhoja për çdo tytë arme. Qitja për marrjen e provave kryhet kur armët regjistrohen në regjistrat e subjektit para se të kryhen veprime të shitjeve.

2. Personat fizikë të autorizuar për blerje arme jashtë vendit, brenda afatit të 5 ditëve të futjes së armës në Shqipëri, marrin masa për kryerjen e qitjes eksperimentale në laboratorët e policisë shkencore, apo dhe në vende të tjera, si poligone private apo poligone shtetërore, dhe dorëzimin e plumbave dhe gëzhojave, sipas procedurave të këtij udhëzimi.

3. Plumbat dhe gëzhojat merren nga qitja provuese, duke plotësuar gjithë kushtet teknike në pajisje të mbushura me ujë nga personeli i trajnuar e i kualifikuar, me masa të plota të sigurimit teknik.



Plumbat e marra nga pajisja me ujë duhet të thahen para se të vendosen në kuti.

4. Drejtuesi teknik i subjektit të licencuar për veprimtari të lejuara me armët, kryen gjithë veprimet për realizimin e qitjes e administrimin e plumbave dhe të gëzhgojave.

5. Pas qitjes eksperimentale drejtuesi teknik merr masa që të shënohen plumbat dhe gëzhgojat, sipër tyre me pajisje elektrike, me 4 numrat e fundit të armës që i ka qitur dhe vendosen në kuti.

6. Modelet e plumbave e gëzhgojave dorëzohen në Institutin e Policisë Shkencore, të vendosura në kuti kartoni ose plastike, të pajisura me një shirit ngjites për bllokimin e hapjes. Në kutinë e modeleve të plumbave dhe të gëzhgojave shkruhen të dhënat e armës që i ka qitur: tipi i armës, kalibri, numri serial, vendi prodhimit, viti i prodhimit, i sigluar me emër e mbiemër nga drejtuesi teknik i subjektit që ka kryer qitjen e provës.

7. Kutitë me modelet e plumbave dhe të gëzhgojave dhe formulari për çdo armë dërgohen me dokument dhe shkresë zyrtare në policinë shkencore. Formulari hartohet në tri kopje dhe, pasi konfirmohen nga policia shkencore, një kopje i qëndron policisë shkencore, dy kopje i kthehen subjektit, ku njëra prej tyre dorëzohet në organin përgjegjës të policisë vendore në kohën e shitjes së armës.

8. Modelet e marra nga policia shkencore kontrollohen për standardin e marrë dhe në rast se nuk janë të sakta, provat i kthehen subjektit për t'i përsëritur. Për saktësinë e modeleve bëhet kontroll i provave me përzgjedhje nga eksperti kriminalist i fushës.

9. Modelet e marra duhet të jenë të tilla që gjurma e lënë nga nxjerrësi i gëzhgojave të mos jetë mbi shkrimet e gëzhgojës. Gëzhgoja në fundin e saj të mos ketë gjurmë të tjera përveç atyre që lënë mekanizmat e armës.

KREU VII

DOKUMENTACIONI DHE PROCEDURAT QË KRYHEN PAS DORËZIMIT NË POLICINË SHKENCORE

1. Kartela e kompletuar (shkresa përcjellëse), formulari i plotësuar për të dhënat e armës, gëzhgojat dhe predhat, modele krahasimi) dorëzohen në sekretarinë e Institutit të Policisë Shkencore.

2. Sekretaria e Institutit të Policisë Shkencore regjistron hyrjen e kartelës në seksion të veçantë dhe ia kalon këto kartela shefit të sektorit të balistikës.

3. Eksperti që merr kartelën e studion atë dhe modelet, bindet për vlefshmërinë e tyre, për sa i përket vlefshmërisë së gjurmëve të lëna në to nga mekanizmat e armës, dhe, pas kësaj, vendos emrin e vet në formular në të tria kopjet, duke e nënshkruar secilën prej tyre. Një prej kopjeve të formularëve mbahet në kartotekën balistike, duke e regjistruar në regjister të veçantë dhe u bashkëngjitet modeleve, një i dërgohet organit që lëshon lejen dhe kopjen tjetër e merr subjekti.


4. Në kartotekën balistike të Institutit të Policisë Shkencore, kartelat balistike, ku përfshihen formularët e nënshkruar nga eksperti, që i ka ekzaminuar për vlefshmëri, dhe gëzhgojat e predhat modele krahasimi regjistrohen në libër të veçantë, i cili mbyllet në fundin e çdo viti kalendarik dhe ruhet përgjithmonë.

5. Imazhet e gjurmëve të lëna nga mekanizmat e armës në gëzhgojë regjistrohen në sistemin informatik, në seksionin e armëve të regjistruara, duke krijuar një databazë për këtë qëllim.

6. Imazhet e gjurmëve të lëna nga mekanizmat e armëve në gëzhgojat modele, të marra nga qitjet eksperimentale me armët që shiten, do të regjistrohen sipas formularëve të sistemit informatik ku tek të dhënat shënohet numri rendor, data e hyrjes, emri i pronarit, numri i armës, numri i gëzhgojave, eksperti që ka bërë vlerësimin.

7. Kartela me të dhënat dhe modelet ruhen në kartotekë përgjithmonë dhe mund të hiqet vetëm në rastet e parashikuara në këtë udhëzim. Kartela do të jetë e regjistruar në kartotekë dhe imazhet do të jenë të regjistruara në sistem deri në momentin kur Instituti i Policisë Shkencore merr njoftim zyrtar me shkresë nga organi që lëshon lejen dhe konfirmimin zyrtar të subjektit, për shkatërrimin përfundimtar dhe të pariparueshëm të armës dhe të pjesëve të saj.

8. Në rast të përdorimit të gëzhgojave për identifikim të armëve, si prova në çështje penale, gëzhgoja do të administrohet nga oficeri i policisë gjyqësore dhe do të veprohet njësoj, si dhe provat e tjera që shoqërojnë çështjen në gjyq.





Regjistri 9

Regjistër Ilogarie

Emërtimi _____ Kodi _____ Njësia e matjes _____ Çmimi _____

Nr.	Dokument		Përshkrimi i veprimit	Hyrje	Dalje	Mbetje ndarë në Kategori		
	Nr.	datë				I	II	Shuma
1	2	3	4	5	6	7	8	9
1								
2								
3								
4								
5								
6								
7								
8								
9								
10								

Mbahet nga përgjegjësi material

Regjistri i shitjeve

Regjistër 10

Kategoria: (C 1)...

Emërtimi: (Armë e shkurtër gjysëm automatike (B 1) Pistoletë 9X19 mm 92 FS Bereta, Italiane

Faqe 000001

Nr	Emër Atesë Mbiemër	Datëlindja	Vendbanimi			Arma e Furnizuar		Autorizimi i Policisë		Dokumentet Fletë - Dalje		Vërejtje
			Fshati	Qyteti (tërgu)	Telefon	Numri i serisë		Nr	Datë	Nr	Datë	
1	2	3	4	5	6	7		8	9	10	11	12
1												
2												
3												
4												
5												
6												
7												
8												
9												
10												

Regjistri. 34

I daljes së përkohshme të armatimit

NR	Arma, municioni, Tipi, Kalibri, Modeli, Fabrika	Numri i armës	Njësia e matjes	Data dhe ora e dhënies	Sasia		Emër, Mbiemër Firma e marrjes	Kthyer		
					Me shifër	Me shkrim		Data/ora e kthimit	Sasia	Firma e marrësit
1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11
1										
2										
3										
4										
5										
6										
7										
8										
9										
10										

Ky libër mbahet dhe plotësohet nga personeli i ngarkuar me administrimin e armëve të gjata, për personelin që del në shërbim dhe nga magazinierët në raste të veçanta, të përcaktuara me rregullore.



Model 1



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E BRENDSHME
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E POLICISË SË SHTETIT

AUTORIZIM

Për blerje arme zjarri të kategorisë B e të municioneve përkatëse

Në zbatim të nenit 8, pika 6, neneve 24 dhe 26, të ligjit nr. 74/2014, “Për armët”, të ndryshuar; udhëzimit të ministrit të Brendshëm nr. _____, datë _____.2024, “Për procedurat për pajisjen me autorizim për veprimtarinë e lejuar me armë, regjistrimin e armës, administrimin e gëzhgojës në një bankë të dhënash dhe procedurat që kryhen pas dorëzimit në policinë shkencore”; urdhrit të ministrit të Brendshëm nr. 367, datë 18.11.2021, “Për përbërjen, detyrat dhe mënyrën e funksionimit të komisioneve për pajisjen e subjekteve me licencë/autorizim për veprimtarinë e lejuar me armë”, si dhe të vendimit të Komisionit Qendror për Dhënie të Licencave/Certifikatave/Autorizimeve për Veprimtarinë e Lejuar me Armë, pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit nr. _____, datë _____._____.

Autorizohet personi fizik _____, i datëlindjes _____, lindur më _____ dhe banues në Njësinë Administrative _____, identifikuar me ID _____, të blejë armë zjarri të kategorisë B e municionet përkatëse pranë subjekteve të licencuara nga institucioni përgjegjës për tregtim të armëve si vijon:

- 1 (një) armë të shkurtër të kategorisë B.

Sasia e blerjes së municionit sipas armës:

- Municioni për armën e shkurtër deri në 50 fishekë për armë.

I autorizuari detyrohet që, brenda 5 (pesë) ditëve nga data e blerjes së armës, të bëjë regjistrimin e saj në Drejtorinë Vendore të Policisë _____, Komisariatin e Policisë _____, ku ka vendbanimin/ushtron aktivitetin.

Afati i vlefshmërisë së autorizimit për blerje arme është 6 (gjashtë) muaj nga data e lëshimit.

DREJTOR I PËRGJITHSHËM I POLICISË SË SHTETIT

Vula



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E BRENDSHME
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E POLICISË SË SHTETIT
DREJTORIA VENDORE E POLICISË

Nr. _____ Prot. _____, më _____._____._____

AUTORIZIM

Për blerje arme të kategorisë C/D gjahu/sportive dhe armë të tjera të këtij lloji

Në zbatim të neneve 24 dhe 26 të ligjit nr. 74/2014, “Për armët”, i ndryshuar; udhëzimit të ministrit të Brendshëm nr. _____, datë _____._____.2024, “Për procedurat për pajisjen me autorizim për veprimtarinë e lejuar me armë, regjistrimin e armës, administrimin e gëzhgojës në një bankë të dhënash dhe procedurat që kryhen pas dorëzimit në policinë shkencore”; urdhrit të ministrit të Brendshëm nr. 367, datë 18.11.2021 “Për përbërjen, detyrat dhe mënyrën e funksionimit të komisioneve për pajisjen e subjekteve me licencë/autorizim për veprimtarinë e lejuar me armë”; si dhe të vendimit të Komisionit për Dhënie të Autorizimeve për Veprimtarinë e Lejuar me Armët në Drejtorinë Vendore të Policisë _____ nr._____, datë _____,

Autorizohet personi fizik/juridik _____, i datëlindjes _____, lindur më _____ dhe banues në Njësine Administrative _____, identifikuar me ID _____, për të blejë arme të kategorisë C, D dhe armë të tjera brenda dhe jashtë vendit si vijon:

- _____ armë të kategorisë _____.

Sasia e blerjes së municionit sipas armës:

- Municioni për armën deri në _____ fishekë për armë.

I autorizuari detyrohet që, brenda 5 (pesë) ditëve nga data e blerjes së armës, të bëjë regjistrimin e saj në Drejtorinë Vendore të Policisë _____, Komisaratin e Policisë _____, ku ka vendbanimin/ushtron aktivitetin.

Afati i vlefshmërisë së autorizimit për blerje arme është 6 (gjashtë) muaj nga data e lëshimit.

DREJTOR

Vula



Model 3



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E BRENDSHME

DREJTORIA E PËRGJITHSHME E POLICISË SË SHTETIT

Nr. _____ Prot. Tiranë, më _____.____._____

AUTORIZIM

Për blerje arme zjarri të kategorisë C2 me vjaska e municionet përkatëse

Në zbatim të nenit 8, pika 3, neneve 24 dhe 26 të ligjit nr. 74/2014, “Për armët”, i ndryshuar; udhëzimit të ministrit të Brendshëm nr. _____, datë _____.____.2024, “Për procedurat për pajisjen me autorizim për veprimtarinë e lejuar me armë, regjistrimin e armës, administrimin e gëzhgjës në një bankë të dhënash dhe procedurat që kryhen pas dorëzimit në policinë shkencore”; urdhrin të ministrit të Brendshëm nr. 367, datë 18.11.2021, “Për përbërjen, detyrat dhe mënyrën e funksionimit të komisioneve për pajisjen e subjekteve me licencë/autorizim për veprimtarinë e lejuar me armë”; si dhe të vendimit të Komisionit Qendror për Dhënie të Licencave/Certifikatave/Autorizimeve për Veprimtarinë e Lejuar me Armë, pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit nr. _____, datë _____.____.____,

Autorizohet personi fizik/juridik _____, i datëlindjes _____, lindur më _____ dhe banues në Njësinë Administrative _____, identifikuar me ID _____, të blejë armë të kategorisë C2 me vjaska pranë subjekteve të licencuara nga institucioni përgjegjës për tregim të armëve si vijon:

- _____ armë të gjatë të kategorisë C2 me vjaska.

Sasia e blerjes së municionit sipas armës:

- Municioni për armën e gjatë deri në _____ fishekë për armë.

I autorizuari detyrohet që, brenda 5 (pesë) ditëve nga data e blerjes së armës, të bëjë regjistrimin e saj në Drejtorinë Vendore të Policisë _____, Komisariatin e Policisë _____, ku ka vendbanimin/ushtron aktivitetin. .

Afati i vlefshmërisë së autorizimit për blerje arme është 6 (gjashtë) muaj nga data e lëshimit.

DREJTOR I PËRGJITHSHËM I POLICISË SË SHTETIT

Vula



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E BRENDSHME
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E POLICISË SË SHTETIT

AUTORIZIM I POSAÇËM

Për blerje arme zjarri

Në zbatim të neneve 24 dhe 26 të ligjit nr. 74/2014, “Për armët”, i ndryshuar; udhëzimit të ministrit të Brendshëm nr. _____, datë _____.2024, “Për procedurat për pajisjen me autorizim për veprimtarinë e lejuar me armë, regjistrimin e armës, administrimin e gëzhgjës në një bankë të dhënash dhe procedurat që kryhen pas dorëzimit në policinë shkencore”; urdhrit të ministrit të Brendshëm nr. 367, datë 18.11.2021, “Për përbërjen, detyrat dhe mënyrën e funksionimit të komisioneve për pajisjen e subjekteve me licencë/autorizim për veprimtarinë e lejuar me armë”; si dhe të vendimit të Komisionit Qendror për Dhënie të Licencave/Certifikatave/Autorizimeve për Veprimtarinë e Lejuar me Armë, pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit nr. _____, datë _____. _____,

Autorizohet personi fizik _____, i datëlindjes _____, lindur më _____ dhe banues në Njësinë Administrative _____, identifikuar me ID _____, të mbajë armë zjarri si vijon:

- 1 (një) armë të shkurtër të kategorisë B.

Sasia e blerjes së municionit sipas armës:

- Municioni për armën e shkurtër deri në 50 fishekë për armë.

I autorizuari detyrohet që, brenda 5 (pesë) ditëve nga data e blerjes së armës, të bëjë regjistrimin e saj në Drejtorinë Vendore të Policisë _____, Komisariatit e Policisë _____, ku ka vendbanimin/ushtron aktivitetin.

Afati i vlefshmërisë së autorizimit për blerje arme është 6 (gjashtë) muaj nga data e lëshimit.

Afati i vlefshmërisë së autorizimit të posaçëm për mbajtje arme bazohet në vlerësimin e ekzistencës së kërcënimit dhe rrezikut për jetën, vlerësim i cili kryhet të paktën çdo 1 (një) vit.

DREJTOR I PËRGJITHSHËM I POLICISË SË SHTETIT

Vula



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E BRENDSHME
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E POLICISË SË SHTETIT

AUTORIZIM

Për blerje arme zjarri për personat juridikë

Në zbatim të nenit 24 dhe nenit 25 të ligjit nr. 74/2014, “Për armët”, i ndryshuar; udhëzimit të MB-së nr. _____, datë _____.2024, “Për procedurat për pajisjen me autorizim për veprimtarinë e lejuar me armë, regjistrimin e armës, administrimin e gëzhgjës në një bankë të dhënash dhe procedurat që kryhen pas dorëzimit në policinë shkencore”; urdhrin të ministrit të Brendshëm nr. 367, datë 18.11.2021, “Për përbërjen, detyrat dhe mënyrën e funksionimit të komisioneve për pajisjen e subjekteve me licencë/autorizim për veprimtarinë e lejuar me armë”; si dhe të vendimit të Komisionit Qendror për Dhënie të Licencave/Certifikatave/Autorizimeve për Veprimtarinë e Lejuar me Armë, pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit nr._____, datë _____._____.

Autorizohet subjekti juridik _____, i pajisur me licencë _____për “_____”, të vlefshme deri më datë_____, me seli në _____, Shqipëri, me administrator_____, drejtues teknik_____, të blejë armë zjarri/municione të kategorisë B pranë subjekteve të licencuara nga institucioni përgjegjës për tregtim të armëve si vijon:

- Armë të kategorisë B.

Sasia e blerjes së municionit sipas armës:

- Municione

I autorizuari detyrohet që, brenda 5 (pesë) ditëve nga data e blerjes së armës/municioneve, të bëjë regjistrimin e saj në Drejtorinë Vendore të Policisë_____, ku ka vendbanimin/ushton aktivitetin.

Afati i vlefshmërisë së autorizimit për blerje arme është 6 (gjashtë) muaj nga data e lëshimit.

DREJTOR I PËRGJITHSHËM I POLICISË SË SHTETIT

Vula



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E BRENDSHME
DREJTORIA

AUTORIZIM

Për blerje të armës nga shtetas të huaj rezidentë në RSH

Në zbatim të nenit 8, nenit 24 të ligjit nr. 74/2014, “Për armët”, të ndryshuar; udhëzimit të ministrit të Brendshëm nr. _____, datë _____.2024, “Për procedurat për pajisjen me autorizim për veprimtarinë e lejuar me armë, regjistrimin e armës, administrimin e gëzhgojës në një bankë të dhënash dhe procedurat që kryhen pas dorëzimit në policinë shkencore”; urdhrit të ministrit të Brendshëm nr. 367, datë 18.11.2021, “Për përbërjen, detyrat dhe mënyrën e funksionimit të komisioneve për pajisjen e subjekteve me licencë/autorizim për veprimtarinë e lejuar me armë”; si dhe të vendimit të Komisionit _____ për dhënie të licencave/certifikatave/autorizimeve për veprimtarinë e lejuar me armë, pranë Drejtorisë _____ nr. _____, datë _____._____.

Autorizohet shtetasi i huaj rezident në RSH, _____, me shtetësi _____, me dokument ID _____, i pajisur me autorizim për mbajtje arme nr. _____, në përputhje me dokumentacionin ligjor nga vendi i origjinës, të blejë armë të kategorisë B/C, pranë subjekteve të licencuara nga institucioni përgjegjës për tregtim të armëve si vijon:

- Armë të kategorisë _____.

Sasia e blerjes së municionit sipas armës:

- Municione

I autorizuari detyrohet që brenda 5 (pesë) ditëve nga data e blerjes së armë municioneve, të bëjë regjistrimin e saj në Drejtorinë Vendore të Policisë _____, ku është i regjistruar rezident.

Afati i vlefshmërisë së autorizimit për blerje arme është 6 (gjashtë) muaj nga data e lëshimit.

DREJTOR

Vula



 REPUBLIKA E SHQIPËRISË D.P.P.SH  Nri Regjistrat	AUTORIZIM PËR MBAJTJE ARMË ZJARRI (I POSAÇËM) Mbiemri Emri Atësia Nr. personal Data e Lindjes Adresa AL
TIPI Marka Modeli Kalibri Nr. Serial	Data e Lëshimit Data e Skadimit Autorizimi është i vlefshëm për mbajtje arme në vendbanim dhe në lëvizje.

Model 4/a



Model 5

 REPUBLIKA E SHQIPËRIË D.P.P.SH		AUTORIZIM PËR MBAJTJE ARME ZJARRI (NE VENDBANIM)	
 Nr i Regjistrimit DI 100019150002		Mbiemri	
		Emri	
		Atësia	
		Nr. personal	
		Data e Lindjes	
Adresa		AL	
TIPI		Data e Lëshimit	
Marka		Data e Skadimit	
Modeli		Autorizimi është i vlefshëm vetëm për në banesë. Jashtë banesës vetëm me lejen e policisë.	
Kalibri			
Nr. Serial			



Model 6

 REPUBLIKA E SHQIPËRISË D.P.P.SH  Nr i Regjistrimit DI 100019150002	AUTORIZIM PËR MBAJTJE ARMË GJAHU/SPORTIVE Mbiemri Emri Atësia Nr. personal Data e Lindjes Adresa
--	---

AL

TIPI Marka Modeli Kalibri Nr. Serial	Data e Lëshimit Data e Skadimit Autorizimi është i vlefshëm jashtë banesës i shoqëruar me lejen e gjuetisë ose lejen e policisë.
--	--




Model 9



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E BRENDSHME
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E POLICISË SË SHTETIT
DREJTORIA VENDORE E POLICISË

AUTORIZIM

Për mbajtje e armës së zjarrit në shërbim për punonjës in SHPSF-së/Autoriteti Portual/Banka e Shqipërisë



Në zbatim nenit 27 të ligjit nr. 74/2014, “Për armët”, të ndryshuar, të udhëzimit të ministrit të Brendshëm nr. _____, datë _____.2024, “Për procedurat për pajisjen me autorizim për veprimtarinë e lejuar me armë, regjistrimin e armës, administrimin e gëzhgojës në një bankë të dhënash dhe procedurat, që kryhen pas dorëzimit në policinë shkencore”, si dhe vendimit të Komisionit Vendor në Drejtorin Vendore të Policisë me nr._____, datë____. ____.

Autorizohet për mbajtje arme zjarri në shërbim punonjësi i shërbimit:

Emër _____
Atësia _____
Mbiemër _____
Datëlindja _____
ID _____
Nr. i certifikatës _____

Autorizimi për mbajtje arme zjarri në shërbim është i vlefshëm gjatë kohës së punës vetëm në ambientet e punës dhe shërbimit.

Autorizimi është i vlefshëm 5 vjet nga afati i lëshimit të tij, me të drejtë përtëritje.

DREJTOR

Vula




Model 10



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E BRENDSHME
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E POLICISË SË SHTETIT
DREJTORIA VENDORE E POLICISË

AUTORIZIM

Mbajtja e armës së zjarrit në shërbim dhe në lëvizje për drejtuesin teknik/punonjës in e SHPSF-së (truprojë)



Në zbatim të nenit 27 të ligjit nr. 74/2014, “Për armët”, të ndryshuar; të udhëzimit të ministrit të Brendshëm nr. _____, datë _____.2024, “Për procedurat për pajisjen me autorizim për veprimtarinë e lejuar me armë, regjistrimin e armës, administrimin e gëzhgojës në një bankë të dhënash dhe procedurat që kryhen pas dorëzimit në policinë shkencore”; si dhe të vendimit të Komisionit Vendor në Drejtorin Vendor të Policisë me nr.____, datë____. _____.

Autorizohet për mbajtje arme zjarri në shërbim dhe lëvizje drejtuesi teknik/punonjësi i SHPSF-së Truprojë:

Emër_____

Atësia_____

Mbiemër_____

Datëlindja_____

ID_____

Nr. i certifikatës_____

Autorizimi për mbajtje arme zjarri në shërbim dhe lëvizje është i vlefshëm gjatë kohës së punës në ambientet e punës/shërbimit, si dhe jashtë qendrës së banimit apo të punës/shërbimit.

Autorizimi është i vlefshëm 5 vjet nga afati i lëshimit të tij, me të drejtë përtëritje.

DREJTOR

Vula



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E BRENDSHME
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E POLICISË SË SHTETIT

Nr. _____ Prot. Tiranë, më _____.____._____

AUTORIZIM

Për koleksionim armësh

Në zbatim të nenit 24 dhe të nenit 32 të ligjit nr. 74/2014, “Për armët”, të ndryshuar; VKM-së nr. 96, datë 4.2.2015, “Për përcaktimin e rregullave dhe procedurave të deklarimit, ruajtjes regjistrimit dhe paaftësimit për armët e koleksionit”, të ndryshuar; udhëzimit të ministrit të Brendshëm nr. _____, datë _____.____.2024, “Për procedurat për pajisjen me autorizim për veprimtarinë e lejuar me armë, regjistrimin e armës, administrimin e gëzhgojës në një bankë të dhënash dhe procedurat që kryhen pas dorëzimit në policinë shkencore”; urdhrin të ministrit të Brendshëm nr. 367, datë 18.11.2021, “Për përbërjen, detyrat dhe mënyrën e funksionimit të komisioneve për pajisjen e subjekteve me licencë/autorizim për veprimtarinë e lejuar me armë”; si dhe vendimit të Komisionit Qendror për dhënie të licencave/certifikatave/autorizimeve për veprimtarinë e lejuar me armë, pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit nr._____, datë _____.____._____,

Autorizohet personi fizik/juridik _____, i datëlindjes _____, lindur më _____ dhe banues në Njësinë Administrative _____, bashkia _____, identifikuar me ID _____, në adresë të vendit të koleksionimit të armëve, të blejë armë për koleksionim:

- _____ armë të kategorisë _____.

I autorizuari detyrohet që, brenda 5 (pesë) ditëve, të bëjë regjistrimin e saj në Drejtorinë Vendore të Policisë, Komisariatit të Policisë ku ka vendbanimin ose ushtron aktivitetin.

Ky autorizim është pa afat.

DREJTOR I PËRGJITHSHËM I POLICISË SË SHTETIT

Vula



Model 12



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E BRENDSHME
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E POLICISË SË SHTETIT

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____._____

AUTORIZIM

Për përdorim skenik të armëve

Në zbatim të germës “d” të nenit 12, germës “c”, të nenit 24 dhe pikës 1 të nenit 32 të ligjit nr. 74/2014, “Për armët”, të ndryshuar; udhëzimit të ministrit të Brendshëm nr. _____, datë _____.____.2024, “Për procedurat për pajisjen me autorizim për veprimtarinë e lejuar me armë, regjistrimin e armës, administrimin e gëzhgojës në një bankë të dhënash dhe procedurat që kryhen pas dorëzimit në policinë shkencore”; urdhrin të ministrit të Brendshëm nr. 367, datë 18.11.2021, “Për përbërjen, detyrat dhe mënyrën e funksionimit të komisioneve për pajisjen e subjekteve me licencë/autorizim për veprimtarinë e lejuar me armë”, si dhe vendimit të Komisionit Qendror për dhënie të licencave/certifikatave/autorizimeve për veprimtarinë e lejuar me armë, pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit nr. _____, datë _____.____.____,

Autorizohet personi fizik/juridik _____, i datëlindjes _____, lindur më _____ dhe banues në Njësinë Administrative _____, rruga _____, identifikuar me ID _____, të mbajë armë për përdorim skenik dhe kinematografik si vijon:

- _____ armë të kategorisë _____.

I autorizuari detyrohet që, brenda 5 (pesë) ditëve, të bëjë regjistrimin e saj në Drejtorinë Vendore të Policisë, Komisaratin e Policisë ku ka vendbanimin ose ushtron aktivitetin.

Ky autorizim është i vlefshëm _____ nga data e lëshimit.

DREJTOR I PËRGJITHSHËM I POLICISË SË SHTETIT_____
Vula



Model 13



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E BRENDSHME
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E POLICISË SË SHTETIT

Nr. _____ Prot

Tiranë më, _____, _____

AUTORIZIM I PËRKOHSHËM**Për transferim të përkohshëm të armëve të gjahut dhe sportive**

Në zbatim nenit 19/3, 40 të Ligjit Nr. 74/2014 “Për armët”, të ndryshuar, si dhe Vendimit të Komisionit të Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit Nr. _____, datë _____.

Autorizohet personi fizik/juridik/Federata e Qitjes Sportive _____, për lejin e transferimit të përkohshëm të armëve të gjahut/sportive në territorin e Republikës së Shqipërisë, në datat _____ deri në _____, hyrje nga Pika e Kalimit Kufitar _____, dalje nga Pika e Kalimit Kufitar _____, me të dhënat si më poshtë:

Armët e gjahut/sportive: 0.0

1. Lloji i armës _____, tipi _____, kalibri _____ mm dhe numër serie _____;
2. Lloji i armës _____, tipi _____, kalibri _____ mm dhe numër serie _____;
3. Lloji i armës _____, tipi _____, kalibri _____ mm dhe numër serie _____;
4. Lloji i armës _____, tipi _____, kalibri _____ mm dhe numër serie _____;
5. Lloji i armës _____, tipi _____, kalibri _____ mm dhe numër serie _____;
6. Lloji i armës _____, tipi _____, kalibri _____ mm dhe numër serie _____;

DREJTOR I PËRGJITHSHËM I POLICISË SË SHTETIT

Vula



Model 14



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E BRENDSHME
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E POLICISË SË SHTETIT

Nr. _____ Prot. Tiranë, më _____.____._____

AUTORIZIM I PËRKOHSHËM

Për mbajtje arme personale nga autoritetet e huaja



Në zbatim nenit 40 të ligjit nr. 74/2014, “Për armët”, të ndryshuar; të udhëzimit të ministrit të Brendshëm nr. _____, datë _____.____.2024, “Për procedurat për pajisjen me autorizim për veprimtarinë e lejuar me armë, regjistrimin e armës, administrimin e gëzhgojës në një bankë të dhënash dhe procedurat që kryhen pas dorëzimit në policinë shkencore”,

Autorizohet z./grada _____, punonjës i _____, të mbajë armë personale model _____, kalibri _____, me numër _____, me _____ copë fishekë.

Autorizimi është i vlefshëm me pasaportë personale/dokument nga data _____.____.____ deri më datë _____.____.____.

DREJTOR I PËRGJITHSHËM I POLICISË SË SHTETIT_____
Vula



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E BRENDSHME
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E POLICISË SË SHTETIT

Nr. _____ Prot. Tiranë, më _____.____._____

AUTORIZIM I PËRKOHSHËM

Për hyrje-daljen/tranzit të armëve të gjahut dhe sportive

Në zbatim nenit 19/3, nenit 40 të ligjit nr. 74/2014, “Për armët”, të ndryshuar, të udhëzimit të ministrit të Brendshëm nr. _____, datë _____.____.2024, “Për procedurat për pajisjen me autorizim për veprimtarinë e lejuar me armë, regjistrimin e armës, administrimin e gëzhgjës në një bankë të dhënash dhe procedurat që kryhen pas dorëzimit në policinë shkencore”,

Autorizohet personi fizik /juridik /Federata e Qitjes Sportive _____, për lejimin e hyrje-daljes/tranzit të armëve të gjahut/sportive në territorin e Republikës së Shqipërisë, në datat _____.____.____ deri më _____.____.____, hyrje nga Pika e Kalimit Kufitar _____, dalje nga Pika e Kalimit Kufitar _____, me të dhënat si më poshtë:

Armët e gjahut/sportive:

Nr. _____, lloji i armës _____, tipi _____, kalibri _____mm dhe numër serie _____.

DREJTOR I PËRGJITHSHËM I POLICISË SË SHTETIT

Vula



Model 16



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E BRENDSHME
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E POLICISË SË SHTETIT

AUTORIZIM

Për import të armëve të gjahut dhe sportive pjesëve kryesore dhe municioneve të tyre

Në zbatim të nenit 19/1 dhe 19/2 të ligjit nr. 74/2014, “Për armët”, të ndryshuar; të udhëzimit të ministrit të Brendshëm nr. _____, datë _____.2024, “Për procedurat për pajisjen me autorizim për veprimtarinë e lejuar me armë, regjistrimin e armës, administrimin e gëzhgojës në një bankë të dhënash dhe procedurat që kryhen pas dorëzimit në policinë shkencore”; urdhrin të ministrit të Brendshëm nr. 367, datë 18.11.2021, “Për përbërjen, detyrat dhe mënyrën e funksionimit të komisioneve për pajisjen e subjekteve me licencë/autorizim për veprimtarinë e lejuar me armë”, si dhe vendimit të Komisionit Qendror për dhënie të licencave/certifikatave/autorizimeve për veprimtarinë e lejuar me armë, pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit nr._____, datë _____._____,

Autorizohet subjekti fizik/juridik _____, i pajisur me licencë _____ për “Import dhe tregtimin e armëve të gjahut, sportive, pjesëve kryesore dhe municioneve të tyre”, të vlefshme deri më datë _____, me seli në _____, Shqipëri, me administrator _____, drejtues teknik _____, të importojë nga shteti _____, me tranzit nga _____, armë gjahu/sportive, pjesë kryesore dhe municione të tyre, sipas përcaktimeve të mëposhtme:

- Lloji i armës _____, tipi _____, kalibri _____ mm dhe numër serie _____.

Sasia e importit të municionit sipas armës:

- Municioni për armën _____.

I autorizuari detyrohet që, brenda 5 (pesë) ditëve nga importi i armëve në vend, të bëjë regjistrimin e tyre në Drejtorinë Vendore të Policisë, Komisariatit e Policisë ku ka vendbanimin ose ushtron aktivitetin.

Afati i këtij autorizim është i vlefshëm _____

DREJTOR I PËRGJITHSHËM I POLICISË SË SHTETIT

Vula



Model 17



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E BRENDSHME
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E POLICISË SË SHTETIT
DREJTORIA VENDORE E POLICISË
KOMISARIATI I POLICISË _____

Nr. _____ Prot. _____ më, _____._____._____

AUTORIZIM I PËRKOHSHËM
(DITOR)

Për nxjerrjen e armës nga vendbanimi

Në zbatim të nenit 37 të ligjit nr. 74/2014, “Për armët”, të ndryshuar; udhëzimit të ministrit të Brendshëm nr. _____, datë _____._____.2024, “Për procedurat për pajisjen me autorizim për veprimtarinë e lejuar me armë, regjistrimin e armës, administrimin e gëzhgojës në një bankë të dhënash dhe procedurat që kryhen pas dorëzimit në policinë shkencore”, personi _____ i datëlindjes _____, lindur më _____ dhe banues në Njësinë Administrative _____, rruga _____, identifikuar me ID _____, juridiksion i Komisaritit të Policisë _____, i pajisur me autorizim mbajtjeje arme, tip _____, modeli _____, kalibri _____, me numër serie _____,

Autorizohet të nxjerrë armën nga vendbanimi për qitje sportive/shërbime e riparime teknike pranë subjektit _____ të licencuar “Për poligon civil qitjeje”/i licencuar për shërbime teknike, me adresë _____.

Ky autorizim është i vlefshëm për datën _____._____._____.

SHEF I KOMISARIATIT

Vula



URDHËR

Nr. 202, datë 18.10.2024

PËR DELEGIM TË KOMPETENCAVE

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të neneve 28 dhe 29, të ligjit nr. 44/2025, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, të ligjit nr. 90/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”,

URDHËROJ:

1. Delegimin e kompetencave të drejtorit të përgjithshëm të Gjendjes Civile z. Shpëtim Çokaj, me detyrë drejtor i Drejtorisë së Administrimit të Regjistrave në Drejtorinë e Përgjithshme të Gjendjes Civile, në Ministrinë e Brendshme.

2. Kompetencat e deleguara, sipas pikës 1 të këtij urdhri, të ushtrohen deri në emërimin e drejtorit të përgjithshëm të Gjendjes Civile, ose deri në shfuqizimin e këtij urdhri.

3. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohet z. Shpëtim Çokaj dhe Shërbimi Shtetëror i Gjendjes Civile.

4. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për sigurimin e zbatimit dhe kontrollin e zbatimit të këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I BRENDSHËM

Ervin Hoxha

URDHËR

Nr. 831, datë 21.10.2024

**PËR NDALIMIN E PESHKIMIT NË
LIQENIN E OHRIT DHE
GRUMBULLIMIN E VEZËVE TË
KORANIT PËR INKUBIM**

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës, të pikës 1, të nenit 13, të ligjit nr. 64, datë 31.5.2012, “Për peshkimin”, të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Ndalimin e peshkimit me çfarëdolloj mjeti dhe metode gjuetie, si dhe ndalimin e mbajtjes në bord, tranzitimin në barkë dhe zbarkimin e qëllimtë të belushkës (*Salmothymus obridanus*), në liqenin e Ohrit, prej datës 1.11.2024 deri më datë 1.3.2025.

2. Ndalimin e peshkimit me çfarëdolloj mjeti dhe metode gjuetie, si dhe ndalimin e mbajtjes në bord, tranzitimin në barkë dhe zbarkimin e qëllimtë të gjitha llojeve të peshqve në liqenin e Ohrit, prej datës 1.12.2024 deri më datë 1.3.2025, me përjashtim të tratave të zallit (vlagë) për gjuetinë e cironkës (*Alburnus alburnus alborella*), sipas zonave bregliqenore të përcaktuara nga Organizata e Menaxhimit të Peshkimit (OMP), Pogradec.

3. Çdo mjet gjuetie peshku i kapur nga organet e monitorimit dhe të kontrollit gjatë kohës së ndalimit të gjuetisë së peshkut të sekuestrohet.

4. Drejtoria e Shërbimeve të Peshkimit dhe Akuakulturës (DSHPA) të koordinojë veprimtarinë organizative, teknike dhe financiare me Qendrën e Prodhimit të Rasateve të Koranit në fshatin Lin të Pogradecit, për gatishmërinë e marrjes së vezëve të koranit (*Salmo letnica*), shtrimit dhe trajtimit të tyre për inkubim.

5. Për periudhën prej 1.1.2025 deri më 1.3.2025 të lejohet vetëm peshkimi i riprodhuesve të koranit për qëllime të grumbullimit të vezëve deri në 220 kg, të cilat do të shtrohen për inkubim në impiantet e Qendrës së Prodhimit të Rasateve të Koranit, në fshatin Lin të Pogradecit.

6. Shpenzimet e pagesës së materialit biologjik (vezëve), karburantit që shpenzohet për grumbullimin dhe transportimin e vezëve të koranit dhe shpenzimet e tjera që kanë të bëjnë me këtë aktivitet do të mbulohen nga buxheti i planifikuar i DSHPA-së.

7. Veprimtaria e grumbullimit të vezëve, të kryhet e organizuar nën drejtimin e DSHPA-së, në varësi të së cilës është Sektori i Kontrollit dhe Monitorimit të Peshkimit, Qendra e Prodhimit të Rasateve të Koranit në fshatin Lin të Pogradecit, të cilat në bashkëpunim me OMP-në Pogradec, të përcaktojnë dhe aktivizojnë për këtë qëllim 60 peshkatarë me përvojë, anëtarë të kësaj OMP-je.

8. DSHPA-ja, nëpërmjet Qendrës së Prodhimit të Rasateve të Koranit në fshatin Lin të Pogradecit, të lidhë kontratë me OMP-në Pogradec, për



mbledhjen dhe dorëzimin e vezëve të koranit, të ndara sipas zonave specifike buzë liqenit.

9. OMP Pogradec dhe DSHPA-ja, në bashkërendim me Drejtorinë e Politikave, Strategjiave dhe Programeve të Peshkimit dhe Akuakulturës të hartojnë një plan veprimi të detajuar dhe të miratuar prej tyre.

10. Ngarkohen Drejtoria e Politikave, Strategjiave dhe Programeve të Peshkimit dhe Akuakulturës, Drejtoria e Shërbimeve të Peshkimit dhe Akuakulturës, Qendra e Prodhimit të Rasateve të Koranit në fshatin Lin të Pogradecit, si dhe Organizata e Menaxhimit të Peshkimit Pogradec, të bashkëpunojnë me strukturat e qeverisjes vendore Pogradec, Komisariatit e Policisë, Policinë Tatimore, Drejtorinë Rajonale të AKU-së Korçë, për zbatimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I BUJQËSISË DHE
ZHVILLIMIT RURAL
Anila Denaj

VENDIM
Nr. 61, datë 19.9.2024

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë,
e përbërë nga:

Holta Zaçaj	kryetare;
Marsida Xhaferllari	anëtare;
Sonila Bejtja	anëtare;
Sandër Beci	anëtar;
Ilir Toska	anëtar;
Genti Ibrahim	anëtar;
Marjana Semini	anëtare;
Fiona Papajorgji	anëtare,

me sekretare Belma Lleshi, në datën 19.9.2024 mori në shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve çështjen nr. 6 (P) 2024 të Regjistrit Themeltar, që u përket:

KËRKUES: Prend Suta, përfaqësuar nga avokat Preng Frroku, me prokurë.

SUBJEKT I INTERESUAR: Prokuroria e Përgjithshme, përfaqësuar nga prokuror Isa Jata, me autorizim.

OBJEKTI: Shfuqizimi i vendimit nr. 00-2023-1811 (299), datë 7.11.2023, të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, si i papajtuësëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

BAZA LIGJORE: Nenet 33, 42, pika 2, 43, 44, 52, 131, pika 1, shkronja “F” dhe 134, pika 1, shkronja “I”, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; neni 6 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (*KEDNJ*); nenet 31 e vijuese të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar (*ligji nr. 8577/2000*).

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatoren e çështjes Fiona Papajorgji, mori në shqyrtim pretendimet e kërkesit, i cili ka kërkuar pranimin e kërkesës, parashtrimet me shkrim të subjektit të interesuar, Prokurorisë së Përgjithshme, që ka kërkuar rrëzimin e kërkesës, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I **Rrethanat e çështjes**

1. Drejtoria Rajonale e Sigurimeve Shoqërore (*DRSSH*), Shkodër në datën 21.4.2015 ka depozituar kallëzimin penal ndaj shtetasit Prend Suta (*kërkuess*) për veprën penale “Mashtrimi në sigurime”, të parashikuar nga neni 145 i Kodit Penal (*KP*). Sipas kallëzimit rezulton se kërkuessi i është drejtuar *DRSSH*-së, Shkodër në datën 27.3.2001, me kërkesë për caktimin e trajtimit të veçantë të minatorit, sipas ligjit nr. 8685, datë 9.11.2000, “Për një trajtim të veçantë të punonjësve që kanë punuar në miniera në nëntokë” (*ligji nr. 8685/2000*). *DRSSH*-ja, Shkodër, me vendimin nr. 9, datë 18.7.2001, i ka caktuar atij trajtim të veçantë prej datës 16.12.2000, në masën 5.148 lekë/muaj. Në datën 9.1.2015 kërkuessi ka paraqitur përsëri kërkesë, këtë herë për caktimin e pensionit të pleqërisë sipas ligjit nr. 150/2014, “Për pensionet e punonjësve që kanë punuar në miniera, në nëntokë” (*ligji nr. 150/2014*). Lidhur me këtë kërkesë, *DRSSH*-ja, Shkodër ka verifikuar dokumentacionin e vjetërsisë në punë të kërkesit, mbi bazën e të cilit ishte caktuar fillimisht trajtimi i veçantë i minatorit. Konkretisht, nga vërtetimet e dërguara nga Drejtoria



e Arkivit Qendror të Institutit të Sigurimeve Shoqërore, evidentohet dublim i periudhave të punësimit të kërkuesit në regjistrin themeltar të punonjësve nr. 5 të Parkut Automobilistik të Mallrave Pukë dhe regjistrin themeltar të punonjësve nr. 11 të Ndërmarrjes Gjeologjike Pukë.

2. Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pukë ka regjistruar procedimin penal nr. 52 të vitit 2015 për veprën penale të lartpërmendur në ngarkim të kërkuesit dhe pas kryerjes së hetimeve paraprake ka paraqitur në gjykatë kërkesë për gjykimin e tij.

3. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Pukë, me vendimin nr. 52-2016-171 (52), datë 19.5.2016, ka vendosur deklarimin fajtor të kërkuesit për kryerjen e veprës penale “Mashtrimi në sigurime”, të parashikuar nga neni 145 i KP-së dhe dënimin e tij me 6 (gjashtë) muaj burgim. Gjykata e shkallës së parë ka vendosur pezullimin e ekzekutimit të vendimit të dënimit me burgim dhe vënien në provë të kërkuesit për një periudhë kohore prej 18 muajsh, sipas nenit 59 të KP-së, si dhe e ka urdhëruar atë të mbajë kontakte me shërbimin e provës. Po kështu, bazuar në nenet 190 dhe 195 të Kodit të Procedurës Penale (KPP), gjykata ka urdhëruar që në dosjen e pensionit të kërkuesit, si dhe në librezën e tij të punës, ku ndodhet shënimi për periudhën e punësimit në Ndërmarrjen Gjeologjike Pukë, në fletën e regjistrit themeltar të punonjësve me nr. 11/341, të bëhen shënimet përkatëse si dokumente të falsifikuara për mospërdorimin e tyre. Kundër këtij vendimi ka paraqitur ankim kërkuesi.

4. Gjykata e Apelit Shkodër, me vendimin nr. 310, datë 21.3.2018, ka vendosur prishjen e vendimit të gjykatës së shkallës së parë dhe pushimin e çështjes penale në ngarkim të kërkuesit, duke arsyetuar se arsyetimi i gjykatës së shkallës së parë nuk gjen mbështetje në përfundimet e aktit të ekspertimit tekniko-grafik nr. 8841, datë 9.9.2015 (*akti i ekspertimit nr. 8841/2015*), si dhe nga provat e paraqitura nga organi i akuzës nuk provohet përtej çdo dyshimi të arsyeshëm se kërkuesi ka kryer veprën penale të parashikuar nga neni 145 i KP-së. Kundër këtij vendimi në datën 16.4.2018 ka ushtruar rekurs Prokuroria pranë Gjykatës së Apelit Shkodër (*Prokuroria e Apelit*).

5. Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, në dhomën e këshillimit, me vendimin nr. 00-2023-1811 (299), datë 7.11.2023, ka vendosur prishjen e vendimit të gjykatës së apelit dhe lënien në fuqi të vendimit të gjykatës së shkallës së parë, me arsyetimin se shkaqet

e ngritura në rekurs nga organi i akuzës janë të tilla që e cenojnë vendimin e gjykatës së apelit, për shkak të zbatimit të gabuar të ligjit procedural dhe material penal. Po sipas Kolegjit Penal, vendimmarrja e gjykatës së shkallës së parë është pa të meta ligjore në drejtim të arsyetimit dhe vlerësimit të provave në përputhje me ligjin procedural penal.

6. Në datën 5.2.2024 kërkuesi ka paraqitur ankim kushtetues individual në Gjykatën Kushtetuese (*Gjykata*), sipas objektit. Me vendimin e datës 5.4.2024, Kolegji i Gjykatës ka vendosur kalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve.

II

Pretendimet në Gjykatën Kushtetuese

7. **Kërkuesi**, në mënyrë të përmbledhur, ka pretenduar se i është cenuar:

7.1. *E drejta për proces të rregullt ligjor*, e garantuar nga neni 42 i Kushtetutës dhe neni 6 i KEDNJ-së, në drejtim të:

7.1.1. *Së drejtës për t'u dëgjuar*, pasi Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë ka disponuar në dhomën e këshillimit për ndryshimin e vendimit të gjykatës së apelit pa dëgjuar palët, në cenim të parimit sipas të cilit kushdo ka të drejtë të dëgjohet, si dhe në kundërshtim me parimet bazë për proces të rregullt ligjor, duke mos zbatuar drejt Kushtetutën dhe jurisprudencën e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (*GJEDNJ*). Pjesëmarrja e palëve në gjykim shërben për të mbrojtur në substancë të drejtat e tyre. Gjithashtu, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë nuk duhej të prishte vendimin e gjykatës së apelit në dhomën e këshillimit, por duhej që rekursin e Prokurorisë së Apelit ta kalonte për gjykim në seancë publike. Si pasojë e kësaj vendimmarrjeje është cenuar edhe e drejta për gjykim të drejtë.

7.1.2. *Së drejtës për gjykim brenda afatit të arsyeshëm*, pasi Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë ka shkelur afatet ligjore në gjykimin e çështjes.

7.1.3. *Standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor*, pasi Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë nuk e ka interpretuar drejt dhe saktë nenin 145 të KP-së lidhur me rrethanat dhe provat që janë paraqitur në gjykim, si dhe ka shkelur nenet 253 dhe 254 të Kodit të Procedurës Civile (*KPC*), pasi librezat e punës dhe vërtetimi i sigurimeve shoqërore janë dokumente të paraqitura nga kërkuesi, por janë të nxjerra nga organet shtetërore. Regjistri nr. 11 dhe faqja 341 e tij



përbëjnë prova të plota, pasi i janë nënshtruar aktit të ekspertimit nr. 8841/2015 të kryer nga Policia Shkencore, nga ku ka rezultuar se në to nuk ka as ndërhyrje dhe as falsifikim. Nga tërësia e provave të marra në shqyrtim, në kuadër të gjykimit të zakonshëm, nuk provohet fakti që kërkuesi të ketë kryer veprime të anës objektive të veprës penale të parashikuar nga neni 145 i KP-së.

7.2. *E drejta e sigurimeve shoqërore në pleqëri*, e garantuar nga neni 52 i Kushtetutës, pasi pavarësisht vjetërsisë në punë kërkuesi nuk ka përfituar pension pleqërie.

7.3. *E drejta për rehabilitim dhe/ose zhdëmtim në përputhje me ligjin*, e garantuar nga neni 44 i Kushtetutës, si pasojë e vendimmarrjes së Gjykatës së Lartë, në shkelje të neneve 228, 253 dhe 254 të KPC-së.

8. Subjekti i interesuar, Prokuroria e Përgjithshme, ka prapësuar si vijon:

8.1. Për cenimin e së drejtës për proces të rregullt ligjor:

8.1.1. Pretendimi për cenimin e *së drejtës për t'u dëgjuar* është i pabazuar, pasi edhe pse rekursi është gjykuar në dhomën e këshillimit, ai është marrë në shqyrtim nga Gjykata e Lartë, duke u dhënë përgjigje të argumentuar pretendimeve të ngritura në të. Kolegji Penal me të drejtë ka çmuar se vendimmarrja e gjykatës së apelit në drejtim të arsyetimit dhe vlerësimit të provave në përputhje me ligjin material e procedural penal është e cenueshme, në kushtet kur ajo gjykatë ka bërë vlerësim jo të saktë të provave, duke mos pasqyruar me vërtetësi rrethanat e faktit dhe duke mos ballafaquar dhe çmuar provat me njëra-tjetrën e konkretisht konkluzionet e aktit të ekspertimit nr. 8841/2015 me fletën e regjistrit themeltar të Ndërmarrjes së Parkut të Automjeteve Pukë. Gjykata e Lartë e ka ushtruar rolin e saj kontrollues në drejtim të ligjshmërisë dhe bazueshmërisë së vendimeve të ankmuara, pra mbi mënyrën e zbatimit të ligjit nga gjykatat më të ulëta dhe ka vendosur ta zgjidhë atë në dhomën e këshillimit sipas parashikimit të nenit 436/a, pika 1, të KPP-së.

8.1.2. Pretendimi për cenimin e procesit të rregullt ligjor si rrjedhojë e gjykimit të çështjes në dhomën e këshillimit nga Gjykata e Lartë është i pabazuar. Sipas procesverbalit të shqyrtimit të çështjes në dhomën e këshillimit të datës 31.10.2023 rezulton se palët në proces kanë pasur dijeni për zhvillimin e gjykimit në dhomën e këshillimit me anë

të shpalljes publike të datës 20.9.2023, të bërë nga Gjykata e Lartë. Edhe pse kërkuesi ka marrë dijeni për zhvillimin e gjykimit në dhomën e këshillimit, nuk ka paraqitur kundërrekurs brenda afatit ligjor. Kolegji Penal ka zbatuar parashikimet e KPP-së në lidhje me formimin e trupit gjykues, si dhe procedurën e gjykimit të çështjes. Kolegji Penal ka konstatuar se çështja mund të gjykohej në dhomën e këshillimit, çka e bën vendimin e Gjykatës së Lartë plotësisht legjitim. E ndodhur në situatën kur dy gjykatat e faktit kanë zbatuar në mënyra të ndryshme ligjin material në zgjidhjen e çështjes, Gjykata e Lartë ka ushtruar funksionin e saj si gjykatë ligji, duke iu referuar vlerësimit që gjykata e shkallës së parë u ka bërë provave dhe fakteve. Gjykata e Lartë e ka zgjidhur çështjen brenda funksionit të saj kushtetues, duke interpretuar ligjin material penal në lidhje me deklarinimin fajtor të të akuzuarit.

8.1.3. Kërkuesi nuk ka shteruar mjetet juridike për pretendimin për cenimin e së drejtës për gjykim brenda afatit të arsyeshëm. Ai i ka pasur të gjitha mundësitë t'i drejtohej Gjykatës së Lartë me kërkesë për konstatimin e cenimit të afatit të arsyeshëm dhe përshpejtimin e procedurës së shqyrtimit të rekursit të Prokurorisë së Apelit për çështjen në ngarkim të tij. Ndërkohë rezulton se ai nuk ka paraqitur kërkesë për konstatimin e shkeljes së afatit të arsyeshëm dhe përshpejtimin e procedurave sipas parashikimit të KPC-së.

8.1.4. Pretendimi për cenimin e standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor është i pabazuar. Veprimet dhe mosveprimet e kërkuesit në procesin penal janë analizuar edhe nga Gjykata e Lartë, ku është evidentuar mosrespektimi/zbatimi i gabuar i ligjit nga ana e gjykatës së apelit, për sa kohë që ajo gjykatë nuk ka vlerësuar drejt veprimet konkrete të atribuara të pandehurit nëpërmjet akuzës, në cilësinë e veprimeve, që përbëjnë elementet e figurës së veprës penale "Mashtrimi në sigurime". Ajo ka vlerësuar se pretendimet e paraqitura nga organi i akuzës janë të tilla që cenojnë vendimmarrjen e gjykatës së apelit, e cila nuk ka çmuar drejt provat e pranuar në gjykim, si dhe e ka mbështetur vendimmarrjen e saj për pafajësinë e kërkuesit në aktin e ekspertimit nr. 8841/2015. Po kështu, argumentet e parashtruara për këtë pretendim të kërkuesit lidhur me argumentimin nga gjykata të fajësisë së tij kanë të bëjnë me çmuarjen e provave nga gjykatat e zakonshme, çka është jashtë juridiksionit kushtetues.



8.2. Pretendimi për cenimin e *së drejtës së sigurimeve shoqërore* në pleqëri, të garantuar nga neni 52 i Kushtetutës, është i pabazuar. Në ndryshim nga sa pretendon kërkuesi, ligjet nr. 8685/2000 dhe nr. 150/2014 kanë përcaktuar rregulla të sakta e të qarta për përfitimin e pensionit të pleqërisë nga persona që realisht kanë kryer punë në nëntokë në periudha të caktuara kohore dhe jo nga persona që kanë përfutuar pensione duke manipuluar sikur kanë punuar në nëntokë, kur ndërkohë është vërtetuar përtej çdo dyshimi të arsyeshëm se ai ka qenë punonjës në ndërmarrje të tjera ose në kooperativë bujqësore. Është e drejtë e kërkuesit që në bazë të ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993, “Për sigurimet shoqërore”, të ndryshuar (ligji nr. 7703/1993) t’u drejtohet ose jo institucioneve kompetente për të përfutuar pension pleqërie për vitet reale të punës së kryer dhe nuk është detyrë e procesit penal për të garantuar pensionin e tij.

8.3. Pretendimi për cenimin e *së drejtës për rehabilitim dhe/ose zhvendim* në përputhje me ligjin, të garantuar nga neni 44 i Kushtetutës, është i pabazuar, pasi është plotësisht e qartë dhe e vërtetuar përtej çdo dyshimi të arsyeshëm të bazuar në prova se veprimet e ndërmarra prej tij për përfitimin e pensionit të pleqërisë janë në kundërshtim të plotë me ligjin nr. 7703/1993.

III

Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

A. Për legjitimitimin e kërkuesit

9. Çështja e legjitimitimit (*locus standi*) është një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja “P” dhe 134, pikat 1, shkronja “I” dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të ligjit nr. 8577/2000, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret e nenit 71/a të ligjit nr. 8577/2000, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike efektive, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësura në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale dhe mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur.

10. Gjykata vlerëson se kërkuesi, si bartës i të drejtave dhe lirive themelore të parashikuara në Kushtetutë, legjitimohet *ratione personae*, bazuar në nenet 131, pika 1, shkronja “P” dhe 134, pika 1, shkronja “I”, të Kushtetutës, pasi ka qenë palë në procesin gjyqësor në të cilin është dhënë vendimi i kundërshtuar, për rrjedhojë ka interes të drejtpërdrejtë në çështjen e parashtruar.

11. Një kriter tjetër paraprak është *shterimi i mjeteve juridike efektive*, që përcaktohet nga neni 131, pika 1, shkronja “P”, i Kushtetutës, sipas të cilit individ mund t’i drejtohet Gjykatës me ankim kushtetues individual vetëm pasi të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike efektive për mbrojtjen e të drejtave kushtetuese që ai pretendon se i janë cenuar. Ky rregull nënkupton jo vetëm që individ t’u jetë drejtuar të gjitha instancave të zakonshme, duke respektuar kërkesat formale dhe afatet e parashikuara në ligjin procedural, por edhe që të gjitha pretendimet që ngre në këtë Gjykatë t’i ketë paraqitur më parë në këto instanca, të paktën në substancë (*shih vendimet nr. 14, datë 21.6.2022; nr. 12, datë 9.3.2021; nr. 8, datë 19.3.2018, të Gjykatës Kushtetuese*).

12. Në rastin në shqyrtim Gjykata vëren se kërkuesi, ndër të tjera, ka pretenduar cenimin e së drejtës për proces të rregullt ligjor në drejtim të së drejtës për gjykim brenda afatit të arsyeshëm, pasi Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë ka shkelur afatet ligjore në gjykimin e çështjes. Në jurisprudencën e saj Gjykata ka theksuar se, si rregull, shqyrtimi i pretendimeve për cenim të afatit të arsyeshëm, pas hyrjes në fuqi të instrumentit mbi konstatimin e shkeljes së afatit të arsyeshëm, përshpejtimin e procedurave dhe shpërblimin e dëmit, sipas neneve 399/1 - 399/12 të KPC-së, duhet të bëhet nga gjykatat e zakonshme, sipas kompetencës që parashikon KPC-ja, në përputhje me parimin e subsidiaritetit (*shih vendimet nr. 24, datë 27.4.2023; nr. 3, datë 17.2.2022; nr. 2, datë 17.2.2022, të Gjykatës Kushtetuese*).

13. Në kuptim të sa më sipër, Gjykata konstaton se këtë pretendim kërkuesi e ka parashtruar për herë të parë në ankimin kushtetues individual. Ai nuk rezulton të ketë bërë ndonjë përpjekje dhe nuk ka përdorur ndonjë nga instrumentet e përcaktuara nga legjislacioni në fuqi për të kërkuar konstatimin e shkeljes së afatit të arsyeshëm dhe përshpejtimin e procedurave (*neni 399/5 i KPC-së*) përpara gjykatave të zakonshme. Për rrjedhojë, kërkuesi për



pretendimin për cenimin e së drejtës për gjykim brenda afatit të arsyeshëm nuk ka shteruar mjetet në dispozicion në kuptim të nenit 131, pika 1, shkronja “P”, të Kushtetutës dhe ai nuk mund të merret në shqyrtim. Ndaj dhe prapësimi i subjektit të interesuar, Prokurorisë së Përgjithshme, në këtë drejtim është i bazuar.

14. Pretendimet e tjera në drejtim të së drejtës për proces të rregullt ligjor, në aspekt të së drejtës për t’u dëgjuar dhe për gjykim të drejtë, standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor, të garantuara nga neni 42 i Kushtetutës, si dhe së drejtës së sigurimeve shoqërore në pleqëri, të garantuar nga neni 52 i Kushtetutës, e së drejtës për rehabilitim dhe/ose zhdëmtim në përputhje me ligjin, të garantuar nga neni 44 i Kushtetutës, në thelb, janë pretendime ndaj procesit gjyqësor në Gjykatën e Lartë, i cili ka përmbyllur procesin gjyqësor për shqyrtimin e themelit të çështjes. Për rrjedhojë, Gjykata vlerëson se për këto pretendime kërkuesi e ka përmbushur kriterin e shterimit të mjeteve juridike efektive.

15. Lidhur me legjitimitimin *ratione temporis*, neni 71/a, pika 1, shkronja “b”, i ligjit nr. 8577/2000, ka parashikuar afatin 4-mujor nga konstatimi i cenimit për paraqitjen e ankimit kushtetues individual. Në rastin në shqyrtim Gjykata vëren se procesi gjyqësor i kundërshtuar nga kërkuesi është përmbyllur me vendimin nr. 00-2023-1811 (299), datë 7.11.2023 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, ndërkohë që ankimi kushtetues individual është paraqitur në Gjykatë në datën 5.2.2024, pra brenda afatit ligjor 4-mujor. Në këto rrethana, Gjykata vlerëson se kërkuesi legjitimohet edhe *ratione temporis*.

16. Në drejtim të legjitimitimit *ratione materiae*, Gjykata vëren se kërkuesi ka pretenduar se gjatë procesit gjyqësor në Gjykatën e Lartë i është cenuar e drejta për proces të rregullt ligjor në drejtim të së drejtës për t’u dëgjuar dhe për gjykim të drejtë, standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor, të garantuara nga neni 42 i Kushtetutës, si dhe e drejta e sigurimeve shoqërore në pleqëri, e garantuar nga neni 52 i Kushtetutës, dhe e drejta për rehabilitim dhe/ose zhdëmtim në përputhje me ligjin, e garantuar nga neni 44 i Kushtetutës. Për sa u takon pretendimeve për cenimin e së drejtës për gjykim të drejtë, së drejtës së sigurimeve shoqërore në pleqëri dhe së drejtës për rehabilitim dhe/ose zhdëmtim në përputhje me ligjin, Gjykata konstaton se kërkuesi i ka paraqitur ato formalisht, pasi nuk ka dhënë ndonjë argument nga pikëpamja kushtetuese në

mbështetje të tyre, ndaj ato nuk do të merren në shqyrtim.

17. Në lidhje me pretendimin për cenimin e së drejtës për t’u dëgjuar, kërkuesi ka parashtruar se Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, i cili ka prishur vendimin e gjykatës së apelit dhe ka lënë në fuqi atë të gjykatës së shkallës së parë, duhet ta kalonte çështjen për gjykim në seancë publike. Po kështu, ai ka pretenduar se Kolegji Penal ka disponuar në dhomën e këshillimit për ndryshimin e vendimit të gjykatës së apelit pa dëgjuar palët. Gjykata në jurisprudencën e saj ka pranuar si element përbërës të procesit të rregullt ligjor edhe të drejtën për t’u dëgjuar. Kjo e drejtë ka për qëllim garantimin e një procesi gjyqësor, ku individit i krijohen mundësitë që përpara marrjes së vendimit gjyqësor të dëgjohet realisht për thelbin e çështjes. Nëpërmjet pjesëmarrjes dhe krijimit të kushteve për t’u dëgjuar, individëve u krijohen mundësi të barabarta për deklaratimet e tyre, për parashtrimin e fakteve, provave e vlerësimeve ligjore (*shih vendimet nr. 7, datë 12.3.2010; nr. 12, datë 6.6.2005, të Gjykatës Kushtetuese*). Gjykata ka pohuar se e drejta për t’u dëgjuar *nuk nënkupton vetëm atë për t’u paraqitur personalisht përpara organit gjyqësor, por ajo realizohet edhe përmes shqyrtimit të dokumenteve, pra mbi komentet dhe shpjegimet e dhëna me shkrim gjatë procesit gjyqësor (shih vendimet nr. 1, datë 16.2.2022; nr. 38, datë 2.12.2021, të Gjykatës Kushtetuese)*.

18. Në rastin në shqyrtim nga materialet e dosjes gjyqësore të administruar për qëllime të këtij gjykimi, Gjykata konstaton se, sikurse prapëson edhe subjekti i interesuar, Prokuroria e Përgjithshme, kërkuesi është njoftuar rregullisht për rekursin e subjektit të interesuar dhe në vijim palët në proces kanë pasur dijeni për zhvillimin e gjykimit në Gjykatën e Lartë në dhomën e këshillimit me anë të shpalljes publike të datës 20.9.2023. Pavarësisht këtyre fakteve, kërkuesi ka zgjedhur të mos ushtrojë të drejtën për të përdorur mjetet e parashikuara nga ligji (kundërrekurs ose parashtrime para seancës), si dhe nuk ka treguar ndonjë shkak pse nuk i ka ushtruar ato. Në këto kushte, Gjykata çmon se kërkuesit i është dhënë mundësia të shprehë qëndrimin e tij për çështjen dhe për realizimin e së drejtës për t’u dëgjuar, ndaj, për rrjedhojë, në lidhje me këtë pretendim, vlerëson se ai nuk ka arritur të provojë se si gjykimi i çështjes në dhomën e këshillimit në Gjykatën e Lartë ka cenuar thelbin e kësaj të drejte.



19. Për sa i përket pretendimit të kërkuarit se Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë duhej ta kalonte çështjen për gjykim në seancë publike, Gjykata vëren se neni 436/a i KPP-së përcakton se shqyrtimi i rekursit nga ky kolegji, si rregull, bëhet mbi bazë të dokumenteve në dhomën e këshillimit. Gjykata e Lartë, në dhomën e këshillimit, vendos shqyrtimin e çështjes në seancë gjyqësore me praninë e palëve vetëm në raste të veçanta të parashikuara në nenin 437, pika 1, të KPP-së. Gjykata në këtë drejtim ka theksuar se vlerësimi nëse çështja duhet të shqyrtohet në dhomë këshillimi ose në seancë publike u përket vetë kolegjeve të Gjykatës së Lartë (*shih vendimet nr. 38, datë 22.2.2023; nr. 21, datë 20.3.2017; nr. 8, datë 26.2.2015, të Gjykatës Kushtetuese*).

20. Në rastin konkret, duke qenë se kërkuari nuk ka pretenduar se gjendet përpara një prej rasteve të parashikuara në nenin 437, pika 1, të KPP-së për shqyrtimin e çështjes në seancë plenare, Gjykata çmon se ai nuk ka arritur të argumentojë se gjykimi i çështjes në dhomën e këshillimit nga Gjykata e Lartë ka ndikuar në të drejtat e tij procedurale. Për rrjedhojë, edhe ky pretendim i kërkuarit nuk mund të merret në shqyrtim në themel.

21. Në lidhje me standardin e arsytimit të vendimit, Gjykata vëren se kërkuari ka pretenduar se gjatë gjykimit nuk është provuar që ai të ketë kryer veprime që përfshihen në anën objektive të figurës së veprës penale të mashtrimit në sigurime. Gjykata, duke mbajtur në konsideratë se në thelb pretendimet e kërkuarit kanë të bëjnë me faktin se Gjykata e Lartë, duke lënë në fuqi vendimin e gjykatës së shkallës së parë, nuk ka arsyetuar në lidhje me provimin e fajësisë së tij përtej çdo dyshimi të arsyeshëm, do të analizojë në vijim bazueshmërinë në themel të pretendimeve të kërkuarit në këndvështrim të standardit të arsytimit të vendimit të lidhur me parimin e prezumimit të pafajësisë.

B. Për themelin e pretendimeve

B.1. Për cenimin e standardit të arsytimit të vendimit gjyqësor të lidhur me parimin e prezumimit të pafajësisë

22. Kërkuari ka pretenduar se Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë e ka gjykuar rekursin e Prokurorisë së Apelit duke mos interpretuar drejt dhe saktë nenin 145 të KP-së lidhur me rrethanat dhe provat që janë paraqitur në gjykim. Ai ka shkelur nenet 253 dhe 254 të KPC-së, pasi librezat e punës dhe vërtetimi i sigurimeve shoqërore janë dokumente të paraqitura nga kërkuari, por janë të nxjerra nga organet shtetërore. Regjistri nr. 11 dhe faqja 341 e tij

përbëjnë prova të plota, pasi i janë nënshtruar aktit të ekspertimit nr. 8841/2015 të kryer nga Policia Shkencore, nga ku ka rezultuar se në to nuk ka as ndërhyrje dhe as falsifikim. Nga tërësia e provave të marra në shqyrtim, në kuadër të gjykimit të zakonshëm, nuk provohet fakti që kërkuari të ketë kryer veprime të anës objektive në kryerjen e veprës penale të parashikuar nga neni 145 i KP-së.

23. Subjekti i interesuar, Prokuroria e Përgjithshme, ka prapësuar se gjykata e apelit ka bërë vlerësim jo të saktë të provave, duke mos pasqyruar me vërtetësi rrethanat e faktit dhe duke mos ballafaquar dhe çmuar provat në përputhje me njëra-tjetrën e konkretisht konkluzionet e aktit të ekspertimit nr. 8841/2015 me fletën e regjistrimit themeltar të Ndërmarrjes së Parkut të Automjeteve Pukë. Veprimet dhe mosveprimet e kërkuarit në procesin penal janë analizuar nga Gjykata e Lartë, ku është evidentuar mosrespektimi/zbatimi i gabuar i ligjit nga ana e gjykatës së apelit, për sa kohë që ajo gjykatë nuk ka vlerësuar drejt veprimet konkrete të atribuara të pandehurit nëpërmjet akuzës, në cilësinë e veprimeve, që përbëjnë elementet e figurës së veprës penale “Mashtrimi në sigurime”. Ajo ka vlerësuar se pretendimet e paraqitura nga organi i akuzës janë të tilla që cenojnë vendimmarrjen e gjykatës së apelit, e cila nuk ka i çmuar drejt provat e pranuar në gjykim, si dhe e ka mbështetur vendimmarrjen e saj për pafajësinë e kërkuarit në aktin e ekspertimit nr. 8841/2015. Po kështu, argumentet e parashtruara për këtë pretendim të kërkuarit lidhur me argumentimin nga gjykata të fajësisë së tij kanë të bëjnë me çmuarjen e provave nga gjykatat e zakonshme, çka është jashtë juridiksionit kushtetues.

24. Në jurisprudencën kushtetuese është pohuar se arsytimi i vendimeve gjyqësore është element thelbësor i një vendimi të drejtë dhe se funksioni i një vendimi të arsyetuar është t'u tregojë palëve që ato janë dëgjuar, si dhe u jep mundësinë atyre ta kundërshtojnë atë. Prandaj, Gjykata ka vlerësuar se vendimi duhet të mbështetet vetëm mbi faktet që janë paraqitur gjatë procesit gjyqësor dhe duhet të përmbajë bazën ligjore, analizën e provave dhe mënyrën e zgjidhjes së mosmarrëveshjes (*shih vendimet nr. 19, datë 7.7.2022; nr. 63, datë 23.9.2015; nr. 55, datë 18.12.2012, të Gjykatës Kushtetuese*). Po sipas Gjykatës, ajo e vlerëson arsytimin e një vendimi gjyqësor vetëm në kuadrin e përmbushjes ose jo të standardeve të mësipërme, pasi nuk është



kompetencë e saj të analizojë provat dhe faktet ku është bazuar gjykata për zgjidhjen e çështjes së themelit. Kjo mbetet detyrë funksionale e gjykatave të juridiksionit të zakonshëm. Detyra e saj është të shqyrtojë dhe vlerësojë nëse gjatë procesit gjyqësor ka pasur shkelje të të drejtave kushtetuese, si dhe nëse zbatimi i ligjit ka qenë eventualisht arbitrar, në kuptimin që të bjerë ndesh haptazi me konceptin e gjykimit të drejtë të përcaktuar në nenin 42 të Kushtetutës (*shih vendimet nr. 30, datë 29.5.2023; nr. 33, datë 14.11.2022; nr. 3, datë 23.2.2016, të Gjykatës Kushtetuese*).

25. Gjykata, gjithashtu, ka theksuar se në respektim të parimit të prezumimit të pafajësisë gjykatat e zakonshme nuk duhet ta fillojnë procesin me bindjen se i pandehuri ka kryer krimin për të cilin akuzohet, se barra e provës i takon palës akuzuese, se çdo dyshim duhet të shkojë në favor të të pandehurit dhe se gjykata duhet ta mbështesë vendimin në prova të drejtpërdrejta dhe të tërthorta që duhet të provohen nga akuza. Ato janë të detyruara të përcaktojnë faktet e çështjes, të rëndësishme për vlerësimin e përgjegjësisë ligjore të të akuzuarit, sa më qartë dhe saktë të jetë e mundur dhe nuk mund t'i paraqesin ato thjesht si aludime apo dyshime (*shih vendimet nr. 63, datë 20.11.2023; nr. 12, datë 24.4.2018; nr. 68, datë 14.11.2016, të Gjykatës Kushtetuese*). Po në këtë drejtim, bazuar edhe në jurisprudencën e GJEDNJ-së (*shih Salabiaku kundër Francës, 7 tetor 1988, §§ 27-28; Radio Franca dhe të tjerët kundër Francës, 30 mars 2004, § 24*), Gjykata ka pohuar se nuk ndalohen prezumimet ligjore ose të faktit në çështjet penale. Megjithatë, prezumimet duhet të jenë brenda kufijve të arsyeshëm, duke mbajtur në konsideratë rëndësinë e interesit që rrezikohet dhe të sigurojnë të drejtat e mbrojtjes (*shih vendimin nr. 63, datë 20.11.2023, të Gjykatës Kushtetuese*).

26. Në rastin konkret, duke marrë në konsideratë standardet e mësipërme, Gjykata do të analizojë në vijim nëse Gjykata e Lartë ka arsyetuar në lidhje me përgjegjësinë ligjore të kërkuesit në kuptim të të provuarit të fajësisë së tij përtej çdo dyshimi të arsyeshëm. Në këtë drejtim vërehet se gjykatat e faktit, duke u bazuar në aktet e ekspertimit të kryera gjatë procesit, kanë arritur në përfundime të ndryshme në lidhje me fajësinë e kërkuesit. Koncretisht, referuar materialeve të dosjes gjyqësore, Gjykata vëren se gjykata e shkallës së parë ka vendosur deklarinimin fajtor të kërkuesit për kryerjen e veprës penale “Mashtrimi në sigurime”, të parashikuar nga neni 145 i KP-së, pasi bazuar në provat e paraqitura në gjykim nga organi i

akuzës, ndër të cilat edhe akti i ekspertimit grafik nr. 8841/2015 i regjistrimit themeltar të punonjësve nr. 5 të Parkut Automobilistik të Mallrave Pukë dhe i regjistrimit themeltar të punonjësve nr. 11 të Ndërmarrjes Gjeologjike Pukë, rezultonte se kërkuesi ka konsumuar tërësisht elementet e veprës penale. Sipas saj, përveçse regjistri themeltar i punonjësve të Ndërmarrjes Gjeologjike ishte i falsifikuar (ka ndërhyrje), rezultonte se vjetërsia e punës së kërkuesit ishte e dubluar tërësisht në Ndërmarrjen e Parkut të Automjeteve Pukë dhe Kooperativën Bujqësore Korthpulë, në të cilat ka përputhshmëri të saktë të gjeneraliteteve të kërkuesit (*shih faqet 5 dhe 8 të vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pukë*).

27. Gjykata e apelit ka përsëritur shqyrtimin gjyqësor, duke bërë të mundur marrjen e provave të reja shkresore, si dhe ka kryer një akt ekspertimi të ri grafik të nënshkrimit, sipas të cilit nuk përjashtohet mundësia që nënshkrimet objekt ekspertimi të plotësuar në formën e emrit dhe mbiemrit të kërkuesit të jenë plotësuar nga vetë ai. Po sipas aktit të ri të ekspertimit, nënshkrimet objekt ekspertimi nuk mund të krahasohen me nënshkrimet modele për krahasim të plotësuar në formën e firmave në emër tij dhe të paraqitura për krahasim për arsye të ndryshmeve në mënyrën e ndërtimit dhe konfigurimit të tyre. Bazuar në këto prova, gjykata e apelit ka argumentuar se arsyetimi i gjykatës së shkallës së parë nuk gjen mbështetje në konkluzionet e aktit të ekspertimit nr. 8841/2015. Sipas saj, në ndryshim nga përfundimi i arritur nga gjykata e shkallës së parë se regjistri themeltar i punonjësve të Ndërmarrjes Gjeologjike është i falsifikuar (ka ndërhyrje), në pikën 2 të përfundimeve të aktit të ekspertimit nr. 8841/2015 rezulton se në këtë akt nuk konstatohen ndërhyrje (*shih faqen 4 të vendimit të Gjykatës së Apelit Shkodër*).

28. Bazuar në arsyetimin e mësipërm, gjykata e apelit ka çmuar se në mungesë të të provuarit të falsitetit të shënimeve të regjistrimit themeltar të punonjësve nr. 11 të Ndërmarrjes Gjeologjike Pukë, në emër të kërkuesit, nuk krijohet bindja se duke paraqitur këtë akt zyrtar në DRSSH-në, Shkodër për të përfituar pensionin e pleqërisë, kërkuesi ka paraqitur të dhëna të rreme. Në këto rrethana, ajo ka dalë në përfundimin se nga provat e paraqitura nga organi i akuzës nuk provohet përtej çdo dyshimi të arsyeshëm se kërkuesi ka kryer veprën penale “Mashtrimi në sigurime”, pasi duke pasur dy akte



zyrtare, që përjashtojnë njëri-tjetrin, duke qenë se te njëri prej tyre kishte ndërhyrje, ndërsa tek tjetri nuk kishte të tilla, nuk provohet fajësia e kërkuesit për këtë vepër penale. Në zbatim të parimit të prezumimit të pafajësisë, duke qenë se çdo dyshim për akuzën çmohet në favor të të pandehurit, gjykata e apelit ka arsyetuar se duke qenë para dy akteve zyrtare që përjashtojnë njëri-tjetrin, nuk provohet fajësia e kërkuesit për akuzën e ngritur (*shih faqet 5 dhe 6 të vendimit të Gjykatës së Apelit Shkodër*).

29. Kolegji Penal të Gjykatës së Lartë ka arsyetuar se gjykata e apelit ka bërë një vlerësim jo të saktë të provave, duke mos pasqyruar me vërtetësi rrethanat e faktit dhe duke mos ballafaquar dhe çmuar provat në përputhje me njëra-tjetrën e konkretisht konkluzionet e aktit të ekspertimit nr. 8841/2015 me provën e administruar në gjykim, që është fleta e regjistrit themeltar të Ndërmarrjes së Parkut të Automjeteve Pukë. Ky kolegji ka vlerësuar se shkaqet e ngritura nga prokurori janë të tilla që e cenojnë vendimin e gjykatës së apelit, ndërkohë që vendimmarrja e gjykatës së shkallës së parë është konsideruar pa të meta ligjore në drejtim të arsyetimit dhe vlerësimit të provave në përputhje me ligjin procedural penal (*shih paragrafët 17, 21 dhe 23 të vendimit të Gjykatës së Lartë*). Për të arritur në këtë përfundim Gjykata e Lartë ka analizuar përfundimet e aktit të ekspertimit grafik nr. 8841/2015 të regjistrit themeltar të punonjësve nr. 5 të Parkut Automobilistik të Mallrave Pukë dhe regjistrit themeltar të punonjësve nr. 11 të Ndërmarrjes Gjeologjike Pukë, si dhe të aktit të ri të ekspertimit grafik të nënshkrimit. Ajo ka arsyetuar se në regjistrin e ndërmarrjes së Parkut të Automjeteve Pukë ka korrigjime të ditës së fillimit të marrëdhënies së punës dhe askush tjetër nuk ka pasur interes për të pasqyruar këtë periudhë pune në regjistër, prandaj kërkuesi rezulton të ketë paraqitur rrethana të rreme pranë organeve të sigurimeve shoqërore, me qëllim përfitimin e padrejtë të pensionit, duke plotësuar elementet e veprës penale (*shih paragrafët 20 dhe 22 të vendimit të Gjykatës së Lartë*).

30. Duke analizuar faktet e mësipërme të çështjes në shqyrtim, Gjykata konstaton se Gjykata e Lartë ka lënë në fuqi vendimin e gjykatës së shkallës së parë, pavarësisht se në vendimin e saj nuk është arsyetuar lidhur me elementet e veprës penale, nuk është argumentuar se nga kush është falsifikuar fleta e regjistrit të punësimit dhe se si është arritur në këtë përfundim në lidhje me një dokument që është

administruar nga vetë DRSSH-ja, Shkodër. Në vlerësimin e Gjykatës, në kushtet kur aktet zyrtare kanë sjellë të dhëna të ndryshme për të njëjtin fakt, Gjykata e Lartë nuk ka vlerësuar përgjegjësinë ligjore të kërkuesit përmes arsyetimit të rrethanave faktike të rëndësishme për çështjen. Me fjalë të tjera, Gjykata e Lartë, duke u bazuar në vendimin e gjykatës së shkallës së parë, ka prezumuar faktin penal dhe autorin e veprës penale nisur nga interesi i kërkuesit për të përfituar pension. Në këtë mënyrë, prezumimi i faktit në kuptim të procesit të çmuarjes në tërësi të provave të paraqitura nga organi i akuzës, si dhe i mosdhënies vlerë të paracaktuar atyre, në arsyetimin e vendimit të Gjykatës së Lartë, nuk rezulton i argumentuar në lidhje me parimin e prezumimit të pafajësisë, në kuptim të të provuarit të fajësisë së tij tej çdo dyshimi të arsyeshëm.

31. Gjithashtu, Gjykata konstaton se për të arritur në një përfundim të tillë, Kolegji Penal duket se ka plotësuar arsyetimin e gjykatës së shkallës së parë, duke marrë në vlerësim aktet e ekspertimit teknik dhe të nënshkrimit, pra duke analizuar edhe një herë provat e marra në shqyrtim nga gjykatat e faktit (*shih paragrafët 20 dhe 22 të vendimit të Gjykatës së Lartë*). Në këtë mënyrë Gjykata e Lartë ka ripërcaktuar faktet e çështjes, duke bërë vlerësim të mëtejshëm të provave nga ai i gjykatave të juridiksionit të zakonshëm.

32. Për sa më lart, Gjykata vlerëson se mënyra se si ka vepruar Gjykata e Lartë në raport me pasojat e ardhura për kërkuesin (deklarim fajtor të tij), duke mos arsyetuar, nga njëra anë, se pse nuk duhet të merren në konsideratë rrethanat dhe provat që ishin në favor të kërkuesit dhe, nga ana tjetër, pse dyshimet për akuzën nuk janë çmuar në favor të tij, si dhe duke ripërcaktuar faktet e çështjes e duke bërë vlerësim të mëtejshëm të provave në kufijtë e hamendësimeve, vë në dyshim respektimin e së drejtës për proces të rregullt të parashikuar në nenin 42 të Kushtetutës, jo vetëm në drejtim të garantimit të parimit të prezumimit të pafajësisë, por edhe të gjykatës së caktuar me ligj, duke zhvilluar një proces i cili nuk pajtohet me natyrën e gjykimit në atë gjykatë.

33. Në përfundim, Gjykata vlerëson se pretendimi i kërkuesit për cenimin e së drejtës për proces të rregullt ligjor në drejtim të standardit të arsyetimit të vendimit të lidhur me parimin e prezumimit të pafajësisë dhe gjykatës së caktuar me



ligj është i bazuar, sipas arsytimit të mësipërm të këtij vendimi, ndaj kërkesa duhet të pranohet.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese, në mbështetje të neneve 131, pika 1, shkronja “P” dhe 134, pika 1, shkronja “I”, të Kushtetutës, si dhe neneve 72 e vijuese të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, njëzëri,

VENDOSI:

1. Pranimin e kërkesës.
 2. Shfuqizimin e vendimit nr. 00-2023-1811 (299), datë 7.11.2023, të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë.
 3. Dërgimin e çështjes për rishqyrtim në Gjykatën e Lartë.
- Ky vendim është përfundimtar dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Marrë më 19.9.2024.

Shpallur më 21.10.2024.

Kryetare: Holta Zaçaj

Anëtarë: Sonila Bejtja, Marsida Xhaferllari, Genti Ibrahim, Ilir Toska, Sandër Beci, Fiona Papajorgji, Marjana Semini

VENDIM

Nr. 64, datë 1.10.2024

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Holta Zaçaj,	kryetare;
Fiona Papajorgji,	anëtare;
Sonila Bejtja,	anëtare;
Ilir Toska,	anëtar;
Marjana Semini,	anëtare;
Marsida Xhaferllari.	Anëtare,

me sekretare Belma Lleshi, në datën 1.10.2024 mori në shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve çështjen nr. 6 (S) 2024, që u përket:

KËRKUESE: Sonila Muhametaj

SUBJEKTE TË INTERESUARA:

Këshilli i Lartë i Prokurorisë, përfaqësuar nga Danja Hobdari dhe Lorana Kasapi, me autorizim.

Elvin Gokaj

Alfred Shehu

OBJEKTI: Shfuqizimi i vendimeve të Këshillit të Lartë të Prokurorisë nr. 356, datë 3.11.2021, “Për miratimin e listës së kandidatëve për prokurorë pranë Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, të cilët plotësojnë kushtet ligjore”; nr. 385, datë 13.12.2021, “Për miratimin e shkallës së vlerësimit të kandidatëve për ngritjen në detyrë pranë Prokurorisë së Posaçme”; nr. 386, datë 13.12.2021, “Për miratimin e listës me renditjen e kandidatëve për prokurorë pranë Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar”; nr. 387, datë 13.12.2021, “Për emërimin si prokuror në Prokurorinë e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar të kandidatit Elvin Gokaj”; nr. 388, datë 13.12.2021, “Për emërimin si prokuror në Prokurorinë e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar të kandidatit Alfred Shehu”; vendimeve gjyqësore nr. 83, datë 1.12.2022 dhe nr. s’ka, datë 4.5.2023, të Gjykatës Administrative të Apelit; nr. 5, datë 10.7.2023, të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë; nr. 00-2023-4083, datë 25.9.2023, të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

Detyrimin e Këshillit të Lartë të Prokurorisë të riçelë procesin e vlerësimit të kandidatëve për SPAK-un në fazën fillestare.

BAZA LIGJORE: Nenet 4, 7, 17, 18, 42, 43, 116, 118, 124, 131, pika 1, shkronja “P”, 134, pikat 1, shkronja “I” dhe 2, 148 e vijuese të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (*Kushtetuta*); neni 6 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (*KEDNJ*); nenet 27, 49, pika 3, shkronja “e”, 71 dhe 71/a të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar (*ligji nr. 8577/2000*).

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes Marsida Xhaferllari, mori në shqyrtim parashtrimet me shkrim të kërkuases, që ka kërkuar pranimin e kërkesës, prapësimet me shkrim të subjekteve të



interesuara, Këshillit të Lartë të Prokurorisë (KLP) dhe prokurorit Elvin Gokaj, të cilat kanë kërkuar rrëzimin e kërkesës, konstatoi mungesën e prapësimeve me shkrim nga subjekti i interesuar, prokurori Alfred Shehu, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I

Rrethanat e çështjes

1. Kërkuesja është emëruar prokurore në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Krujë me dekretin nr. 5053, datë 4.10.2006 të Presidentit të Republikës. Prej datës 7.12.2021, me vendim të KLP-së, ajo ushtron detyrën e prokurores në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë.

2. Në datën 4.10.2021 KLP-ja ka vendosur fillimin e procedurave për ngritjen në detyrë nga radhët e prokurorëve për dy pozicione të lira në Prokurorinë e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar (*Prokuroria e Posaçme*) dhe në datën 8.10.2021 ka shpallur thirrjen për kandidim në këto procedura, së cilës i janë përgjigjur tre prokurorë, ndër ta edhe kërkuesja.

3. Pas përfundimit të afatit të kandidimit është ngritur Komisioni i Posaçëm për vlerësimin e kandidatëve për prokurorë në Prokurorinë e Posaçme. Gjatë procedurave, KLP-ja, me propozim të Komisionit të Posaçëm, ka nxjerrë 5 vendime: i. nr. 356, datë 3.11.2021, për miratimin e listës së kandidatëve që plotësonin kushtet ligjore për ngritjen në detyrë në Prokurorinë e Posaçme; ii. nr. 385, datë 13.12.2021, për miratimin e shkallës së vlerësimit të kandidatëve për ngritjen në detyrë në Prokurorinë e Posaçme; iii. nr. 386, datë 13.12.2021, për miratimin e listës së renditjes së kandidatëve për prokurorë në Prokurorinë e Posaçme për dy pozicionet e lira, ku kërkuesja është renditur e treta; iv. nr. 387, datë 13.12.2021, për emërimin e prokurorit të renditur i pari në Prokurorinë e Posaçme për një mandat 9-vjeçar pa të drejtë riemërimi; v. nr. 388, datë 13.12.2021, për emërimin e prokurorit të renditur i dyti në Prokurorinë e Posaçme për një mandat 9-vjeçar pa të drejtë riemërimi.

4. Kërkuesja është njohur me dokumentacionin e procedurave për ngritjen në detyrë dhe, duke mos qenë dakord me to, përfshirë vlerësimin e saj si

kandidate, në datën 13.1.2022 ka paraqitur padi në Gjykatën Administrative të Apelit, përmes së cilës ka kërkuar konstatimin e pavlefshmërisë absolute dhe shfuqizimin e 5 vendimeve të KLP-së, kualifikimin për emërimin e saj në Prokurorinë e Posaçme, si dhe detyrimin e KLP-së për të vijuar me procedurën e emërimit të saj si prokurore në atë prokurori.

5. Me vendimin nr. 36, datë 24.5.2022, Gjykata Administrative e Apelit ka vendosur pranimin e pjesshëm të padisë së kërkueses; konstatimin e pavlefshmërisë absolute të vendimeve nr. 385/2021, nr. 386/2021, nr. 387/2021 dhe nr. 388/2021 të KLP-së; detyrimin e KLP-së për të rishikuar procesin e përzgjedhjes të ngritjes në detyrë të kandidatëve për Prokurorinë e Posaçme; rrëzimin e padisë për kërkimet e tjera, si të pabazuara në ligj. Në dispozitivin e vendimit gjykata është shprehur se ai është përfundimtar dhe i formës së prerë.

6. Kundër vendimit ka paraqitur rekurs KLP-ja, e përfaqësuar nga Avokatura e Shtetit, për të cilin Gjykata Administrative e Apelit, në dhomën e këshillimit, ka vendosur mospranimin e tij. Avokatura e Shtetit ka paraqitur rekurs të veçantë ndaj vendimit të mospranimit të rekursit, si dhe kërkesë për pezullimin e ekzekutimit të vendimit të themelit të Gjykatës Administrative të Apelit. Me vendimin nr. 101(31157-00020-86-2022), datë 20.6.2022, Gjykata Administrative e Apelit, në dhomën e këshillimit, ka vendosur pranimin e rekursit të veçantë.

7. Në datën 1.7.2022 kërkuesja ka paraqitur kundërrekurs si ndaj rekursit të veçantë, ashtu edhe ndaj rekursit të KLP-së, duke kërkuar mospranimin e rekursit të veçantë dhe lënien në fuqi të vendimit të themelit të Gjykatës Administrative të Apelit.

8. Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë e ka shqyrtuar çështjen në dhomën e këshillimit dhe me vendimin nr. 00-2022-1717 (265), datë 7.7.2022, ka vendosur prishjen e vendimit të Gjykatës Administrative të Apelit për mospranimin e rekursit të KLP-së dhe të vendimit të themelit të asaj gjykate, duke e dërguar çështjen për rigjykim në shkallë të dytë, si dhe pushimin e gjykimit të kërkesës për pezullimin e ekzekutimit të vendimit, për shkak të mbetjes së saj pa objekt.

9. Në datën 30.11.2022 kërkuesja i është drejtuar me kërkesë Gjykatës Kushtetuese (*Gjykata*) për shfuqizimin si të papajtueshme me Kushtetutën të vendimeve të Gjykatës së Lartë dhe të Gjykatës Administrative të Apelit për pranimin e rekursit të



veçantë, si dhe të vendimeve të KLP-së të dhëna gjatë procedurës së ngritjes në detyrë të dy prokurorëve. Kolegji i Gjykatës, me vendimin nr. 12, datë 24.1.2023, ka vendosur moskalimin e çështjes në seancë plenare me arsyetimin se kërkesja nuk kishte shteruar mjetet juridike efektive në dispozicion.

10. Ndërkohë, Gjykata Administrative e Apelit, pas rigjykimit të çështjes, me vendimin nr. 83, datë 1.12.2022, ka vendosur rrëzimin e padisë së kërkeses, si të pabazuar në ligj dhe në prova. Kundër këtij vendimi kërkesja ka paraqitur rekurs, për të cilin Gjykata Administrative e Apelit, me vendimin e datës 4.5.2023, ka vendosur mospranimin e tij, me arsyetimin se rekursi ishte paraqitur jashtë afatit ligjor 30-ditor.

11. Në datën 10.5.2023 kërkesja ka paraqitur ankim të veçantë ndaj vendimit për mospranimin e rekursit. Gjykata Administrative e Apelit, me vendimin nr. 170, datë 12.5.2023, ka vendosur pranimin e rekursit të veçantë dhe e ka dërguar dosjen gjyqësore në Gjykatën e Lartë.

12. Kërkesja, pasi është njohur me procedurat e ndarjes së çështjes së saj në Gjykatën e Lartë, ka paraqitur kërkesën e datës 29.6.2023 për përjashtimin e gjyqtarit relator, me argumentin se ai kishte qenë pjesë e trupit gjykues në dhënien e vendimit të mëparshëm të Gjykatës së Lartë që kishte urdhëruar rigjykimin e çështjes së saj. Gjykata e Lartë, me vendimin nr. 5, datë 10.7.2023, ka vendosur mospranimin e kërkesës, me arsyetimin se trupi gjykues i Gjykatës së Lartë, përfshirë gjyqtarin për të cilin kërkohej përjashtimi në vendimin me të cilin ishte urdhëruar rigjykimin e çështjes nuk ishte shprehur për themelin e mosmarrëveshjes.

13. Në vijim, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2023-4083, datë 25.9.2023, ka vendosur mospranimin e rekursit të kërkeses kundër vendimit të datës 4.5.2023, të Gjykatës Administrative të Apelit, me të cilin ishte vendosur mospranimi i rekursit të saj ndaj vendimit gjyqësor të themelit.

14. Në datën 24.1.2024 kërkesja i është drejtuar Gjykatës me ankim kushtetues individual, sipas objektit, i cili pas plotësimit të tij, sipas parashikimeve të nenit 27 të ligjit nr. 8577/2000, është regjistruar në datën 15.2.2024. Me vendimin e datës 18.4.2024 Kolegji i Gjykatës ka vendosur kalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve.

15. Përpara shqyrtimit të çështjes në seancë plenare, Mbledhja e Gjyqtarëve, me vendimet e datave 17.4.2024 dhe 7.5.2024, ka vendosur pranimin e kërkesave të dy gjyqtarëve kushtetues për heqjen dorë nga shqyrtimi i çështjes, për shkak të pjesëmarrjes së tyre si anëtarë të KLP-së në marrjen e vendimeve të këtij organi që kundërshtohen nga kërkesja. Ndërsa me vendimin nr. 62, datë 23.9.2024, Gjykata ka vendosur deklarimin e mbarimit të mandatit përpara afatit të një gjyqtari tjetër kushtetues.

II

Pretendimet në Gjykatën Kushtetuese

16. **Kërkesja**, në mënyrë të përmbledhur, ka pretenduar se nga aktet e kundërshtuara i janë cenuar:

16.1. *E drejta për një proces të rregullt ligjor*, e garantuar nga neni 42 i Kushtetutës dhe neni 6 i KEDNJ-së, në aspektet e mëposhtme:

16.1.1. *E drejta për t'u gjykuar nga një gjykatë e paanshme*, pasi një prej gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë që vendosi mospranimin e rekursit të kërkeses ishte pjesë e trupit gjykues që kishte vendosur më parë prishjen e vendimit dhe kthimin e çështjes së saj për rigjykim. Në procesin e parë, trupi gjykues i Gjykatës së Lartë është shprehur edhe për kërkesën për pezullimin e ekzekutimit të vendimit, ndaj ka shfaqur haptazi mendim për themelin e çështjes. Ndonëse kërkesja kërkoj përjashtimin e gjyqtarit nga gjykimi, kërkesa e saj nuk u pranua nga Gjykata e Lartë.

16.1.2. *E drejta për t'u dëgjuar*, pasi çështja e kërkeses nuk u shqyrtua nga Gjykata e Lartë në seancën gjyqësore me pranimin e palëve, sipas dispozitave ligjore, duke cenuar edhe *parimet e transparencës dhe të kontradiktoritetit*. Prania e palëve ishte e detyrueshme për shkak të problematikave dhe kompleksitetit të çështjes.

16.1.3. *E drejta e aksesit dhe e ankimit substancial* në drejtim edhe të *së drejtës për mbrojtje efektive*, si rrjedhojë e arsyetimit të Gjykatës së Lartë për paraqitjen e rekursit të kërkeses jashtë afatit ligjor. Vendimi i Gjykatës Administrative të Apelit është arsyetuar pas 4 muajve nga shpallja dhe i është komunikuar kërkeses në datën 28.3.2023, ndaj afati ligjor 30-ditor për paraqitjen e rekursit ka filluar në datën 29.3.2023 dhe ka përfunduar në datën 29.4.2023, ditë e shtunë. Në kushtet kur dita e hënë, 1.5.2023,



ishte festë zyrtare, atëherë afati për paraqitjen e rekursit përfundonte në datën 2.5.2023. Rekursi është nënshkruar elektronikisht nga mbrojtësi në datën 27.4.2023, për shkak se gjendej jashtë shtetit, ndërsa kërkesja ishte në pamundësi ta postonte atë për arsye shëndetësore. Neni 445 i Kodit të Procedurës Civile (KPC) parashikon edhe afatin prekluziv 1-vjeçar për paraqitjen e rekursit nga shpallja e vendimit. Gjykata e Lartë nuk u ka dhënë përgjigje pretendimeve në themel të parashtruara prej saj në rekurs.

16.1.4. *Standardi i arsyetimit të vendimit gjyqësor*, pasi vendimi i Gjykatës së Lartë është jologjik dhe i paqartë në arsyetim e dispozitiv. Pjesa arsyetuese nuk lidhet me përfundimin e arritur dhe dispozitivi nuk gjen mbështetje në asnjë dispozitë ligjore. Vendimi është i paqartë nëse i referohet rekursit të veçantë ndaj vendimit të mospranimit ose rekursit ndaj vendimit të themelit. Gjykata e Lartë nuk u ka dhënë përgjigje pretendimeve në themel të parashtruara prej saj në rekurs, duke i cenuar të drejtën e aksesit substancial.

16.2. *E drejta për të fituar mjetet e jetesës me punë të ligjshme*, e garantuar nga neni 49 i Kushtetutës në drejtim të zhvillimit të karrierës profesionale.

16.3. *Dinjtëti, të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, drejtësia shoqërore dhe rendi kushtetues*, të garantuara si vlera themelore nga neni 3 i Kushtetutës dhe si detyrim i shtetit që buron nga neni 1 i KEDNJ-së.

16.4. *Parimet e ligjshmërisë, shtetit të së drejtës dhe të hierarkisë së normave juridike* të shprehura në nenet 4, 116 dhe 118 të Kushtetutës, pasi vendimet e kundërshtuara të KLP-së janë të bazuara në rregullore, të cilat bien në kundërshtim me ligjin dhe nuk respektojnë garancitë e nxjerrjes së akteve nënligjore.

17. **Subjekti i interesuar, KLP-ja**, në mënyrë të përmbledhur, ka prapësuar:

17.1. Kërkesja nuk legjitimohet për pretendimet që lidhen me vendimet e KLP-së dhe vendimin e themelit të Gjykatës Administrative të Apelit, pasi rekursi është paraqitur prej saj jashtë afatit ligjor, ndaj nuk ka shteruar mjetet juridike në dispozicion. Pretendimet e kërkeses, në thelb, nuk kanë natyrë kushtetuese, pasi kanë të bëjnë me vlerësimin e provave dhe interpretimin e ligjit nga gjykatat e zakonshme.

17.2. Pretendimi për cenimin e *së drejtës për t'u gjykuar nga një gjykatë e paanshme* nuk është ngritur në nivel kushtetues, pasi kërkesja nuk ka argumentuar

se si vendimarrja e gjyqtarit të Gjykatës së Lartë ka ndikuar në qëndrimin e Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë të përbërë nga 3 gjyqtarë. Thjesht fakti se një gjyqtar ka marrë pjesë në vendim nuk mjafton në vetvete për të mbështetur dyshimet për paanshmërinë e tij. Në të dyja vendimet e Gjykatës së Lartë për kërkesen, gjyqtari nuk ka shqyrtuar themelin e çështjes.

17.3. Pretendimi për cenimin e *së drejtës për t'u dëgjuar* është i pabazuar, për sa kohë procesi gjyqësor në shkallë të dytë është zhvilluar në seancë gjyqësore publike. Kërkesja mban qëndrim kontradiktor, pasi gjatë gjykimit në shkallë të dytë ka marrë pjesë vetëm në seancën përgatitore, ndonëse pretendon se prania e palëve në gjykim ishte e domosdoshme.

17.4. Pretendimet për cenimin e *së drejtës së aksesit, ankimit substancial dhe së drejtës së mbrojtjes* janë të pabazuara, pasi kërkesja nuk e ka ushtruar të drejtën e rekursit brenda afatit ligjor. Problemet shëndetësore të kërkeses, rrethanat familjare dhe ngarkesa në punë nuk justifikojnë kalimin e afatit ligjor. Pretendimi për përlllogaritjen e afatit me bazë mujore nuk bazohet në ligj, pasi afati është i caktuar në ditë dhe llogaritet me ditë.

17.5. Pretendimi për cenimin e *standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor* është i pabazuar. Vendimi i Gjykatës së Lartë është i rregullt në formë, i qartë, koherent dhe pa kundërthënie në përmbajtje. Interpretimi i ligjit nga Gjykata e Lartë nuk është arbitrar për sa i përket llogaritjes së afatit të paraqitjes së rekursit.

17.6. Pretendimi për cenimin e *së drejtës për të fituar mjetet e jetesës me punë të ligjshme* është i pabazuar, pasi kërkesja nuk është penguar në ushtrimin e profesionit.

18. **Subjekti i interesuar, prokurori Elvin Gokaj**, në mënyrë të përmbledhur, ka prapësuar:

18.1. Kërkesja nuk legjitimohet për të kundërshtuar shkallën e vlerësimit dhe pikëzimit tim nga KLP-ja. Pretendimet për vlerësimin që KLP-ja ka bërë ndaj personit tim janë tërësisht të pavërteta.

18.2. Pretendimet e kërkeses për procesin e vlerësimit të kandidaturave nga KLP-ja janë të pabazuara. Vlerësimet e kandidatëve janë në diskrecionin e anëtarëve të KLP-së dhe gjykata nuk mund të marrë atributet e KLP-së, pasi kjo do të cenonte parimin e ndarjes dhe balancimit të pushteteve. Vendimet gjyqësore për rrëzimin e padisë së kërkeses dhe mospranimin e rekursit të saj janë të drejta dhe të bazuara në ligj.



19. *Subjekti i interesuar, prokurori Alfred Shehu*, nuk ka paraqitur prapësime me shkrim, megjithëse është njoftuar rregullisht nga Gjykata.

III

Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

A. Për legjitimitimin e kërkuës

20. Çështja e legjitimitimit (*locus standi*) është një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja “P” dhe 134, pikat 1, shkronja “I” dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të ligjit nr. 8577/2000, çdo individ mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë edhe kriteret kumulative të nenit 71/a të ligjit nr. 8577/2000, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike efektive, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësura në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale dhe mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur.

21. Gjykata vëren se kërkuësja ka qenë palë në procesin administrativ të ngritjes në detyrë, ku KLP-ja ka dhënë 5 vendimet e kundërshtuara prej saj me ankimin kushtetues individual, si dhe palë në procesin gjyqësor për kundërshtimin e 5 vendimeve të KLP-së, që ka përfunduar me vendimet gjyqësore, që ajo kundërshton me ankimin kushtetues individual. Duke mbajtur në konsideratë se vendimet e KLP-së janë dhënë brenda të njëjtit proces administrativ, kanë dhënë efekte ndaj kërkuësës dhe në vijim, kanë qenë objekt shqyrtimi gjyqësor nga gjykatat e juridiksionit të zakonshëm, bazuar në padinë e ngritur prej saj, Gjykata çmon se kërkuësja e justifikon interesin në çështjen e parashtruar, ndaj legjitimohet *ratione personae*.

22. Një tjetër kriter paraprak i ankimit kushtetues individual lidhet me *shterimin e mjeteve juridike efektive*, i parashikuar nga neni 131, pika 1, shkronja “P”, i Kushtetutës dhe neni 71/a, pika 1, shkronja “a”, i ligjit nr. 8577/2000. Gjykata ka pohuar se ky kriter nënkupton që ankuesi duhet të shfrytëzojë në rrugë normale mjetet juridike, të cilat janë të përshtatshme, të disponueshme dhe të frytshme për një çështje konkrete. Shterimi i mjeteve përbën parakusht që duhet përmbushur nga kërkuësi, i cili përpara se t'i drejtohet Gjykatës duhet të vërtetojë se ka përdorur

të gjitha mjetet ligjore të njohura nga ligji dhe të mjaftueshme për të rivendosur të drejtat e shkelura (*shih vendimet nr. 43, datë 27.12.2022; nr. 38, datë 25.4.2017, të Gjykatës Kushtetuese*).

23. Në çështjen konkrete, Gjykata vëren se kërkuësja i është drejtuar asaj me ankim kushtetues individual pasi është ankuar në rrugë gjyqësore ndaj vendimeve të KLP-së, duke shfrytëzuar në formë mjetet e ankimit deri në Gjykatën e Lartë. Gjykata e apelit dhe në vijim Gjykata e Lartë kanë vendosur mospranimin e rekursit të kërkuësës për shkak të paraqitjes së tij jashtë afatit ligjor. Subjekti i interesuar, KLP-ja, në lidhje me vendimet e saj ka prapësuar se në kushtet kur rekursi nuk është paraqitur brenda afatit ligjor, atëherë kërkuësja nuk ka shteruar mjetet juridike në dispozicion për ato pretendime.

24. Në lidhje me këtë prapësim, Gjykata vëren se kërkuësja në ankimin kushtetues individual ka kundërshtuar 5 vendime të KLP-së, vendimin e gjykatës së apelit për rrëzimin e padisë së saj për kundërshtimin e tyre, si dhe vendimmarrjen e gjykatës së apelit dhe Gjykatës së Lartë për mospranimin e rekursit ndaj vendimit të gjykatës së apelit. Lidhur me vendimet gjyqësore për mospranimin e rekursit, ajo ka parashtruar argumentin se ato janë rrjedhojë e një procesi të parregullt ligjor dhe për të cilat ajo nuk ka mjete të tjera ankimi në dispozicion. Në këtë pikë, Gjykata çmon se vlerësimi i pretendimeve të kërkuësës për kushtetutshmërinë e procesit gjyqësor për mospranimin e rekursit ka rëndësi përcaktuese nëse kërkuësja i ka shteruar ose jo mjetet juridike për pretendimet ndaj vendimeve të KLP-së dhe vendimit të gjykatës së apelit për rrëzimin e padisë. Me fjalë të tjera, nëse procesi gjyqësor për mospranimin e rekursit ka qenë në përputhje me Kushtetutën, atëherë ajo e ka humbur mundësinë për t'i ngritur ato pretendime, ndërsa nëse procesi gjyqësor për mospranimin e rekursit nuk ka qenë në përputhje me Kushtetutën dhe si i tillë duhet të përsëritet, atëherë kërkuësja ka ende mjete në dispozicion – rekursin në Gjykatën e Lartë. Në këtë situatë, Gjykata çmon se ndonëse kërkuësja i ka shteruar mjetet juridike në dispozicion për pretendimet ndaj vendimeve gjyqësore për mospranimin e rekursit, për pretendimet e tjera që lidhen me vendimet e KLP-së dhe vendimin e gjykatës së apelit për rrëzimin e padisë, Gjykata do



të shprehet pasi të vlerësojë kushtetutshmërinë e procesit gjyqësor për mospranimin e rekursit.

25. Lidhur me legjitimitimin *ratione temporis*, neni 71/a, pika 1, shkronja “b”, i ligjit nr. 8577/2000 ka parashikuar afatin ligjor 4-mujor nga konstatimi i cenimit për paraqitjen e ankimit kushtetues individual. Gjykata në jurisprudencën e saj, në rastet e kundërshtimit të vendimeve të Gjykatës së Lartë, ka llogaritur afatin 4-mujor, duke filluar nga data në të cilën vendimi i arsyetuar është bërë i disponueshëm për palët përmes njoftimit elektronik të tij, në rast se palët kanë lënë të dhënat elektronike të kontaktit (*shih vendimet nr. 14, datë 7.3.2024; nr. 42, datë 19.9.2023, të Gjykatës Kushtetuese*).

26. Në çështjen konkrete, Gjykata vëren se vendimi i Gjykatës së Lartë për mospranimin e rekursit të kërkuësës është dhënë në datën 25.9.2023 dhe i është komunikuar asaj në rrugë elektronike në datën 5.1.2024, ndërsa ankimi kushtetues individual është paraqitur në datën 24.1.2024, pra brenda afatit ligjor 4-mujor.

27. Në drejtim të legjitimitimit *ratione materiae*, kërkuësja ka kundërshtuar vendimmarrjen e gjykatave të zakonshme për mospranimin e rekursit, duke pretenduar, ndër të tjera, cenimin e së drejtës për t’u dëgjuar për shkak se Gjykata e Lartë, edhe pse çështja ishte komplekse, e ka shqyrtuar atë në dhomën e këshillimit dhe jo në seancë gjyqësore me pjesëmarrjen e palëve.

28. Gjykata vëren se ligji nr. 49/2012, datë 3.5.2012, “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar parashikon se gjykatat administrative, sipas natyrës së çështjes, i shqyrtojnë çështjet gojarisht në seancë gjyqësore ose mbi bazë të akteve shkresore, në dhomën e këshillimit (neni 3, pika 4). Po kështu, procedurat për shqyrtimin e kushteve formale të ankimit zhvillohen në dhomën e këshillimit, mbi bazën e dokumenteve dhe pa pjesëmarrjen e palëve (nenet 58 dhe 60), ndërsa shqyrtimi i rekursit në Gjykatën e Lartë, si rregull, bëhet mbi bazë të dokumenteve, në dhomën e këshillimit (neni 61). Në rastin konkret, Gjykata e Lartë është vënë në lëvizje përmes ankimit të veçantë të kërkuësës, duke iu dhënë në këtë mënyrë mundësia për t’u dëgjuar me shkrim në lidhje me pretendimet e saj.

29. Për sa më lart, Gjykata çmon se kërkuësja nuk ka arritur të argumentojë se si gjykimi i çështjes në dhomën e këshillimit nga Gjykata e Lartë ka ndikuar në këtë të drejtë kushtetuese. Vetëm argumenti se

çështja duhej të ishte shqyrtuar në seancë publike për shkak të kompleksitetit, nuk është i mjaftueshëm për të vënë në dyshim respektimin e së drejtës për proces të rregullt, për sa kohë që Gjykata e Lartë ka vepruar në përputhje me kompetencat e saj dhe me rregullat procedurale që gjejnë zbatim. Siç është pohuar në jurisprudencën kushtetuese, veprimtaria seleksionuese e dhomës së këshillimit në Gjykatën e Lartë është një veprimtari e domosdoshme në funksion të aksesit në gjykatë vetëm të atyre çështjeve që i parashikon ligji, duke lënë jashtë përzgjedhjes kërkesat e paarsyeshme dhe haptazi të pambështetura në ligj. Sipas këtyre standardeve, kur kërkesat e ligjit për kalimin në seancë nuk janë plotësuar, vendoset për mospranimin e kërkesës dhe ky lloj shqyrtimi paraprak vlerësues është kompetencë vetëm e trupës së gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë në dhomën e këshillimit (*shih vendimet nr. 16, datë 16.3.2021; nr. 26, datë 27.3.2017, të Gjykatës Kushtetuese*). Për rrjedhojë, Gjykata çmon se pretendimi i kërkuësës për cenimin e së drejtës për t’u dëgjuar është haptazi i pabazuar dhe nuk mund të merret në shqyrtim *ratione materiae*.

30. Kërkuësja ka pretenduar edhe cenimin e parimit të gjykimit nga një gjykatë e paanshme, së drejtës së aksesit dhe ankimit substancial në drejtim të së drejtës për mbrojtje efektive, si dhe të standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor për shkak të vendimmarrjes së gjykatës së apelit dhe Gjykatës së Lartë për mospranimin e rekursit. Gjykata vëren se këto pretendime lidhen me aspekte të së drejtës për proces të rregullt ligjor të garantuar nga neni 42 i Kushtetutës dhe, si të tilla, përfshihen në juridiksionin kushtetues. Për sa u takon pretendimeve për cenimin e së drejtës së aksesit, ankimit substancial, së drejtës për mbrojtje efektive dhe standardit të arsyetimit, Gjykata vëren se argumentet e kërkuësës, në thelb, kanë të bëjnë me mënyrën se si gjykatat e zakonshme kanë arsyetuar vendimmarrjen e tyre për mospranimin e rekursit të saj, duke i vënë në dyshim të drejtën për të marrë përgjigje përfundimtare nga gjykatat. Për rrjedhojë, Gjykata çmon ta shqyrtojë themelin e këtyre pretendimeve në këndvështrimin e së drejtës së aksesit të lidhur me standardin e arsyetimit të vendimit gjyqësor.

31. Për sa më lart, Gjykata do të analizojë në vijim pretendimet e kërkuësës për cenimin e parimit të gjykimit nga një gjykatë e paanshme dhe së drejtës



së aksesit substancial të lidhur me standardin e arsytimit të vendimit gjyqësor.

B. Për themelin e pretendimeve

B.1. Për cenimin e së drejtës për t'u gjykuar nga një gjykatë e paanshme

32. Kërkuesja ka pretenduar se Gjykata e Lartë në dhënien e vendimit për mospranimin e rekursit të saj i ka cenuar të drejtën për t'u gjykuar nga një gjykatë e paanshme, pasi një prej gjyqtarëve ishte pjesë e trupit gjykues të Gjykatës së Lartë që kishte vendosur më parë prishjen e vendimit të gjykatës së apelit në favor të kërkueses dhe kthimin e çështjes për rigjykim. Sipas kërkueses, gjyqtari në rastin e parë kishte shfaqur haptazi mendimin e tij për themelin e çështjes, veçanërisht kur kishte shqyrtuar kërkesën për pezullimin e ekzekutimit të vendimit. Për më tepër, sipas kërkueses, ajo kërkoi përjashtimin e gjyqtarit, por Gjykata e Lartë nuk e pranoi kërkesën e saj.

33. Subjekti i interesuar, KLP-ja, ka prapësuar se kërkueses nuk i është cenuar e drejta për t'u gjykuar nga një gjykatë e paanshme, pasi në të dyja vendimet e dhëna Gjykata e Lartë nuk ka shqyrtuar themelin e çështjes. Sipas KLP-së, thjesht fakti se një gjyqtar ka marrë pjesë në vendim nuk mjafton në vetvete për të mbështetur dyshimet për paanshmërinë e tij. Po kështu, sipas KLP-së, kërkuesja nuk ka arritur të argumentojë se si vendimmarrja e gjyqtarit të Gjykatës së Lartë ka ndikuar në qëndrimin e Kolegjit Administrativ të kësaj gjykate, të përbërë nga 3 gjyqtarë. Ndërsa, subjekti i interesuar, prokurori Elvin Gokaj, nuk ka paraqitur prapësime në lidhje me këtë pretendim.

34. Gjykata në jurisprudencën e saj ka theksuar se gjykimi nga një gjykatë e paanshme është një nga elementet e rëndësishme të procesit të rregullt ligjor, të garantuar nga neni 42 i Kushtetutës dhe neni 6 i KEDNJ-së. Parimi i paanshmërisë nënkupton mungesën e paragjyqimeve nga gjyqtarët për çështjen e shtruar përpara tyre. Një gjykatë duhet të jetë e paanshme jo vetëm formalisht, por edhe në mënyrë të shprehur. E drejta për t'u gjykuar përpara një gjykate kompetente, të pavarur dhe të paanshme, të caktuar me ligj, kërkon që drejtësia jo vetëm duhet të bëhet, por ajo, gjithashtu, duhet të shihet që bëhet (*shih vendimet nr. 21, datë 26.9.2022; nr. 10, datë 13.2.2017; nr. 49, datë 10.7.2015, të Gjykatës Kushtetuese*). Po kështu, Gjykata ka pohuar se respektimi i këtij parimi duhet të verifikohet duke zbatuar dy teste, testin subjektiv, i cili, në thelb,

kërkon të provuarit e faktit se bindja personale e një gjyqtari ka ndikuar në vendimin e gjykatës dhe, gjithashtu, testin objektiv, i cili kërkon të provuarit nëse gjyqtari ka ofruar garanci të mjaftueshme për të përjashtuar çdo dyshim të arsyeshëm në këtë drejtim. Në kuptim të testit subjektiv, paanshmëria e gjyqtarëve duhet të prezumohet derisa të provohet e kundërta. Për sa i përket testit objektiv, ai nënkupton se veç sjelljes personale të çdo anëtarit të trupit gjykues duhet të provohet nëse ka fakte bindëse të cilat vënë në dyshim paanshmërinë. Në këtë kuadër, edhe dukja e jashtme ka rëndësi. Për rrjedhojë, kur vlerësohet nëse në një çështje konkrete ka një arsye të përligjur që rrezikon paanshmërinë e një trupi gjykues, këndvështrimi i atyre që paraqesin këtë pretendim ka rëndësi, por vendimtar mbetet përcaktimi nëse ky dyshim është objektivisht i justifikueshëm (*shih vendimet nr. 10, datë 12.4.2022; nr. 10, datë 13.2.2017; nr. 49, datë 10.7.2015, të Gjykatës Kushtetuese*).

35. Duke iu kthyer çështjes konkrete, Gjykata vëren se pretendimi i kërkueses është parashtruar në drejtim të testit objektiv të parimit të paanshmërisë së gjykatës, ndaj për t'i dhënë përgjigje pretendimit të saj duhet analizuar nëse Gjykata e Lartë, pjesë e së cilës ishte gjyqtari i kundërshtuar nga kërkuesja, ka ofruar garanci të mjaftueshme për të përjashtuar çdo dyshim të arsyeshëm në këtë drejtim. Me fjalë të tjera, Gjykata do të verifikojë nëse ka fakte bindëse të cilat vënë në dyshim paanshmërinë e Gjykatës së Lartë në dhënien e vendimit të mospranimin të rekursit dhe nëse dyshimi i kërkueses është objektivisht i justifikueshëm.

36. Gjykata vëren se Gjykata e Lartë, e përbërë nga tre gjyqtarë, në datën 7.7.2022 ka dhënë vendimin për prishjen e vendimit të gjykatës së apelit për mospranimin e rekursit të KLP-së, prishjen e vendimit të themelit të gjykatës së apelit, i cili ishte në favor të kërkueses dhe dërgimin e çështjes për rishqyrtim në shkallë të dytë, si dhe pushimin e gjykimit për kërkesën e KLP-së për pezullimin e ekzekutimit të vendimit. Gjykata e Lartë në vendimin e saj, në mënyrë të përmbledhur, ka arsyetuar se: i. vendimi për mospranimin e rekursit të KLP-së ishte rrjedhojë e interpretimit të gabuar të ligjit nr. 96/2016, "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", i cili, në ndryshim nga sa interpretonte gjykata e apelit, e lejonte rekursin në Gjykatën e Lartë ndaj vendimeve të themelit të kësaj natyre; ii. vendimi i themelit i



gjykatës së apelit për pranimin e pjesshëm të padisë së kërkuësës ishte rrjedhojë e shkeljeve procedurale në marrjen e vendimit, që kishin të bënin me mungesën e shumicës vendimmarrëse të gjyqtarëve në arsyetimin e vendimit (konkretisht nga tre gjyqtarë që formojnë trupi gjykues, një prej tyre ishte në pakicë, ndërsa një prej dy gjyqtarëve të shumicës kishte shprehur mendim paralel, por që në thelb kundërshtonte dispozitivin e vendimit); iii. në kushtet kur vendimi i themelit të gjykatës së apelit duhej prishur dhe çështja duhej të kthehej për rishqyrtim, atëherë kërkesa e KLP-së për pezullimin e ekzekutimit të atij vendimi mbetet pa objekt, ndaj gjykimi i saj duhej pushuar (*shih vendimin nr. 00-2022-1717 (265), datë 7.7.2022, të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, faqet 15–21, paragrafët 41-44, 48-56 dhe 57–59*).

37. Pas rigjyimit të çështjes në shkallë të dytë, gjykata e apelit në datën 1.12.2022 ka vendosur rrëzimin e padisë së kërkuësës, ndërsa në datën 4.5.2023 ka vendosur mospranimin e rekursit të saj, me arsyetimin se ishte paraqitur jashtë afatit ligjor 30-ditor, duke i njohur kërkuësës të drejtën e rekursit të veçantë. Me regjistrimin e çështjes në Gjykatën e Lartë, rekursi i veçantë i është caktuar për shqyrtim Kolegjit Administrativ të përbërë nga 3 gjyqtarë, njëri prej të cilëve kishte marrë pjesë në dhënien e vendimit të mëparshëm në Gjykatën e Lartë. Kërkuësja ka paraqitur kërkesë për përjashtimin e gjyqtarit në fjalë, por Gjykata e Lartë, e formuar nga një gjyqtar i ndryshëm nga ata të trupit gjykues, me vendimin e datës 10.7.2023, ka vendosur mospranimin e saj, duke arsyetuar se në vendimin për kthimin e çështjes së themelit për rigjykim në gjykatën e apelit, trupi gjykues nuk ishte shprehur për themelin e mosmarrëveshjes administrative, ndaj gjyqtari i saj për të cilin kërkuësja kishte kërkuar përjashtimin nuk ndodhej në kushtet e nenit 72, pika 4, të KPC-së. Në vijim, Gjykata e Lartë në datën 25.9.2023 ka dhënë vendimin për mospranimin e rekursit të veçantë, me arsyetimin se ai nuk përmbante shkaqe ligjore që e bënin të cenueshëm vendimin e Gjykatës Administrative të Apelit dhe konstatimi i kësaj të fundit se rekursi ishte paraqitur jashtë afatit ligjor ishte në përputhje me situatën faktike dhe ligjore. Nga ana tjetër, pretendimet e kërkuësës të parashtruara në rekursin e veçantë për çështjen e themelit nuk mund të merreshin në shqyrtim, pasi vendimi i Gjykatës Administrative të Apelit për rrëzimin e kërkesëpadisë nuk ishte objekt

shqyrtimi nga Kolegji Administrativ (*shih vendimin nr. 00-2023-4083, datë 25.9.2023, të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, faqja 4*).

38. Gjykata vëren se, në ndryshim nga sa pretendon kërkuësja, Gjykata e Lartë, edhe pse formalisht ka pasur për shqyrtim të njëjtin proces gjyqësor me të njëjtat palë ndërgjyqëse, në thelb ka shqyrtuar çështje të ndryshme juridike. Kështu, gjatë shqyrtimit të rekursit të KLP-së, Gjykata e Lartë, në përputhje me kompetencat kushtetuese dhe ligjore të saj, ka shqyrtuar zbatimin e ligjit procedural për të drejtën ligjore të rekursit të palëve ndaj vendimit të gjykatës së apelit, në lidhje me llojin e vendimit që kundërshtohet, si dhe për procesin vendimmarrës në lidhje me formimin e shumicës së gjyqtarëve në dhënien e vendimit. Ndërsa gjatë shqyrtimit të rekursit të veçantë të kërkuësës, Gjykata e Lartë, në përputhje me kompetencat kushtetuese dhe ligjore të saj, ka shqyrtuar kushtin ligjor të afatit të paraqitjes së rekursit dhe pasojat e mosrespektimit të tij. Në këtë mënyrë, pretendimi i kërkuësës se gjyqtari i Gjykatës së Lartë që ka dhënë dy vendime në çështjen e saj ka pasur paragjykim të papajtuësme me parimin e paanësisë, nuk qëndron. Në këtë pikë, Gjykata vë në dukje se Gjykata e Lartë, sipas nenit 141 të Kushtetutës, ushtron rolin e saj si gjykatë ligji për të gjithë territorin e vendit dhe për shkak të kësaj karakteristike kushtetuese, në parim, nuk përjashtohet mundësia që i njëjti gjyqtar të japë disa vendime brenda të njëjtit proces gjyqësor, nëse çështjet ligjore që shqyrtohen janë të ndryshme. Gjykata, kur ka shqyrtuar pretendime për cenimin e parimit të paanësisë për shkak të pjesëmarrjes së të njëjtit gjyqtar në dhënien e dy vendimeve në Gjykatën e Lartë, ka analizuar nëse vendimet e kundërshtuara janë marrë në përfundim të proceseve gjyqësore që kanë karakteristika të dallueshme dhe që bazohen në konsiderata dhe vlerësime të ndryshme të gjyqtarëve. Sipas Gjykatës, pjesëmarrja e të njëjtëve gjyqtarë në dy vendimet e dhëna për rrethana të ndryshme të çështjes, nuk krijon dyshim të justifikuar për mosrespektimin e parimit të gjykimit nga një gjykatë e paanshme (*shih vendimin nr. 22, datë 20.5.2013, të Gjykatës Kushtetuese*).

39. Për sa më sipër, Gjykata çmon se Gjykata e Lartë, në të cilën bënte pjesë gjyqtari i kundërshtuar nga kërkuësja, ka ofruar garanci të mjaftueshme për të përjashtuar çdo dyshim të arsyeshëm në drejtim të testit objektiv të parimit të paanshmërisë së gjykatës, pasi nuk ka fakte bindëse që të vënë në



dysim paanshmërinë e saj dhe dysimi i kërkuës nuk është objektivisht i justifikueshëm. Për rrjedhojë, pretendimi i kërkuës për cenimin e së drejtës për t'u gjykuar nga një gjykatë e paanshme është i pabazuar.

B.2. Për cenimin e së drejtës së aksesit substancial të lidhur me standardin e arsyetimit të vendimit gjyqësor

40. Kërkuësja ka pretenduar se vlerësimi i gjykatës së apelit dhe Gjykatës së Lartë se rekursi i saj ishte paraqitur jashtë afatit ligjor 30-ditor, është rrjedhojë e zbatimit të gabuar të ligjit, çka i ka cenuar asaj të drejtat kushtetuese. Sipas saj, vendimi i gjykatës së apelit për mospranimin e rekursit ndaj vendimit që kishte rrëzuar padinë ndaj vendimeve të KLP-së i është komunikuar në datën 28.3.2023, ndaj afati ligjor 30-ditor ka filluar në datën 29.3.2023 dhe, për shkak të pushimit javor dhe festave zyrtare, ka përfunduar në datën 2.5.2023. Gjithashtu, kërkuësja ka parashtruar se rekursi është nënshkruar nga avokati elektronikisht në datën 27.4.2023, ndërsa ajo ka qenë në pamundësi për ta postuar vetë atë për shkak të gjendjes shëndetësore. Sipas saj, vendimi i Gjykatës së Lartë për mospranimin e rekursit është jologjik dhe i paqartë, arsyetimi nuk lidhet me dispozitivin dhe nuk kuptohet nëse është vendosur mospranimi i rekursit të themelit apo i rekursit të veçantë. Po kështu, sipas kërkuës, Gjykata e Lartë nuk u ka dhënë përgjigje pretendimeve në themel të parashtruara prej saj në rekurs.

41. Subjekti i interesuar, KLP-ja, ka prapësuar pretendimet e kërkuës, duke theksuar se ajo nuk e ka ushtruar të drejtën e rekursit brenda afatit ligjor dhe se problemet e saj shëndetësore, rrethanat familjare dhe ngarkesa në punë nuk justifikojnë kalimin e afatit ligjor. Sipas KLP-së, përllogaritja e gjykatave për afatin është i saktë, pasi afati është caktuar nga ligji në ditë dhe llogaritet me ditë. Po sipas KLP-së, vendimi i kundërshtuar i Gjykatës së Lartë është i rregullt në formë, i qartë, koherent dhe pa kundërthënie në përmbajtje, ndërsa interpretimi i ligjit prej saj lidhur me afatin e paraqitjes së rekursit nuk është arbitrar. Subjekti i interesuar, prokurori Elvin Gokaj, ka prapësuar se vendimi i Gjykatës së Lartë për mospranimin e rekursit është i drejtë dhe i bazuar në ligj.

42. Gjykata ka theksuar se shteti i së drejtës nuk mund të konceptohet pa u njohur individëve të drejtën për t'iu drejtuar gjykatës, e cila nuk përfshin vetëm të drejtën për të filluar një proces, por edhe të drejtën për të pasur një zgjidhje gjyqësore

përfundimtare për mosmarrëveshjen. Nëse mohohet kjo e drejtë, procesi konsiderohet i parregullt, sepse akses i gjykatë është, përpara së gjithash, kusht kryesor për të realizuar mbrojtjen e të drejtave të tjera të individit (*shih vendimet nr. 29, datë 1.11.2022; nr. 11, datë 21.4.2022; nr. 17, datë 24.3.2014, të Gjykatës Kushtetuese*). Megjithatë, e drejta e aksesit mund të kufizohet kur bëhet fjalë për kushtet e pranueshmërisë së një ankimi, siç janë afatet e përcaktuara në Kushtetutë dhe ligje, të cilat janë në funksion të parimit të sigurisë juridike (*shih vendimet nr. 9, datë 7.2.2017; nr. 18, datë 31.3.2014; nr. 17, datë 19.6.2009, të Gjykatës Kushtetuese*). Sipas Gjykatës, mbrojtja kushtetuese dhe ligjore e të drejtave dhe lirive të individit mund të realizohet vetëm kur ushtrohet brenda afateve ligjore të përcaktuara. Përcaktimi i këtyre afateve nuk përbën një qëllim në vetvete, por bëhet për mbrojtjen e të drejtave të të tjerëve. Vendosja e afateve ligjore kohore synon garantimin e parimit të sigurisë juridike, miradministrimin e drejtësisë, realizimin e një procesi të rregullt ligjor, dhënien e drejtësisë në kohën e duhur, si dhe shmangien e abuzimit me të drejtat (*shih vendimet nr. 27, datë 18.5.2023; nr. 9, datë 7.2.2017; nr. 26, datë 15.12.2008, të Gjykatës Kushtetuese*).

43. Gjykata ka pohuar, gjithashtu, se e drejta për një proces të rregullt ligjor përfshin edhe të drejtën për të pasur një vendim gjyqësor të arsyetuar, që i garantohet individit nga nenet 42 dhe 142, pika 1, të Kushtetutës. Arsyetimi i vendimeve është element thelbësor i një vendimi të drejtë. Funksioni i një vendimi të arsyetuar është t'u tregojë palëve që ato janë dëgjuar, si dhe u jep mundësinë atyre ta kundërshtojnë atë. Vendimi gjyqësor në çdo rast duhet të jetë logjik, i rregullt në formë dhe i qartë në përmbajtje. Në tërësinë e tij ai duhet konsideruar si një unitet, në të cilin pjesët përbërëse janë të lidhura ngushtësisht mes tyre (*shih vendimet nr. 19, datë 7.7.2022; nr. 2, datë 11.2.2021; nr. 3, datë 20.1.2017, të Gjykatës Kushtetuese*).

44. Në mënyrë konstante Gjykata ka pohuar se është detyrë e gjykatave të juridiksionit të zakonshëm të vlerësojnë faktet dhe provat e administruara, si dhe të interpretojnë ligjin për qëllim të procesit gjyqësor që ato zhvillojnë, ndërsa detyra e saj është të vlerësojë nëse gjatë procesit gjyqësor ka pasur shkelje të të drejtave kushtetuese, si dhe nëse zbatimi i ligjit ka qenë eventualisht arbitrar, në kuptimin që të bjerë ndesh haptazi me konceptin e



grykimit të drejtë të përcaktuar në nenin 42 të Kushtetutës. Grykata nuk vepron si shkallë e katërt grykimi, por ajo ndërhyr atëherë kur gabimi ligjor ose faktik nga grykatat e juridiksionit të zakonshëm është aq i dukshëm, sa një grykatë e arsyeshme nuk mund ta kishte bërë ndonjëherë ose është i tillë që grykimit e bën të padrejtë (*shih vendimet nr. 59, datë 14.11.2023; nr. 30, datë 29.5.2023; nr. 33, datë 14.11.2022, të Grykatës Kushtetuese*).

45. Nën dritën e standardeve të mësipërme për procesin e rregullt ligjor, Grykata do të verifikojë nëse kërkueses i është e respektuar e drejta e aksesit substancial, pra e drejta e saj për të marrë zgjidhje përfundimtare nga grykatat e zakonshme, e cila materializohet edhe nëpërmjet ushtrimit të mjeteve të ankimit, përfshirë rekursin. Për t'i dhënë përgjigje kësaj pyetjeje, Grykata do të analizojë nëse grykatat e zakonshme, që kanë shqyrtuar kushtet formale të paraqitjes së rekursit të kërkueses dhe veçanërisht afatin, i kanë arsyetuar vendimet e tyre pa gabime ligjore ose faktike të dukshme, duke mbajtur në konsideratë se vendimet e tyre për mospranimin e ankimit ndikojnë drejtpërdrejt në aksesin e individit në grykatë.

46. Duke iu kthyer çështjes konkrete, Grykata vëren se grykata e apelit në datën 1.12.2022 ka vendosur rrëzimin e padisë së kërkueses, në mungesë të saj. Vendimi i është komunikuar kërkueses në datën 28.3.2023, e cila ka paraqitur rekurs në datën 28.4.2023. Grykata e apelit në datën 4.5.2023 ka vendosur mospranimin e rekursit të kërkueses, për shkak të paraqitjes së tij jashtë afatit ligjor 30-ditor, me arsyetimin se afati i paraqitjes së rekursit është i prerë dhe fillon nga e nesërmja e njoftimit, ndaj kishte përfunduar në datën 27.4.2023.

47. Në rekursin e veçantë drejtuar Grykatës së Lartë, kërkuesja ka pretenduar se grykata e apelit ka gabuar në llogaritjen e afatit ligjor, pasi rekursi i paraqitur në datën 28.4.2023 ishte brenda afatit. Në mbështetje të këtij pretendimi, ajo ka parashtruar disa argumente, të tilla si: muaji ka 30 ditë kalendarike ndaj afati duhej llogaritur me bazë mujore dhe si i tillë përfundonte në të njëjtën ditë të muajit vijues, pra më 29.4.2023; për shkak të pushimit javor dhe festës zyrtare, afati në rastin e saj ka përfunduar në datën 2.5.2023; rrethanat familjare, gjendja shëndetësore dhe ngarkesa në punë kanë ndikuar në paraqitjen e rekursit në javën e fundit të afatit ligjor. Gjithashtu, kërkuesja në rekursin e veçantë ka ngritur edhe pretendime ndaj vendimit të

themelit të grykatës së apelit që kishte vendosur rrëzimin e padisë së saj.

48. Grykata e Lartë, në përfundim të shqyrtimit të rekursit të veçantë, në datën 25.9.2023 ka vendosur mospranimin e tij, duke arsyetuar se: i. shkaqet e ngritura ndaj vendimit të themelit për rrëzimin e padisë nuk mund të merreshin në shqyrtim, pasi ai vendim nuk ishte objekt i shqyrtimit të rekursit të veçantë; ii. shkaqet e parashtruara ndaj vendimit të grykatës së apelit për mospranimin e rekursit nuk qëndronin. Lidhur me këtë të fundit, Grykata e Lartë ka vënë në dukje se rrethanat familjare, shëndetësore dhe të punës nuk përbënin argument ligjor për zgjatjen e afatit ligjor, i cili ishte afat prekluziv, për më tepër kërkuesja kishte pasur avokat, i cili e kishte nënshkruar në datën 27.4.2023 dhe mund ta dërgonte rekursin me postë. Po kështu, sipas Grykatës së Lartë, pretendimi për llogaritjen e afatit me bazë mujore ishte i pabazuar në ligj, pasi ishte afat i caktuar nga ligji në ditë dhe llogaritej me ditë (*shih vendimin nr. 00-2023-4083, datë 25.9.2023, të Kolegjit Administrativ të Grykatës së Lartë, faqja 4, paragrafët 8-10*).

49. Duke i analizuar të dhënat e mësipërme, Grykata çmon se llogaritja e afatit të paraqitjes së rekursit nga grykata e apelit dhe më pas nga Grykata e Lartë rezulton të jetë bërë duke treguar bazën ligjore të zbatueshme dhe përmes një interpretimi të arsyeshëm të saj. Në këtë mënyrë, ndonëse aksesin e kërkueses është kufizuar nga vendimi i mospranimit të rekursit, kufizimi i tij është në përputhje me Kushtetutën, për sa kohë rekursi është paraqitur prej saj përtej afatit ligjor. Po kështu, Grykata çmon se vendimi i Grykatës së Lartë, ndryshe nga sa pretendon kërkuesja, paraqitet i rregullt në formë dhe në përmbajtje, dhe në pjesën arsyetuese u jep përgjigje pretendimeve të saj të parashtruara në rekursin e veçantë. Në tekstin e vendimit të Grykatës së Lartë, përfshirë dispozitivin, nuk ka pasaktësi, por qartësisht kuptohet se objekt i shqyrtimit ka qenë rekursi i veçantë ndaj vendimit të grykatës së apelit për mospranimin e rekursit. Për rrjedhojë, Grykata vlerëson se vendimi i Grykatës së Lartë nuk rezulton të jetë jologjik, kontradiktor ose i paqartë në përmbajtje. Interpretimi që Grykata e Lartë i ka bërë ligjit të zbatueshëm në çështjen e kërkueses nuk rezulton të ketë qenë arbitrar, në kuptimin që bie ndesh me konceptin e grykimit të drejtë të përcaktuar në nenin 42 të Kushtetutës.



50. Për sa më lart, Gjykata vlerëson se pretendimi i kërkuës për cenimin e së drejtës së aksesit substancial të lidhur me standardin e arsytimit të vendimit gjyqësor, si rrjedhojë e mospranimit të ankimit të saj të veçantë, është i pabazuar.

51. Duke iu kthyer edhe një herë pretendimeve të kërkuës në lidhje me vendimet e KLP-së dhe vendimin e gjykatës së apelit që ka rrëzuar padinë e saj, Gjykata, ashtu siç vuri në dukje më lart në këtë vendim (*shih paragrafët 23–24 të vendimit*), arrin në përfundimin se këto pretendime nuk mund të merren në shqyrtim. Në kushtet kur nga gjykimi kushtetues i çështjes rezultoi se procesi gjyqësor për mospranimin e rekursit të kërkuës ka qenë në përputhje me Kushtetutën, atëherë ajo e ka humbur mundësinë për t'i ngritur ato pretendime në ankimin kushtetues individual për sa kohë nuk janë shteruar mjetet juridike që kërkuësja ka pasur në dispozicion.

52. Në përfundim, Gjykata çmon se pretendimet e kërkuës për cenimin e parimit të gjykimit nga një gjykatë e paanshme dhe së drejtës së aksesit substancial të lidhur me standardin e arsytimit të vendimit janë të pabazuara, ndaj kërkesa duhet të rrëzohet, sipas arsytimit të mësipërm të këtij vendimi.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese, në mbështetje të neneve 131, pika 1, shkronja “P” dhe 134, pika 1, shkronja “I”, të Kushtetutës, si dhe nenit 72 të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, njëzëri,

VENDOSI:

1. Rrëzimin e kërkesës.

Ky vendim është përfundimtar dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Marrë më 1.10.2024.

Shpallur më 23.10.2024.

Kryetare: Holta Zaçaj

Anëtarë: Sonila Bejtja, Fiona Papajorgji, Marsida Xhaferllari, Marjana Semini, Ilir Toska

VENDIM

Nr. 00-2024-1611 (125), datë 22.5.2024

NË EMËR TË REPUBLIKËS

Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, me trup gjykues të përbërë nga gjyqtarët:

Ilir Panda kryesues;

Medi Bici anëtar;

Sokol Binaj anëtar;

Albana Boksi anëtare;

Sandër Simoni anëtar,

në datat 28. 9.2023, 26.10.2023 dhe 22.5.2024, mori në shqyrtim, në seancë gjyqësore publike, çështjen penale që u përket:

KËRKUES: Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë

KUNDËR: Bledar Bedini (Imami)

OBJEKTI: Miratimin e kërkesës për dhënien e pëlqimit për ekstradim nga Shqipëria në Itali të shtetasit shqiptar Bledar Bedini *alias* Bledar Imami.

BAZA LIGJORE: Konventa Evropiane “Për Ekstradimin”, datë 13.12.1957 (ratifikuar me ligjin nr. 8498, datë 10.6.1999) dhe Protokollin e Katërt shtesë të saj, neni 489 e vijues i Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Shqipërisë, si dhe nenet 32 e 33, të ligjit nr. 10193, datë 3.12.2009, “Për marrëdhëniet juridiksionale me autoritetet e huaja në çështjet penale”, i ndryshuar me ligjet nr. 100/2012, datë 18.3.2013, nr. 97/2021, datë 7.7.2021.

KOLEGJI PENAL I GJYKATËS SË LARTË,

pasi dëgjoi relatimin e gjyqtarit Medi Bici; prokurorin pranë Prokurorisë së Përgjithshme Arqilea Koça, i cili kërkoj prishjen e vendimit të Gjykatës së Apelit Tiranë dhe lënien në fuqi të vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë; mbrojtësin e zgjedhur, avokatin Ardian Visha, i cili kërkoj lënien në fuqi të vendimit të Gjykatës së Apelit Tiranë dhe e bisedoi çështjen në tërësi, në përfundim;

VËREN:

I. Rrethanat e çështjes:

1. Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë ka paraqitur për shqyrtim, në datën 18.3.2022, në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, kërkesën me objekt: Miratimin e kërkesës për



dhënien e pëlqimit për ekstradim nga Shqipëria në Itali të shtetasit Bledar Bedini *alias* Bledar Imami.

2. Rezulton se më datë 15.2.2022, nga ana e Policisë Gjyqësore është kryer arrestimi i përkohshëm, për qëllim ekstradimi, i shtetasit shqiptar Bledar Bedini *alias* Bledar Imami, pasi ky subjekt mbi bazën e vendimit të Gjykatës së Apelit të Milanos, nr. 57/2009 SIEP, datë 13.6.2005, është dënuar me 7 vjet burgim që i ka mbetur për t'u shlyer, pjesë e dënimit më të madh që i është dhënë për 10 vjet burgim, për kryerjen e veprës penale "Trafikim narkotikësh", parashikuar nga neni 110 i Kodit Penal Italian (në vijim KP Italian), vendim i cili është bërë përfundimtar më datë 13.1.2009.

3. Me vendimin nr. 57/2009 SIEP, datë 21.1.2009, të Prokurorisë së Përgjithshme të Republikës në Milano, shtetasi shqiptar Bledar Bedini *alias* Bledar Imami është shpallur në kërkim ndërkombëtar për ekzekutimin e dënimit që i ka mbetur për t'u shlyer, 7 vjet burgim sipas vendimit nr. 57/2009, datë 13.6.2005, të Gjykatës së Apelit të Milanos, i akuzuar për kryerjen e veprës penale "Trafikim narkotikësh". Mbi bazën e kërkesës së Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë për vlefhtësimin e ligjshëm të arrestit të shtetasit Bledar Bedini (Imami) për qëllime ekstradimi, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr. 394 akti, datë 17.2.2022, ka vendosur: Vlefhtësimin e ligjshëm të arrestit në flagrancë të kryer nga policia gjyqësore, më datë 15.2.2022, ndaj shtetasit shqiptar Bledar Bedini (Imami). Caktimin ndaj shtetasit shqiptar Bledar Bedini (Imami) të masës së sigurimit personal "arrest në burg" për qëllime ekstradimi nga shteti shqiptar në shtetin italian. Ngarkohet Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Tiranë për ekzekutimin e këtij vendimi. Një kopje e këtij vendimi t'i dërgohet Ministrisë së Drejtësisë Tiranë, etj.....

4. Me shkresën nr. 867/3 prot, datë 17.3.2022, Ministria e Drejtësisë, në vijim të komunikimeve mbi arrestimin për qëllime ekstradimi nga Shqipëria në Itali të shtetasit shqiptar Bledar Bedini *alias* Bledar Imami, i datëlindjes 1.3.1971, banues në Tiranë, i ka komunikuar Prokurorisë së Përgjithshme kërkesën datë 7.3.2022, të Ministrisë së Drejtësisë së Republikës së Italisë për ekstradimin nga Republika e Shqipërisë në Republikën e Italisë të shtetasit shqiptar Bledar Bedini *alias* Bledar Imami, i lindur më datë 1.3.1971.

5. Me shkresën nr. 325/16 prot., datë 18.3.2022, Prokuroria e Përgjithshme i ka dërguar Prokurorisë

pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë, kërkesën nr. 867/3 prot., datë 17.3.2022, të Ministrisë së Drejtësisë, për ekstradimin nga Republika e Shqipërisë në Republikën e Italisë të shtetasit shqiptar Bledar Bedini *alias* Bledar Imami.

6. Në kërkesën e datës 7.3.2022, të Ministrisë së Drejtësisë së Republikës së Italisë për ekstradimin e shtetasit shqiptar Bledar Bedini *alias* Bledar Imami parashtrohet:

- Shtetasi Bledar Bedini *alias* Bledar Imami, është i kërkuar në nivel ndërkombëtar mbi bazën e urdhrin për burgim me nr. 57/2009 SIEP të dhënë më datë 21.1.2009, nga Prokuroria e Përgjithshme e Republikës së Milanos për ekzekutimin e dënimit për 7 vjet burgim, që i ka mbetur për t'u shlyer pjesë e dënimit më të madh që i është dhënë me 10 vjet burgim, i cili është bërë përfundimtar më datë 13.1.2009, për veprën penale të importit, mbajtjes dhe shitjes së substancave narkotike të llojit kokainë dhe të pjesëmarrjes në shoqatë që kishte për qëllim importimin, mbajtjen dhe hyrjen e substancave narkotike të llojit kokainë, fakte të kryera midis vitit 2000 dhe vitit 2001.

- Kërkesa për ekstradim bazohet në rregullat e përcaktuara nga Konventa Evropiane, e nënshkruar në Paris, më datë 13.12.1957, e plotësuar dhe modifikuar nga Protokollin i Dytë, i Tretë dhe i Katërt shtesë, përkatësisht të firmosura në datat 17.3.1987, 10.11.2010 dhe 20.9.2012, si dhe në marrëveshjen e dyanshme shtesë të të njëjtës konventë, nënshkruar në Tiranë më datë 3.12.2007.

- Sipas kërkesës, sistemi juridik italian parashikon se dënimi me burgim të përjetshëm nuk parashkruhet, nga ana tjetër që dënimi me burgim shuhet për shkak të parashkrimit me kalimin e një kohe të barabartë me dyfishin e dënimit të dhënë, por gjithsesi, jo më të madhe se tridhjetë vjet dhe jo më të vogël se dhjetë vjet.

7. Në urdhrin e ekzekutimit me burgim nr. 57/2009 SIEP, datë 21.9.2009, urdhërohet ekzekutimi i vendimit të Gjykatës së Apelit të Milanos, i datës 13.6.2005, i cili është bërë përfundimtar dhe i pakthyeshem më datë 13.1.2009, në ngarkim të Bledar Imami *alias* Bledar Bedini, i biri i Halilit, datëlindja 1.3.1971, lindur në Tiranë, Shqipëri, i arratisur, njohur fajtor për veprat penale, të parashikuara nga neni 110 KP Italian, neni 81 c. 2 KP Italian, neni 73 c. i parë - DPR 309/1990, neni 73 c. i gjashtë, DPR 309/1990, neni 80 c. i dytë, DPR 309/1990; kryer në datën 15.9.2000, e duke



vazhduar deri në datën 18.5.2001 episod shkronja “d” - vendi: Milano e në vend tjetër 1) neni 110 KP Italian, neni 81 c. 2) KP Italian, neni 73 c. i parë - DPR 309/ 1990, neni 73 c. i gjashtë, DPR 309/1990, neni 80 c. i dytë, DPR 309/1990; kryer në datën 15.9.2000 e duke vazhduar deri më datë 18.5.2001 episod shkronja “e” - vendi: Milano e në vend tjetër, neni 74 c. i dytë DPR 309/1990 kryer më datë **.9.2000 e duke vazhduar deri më **.5.2001- vendi Milano e në vend tjetër. Në lidhje me gjendjen e ekzekutimit thuhet se është i lirë dhe është lëshuar urdhri i ekzekutimit për dënimin prej 7 (shtatë) vjetësh e gjobë prej 110.000 euro. Në vijim, është paraqitur kërkesa për aplikimin e favorizimeve sipas neneve 174 dhe 672 të KPP, të lëshuar në datën 21.1.2009 dhe si pasojë i është ulur dënimi në masën 3 vjet burgim dhe gjobë 10.000 euro, duke i mbetur për të vuajtur gjithsej 7 vjet burgim e gjobë prej 100.000 euro.

8. Në vendimin e Gjykatës së Apelit të Milanos, nr. SIEP 57/2009, datë 13.6.2005, i cili është bërë përfundimtar më datë 13.1.2009, shtetasi shqiptar Bledar Bedini *alias* Bledar Imami është dënuar me 7 (shtatë) vjet burgim për kryerjen e veprave penale “Importimi, mbajtja dhe shitja e narkotikëve” dhe “Pjesëmarrja në organizatë kriminale me qëllim, importimin, mbajtjen dhe shitjen e substancave narkotike”, parashikuar nga nenet 81 KPV. KP, 110-81 KPV. KP, - 73 CO. 1 E6- 80 CO. 2 DPR 309/974 CO 2 DPR 309/90, sepse me disa veprime aktive është konsideruar përgjegjës për veprat penale të specifikuara më sipër, pasi ka marrë pjesë në një organizatë të qëllimshme për importimin nga Holanda të sasive të konsiderueshme me kokainë të destinuara për shitje në tregjet klandestine në Milano, Torino dhe se ka bashkëpunuar me të tjerët për të shitur sasitë e përmendura në momentin që mbërrinin në Itali. Veprat për të cilat dënohet Bledar Bedini *alias* Bledar Imami nuk janë të natyrës politike apo ushtarake, si dhe nuk janë në prag të parashkrimit.

9. **Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë**, me vendimin nr. 375 akti, datë 14.9.2022, ka vendosur:

Pranimin e kërkesës së Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Miratimin e kërkesës për lejimin e ekstradimit nga Republika e Shqipërisë në Republikën e Italisë të shtetasit shqiptar Bledar Bedini *alias* Bledar Imami, i biri i Halilit dhe Refijes, i datëlindjes 1.3.1971, lindur dhe banues në rrugën “Bajram

Curri”, pallatet “1 Maji”, shkalla nr. 34, apartamenti nr. 1, Tiranë, sipas kërkesës së autoriteteve italiane.

10. Gjykata e shkallës së parë, arsyeton se *pas analizës së provave të përshkruara më sipër konstaton: Së pari, Republika e Shqipërisë ka ratifikuar Konventën Evropiane mbi Ekstradimin në 13 dhjetor 1957. Ndodhur në këto kushte, Gjykata vlerëson që plotësohet parashikimi i nenit 11 të KP, që parashikon lejimin e ekstradimit të shtetasve në rastet kur është parashikuar shprehimisht në marrëveshjet ndërkombëtare në të cilat Republika e Shqipërisë është palë, siç është shteti kërkuar Italia. Së dyti, veprat penale për të cilat është dënuar shtetasi shqiptar Bledar Bedini (Imami) parashikohen si të tilla edhe nga KP i Republikës së Shqipërisë. Së treti, Gjykata vlerëson që në rastin konkret nuk ka arsye të mendohet që shtetasi shqiptar Bledar Bedini (Imami) do t’ju nënshtrohet persekutimeve ose diskriminimeve për shkak të racës, seksit, fesë, gjnës, bindjeve politike, gjendjes personale a shoqërore ose dënimeve apo trajtimeve të egra, ç’njëzore a poshtëruese, por as edhe veprimeve që përbëjnë shkelje të një të drejte apo lirie themelore të njeriut. Së katërti, nuk rezulton që për veprat penale, të cilat ka kryer shtetasi shqiptar Bledar Bedini (Imami) të jetë dhënë amnisti nga shteti shqiptar. Së pesti, nuk rezultoi që të jetë parashikuar dënimi i dhënë sipas ligjit të shtetit italian. Gjykata, bazuar në dokumentacionin bashkëlidhur mbi ekstradimin e shtetasit shqiptar Bledar Bedini *alias* Bledar Imami, Bledar Bedini (Imami), mbështetur në Konventën Evropiane “Për Ekstradimin”, datë 13 dhjetor 1957, dhe Protokollin e Katërt shtesë të saj, nenit 489 e vijues të KPP të Republikës së Shqipërisë, si dhe nenet 32 e 33, të ligjit nr. 10193, datë 3.12.2009, “Për marrëdhëniet juridiksionale me autoritetet e huaja në çështjet penale”, i ndryshuar me ligjet nr. 100/2012, datë 18.3.2013, nr. 97/2021, datë 7.7.2021 dhe neneve 488, 489, 490, 492, 497, 498 dhe 499 të KPP-së të Republikës së Shqipërisë...*

11. Kundër vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë ka paraqitur ankim shtetasi Bledar Bedini (Imami) i cili kërkon: ...Ndryshimin e vendimit të datës 14.9.2022, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë. Rrëzimin e kërkesës së Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe refuzimin e kërkesës për lejimin e ekstradimit të shtetasit Bledar Bedini *alias* Imami drejt Republikës së Italisë. Urdhërimin e lirimit të menjëhershëm të shtetasit Bledar Bedini *alias* Imami.

12. Ankuesi pretendon se pranë Gjykatës së Lartë ndodhet për gjykim çështja penale me objekt njohje e vendimit penal të huaj ndaj shtetasit Bledar Bedini, kjo çështje nuk ka përfunduar ende në atë gjykatë ndaj nuk mund të ekzekutohet ekstradimi



ndaj tij pa u njohur vendimi penal i huaj. Po ashtu, prokuroria nuk i dha një përgjigje se ç'kuptim ka rekursi i ushtruar në Gjykatën e Lartë nga ekzekutimi i ekstradimit, pra ka një përplasje kërkesash nga organi i akuzës.

13. **Gjykata e Apelit Tiranë**, me vendimin nr. 1242, datë 20.12.2022, ka vendosur:

Ndryshimin e vendimit nr. 375, datë 14.9.2022, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Mospranimin e kërkesës për ekstradimin e shtetasit shqiptar Bledar Bedini (Imami). Urdhërohet lirimi nga paraburgimi i të arrestuarit Bledar Bedini (Imami) nëse nuk mbahet për ndonjë veprë tjetër penale apo vendim tjetër penal, etj...

14. Gjykata e apelit arsyeton se ... *Gjykata e apelit, pasi shqyrtoi shkaqet e parashtruara në ankimin e paraqitur dhe tërësinë e të gjitha akteve të administruara në dosje, vlerëson se vendimi i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, i cili ka lejuar ekstradimin e shtetasit shqiptar Bledar Bedini alias Bledar Imami është rrjedhojë e moszbatimit të drejtë të ligjit procedural penal dhe më konkretisht dispozitave procedurale penale që normojnë ekstradimin për jashtë shtetit që parashikohen në nenin 488 e vijues të KPP. Nga shqyrtimi në tërësi i çështjes dhe pasi mori në konsideratë pretendimet e palëve, Prokuroria pranë Gjykatës së Apelit Tiranë, si dhe mbrojtja, gjykata e apelit evidenton si çështje të ligjit interpretimin e zbatimit të drejtë të neneve 6, 7, 11 të KP, nenit 491, shkronja "e", të KPP dhe nenit 9, të ligjit nr. 10193, datë 3.12.2009, "Për marrëdhëniet juridiksionale me autoritetet e huaja në çështjet penale", në raport me nenin 122 të Kushtetutës, nenin 26 të Konventës së Këshillit të Evropës "Për Ekstradimin" dhe të dy Protokolleve Shtesë, ratifikuar me ligjin nr. 8322, datë 2.4.1998, të Kuvendit të Shqipërisë, pika 2, e nenit 10, të Konventës "Për Ekstradimin", ndryshuar me Protokollin e Katërt shtesë të kësaj konvente, e ratifikuar me ligjin nr. 117/2013, "Për Ratifikimin e Protokollit të Katërt shtesë të Konventës Evropiane të Ekstradimit", nenit 18, të "Marrëveshjes ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Republikës së Italisë, si shtesë e Konventës Evropiane për Ekstradimin, të 13 dhjetorit 1957", që ka si qëllim të lehtësojë zbatimin e tyre, ratifikuar me ligjin nr. 9871, datë 11.2.2008, dhe në zbatim të tyre çmon se gjen mbështetje pretendimi i mbrojtjes se, sipas ligjit shqiptar është parashkruar ekzekutimi i dënimit penal për të cilin kërkohet të ekstradohet shtetasi Bledar Imami, kërkesa për efekt ekstradimi është një kërkesë e përsëritur, e cila cenon parimin e sigurisë juridike, si dhe pretendimi se gjykimi është zhvilluar në mungesë dhe shteti italian nuk ka dhënë garanci për rishikimin e vendimit. Në zbatim të drejtë të këtyre dispozitave, gjykata vlerëson të mbajë një qëndrim*

mbi mënyrën e interpretimit të këtyre dispozitave dhe konkretisht: i. ato që kanë të bëjnë me zbatimin e parimit të reciprocitetit në marrëdhëniet juridiksionale të bashkëpunimit gjyqësor me jashtë dhe a është i varur zbatimi i këtij parimi në rastin kur shteti kërkues i ka vënë rezervë normës konventore, me kusht që ai të mos shtrihet ndaj shtetasve të vet dhe as ndaj veprimit të ligjit të vet juridiksional ndaj shtetasve të huaj; ii. nëse shtrihet kjo rezervë ndaj shtetasve shqiptarë e ndaj të cilëve shteti kërkues ka juridiksion zbatimin e ligjit të brendshëm të tij në rastin e parashkrimit të ekzekutimit të dënimit penal; dhe iii. se cila normë ka përparësi për t'u zbatuar: ajo konventore, marrëveshja dypalëshe, ligji i brendshëm, në rastin kur kemi rezervë apo deklaram ndaj normës konventore e kur zbatohet parimi i reciprocitetit.

14.1 Sipas pikës 2, të nenit 39 të Kushtetutës, ekstradimi mund të lejohet vetëm kur është parashikuar shprehimisht në marrëveshjet ndërkombëtare në të cilat Republika e Shqipërisë është palë dhe vetëm me vendim gjyqësor. Koncepti i institutit të ekstradimit, referuar Konventës Evropiane "Për Ekstradimin" dhe KPP konsiston në një nga format e bashkëpunimit ndërkombëtar dhe ka për qëllim dorëzimin e një personi një shteti të huaj për ekzekutimin e një vendimi me burgim ose të një akti që vërteton procedimin e tij për një veprë penale. Nga përmbajtja e neneve 5, 39 dhe 116 të Kushtetutës, si dhe nenit 10 të KPP, burimet e së drejtës që rregullojnë ekstradimin në legjislacionin shqiptar janë Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, marrëveshjet ndërkombëtare shumëpalëshe dhe dypalëshe të ratifikuara, parimet dhe normat e së drejtës ndërkombëtare të pranuar, si dhe dispozitat e KP dhe të KPP. Shteti shqiptar është palë kontraktuese në Konventën Evropiane "Për Ekstradimin", e 13 dhjetorit 1957 dhe e dy Protokolleve Shtesë ratifikuar me ligjin nr. 8322, datë 2.4.1998 dhe e Protokollit të Tretë Shtesë të kësaj konvente, ratifikuar me ligjin nr. 10426, datë 2.6.2011. Sipas nenit 10 të kësaj konvente "Ekstradimi nuk akordohet nëse parashkrimi i aktit ose i dënimit hyn në fuqi qoftë falë legjislacionit të palës që kërkon, qoftë nga ai i palës së kërkuar. Nga ana tjetër, rezulton se Republika e Shqipërisë, me anë të ligjit nr. 117/2013, datë 15.4.2013, ka ratifikuar tashtë edhe "Protokollin e Katërt shtesë të Konventës Evropiane të Ekstradimit". Neni 1 i Protokollit të Katërt shtesë, ka ndryshuar nenin 10 të Konventës të Evropiane "Për Ekstradimin", duke parashikuar: "1. Ekstradimi nuk miratohet kur ndjekja penale ose dënimi i personit të kërkuar është parashkruar sipas ligjit të palës kërkuese. 2. Ekstradimi nuk refuzohet për arsye se ndjekja penale ose dënimi i personit të kërkuar do të parashkruhej sipas ligjit të palës së kërkuar".



14.2 Pra, në bazë të Protokollit të Katërt shtesë të Konventës Evropiane mbi Ekstradimin shteti shqiptar dhe ai italian kanë pranuar të ndalojnë ekstradimin e shtetasve nëse është parashkruar vepra penale ose ekzekutimi i dënimit vetëm sipas ligjit të shtetit kërkues dhe jo më edhe sipas ligjit të shtetit të kërkuar. Duke iu kthyer çështjes objekt shqyrtimi, Gjykata e Apelit Tiranë çmon të bazuar pretendimin e mbrojtjes për refuzimin e ekstradimit, pasi në zbatim të pikës 1/b, të nenit 54 të ligjit “Për marrëdhëniet juridiksionale me autoritetet e huaja në çështjet penale”, ekzekutimi i dënimit është parashkruar. Gjykata e apelit çmon të evidentojë që një vendim penal i huaj të sjellë pasojat që burojnë në pjesën urdhëuese të tij kërkohet, midis të tjerave, që jo vetëm vepra penale që është kryer të jetë njëkohësisht e dënueshme nga legjislacionet penale të shteteve palë në një marrëveshje, por edhe që dënimi të jetë njëkohësisht i ekzekutueshëm dhe jo i parashkruar, si nga shteti kërkues, ashtu dhe nga shteti i kërkuar. Parashkrimin e ekzekutimit të vendimit të dënimit, ligjvënisi e ka parashikuar si rrethanë penguese, jo vetëm për sa i përket ekzekutimit, por edhe njohjes së një vendimin penal të huaj dhe lejimit të ekstradimit. Neni 54 i ligjit “Për marrëdhëniet juridiksionale me autoritetet e huaja në çështjet penale”, i titulluar: Kërkesat për njohjen dhe ekzekutimin e vendimeve penale të huaja, në pikën “b” të tij parashikon, se: ... Përveç kushteve të parashikuara në neni 514 të KPP, vendimi penal i huaj njihet dhe ekzekutohet edhe kur plotësohen kushtet e mëposhtme: b) ekzekutimi i vendimit të dënimit në bazë të legjislacionit të brendshëm nuk është parashkruar. Për sa i përket parashkrimit të ekzekutimit të një vendimi dënimi KP i RSH në nenin 68 të tij parashikon se vendimi i dënimit nuk ekzekutohet kur nga dita që vendimi ka marrë formë të prerë, kanë kaluar dhjetë vjet për vendimin që përmban dënimin nga pesë gjer në pesëmbëdhjetë vjet burgim.

14.3 Në rastin konkret, vendimi nr. 10235/2001, datë 9.7.2004, i Gjykatës së Shkallës së Parë Milano Itali, i ndryshuar pjesërisht me vendimin nr. 2858/2005, datë 13.6.2005, të Gjykatës së Apelit Milano, Itali i cili është bërë përfundimtar më datë 13.1.2009, të drejtën për t’u ekzekutuar nga organet kompetente të shtetit shqiptar sipas KPP të RSH, e ka pasur deri në datën 13.1.2019. Pas datës 13.1.2019, dënimi prej 10 vjetësh burgim konsiderohet i shuar për shkak të parashkrimit të së drejtës për ekzekutimin e vendimit që përmban dënimin e mësipërm. Lidhur me pretendimin e ngritur nga mbrojtësi se sipas ligjit të brendshëm është parashkruar ekzekutimi i vendimit penal dhe për këtë shkak duhet të refuzohet ekstradimi, gjykata konkludon se me ligjin nr. 117/2013, “Për Ratifikimin e Protokollit të Katërt shtesë të Konventës Evropiane të Ekstradimit”, Republika e Shqipërisë ka ratifikuar Protokollin e Katërt

shtesë të Konventës Evropiane të Ekstradimit. Ky ligj është botuar në Fletoren Zyrtare nr. 61, datë 24.4.2013 dhe ka hyrë në fuqi 15 ditë nga botimi në Fletoren Zyrtare. Në nenin 1, “Kalimi i afatit”, të këtij protokollit shtesë, parashikohet se: ... Neni 10 i Konventës zëvendësohet me dispozitat e mëposhtme: “Kalimi i afatit 1. Ekstradimi nuk miratohet kur ndjekja penale ose dënimi i personit të kërkuar është parashkruar sipas ligjit të Palës Kërkuese. 2. Ekstradimi nuk refuzohet për arsye se ndjekja penale ose dënimi i personit të kërkuar do të parashkruhej sipas ligjit të palës së kërkuar. 3. Çdo shtet, në kohën e nënshkrimit ose gjatë depozitimit të instrumentit të tij të ratifikimit, pranimit, miratimit ose aderimit, mund të deklarojë se rezervon të drejtën për të mos zbatuar paragrafin 2: a) Kur kërkesa për ekstradim bazohet në veprat penale për të cilat shteti ka juridiksion sipas ligjit të tij penal; dhe/ose b) Nëse legjislacioni i tij i brendshëm ndalon shprehimisht ekstradimin kur ndjekja penale ose dënimi i personit të kërkuar do të parashkruhej sipas ligjit të tij. 4. Në përvaktimin nëse ndjekja penale ose dënimi i personit të kërkuar do të parashkruhej sipas ligjit të saj, çdo palë që ka bërë një rezervë sipas paragrafit 3 të këtij neni merr në konsideratë, në përputhje me ligjin e saj, çdo akt ose ngjarje që ka ndodhur në palën kërkuese, në masën që aktet ose ngjarjet e të njëjtës natyrë kanë efektin e ndërprerjes ose pezullimit të parashkrimit në palën e kërkuar...”

14.4 Republika e Italisë, si një nga shtetet palë të Konventës Evropiane “Për Ekstradimin”, ka depozituar instrumentin e ratifikimit të Protokollit të Katërt Shtesë të Konventës Evropiane të Ekstradimit, së bashku me rezervën, në lidhje me nenin 10, paragrafi i tretë, duke rezervuar të drejtën që të mos e mos aplikojë nenin 10 paragrafi 2, të Konventës “Për Ekstradimin”, të amenduar me nenin 1, të Protokollit të Katërt shtesë, në rastet kur kërkesa e ekstradimit është bërë për krime për të cilat shteti italian ka juridiksion sipas ligjit të tij penal. Sipas nenit 13, pika 3, të Protokollit të Katërt shtesë, “Nuk mund të bëhet asnjë rezervë, në lidhje me dispozitat e këtij protokollit, me përjashtim të rezervave, të parashikuara në nenin 10, paragrafi 3, neni 21, paragrafi 5, i Konventës së ndryshuar nga ky protokoll dhe neni 6, paragrafi 31, i këtij protokollit. Reciprociteti mund të zbatohet për çdo rezervë të bërë. Sa më lart, shteti italian ka paraqitur rezervë për të mos aplikuar nenin 10/2 të Konventës “Për Ekstradimin”, të amenduar me nenin 1, të Protokollit të Katërt shtesë, në rastet kur legjislacioni i tij i brendshëm ndalon shprehimisht ekstradimin, kur ndjekja penale ose dënimi i personit të kërkuar do të parashkruhej sipas ligjit të tij. Legjislacioni penal parashikon se ekstradimi karakterizohet nga parimi i reciprocitetit, i shprehur në termat: shteti i kërkuar jep ekstradimin vetëm në rast se shteti kërkues, në rrethana të



ngjashme ose të njëjta ose me palë të kundërta, është i detyruar të bëjë të njëjtën gjë. Parimi i reciprocitetit, përveç garantimit të barazisë në marrëdhëniet ndërkombëtare në çështjet penale, ndihmon dhe në standardizimin e ligjeve mbi këtë temë të favorizojnë zhvillimin e një praktike ekstradimi konvencionale. Parimi i reciprocitetit si një nga parimet e së drejtës ndërkombëtare publike ka gjetur sanksionim në nenin 26 të Konventës Evropiane të Ekstradimit. Në pikën 3, të nenit 26 të Konventës parashikohet se: “Një palë kontraktuese që ka formuluar një rezervë, në lidhje me një dispozitë konvencionale, nuk mund të pretendojë që një shtet tjetër të aplikojë këtë dispozitë, përveçse në masën në të cilën ajo vetë e ka pranuar”. Zbatimit të parimit të reciprocitetit i ka qëndruar besnik dhe Marrëveshja ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Republikës së Italisë, e cila në nenin 18, paragrafi 1, titulli “Dispozita lidhur me Ekstradimin e shtetasve”, ku parashikohet se: “Palët Kontraktuese marrin përsipër, në mënyrë të ndërsjellë, të dorëzojnë shtetasit e tyre që ndodhen në ndjekje penale nga njëra prej tyre për kryerjen e veprave penale, ose që janë shpallur në kërkim për vuajtjen e dënimit apo të një mase shtrënguese, në përputhje me normat dhe kërkesat e Konventës Evropiane mbi Ekstradimin. Marrëveshja në fjalë nuk parashikon rregullim tjetër mbi ekstradimin, duke i qëndruar besnik në këtë aspekt rregullimeve të Konventës dhe sanksionimit të parimit që ekstradimi do të zbatohet në mënyrë të ndërsjellë në mes të dy shteteve, në përputhje me rregullimet e Konventës. Kjo marrëveshje i referohet në mënyrë të veçantë ekstradimit. Në preambulën e saj thuhet se Shqipëria i mbetet deklarimit që ka bërë në depozitimin e instrumentit të ratifikimit të Konventës Evropiane “Për Ekstradimin” ku deklaronte se: Shqipëria refuzon ekstradimin e shtetasve të vet, me përjashtim të rasteve kur është parashikuar ndryshe në marrëveshjet ndërkombëtare në të cilat Shqipëria është palë kontraktuese...

14.5 Çështja që ka të bëjë me zbatimin e normave të Konventës “Për Ekstradim”, lidhet me raportet që krijohen mes Republikës së Italisë dhe asaj të Shqipërisë, për shkak të rezervës së shtetit italian, mbi normën që ndalon refuzimin e ekstradimit mbi argumentin se vepra penale apo dënimi janë parashikuar sipas ligjit italian, për çështje që janë në juridiksionin e atij shteti. Lidhur me zbatimin e parimit të reciprocitetit, evidentohet së pari se prokurorja e apelit nuk përkrah qëndrimin e gjykatës së shkallës së parë, për zbatimin tij vetëm në planin politik. Në vijim të këtij arsyetimi, gjykata vlerëson se parimi i reciprocitetit përbën normë të së drejtës, të detyrueshme për t’u zbatuar nga shtetet anëtare të saj. Vetë konventa është burim i së drejtës dhe gjykata ka detyrimin që ta zbatojë atë, duke garantuar mbi të gjitha respektimin e të drejtave të subjekteve, që u

nënshtrohen procedurave të ekstradimit. Duke pranuar se parimi i reciprocitetit mes Republikës së Italisë dhe asaj të Shqipërisë, duhet të zbatohet jo vetëm nga ministri i Drejtësisë (qoftë edhe në momentin, kur kërkon nëpërmjet prokurorisë që të procedohet me kërkesën e shtetit të huaj që kërkon ekstradimin), por edhe nga gjykata që e shqyrton kërkesën. Referuar këtij parimi të sanksionuar në konventë, për të bërë një zbatim të drejtë të konventës, në tërësinë e dispozitave të saj, interpretimi dhe zbatimi i dubur i Konventës Evropiane të Ekstradimit, në raport me shtetin italian, lidhur me parashkrimin e ndjekjes penale apo të dënimit, do të ishte: shteti shqiptar do të lejojë ekstradimin e shtetasve të tij, apo personave të tjerë nga territori i tij ndaj shtetit italian, për aq sa shteti italian e lejon ekstradimin e shtetasve të tij apo personave të tjerë nga territori i tij. Duke qenë se shteti italian mund ta refuzojë ekstradimin në rast se ndjekja penale apo dënimi janë parashikuar (përfshirë këtu dhe ndërprerjet, dhe pezullimet sipas legjislacionit të shtetit të kërkuar) sipas legjislacionit të tij, në bazë të parimit të reciprocitetit, të sanksionuar në Konventë, edhe shteti shqiptar do ta refuzojë ekstradimin, në rast se ndjekja penale apo dënimi janë parashikuar sipas legjislacionit të shtetit shqiptar, prandaj dhe gjykata e gjen pretendimin e mbrojtjes të drejtë dhe të bazuar në të drejtën ndërkombëtare dhe atë të brendshme, Marrëveshja ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Republikës së Italisë, si shtesë e konventës evropiane për ekstradimin, të 13 dhjetorit 1957 dhe e Konventës Evropiane “Për ndihmë juridike për çështjet penale”, të 20 prillit 1959, që ka si qëllim të lehtësojë zbatimin e tyre, të ratifikuar në legjislacionin tonë me ligjin nr. 9871, datë 11.2.2008, në pikën 1, të nenit 18 të kësaj marrëveshjeje parashikohet se: “1. Palët kontraktuese marrin përsipër, në mënyrë të ndërsjellë, të dorëzojnë shtetasit e tyre që ndodhen në ndjekje penale nga njëra prej tyre për kryerjen e veprave penale, ose që janë shpallur në kërkim për vuajtjen e dënimit apo të një mase shtrënguese, në përputhje me normat dhe kërkesat e Konventës Evropiane mbi Ekstradimin”.

14.6 Pra, rezulton se me këtë marrëveshje, shtetet nënshkruese i referohen zbatimit të Konventës Evropiane të Ekstradimit, duke u angazhuar për zbatimin e saj. Kjo Konventë duhet të zbatohet në tërësinë e saj, përfshirë dhe pikën 3, të nenit 26 të saj, që ka të bëjë me parimin e reciprocitetit dhe bazuar në këtë parim edhe shteti shqiptar nuk duhet të pranojë ekstradimin e shtetasve të vet për të cilat ka juridiksion, si në rastin konkret. Në KPP në neni 491 “Mospranimi i kërkesës për ekstradim”, shkronja “e”, parashikohet se: “Nuk mund të jepet ekstradimi: ...ë) kur është parashikuar ndjekja penale ose dënimi sipas ligjit të shtetit të kërkuar”. Ligji për marrëdhëniet juridiksionale me jashtë, në nenin 32 parashikon se: “...ekstradimi i një



personi në drejtim të një shteti të huaj lejohet kur plotësohen edhe kushtet e mëposhtme: Ndjekja penale ose ekzekutimi i dënimit penal nuk janë parashkruar sipas legjislacionit të shtetit kërkuar”. Sa më sipër trajtuar, gjykata çmon se vendimi për të cilën kërkohet ekstradimi i shtetasit Bledar Bedini alias Bledar Imami është parashkruar, pasi bazuar në parimin e reciprocitetit shteti shqiptar nuk duhet të pranojë ekstradimin e shtetasve të vet në të njëjtat kushtet për veprat penale për të cilat ka juridiksion. Duke iu rikthyer rastit konkret nëse është vendi që Republika e Shqipërisë të zbatojë reciprocitetin ndaj shtetit kërkuar, Republikës së Italisë, gjykata e apelit vlerëson se për sa kohë në një rast analog, Republika e Italisë do të refuzonte zbatimin e paragrafit të dytë, të nenit 10 të Konventës për Ekstradimin (sipas Protokollit të Katërt), është rasti që të zbatohet parimi i reciprocitetit. Në zbatim të nenit 26 të Konventës Evropiane të Ekstradimit, Republika e Italisë nuk mund të kërkojë zbatimin e kësaj dispozite nga një shtet tjetër kontraktues, për sa kohë që ka ratifikuar me rezervë Protokollin e Katërt.

14.7 Në kushtet e mësipërme, duke mos zbatuar normën e mësipërme konventore, thirret për zbatim ligji i brendshëm, neni 491, shkronja “e”, të KPP, sipas të cilit përbën kusht ndalues për ekstradimin rasti kur është parashkruar dënimi sipas ligjit të shtetit të kërkuar. Sikurse është parashtruar më sipër, me vendim gjyqësor të formës së prerë nr. 957, datë 9.7.2019, të Gjykatës së Apelit Tiranë është konstatuar se ekzekutimi i dënimit të dhënë nga gjykata italiane është parashkruar sipas ligjit shqiptar, ndaj ky fakt përbën arsyen, për të cilën gjykata e apelit arrin në përfundimin se vendimi i gjykatës së shkallës së parë është marrë në interpretim dhe zbatim të gabuar të ligjit, ekstradimi i shtetasit shqiptar Bledar Bedini alias Bledar Imami, nga Republika e Shqipërisë në Republikën e Italisë, nuk duhet të miratohet, duke e bërë në këtë rast të cenueshëm vendimin nr. 375 akti, datë 14.9.2022, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë. Gjikata e çmon të drejtë pretendimin e ngritur në ankim dhe në gjykimin në apel të mbrojtjes se: ky proces jo vetëm certifikon parashkrimin e pretenduar por e kthen gjithë këtë kaazus në “gjë të gjykuar” e të pamundur për t’u si proces ekstradimi rishtas për të njëjtin fakt dhe akt... Gjikata e gjen të bazuar pretendimin e mbrojtësit në gjykimin në apel se e “njëjta çështje me objekt njohje vendimi penal të huaj ndodhet për gjykim në Gjykatën e Lartë mbi bazën e rekursit të organit të Prokurorisë së Rrethit Tiranë dhe se Prokuroria e Apelit nuk dha një përgjigje se ç’kuptim ka rekursi i ushtruar në Gjykatën e Lartë nga organi i prokurorisë, në lidhje me njohjen e vendimit të huaj kur ndërkohë që kërkohet ekzekutimi i ekstradimit”. Në analizë të këtij pretendimi, gjykata, pasi konstaton se sipas vërtetimit nr. 6330/1 prot., datë 25.11.2022, të Gjykatës së Lartë ku citohet se...nga

verifikimet në sistemin elektronik të menaxhimit të çështjes është në fazë studimi çështja penale nr. 69403-00901-00-2019 akti, datë regjistrimi 30.9.2002, me kërkesë Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, me objekt njohjen e vendimit penal të huaj nr. 2858/2005, datë 13.6.2005, të Gjykatës së Apelit Milano mbi dënimin e shtetasit shqiptar Bledar Imami alias Bedini për veprën penale “Trafikim të lëndëve narkotike në bashkëpunim...çmon se ka një përplasje kërkesash dhe vendimesh penale, në lidhje me të dënuarin dhe në kushtet kur për njohjen e vendimit penal të huaj nuk ka një vendim përfundimtar organi i akuzës nuk mund të pretendojë ekzekutimin e ekstradimit pa u njohur vendimi penal i huaj nga gjykimi në Gjykatën Lartë (kujtojmë se kjo kërkesë është rrëzuar me vendimin nr. 957, datë 9.7.2019, të Gjykatës së Apelit Tiranë).

14.8 Për sa kohë ekziston mundësia ligjore që Gjykata e Lartë mbi bazën e rekursit të prokurorisë mund të ndryshojë vendimin nr. 957, datë 9.7.2019, të Gjykatës së Apelit Tiranë, vlerësohet se kërkesa për njohje vendimi penal ndaj shtetasit shqiptar Bledar Imami alias Bedini nuk është shqyrtuar nga një vendim përfundimtar dhe i pandryshueshëm. Në rastin në shqyrtim, rezulton qartë se shteti italian nuk ka paraqitur më herët kërkesën për ekstradim të shtetasit shqiptar Bledar Imami alias Bedini, duke zgjedhur të kërkojë njohjen e vendimit dhe dënimin penal në Republikën e Shqipërisë. Kjo ishte kërkesa që u shqyrtua nga gjykata shqiptare dhe që u refuzua. Në atë proces, gjykatës as nuk iu paraqit dhe as nuk shqyrtoi një kërkesë për ekstradim, që të vlerësonte nëse ishte apo jo e pranueshme. Pra, konstatohet se njëkohësisht në gjykatat shqiptare shqyrtohen dhe gjykohen dy kërkesa (njohje vendimi penal të huaj dhe kërkesë për ekstradim) për të njëjtin fakt, ndaj të njëjtit shtetas shqiptar, me të njëjtin shtet kërkuar. Në analizë të sa më lartë, Gjykata vlerëson se cenohet parimi i mos gjykimit dy herë për të njëjtin veprë penale, që është i parashikuar në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë (neni 34). Kushtetuta përcakton parimet bazë të së drejtës, ndaj ligjet e tjera përfshirë KP, duhet të përmbajnë norma që pajtohen me të, ose zbatimin e tyre do të duhet të kryhet në përputhje me këto parime bazë (shih edhe nenin 1/a të KP). Nën këtë frymë edhe neni 6 i KP që, ndërsa pranon veprimin e ligjit penal në hapësirë, e shtrir zbatimin edhe për veprat penale që kryhen nga shtetasit shqiptarë jashtë territorit të vendit, por për sa kohë që ndaj tij nuk është dhënë një vendim përfundimtar nga gjykata e huaj, përbën një rregullim, që garanton respektimin e këtij parimi. Megjithatë, kjo dispozitë nuk duhet parë dhe lexuar e shpëputur nga normat e tjera të së drejtës penale, që për shtetasit e mësipërm, parashikojnë një tjetër regjim të zbatimit të ligjit, sikurse është ai i njohjes së vendimit penal të huaj.



14.9 Në nenin 10 të KP, parashikohet se vendimet penale të dhëna ndaj shtetasve shqiptarë nga një gjykatë e huaj mund të njihen, brenda kufijve të ligjit shqiptar, Republikën e Shqipërisë. Këto norma të së drejtës materiale nuk mund të gjejnë zbatim, pa konsideruar edhe organet që ushtrojnë detyrat dhe përgjegjësitë për ndjekjen penale dhe gjykimin penal. Parë në harmoni me njëra-tjetrën, organet e drejtësisë penale shqiptare kanë të drejtën të fillojnë ndjekjen penale, si dhe gjykimin e një shtetasi shqiptar për një veprë të kryer jashtë shtetit, për sa kohë që nuk verifikohet se, për të njëjtin fakt, ai është gjykuar nga gjykatë e huaj me vendim përfundimtar. Dhënia e një vendimi të tillë do të përbënte pengesë që një procedim (hetim apo gjykim) i filluar, të vijonte. Kjo nuk do të thotë se shteti shqiptar pushon së pasuri pushtet dhe juridiksion mbi shtetasin e vet, të dënuar nga gjykata e huaj. Juridiksioni penal, në këtë rast, ushtrohet nëpërmjet procedurës së njohjes së vendimit të gjykatës së huaj, çka do të thotë se mbi shtetasin shqiptar vijon të zbatohet ligji penal shqiptar. Dispozitat e KP janë të detyrueshme për t'u zbatuar edhe në këtë procedurë, lidhur me respektimin e parimeve, ekzistencës së një fakti penalisht të dënueshëm sipas këtij Kodi, apo edhe caktimit të dënimit që duhet të ekzekutohet në Republikën e Shqipërisë. Nisur nga sa më sipër, Gjykata e Apelit arrin në përfundimin se ushtrimi i juridiksionit penal mbi shtetasit shqiptarë që kryejnë vepra penale jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë ushtrohet në dy mënyra: 1. nëpërmjet zbatimit të drejtëpërdrejtë të ligjit penal, sipas dispozitave procedurale që rregullojnë ushtrimin e ndjekjes penale dhe gjykimin penal; 2. Nëpërmjet njohjes së vendimit penal të huaj, në përputhje me dispozitat procedurale penale, që rregullojnë këtë çështje (nenet 512 e vijues të KPP). Si përfundim, Gjykata e Apelit vlerëson se pretendimi i prokurorisë se ligji penal shqiptar nuk mund të zbatohet ndaj shtetasit Bledar Bedini alias Bledar Imami, është i pabazuar. Ligji shqiptar penal zbatohet ndaj këtij shtetasi, dhe shteti shqiptar ka zgjeruar juridiksion mbi këtë çështje për efekt të kërkesës për njohje. Nga përmbajtja e nenit 512 e vijues të KPP, Gjykata vlerëson se njohja e vendimit penal të huaj është parakushti themelor në mënyrë që vendimi të prodhojë pasojë juridike në rendin juridik shqiptar. Me njohjen e një vendimi penal të huaj nuk kemi të bëjmë me një vendim të gjykatës shqiptare që vihet në ekzekutim, por me një vendim të një gjykate të huaj që ekzekutohet në përputhje me legjislacionin shqiptar dhe që është një zgjerim i juridiksionit të autoritetit gjyqësor të huaj në Shqipëri, i cili përfundon mbas njohjes dhe ekzekutimit të tij në Shqipëri (qëndrim i mbajtur edhe nga Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë në vendimin njëses nr. 154, datë 15.4.2000). Kjo është dhe arsyeja që fillimisht është kërkuar njohja e vendimit të dënimit ndaj

shtetasit shqiptar Bledar Imami alias Bedini nga ana e autoriteteve gjyqësore italiane.

14.10 Në eventualitetin e sipërcituar, të pranimit të kërkesës për ekstradim në kushtet kur për të njëjtin fakt është refuzuar më parë kërkesa për njohjen e vendimit penal të huaj ndaj shtetasit shqiptar Bledar Imami alias Bedini, bie ndesh formalisht edhe me parimin e mosdënimit pa ligj që parashikohet në nenin 7 të Evropiane të të Drejtave të Njeriut, si dhe në nenin 29 të Kushtetutës Shqiptare, dhe është pjesë e rëndësishme e procesit të rregullt gjyqësor, së bashku me parimin e mos dënimit dy herë për të njëjtin fakt (ne bis in idem). Neni 29 i Kushtetutës parashikon se: “1. Askush nuk mund të akuzohet ose të deklarohet fajtor për një veprë penale, e cila nuk konsiderohet e tillë me ligj në kohën e kryerjes së saj, me përjashtim të veprave, të cilat në kohën e kryerjes së tyre, përbënin krime lufte ose krime kundër njerëzimit sipas së drejtës ndërkombëtare. 2. Nuk mund të jepet një dënim më i rëndë se ai që ka qenë parashikuar me ligj në kohën e kryerjes së veprës penale. 3. Ligji penal favorizues ka fuqi prapavepruese”. Ndërkohë neni 7 i KEDNJ-së parashikon se: “1. Askush nuk mund të dënohet për një veprim ose një mosveprim, që në momentin kur është kryer nuk përbënte veprë penale, sipas të drejtës së brendshme ose ndërkombëtare. Po ashtu, nuk mund të jepet një dënim më i rëndë se ai që ishte i zbatueshëm në momentin kur është kryer vepra penale. 2. Ky nen nuk do të ndikojë mbi gjykimin dhe dënimin e një personi për një veprim ose mosveprim, i cili, në momentin kur është kryer, quhej veprë penale sipas parimeve të përgjithshme të së drejtës, të njohura nga kombet e qytetëruara”. Në çdo rast njohja e vendimit penal të huaj është një institut i së drejtës procedurale penale që ka karakterin substancial të dënimit penal, jo vetëm duke pasur parasysh kualifikimin e tij formalisht si të tillë, por edhe duke pasur parasysh kufizimet e mëdha të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut që kufizohen në momentin e njohjes së vendimit penal të huaj nga gjykata shqiptare. Në këtë kuptim, nuk mund të pranohet kërkesa për ekstradim në kushtet kur për të njëjtin fakt është refuzuar më parë kërkesa për njohjen e vendimit penal të huaj ndaj shtetasit shqiptar pasi bie ndesh me qëllimin e nenit 29 të Kushtetutës dhe nenit 7 të KEDNJ-së, krijon efektet ekuivalente dhe materiale të një dënimi penal pa ligj, si dhe bie ndesh edhe me parimin e mos dënimit dy herë për të njëjtin fakt (ne bis in idem).

14.11 Përpos sa më lart, Gjykata e Apelit vlerëson se në rastin konkret cenohet edhe parimi kushtetues dhe konventor i sigurisë juridike. Në jurisprudencën e Gjykatës Kushtetuese është vlerësuar se procesi ligjvënës duhet të plotësojë disa kërkesa paraprake të detyrueshme për t'u konfirmuar sakaq me parimin e sigurisë juridike. Ky parim kushtetues ka si kërkesë të domosdoshme faktin që ligji në tërësi, pjesë apo



dispozita të veçanta të tij në përmbajtjen e tyre duhet të jenë të qarta, të përvaktuara dhe të kuptueshme, duke nënkuptuar ndër të tjera që ligji në një shoqëri të ofrojë siguri, qartësi dhe vazhdimësi, në mënyrë që individët t'i drejtojnë veprimet e tyre në mënyrë korrekte e në përputhje me të. Një rregullim i pasaktë i normës ligjore dhe që sjell pasoja, nuk shkon në përputhje me qëllimin, stabilitetin, besueshmërinë dhe efektivitetin që synon vetë norma. [1] Në këtë kuptim Gjykata e Apelit vlerëson se në kushtet e këtij kuadri ligjor (KPP i R.Sh i cili e ndalon ekstradimin për shkaqe parashkrimi të ekzekutimit të dënimit penal në shtetin e kërkuar/neni 491 shkronja “e” /; ratifikimi i Protokollit të Katër Shtesë të Konventës Evropiane të Ekstradimit; dhe interpretimit që bëhet nga organi i akuzës (nëpërmjet paraqitjes së kërkesave të tilla, fillimisht kërkesë për njohje vendimi penal të huaj - kërkesë kjo e refuzuar nga shteti shqiptar - dhe më pas kërkesë për ekstradim), shtetasit shqiptar që ndodhen në raste të ngjashme, përfshirë edhe të dënuar, i cenohet procesi i rregullt ligjor për shkak se ligjvënësi nuk ka respektuar parimin konventor dhe kushtetues të qartësisë dhe precizitetit të ligjit penal të elaboruar në vijimësi nga GJEDNJ-ja dhe Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, i cili kërkon që i gjithë ligji të jetë mjaftueshëm preciz në mënyrë të tillë që të lejojë personin - nëse është e nevojshme me këshillimin e dubur - të parashikojë, deri në shkallën që është e arsyeshme për rrethanat, pasojat të cilat mund t'i shkaktojë një akt i caktuar. Mungesa e qartësisë së ligjit dhe parashikueshmërisë se cilat do jenë pasojat ligjore cenon parimin e sigurisë juridike të personit. Bazuar në sa më lart gjykata e apelit, ndryshe nga gjykata e shkallës së parë, e gjen të pabazuar në ligj kërkesën e organit të akuzës për miratimin e lejimit të ekstradimit të shtetasit Bledar Bedini alias Bledar Imami dhe si të tillë do ta ndryshojë atë...

15. Kundër vendimit të Gjykatës së Apelit Tiranë, ka paraqitur rekurs Prokuroria pranë Gjykatës së Apelit Tiranë, duke kërkuar: Ndryshimin e vendimit nr. 1242, datë 20.12.2022, të Gjykatës së Apelit Tiranë dhe lënien në fuqi të vendimit nr. 375, datë 14.9.2022, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

16. Në rekurs, Prokuroria pranë Gjykatës së Apelit Tiranë ka parashtruar këto shkaqe:

- Vendimi i Gjykatës së Apelit Tiranë vjen në kundërshtim me disa praktika të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë.

- Gjithsesi, edhe vetë Gjykata e Lartë ka mbajtur qëndrime të ndryshme për raste të njëjta, ndaj lind e nevojshme unifikimi i praktikës, në mënyrë që të

mos krijohet pabarazi në trajtimin e njerëzve përballë ligjit.

- Gjykata e Apelit Tiranë vlerësoi se pretendimi i mbrojtjes se, sipas ligjit shqiptar është parashkruar ekzekutimi i dënimit penal për të cilin kërkohet të ekstradohet shtetasi Bledar Imami, kërkesa për efekt ekstradimi është një kërkesë e përsëritur, e cila cenon parimin e sigurisë juridike, si dhe pretendimi se gjykimi është zhvilluar në mungesë dhe shteti italian nuk ka dhënë garanci për rishikimin e vendimit. Gjykata e Apelit Tiranë çmon të bazuar pretendimin e mbrojtjes për refuzimin e ekstradimit, pasi në zbatim të pikës 1/b, të nenit 54, të “Për marrëdhëniet juridiksionale me autoritetet e huaja në çështjet penale”, ekzekutimi i dënimit është parashkruar. Gjykata e Apelit Tiranë çmon të evidentojë që një vendim penal i huaj të sjellë pasojat që burojnë në pjesën urdhëruese të tij kërkohet, midis të tjerave, që jo vetëm vepra penale që është kryer të jetë njëkohësisht e dënueshme nga legjislacionet penale të shteteve palë në një marrëveshje, por edhe që dënimi të jetë njëkohësisht i ekzekutueshëm dhe jo i parashkruar si nga shteti kërkuar, ashtu dhe nga shteti i kërkuar. Parashkrimin e ekzekutimit të vendimit të dënimit, ligjvënësi e ka parashikuar si rrethanë penguese, jo vetëm për sa i përket ekzekutimit, por edhe njohjes së një vendimi penal të huaj dhe lejimit të ekstradimit....gjykata çmon se vendimi për të cilin kërkohet ekstradimi i shtetasit Bledar Bedini alias Bledar Imami është parashkruar, pasi bazuar në parimin e reciprocitetit shteti shqiptar nuk duhet të pranojë ekstradimin e shtetasve të vet në të njëjtat kushte për veprat penale për të cilat ka juridiksion.

- Ky qëndrim i Gjykatës së Apelit Tiranë vjen në kundërshtim me parashikimet e Protokollit të Katërt shtesë të Konventës Evropiane të Ekstradimit, ratifikuar tashmë e me anë të ligjit nr. 117/2013, datë 15.4.2013, hyrë në fuqi më datë 1.6.2014, ku i njëjti Protokoll është miratuar edhe nga shteti italian me ligjin nr. 88, datë 24.7.2019, i cili ka hyrë në fuqi në datën 20.8.2019.

- Shteti italian e ka miratuar këtë Protokoll me rezervë ndaj Shqipërisë, në lidhje me të rejtat që ka sjellë në këtë drejtim, por që shqyrtimi i mundësisë së refuzimit të ekstradimit për këtë shkak, pra të mungesës së reciprocitetit ndërshtetëror në zbatimin e parashikimeve ligjore të bëra pjesë e legjislacionit të brendshëm, për shkak të rezervës së përcaktuar nga shteti italian, i përket autoritetit ekzekutiv dhe jo



gjykatës. Është pikërisht autoriteti ekzekutiv ai që vlerëson në tërësi marrëdhëniet ndërshtetërore dhe i jep ose jo rrugë përfundimisht një ekstradimi të lejuar nga gjykata, pas vlerësimit të kushteve ligjore, që gjykata bën në çdo rast.

- Në “Hyrje” të konventës parashikohet se: “shtetet anëtare të Këshillit të Evropës, nënshkruese të këtij Protokollit, duke marrë në konsideratë synimin e Këshillit të Evropës për të arritur unitet më të madh midis anëtarëve të tij; me dëshirën për të forcuar aftësinë e tyre individuale dhe kolektive për t’iu përgjigjur krimit; duke marrë në konsideratë dispozitat e Konventës Evropiane “Për Ekstradimin” (ETS nr. 24) të hapur për nënshkrim në Paris, më 13 dhjetor 1957 (më poshtë të quajtur “Konventa”, si dhe tri protokollet shtesë të saj (ETS nr. 886 dhe 98, CETS nr. 209), të lidhur në Strasburg përkatësisht më 15 tetor 1975, 17 mars 1978 dhe 10 nëntor 2010; duke e konsideruar të përshtatshëm modernizimin e disa dispozitave të Konventës dhe plotësimin e saj në aspekte të caktuara; duke marrë parasysh progresin e bashkëpunimit ndërkombëtar në çështje penale që prej hyrjes në fuqi të Konventës dhe protokolleve shtesë të saj; kanë rënë dakord si më poshtë.”

- Ky formulim tregon se në zbatim të parimit të ekstraterritorialitetit për të mos lejuar shmangien nga ligji për shkak të parimit të territorialitetit, shtetet janë ato që bien dakord që të kufizojnë të drejtat dhe pushtetin mbi shtetasit e tyre, duke iu dhënë akses dhe mundësi aleatëve në marrëveshje të ushtrojnë juridiksion edhe mbi qytetarët e tyre. Kjo lloj marrëveshje, Konventë siç është cituar, ka fuqi mbi ligjet e brendshme dhe gjykata nuk mund të bëjë një interpretim ndryshe përtej asaj çfarë palët kanë arritur në marrëveshje.

- Në lidhje me faktin nëse ka juridiksionin shteti ynë në lidhje me çështjet e gjykuara në Itali ndaj shtetasit Bledar Bedini, për sa kohë që në vendin tonë nuk ka çështje të filluar apo të hetuar për këtë shtetas dhe vendimi i gjykatës italiane është i formës së prerë ne nuk kemi më juridiksion mbi këtë shtetas për vendimet për të cilat ai është subjekt ekstradimi.

- Gjithashtu, parimi i proporcionalitetit ka një logjikë veprimi që mbi të gjitha është të vendosë në pozita të barabarta subjektet e gjykimit, pavarësisht shtetësisë së tyre. Në rast se një shtetas shqiptar kryen një vepër në Itali ai i nënshtrohet rregullave dhe sanksioneve ligjore të vendit të shtetit Italian në të njëjtin raport me shtetasit italian, në vazhdimësi

edhe të ekzekutimit të vendimeve edhe rregullave të parashkrimit. Atëherë, në rast se do kërkohej ekstradimi i një shtetasi italian si do veprohej? Normalisht që nuk ka asnjë shkak ligjor refuzimi dhe ky lloj trajtimi do të cenojë marrëveshjen dypalëshe që kemi ndërmarrë me Italinë, duke i vendosur në pozita të pabarabarta subjektet sipas shtetësisë.

- Ky tashmë është qëndrim i mbajtur në raste të ngjashme nga Gjykata e Lartë në vendimmarrjet e saj. Me vendimin nr. 00-2022-992, datë 26.7.2022, dhënë ndaj shtetasit shqiptar Leonard Kote, Gjykata e Lartë arsyeton: Për sa i përket pretendimeve të parashtruara në rekurs, se shteti italian e ka miratuar me rezervë Protokollin e Katërt shtesë të Konventës Evropiane të Ekstradimit, si dhe pretendimet në lidhje me faktin se shtetasi Leonard Kote mund t’i nënshtrohet persekutimeve për shkak të gjendjes së tij personale të rënduar shëndetësore apo shoqërore, Kolegji konstaton se këto pretendime janë marrë në shqyrtim nga gjykata e apelit, e cila ka arsyetuar në lidhje me shkeljet e pretenduara, duke dhënë një përgjigje shteruese.

- Me vendimin nr. 00-2022-1035, datë 22.7.2022, dhënë ndaj kërkuarit Petrit Lekndreaj, Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë në këtë vendim të dhënë, ndër të tjerë, shprehet: Kuadri ynë ligjor nuk ka një harmonizim të normave ligjore midis “Protokollit të Katërt shtesë të Konventës Për Ekstradimin”, me ligjin e brendshëm, për sa i përket situatës së normës së zbatueshme për parashkrimin e ndjekjes penale ose të dënimit në një rast të paraqitjes së kërkesës për ekstradim nga autoriteti i huaj gjyqësor. Për zbatimin e dispozitës ligjore konkrete në rast kolizioni të normës ndërkombëtare me ligjin e brendshëm, na vjen në ndihmë neni 122 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe jurisprudenca e Gjykatës Kushtetuese në interpretimin e kësaj norme kushtetuese.

- Sipas jurisprudencës kushtetuese, normat ndërkombëtare kanë epërsi mbi ligjet e vendit që nuk pajtohen me to. Më konkretisht në vendimin nr. 20, datë 1.6.2011, në faqen 7, paragrafi i dytë i tij, Gjykata Kushtetuese shprehet se: ...Nëse nuk ka harmonizim pra, nëse jemi në rastet e vakumit legjislativ, ose kur parashikimet ligjore bien në kundërshtim me dispozitat e Konventës, atëherë gjyqtarët e çdo niveli zbatojnë drejtpërsëdrejti vendimet e GJEDNJ-së, në përputhje me nenin 122 të Kushtetutës dhe nenet 19 dhe 46, të KEDNJ-së. Neni 122 i Kushtetutës përcakton shprehimisht se



dispozitat e marrëveshjeve ndërkombëtare kanë epërsi mbi ligjet e vendit që nuk pajtohen me të...

- Rrjedhimisht, përfundimet e Gjykatës së Apelit Tiranë për refuzimin e kërkesës së ekstradimit, mbështetur edhe në nenin 491, shkronja “ë”, të KPP-së nuk janë të plota dhe sakta. Gjykata e Apelit Tiranë i referohet gabimisht fuqisë së vendimit të refuzimit të njohjes së vendimit. Në këtë rast, Gjykata e Apelit Tiranë duhet të merrte në konsideratë nenin 1, paragrafin e parë dhe të dytë, të “Protokollit të Katërt shtesë të Konventës për Ekstradimin”, i cili aktualisht ka hyrë në fuqi dhe është pjesë e legjislacionit tonë.

- Në rastin e shtetasit Kleanti Keshi, për të cilin Gjykata e Apelit Tiranë, ndër të tjera, kishte vendosur: Refuzimin e ekstradimit nga Republika e Shqipërisë në Republikën e Italisë të shtetasit Kleant Keshi *alias* Gentian Hysa për ekzekutimin e vendimit nr. 7660/RGNR/4993/11 RG GIP, datë 5.12.2011, të Gjykatës të Hetimeve Paraprake të Gjykatës së Torinos që ka marrë formë të prerë me vendimin nr. 2429/2012, datë 4.6.2012, të Gjykatës së Apelit të Torinos, lënë në fuqi nga Gjykata e Kasacionit me vendimin e datës 23.5.2013. Gjykata e Lartë, referuar faqes së njoftimeve nga Gjykata e Lartë, ka vendosur: Prishjen e vendimit të Gjykatës së Apelit Tiranë nr. 258, datë 17.3.2022 dhe lënien në fuqi të vendimit nr. 28, datë 16.3.2021, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër.

- Pra, sa më sipër, rezulton se parashkrimi i ekzekutimit të dënimit sipas legjislacionit të shtetit tonë nuk përbën shkak të refuzimit të ekstradimit.

- Por një qëndrim i ndryshëm është mbajtur nga Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë me vendimin nr. 00-2022-1446 i vendimit (232), datë 20.9.2022, ku Kolegji Penal, ndër të tjera, vlerëson se: “parimi i reciprocitetit përbën normë të së drejtës, të detyrueshme për t’u zbatuar nga shtetet anëtare të saj. Vetë Konventa është burim i së drejtës dhe gjykata ka detyrimin që ta zbatojë atë, duke garantuar mbi të gjitha respektimin e të drejtave të subjekteve, që u nënshtrohen procedurave të ekstradimit. Duke pranuar se parimi i reciprocitetit mes Republikës së Italisë dhe asaj të Shqipërisë, duhet të zbatohet jo vetëm nga ministri i Drejtësisë (qoftë edhe në momentin, kur kërkon nëpërmjet prokurorisë që të procedohet me kërkesën e shtetit të huaj që kërkon ekstradimin), por edhe nga gjykata që e shqyrton kërkesën”.

- Ndaj, duke mbajtur parasysh këto raste, vlerësoj se Gjykata e Lartë duhet të unifikojë praktikën e saj për të mos krijuar konfuzion në zbatueshmërinë e ligjit nga gjykatat më të ulëta.

- Në lidhje me konkluzionin e Gjykatës së Apelit Tiranë se shtetasi Bledar Bedini është gjykuar në mungesë dhe shteti kërkues nuk ka dhënë garanci për rishikimin e vendimit. Sipas akteve të gjykimit rezulton se shtetasi Bledar Bedini është mbrojtur me mbrojtës të zgjedhur prej tij, i cili, referuar tagrave të dhëna nga ky shtetas, ka ushtruar të drejtën e ankimit ndaj vendimeve gjyqësore të dhëna objekt i kërkesës për ekstradim.

- Referuar nenit 21, pika 3 të Konventës Evropiane “Për Vlefshmërinë Ndërkombëtare të Gjykrimeve Penale” parashikohet pa paragjykuar përmbajtjen e neneve 25, paragrafi i dytë, 26, paragrafi i dytë dhe 29, do të konsiderohet si vendim i marrë në prani të të akuzuarit: a) çdo vendim i dhënë në mungesë dhe çdo ordonnancë penale, që është konfirmuar ose dhënë në shtetin dënues pas kundërshtimit nga personi i dënuar; b) çdo vendim i marrë në mungesë në apel, nëse apelimi për vendimin e gjykatës së shkallës së parë është kërkuar nga personi i dënuar. Duke qenë se vendimi është ankimuar nga avokati i zgjedhur nga shtetasi Bledar Imami vendimet nuk konsiderohen si të marra në mungesë të kërkesit.

- Gjithashtu referuar parashikimeve të neneve 175 dhe 176 të KPP italiane, të cilat normojnë rivendosjen në afat të ankimit në rastet kur i pandehuri është gjykuar në mungesë, si dhe referuar vendimmarrjes së Gjykatës së Kasacionit Itali, e cila ka theksuar se “...brenda 30 ditëve nga dorëzimi në shtetin italian, i pandehuri do të jetë informuar mbi të drejtën për të formuluar kërkesën për rivendosjen në afat, duke garantuar gjithnjë të drejtën për mbrojtje...gjyqtari i caktuar për rivendosje në afat të ankimit për të kundërshtuar vendimin do të marrë masa për rinovimin e akteve, për të cilët pala kishte të drejtë të përfitonte sipas nenit 176 të KPP italiane”.

- Pra, çdo shtetas që është dënuar në mungesë nga gjykata italiane dhe që ekstradohet në këtë shtet, ka të drejtën e rivendosjes në afat të ankimit ndaj vendimit të dënimit. Pra, nuk është e nevojshme të ketë një garanci me shkrim nga autoritetet italiane, për sa kohë që kjo është një garanci e krijuar nga legjislacioni italian për garantimin e rishikimit të vendimit të dënimit (shih vendimin nr. 00-2019- 181



(5), datë 22.11.2019, të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë.

- Për sa i përket pretendimit se kërkesa për ekstradim është një kërkesë e përsëritur dhe cenon parimin e sigurisë juridike. Në nenit 498, pika 4 të KPP-së, sipas të cilit: “Vendimi kundër ekstradimit ndalon dhënien e një vendimi të mëpasshëm në favor të ekstradimit si rezultat i një kërkesë të re të paraqitur për të njëjtat fakte nga i njëjti shtet, përveçse kur kërkesa mbështetet në elemente që nuk kanë qenë vlerësuar nga gjykata”.

- Nisur nga përmbajtja e dispozitës së sipërcituar, do të gjendemi përpara shkeljes së parimit të sigurisë juridike në rastin kur ndaj këtij shtetasi do të ishte marrë më parë një vendim kundër ekstradimit të tij dhe në vijim gjykata do të kishte ndërmarrë më pas një vendim të dytë në favor të ekstradimit. Në rastin konkret, nuk kemi shkelje të parimit të sigurisë juridike, gjatë shqyrtimit të kërkesës për ekstradimin e shtetasit Bledar Imami. Ndaj këtij shtetasi, gjykatat shqiptare nuk kanë marrë asnjë vendim të mëparshëm, kundër ekstradimit të tij.

- Gjykimi i mëparshëm, me objekt njohjen e vendimit të gjykatës italiane, nuk përbën një fakt ndalues për ekstradimin.

- Për sa i përket faktit se nuk mund të gjykohej paralelisht edhe kërkesa për njohje, edhe kërkesa për ekstradim, nga aktet rezulton se me vendimin nr. 957, datë 9.7.2019, të Gjykatës së Apelit Tiranë është vendosur: Rrëzimi i kërkesës për njohjen e vendimit penal të huaj. Referuar nenit 462 të KPP-së, ky vendim është i formës së prerë dhe një kopje e vendimit i është përcjellë nëpërmjet Ministrisë së Drejtësisë autoriteteve italiane. Referuar Konventës Evropiane “Për Vlefshmërinë Ndërkombëtare të Gjyqimeve Penale”, në nenin 11, pika 1, parashikohet: Kur shteti dënues kërkon ekzekutimin, ai nuk mund të fillojë ekzekutimin e një sanksioni subjekt i kësaj kërkesë. Shteti dënues kundër, sidoqoftë, të fillojë ekzekutimin e një sanksioni me heqje të lirisë, kur personi i dënuar është tashmë i burgosur në territorin e atij shteti në momentin e paraqitjes së kërkesës. 2. Shteti kërkuar rifiton të drejtën për ekzekutim kur: a) tërheq kërkesën e tij, para se shteti i kërkuar ta ketë informuar atë për ndonjë qëllim të tijin për të ndërmarrë veprime për trajtimin e kërkesës; b) shteti i kërkuar e informon për refuzimin e tij për të ndërmarrë veprime për trajtimin e kërkesës; c) shteti

i kërkuar heq dorë në mënyrë të shprehur nga e drejta e tij për ekzekutim.

- Heqja dorë mund të jetë e vlefshme vetëm nëse të dyja shtetet përkatëse bien dakord për këtë ose nëse ekzekutimi nuk është më i mundur në shtetin e kërkuar. Në çastin e fundit heqja dorë është e detyrueshme, nëse shteti kërkuar ka bërë kërkesë për këtë.

- Për sa më sipër, në kushtet kur shteti italian ka marrë dijeni për refuzimin e kërkesës për njohjen e vendimit penal i ka lindur e drejta të kërkojë ekstradimin e shtetasin shqiptar, pasi tashmë ka juridiksion për ekzekutimin e sanksionit të dhënë ndaj tij.

17. Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, me vendimin e datës 6.7.2023, ka vendosur: Kalimin e çështjes penale nr.70003-00296-00-2023 regi. themeltar, datë regjistrimi 8.5.2023, për shqyrtim në seancë gjyqësore me qëllim njësimin e praktikës gjyqësore.

II. Vlerësimi i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë:

18. Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë (në vijim Kolegji), pasi mori në shqyrtim rekursin e depozituar nga Prokuroria pranë Gjykatës së Apelit Tiranë konstaton se ai i plotëson kriteret formale të pranueshmërisë, sepse është depozituar brenda afatit 45-ditor, të parashikuar në nenin 435 të Kodit të Procedurës Penale (në vijim KPP). Po kështu, verifikohet fakti se shtetasi shqiptar Bledar Bedini *alias* Bledar Imami (i dënuari) është njoftuar rregullisht për rekursin e paraqitur nga prokuroria e apelit, nëpërmjet dëftesës së komunikimit.

19. Gjatë shqyrtimit gjyqësor të çështjes në dhomë këshillimi nga aktet e ndodhura në dosje, Kolegji konstatoi qëndrime të ndryshme të gjykatave, por edhe të trupave gjyqësore të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë në drejtëm të zbatimit të “Protokollit të Katërt shtesë të Konventës Evropiane për Ekstradimin” (në vijim Konventa “Për Ekstradimin”), gjatë shqyrtimit të kërkesave për ekstradim të bëra nga shteti italian kundrejt shtetit shqiptar, me subjekt ekstradimi shtetas shqiptar, të cilët ishin dënuar nga gjykatat italiane, kjo nën zbatimin e parimit të reciprocitetit të pranuar nga neni 26 i Konventës “Për Ekstradimin”, ku në disa raste ishte pranuar zbatimi i këtij parimi dhe në disa raste nuk ishte pranuar zbatimi i tij prej gjykatave shqiptare. Në kuadër të këtyre qëndrimeve të ndryshme, në referim të nenit 438 të KPP-së, i cili



parashikon se “Kolegji Penal, kryesisht ose me kërkesë të palëve, mund të vendosë nënjen e procedurës së gjyqimit për të njëzuar ose ndryshuar praktikën gjyqësore”, Kolegji, në dhomë këshillimi, në datën 6.7.2023, vlerësoi inicimin e procedurës për njësimin e praktikës gjyqësore. Kolegji, në verifikim të qëndrimeve të ndryshme të praktikës gjyqësore, vlerësoi se duhen shtruar për zgjidhje këto çështje:

a) *A duhet të zbatohet parimi i reciprocitetit nga gjykatat në marrëdhëniet juridiksionale me një shtet, i cili ka vendosur rezervë ligjore në normën ndërkombëtare për moszbatimin e saj për çështjet që janë në juridiksionin e atij shteti?*

b) *A duhet të pranohet gjykata kërkesën për ekstradimin e shtetasve shqiptarë, në rast se ndjekja penale apo dënimi janë parashkruar sipas ligjit penal shqiptar, drejt një shteti i cili ka vendosur rezervë në normën ndërkombëtare, duke mospranuar kërkesën për ekstradim të shtetasve të tij për shkak se vepra penale ose dënimi është parashkruar sipas ligjit të atij shteti, për çështje që janë në juridiksionin e tij?*

20. Kolegji, pasi e kaloi çështjen në seancë gjyqësore, përveçse palëve në gjykim, iu drejtua me shkresë Ministrisë së Drejtësisë, për të marrë qëndrimin e saj, në lidhje me pyetjet e ngritura për diskutim, kjo pasi në zbatim të ligjit nr. 10193, datë 3.12.2009, “Për marrëdhëniet juridiksionale me autoritet e huaja në çështjet penale”, është autoriteti përgjegjës për mbajtjen e marrëdhënieve juridiksionale me shtetet e huaja.

21. Qëndrimi i ministrit të Drejtësisë për zbatimin e parimit të reciprocitetit është: i. Parimi i reciprocitetit mund të zbatohet kur shtetet e tjera kanë vendosur rezervë ligjore mbi normën ndërkombëtare, pasi vetë Konventa “Për Ekstradimin” e lejon një gjë të tillë në nenin 26 të saj dhe neni 13 i Protokollit të Katërt shtesë i jep të drejtën shteteve të aplikojnë reciprocitetin; ii. gjykatat shqiptare mund të pranojnë kërkesat për ekstradim edhe në rastet kur vepra penale apo dënimi penal është shuar sipas legjislacionit shqiptar, drejt një shteti që ka vendosur rezervë mbi normën ndërkombëtare për moslejimin e ekstradimit të shtetasve, kur vepra penale apo dënimi janë parashkruar sipas ligjeve të shtetit të kërkuar, për çështje që janë në juridiksionin e tij; iii. zbatimi i parimit të reciprocitetit në të drejtën ndërkombëtare konsiderohet si një parim i pranuar në mënyrë universale, ku një shtet miraton një sjellje të caktuar simetrike, si përgjigje ndaj një veprimi të ngjashëm, i cili është miratuar nga shteti tjetër.

22. Parimi i reciprocitetit nuk është detyrim për shtetet, por një e drejtë e bazuar në vlerësimin rast pas rasti sipas marrëdhënieve diplomatike dhe bashkëpunimit me shtetin përkatës që ka vendosur rezervën. Po kështu, edhe palët patën qëndrimet e tyre ku pala subjekt i kërkesës (i dënuari), ndër të tjera, ka ngritur pretendime që kanë të bëjnë me zbatimin e nenit 491, shkronja “ë”, të KPP-së, dispozitë e cila parashikon: “...nuk mund të jepet ekstradimi: ë) kur është parashkruar ndjekja penale ose dënimi sipas ligjit të shtetit të kërkuar; ...”.

23. Referuar fakteve të cituara më sipër, Kolegji konstatoi se në fushën e ekstradimit kemi ndryshime të ligjit të brendshëm procedural penal, i cili bie ndesh me të drejtën ndërkombëtare Konventa “Për Ekstradimin” dhe protokollet shtesë të saj, dhe Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, ku me vendimin e datës 26.10.2023, vendosi t’i kërkojë Gjykatës Kushtetuese që të shfuqizojë shkronjën “ë”, të nenit 491 të KPP-së, pasi vjen në kundërshtim me nenin 39, pika 2 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe Konventën “Për Ekstradimin”, të vitit 1957, ratifikuar me ligjin nr. 8322, datë 2.4.1998 dhe të protokolleve shtesë të saj.

24. Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, me vendimin nr. 46, datë 12.3.2024, ka vendosur: Moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare. Në vendimmarrjen e saj Gjykata Kushtetuese ka orientuar se i takon Gjykatës së Lartë që në ushtrim të kompetencave të saj kushtetuese të përcaktojë nëse në rastin konkret dispozitat e Konventës për Ekstradimin janë apo jo të vetëzbatueshme, me qëllim eliminimin apo jo të zbatimit në mënyrë të domosdoshme të nenit 491, shkronja “ë”, të KPP-së.

III. Qëndrimet njësuere të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë:

25. Në lidhje me çështjen e parë të shtruar për njësim: *A duhet të zbatohet parimi i reciprocitetit nga gjykatat në marrëdhëniet juridiksionale me një shtet, i cili ka vendosur rezervë ligjore në normën ndërkombëtare për moszbatimin e saj për çështjet që janë në juridiksionin e atij shteti?* Kolegji vlerëson sa më poshtë vijon:

26. Ekstradimi është një element kyç në bashkëpunimin ndërkombëtar në fushën e drejtësisë penale, i cili shërben si një mjet për transferimin e personave të akuzuar ose të dënuar prej një shteti në një tjetër. Ai gjen rregullim, duke filluar që nga



Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë,¹ duke vijuar me marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë,² e më tej në legjislacionin penal,³ procedural penal⁴ dhe ligjin e posaçëm që rregullon fushën e marrëdhënieve juridiksionale me shtetet e huaja.⁵ Në jurisprudencën e tij, Kolegji Penal ka vlerësuar se instituti i ekstradimit përbën një nga format kryesore të bashkëpunimit gjyqësor ndërkombëtar me autoritetet e huaja në fushën e marrëdhënieve juridiksionale. Ekstradimi është e vetmja formë e dorëzimit të një shtetasi, nga shteti në territorin e të cilit ai gjendet, në shtetin që ka kërkuar dorëzimin për qëllime të ekzekutimit të një vendimi gjyqësor apo të gjyqimit penal në shtetin kërkuar.

27. Në nenin 39/2 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, përcaktohet se ekstradimi mund të lejohet vetëm kur është parashikuar shprehimisht në marrëveshjet ndërkombëtare, në të cilat Republika e Shqipërisë është palë dhe vetëm me vendim gjyqësor. Ekstradimi lejohet kur vepra penale që përbën objektin e kërkesës për ekstradim është e parashikuar si e tillë, njëkohësisht, si nga ligji shqiptar dhe ai i huaj (parimi i inkriminimit të dyfishtë). Në këtë vështrim, për të lejuar një ekstradim për jashtë shtetit shqiptar, në radhë të parë duhet të verifikohet nëse shteti kërkuar është palë e marrëveshjeve shumëpalëshe, të cilat Republika e Shqipërisë i ka ratifikuar, e më konkretisht “Konventës për Ekstradimin” dhe protokolleve shtesë të saj, apo nëse ekziston marrëveshje bilaterale (dypalëshe) ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe shtetit kërkuar.

Kolegji vë në dukje se, Republika e Shqipërisë ka ratifikuar Konventën “Për Ekstradimin” (ETS nr. 024) dhe dy protokollat e para shtesë të saj (ETS nr. 086 dhe ETS nr. 098), me ligjin nr. 8322, datë 2.4.1998, që kanë hyrë në fuqi në datën 17 gusht 1998. Në vijim, Protokollin i Tretë Shtesë (ETS nr. 209) është ratifikuar me ligjin nr. 10426, datë 2.6.2011 dhe ka hyrë në fuqi në datën 29.6.2011. Protokollin i Katërt shtesë (ETS nr. 212) është ratifikuar me ligjin nr. 117, datë 15.4.2013 dhe ka

hyrë në fuqi në datën 1.6.2014. Republika e Shqipërisë ishte vendi i parë që ratifikoi Protokollin e Katërt shtesë.

28. Republika e Italisë, gjithashtu, rezulton se është palë në Konventën “Për Ekstradimin” me disa rezerva, ratifikuar me ligjin nr. 300, datë 30 janar 1963, që është botuar në Fletoren Zyrtare nr. 84, datë 28 mars 1963 dhe ka hyrë në fuqi në 4 nëntor 1963. Ratifikimi i Protokollit të Dytë për Italinë është bërë me ligjin nr. 755, datë 18 tetor 1984 dhe është publikuar në Fletoren Zyrtare nr. 311, datë 12 nëntor 1984 dhe ka hyrë në fuqi më datë 23.4.1985. Në vijim, edhe Republika e Italisë rezulton se ka ratifikuar Protokollin e Tretë dhe të Katërt të Konventës “Për Ekstradimin”, me ligjin nr. 88, datë 24 korrik 2019, i cili ka hyrë në fuqi më datë 1 dhjetor 2019. Pikërisht, zbatimi i Protokollit të Katërt shtesë të Konventës “Për Ekstradimin” mes Shqipërisë dhe Italisë, ka nxitur Kolegjin në kalimin e kësaj çështje për njësim.

29. Protokollin i Katërt shtesë i Konventës për Ekstradimin ka ndryshuar dhe ka plotësuar disa dispozita të kësaj Konvente, ku në veçanti, me rëndësi për rastin konkret në gjykim është ndryshimi që ka pësuar neni 10 i saj. Kjo dispozitë ka pasur këtë parashikim: “*Ekstradimi nuk akordohet nëse parashikimi i aktit ose i dënimit hyn në fuqi qoftë falë legjislacionit të palës që kërkon, qoftë nga ai i palës së kërkuar*”. Në nenin 1 të Protokollit të Katërt shtesë, parashikohet: “Neni 10 i Konventës zëvendësohet me dispozitat e mëposhtme: “*Kalimi i afatit 1. Ekstradimi nuk miratohet kur ndjekja penale ose dënimi i personit të kërkuar është parashikuar sipas ligjit të Palës Kërkuuese. 2. Ekstradimi nuk refuzohet për arsye se ndjekja penale ose dënimi i personit të kërkuar do të parashikruhet sipas ligjit të palës së kërkuar. 3. Çdo shtet, në kohën e nënshkrimit ose gjatë depozitimit të instrumentit të tij të ratifikimit, pranimit, miratimit ose aderimit, mund të deklarojë se rezervon të drejtën për të mos zbatuar paragrafin 2: a) Kur kërkesa për ekstradim bazohet në veprat penale për të cilat shteti ka juridiksion sipas ligjit të tij penal; dhe/ose b) Nëse legjislacioni i tij i brendshëm ndalon shprehimisht ekstradimin kur ndjekja penale, ose dënimi i personit të kërkuar do të parashikruhet sipas ligjit të tij. 4. Në*

¹ Neni 39, paragrafi i dytë: “*Ekstradimi mund të lejohet vetëm kur është parashikuar shprehimisht në marrëveshjet ndërkombëtare, në të cilat RSh-ja është palë dhe vetëm me vendim gjyqësor.*”

² Konventa e Këshillit të Evropës “Për ekstradimin” dhe dy protokollat e para shtesë të saj (ETS nr. 086 dhe ETS nr. 098), janë ratifikuar me ligjin nr. 8322, datë 2.4.1998. Protokollin i Tretë shtesë (ETS nr. 209) është ratifikuar me Faqe | 20656

ligjin nr. 10426, datë 2.6.2011, kurse Protokollin i Katërt shtesë (ETS nr. 212) është ratifikuar me ligjin nr.117, datë 15.4.2013.

³ Neni 11 i Kodit Penal.

⁴ Titulli X, Kreu I.

⁵ Ligji nr. 10193, datë 3.12.2009, “Për marrëdhëniet juridiksionale me jashtë”, kreu III-të.



përcaktimin nëse ndjekja penale ose dënimi i personit të kërkuar do të parashkruhet sipas ligjit të saj, çdo palë që ka bërë një rezervë sipas paragrafit 3 të këtij neni merr në konsideratë, në përputhje me ligjin e saj, çdo akt ose ngjarje që ka ndodhur në palën kërkuese, në masën që aktet ose ngjarjet e të njëjtës natyrë kanë efektin e ndërprerjes ose pezullimit të parashkrimit në palën e kërkuar”.

30. Republika e Italisë e ka ratifikuar Protokollin e Katërt shtesë të Konventës “Për Ekstradimin”, duke depozituar edhe rezervën për mos aplikimin e nenit 10, pika 2 të Konventës “Për Ekstradimin” të amenduar me nenin 1, të Protokollit të Katërt shtesë, në rastet kur kërkesa e ekstradimit është bërë për krime/vepra penale për të cilat Italia ka juridiksion sipas ligjit të saj penal.⁶ Në nenin 13, pika 3 të Protokollit të Katërt shtesë është parashikuar se “Nuk mund të bëhet asnjë rezervë në lidhje me dispozitat e këtij protokoll, me përjashtim të rezervave të parashikuara në nenin 10, paragrafi 3, neni 21, paragrafi 5 i Konventës së ndryshuar nga ky protokoll dhe neni 6, paragrafi 31, i këtij protokoll. Reciprociteti mund të zbatohet për çdo rezervë të bërë.” Në vijim, Kolegji thekson se, në nenin 26 të Konventës “Për Ekstradimin”, është sanksionuar një nga parimet e së drejtës ndërkombëtare publike, që është parimi i reciprocitetit. Në pikën 3, të nenit 26 të konventës parashikohet se “Një palë kontraktuese që ka formuluar një rezervë në lidhje me një dispozitë konventore, nuk mund të pretendojë që një shtet tjetër të aplikojë këtë dispozitë, përveçse në masën në të cilën ajo vetë e ka pranuar.” Nga ana tjetër, Republika e Shqipërisë nuk ka bërë asnjë rezervë apo deklaram në lidhje me këtë Protokoll.

31. Zbatimi i dispozitave të cituara të Konventës “Për Ekstradimin” dhe Protokollit të Katërt shtesë, lidhet në thelb me kalimin e afatit të parashkrimit të ndjekjes penale ose të dënimit, që pas hyrjes në fuqi të këtij protokoll referon në parashikimet ligjore të palës/shtetit kërkuar. Neni 10 për të cilin Shqipëria nuk ka bërë asnjë rezervë apo deklaratë për moszbatim, thekson se kalimi i afatit të parashkrimit të ndjekjes penale ose dënimit sipas ligjit të palës/shtetit të kërkuar, nuk përbën shkak për refuzimin e ekstradimit të shtetasve të këtij shteti (shtetit të kërkuar). Kolegji vë në dukje se diskutimi që ka lindur në praktikën gjyqësore shqiptare

fokusohet në zbatimin e parimit të reciprocitetit në marrëdhëniet juridiksionale me Italinë, për shkak të rezervës që ky shtet ka bërë në lidhje me afatin e parashkrimit të ndjekjes penale ose të dënimit.

32. Një nga parimet mbi të cilat bazohet Konventa “Për Ekstradimin” është edhe parimi i mosekstradimit të shtetasve. Çdo vend ka të drejtë të refuzojë ekstradimin e shtetasve të vet, sipas nenit 6/1, shkronja “a”, të Konventës “Për Ekstradimin”. Ky parim nuk është detyrues, pasi shteteve iu njihet e drejta të veprojnë ndryshe, sipas parashikimeve të një marrëveshjeje dypalëshe. Republika e Shqipërisë ka bërë një deklaram lidhur me këtë normë, duke përcaktuar se ajo refuzon ekstradimin e shtetasve të vet, me përjashtim të rasteve kur është parashikuar ndryshe në marrëveshjen ndërkombëtare, ku Shqipëria është palë. Po i njëjti rregullim gjendet në nenin 491, pika 8 të KPP-së. Republika e Shqipërisë ka hequr dorë nga ndalimi për mos ekstradimin e shtetasve të vet, në zbatim të parimit të reciprocitetit, duke lidhur marrëveshje ndërkombëtare dypalëshe me disa shtete, mes të cilave edhe Republika e Italisë. Shtetasit shqiptarë që kryejnë vepra penale jashtë territorit shqiptar dhe që ndalohen apo arrestohen në Shqipëri do të procedohen penalisht nga gjykatat shqiptare, në përputhje me nenin 6 të KP-së. Paragrafi i dytë i këtij neni shprehet: “Ligji penal i Republikës së Shqipërisë është i zbatueshëm edhe për shtetasin shqiptar për kryerje krimi në territorin e një shteti tjetër ku krimi është njëkohësisht i dënueshëm dhe derisa nuk është dhënë për të një vendim përfundimtar nga një gjykatë e huaj”.

33. Në kuadër të marrëveshjeve mes Shqipërisë dhe Italisë, Kolegji vë në dukje se Konventa “Për Ekstradimin” në nenin 28/2, ka parashikuar: “Palët kontraktuese nuk mund të përfundojnë midis tyre marrëveshje dypalëshe ose shumëpalëshe, veçse për të përmbushur dispozitat e kësaj Konvente ose për të lehtësuar zbatimin e parimeve që përmban kjo Konventë”. Në këtë kuadër, midis Republikës së Shqipërisë dhe Republikës së Italisë është miratuar edhe marrëveshja dypalëshe “Për ratifikimin e Marrëveshjes ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Republikës së Italisë”, si shtesë të Konventës Evropiane për Ekstradim të datës 13.12.1957, dhe të Konventës për ndihmën juridike për çështjet penale të datës 20.4.1959, që ka si qëllim të lehtësojë zbatimin e tyre.” Kjo marrëveshje

⁶Verifikuar në faqen web të Këshillit të Europës, ku figurojnë traktatet e nënshkruara nga shtetet anëtare, rezervat, deklaratat. Rezerva në këtë rast është depozituar nga përfaqësuesi i përhershëm i Republikës së Italisë, së bashku me instrumentet e ratifikimit, në datën 30.8.2019

<https://www.coe.int/en/web/conventions/full-list?module=declarations-by-treaty&numSte=212&codeNature=0>



është ratifikuar nga Shqipëria me ligjin nr. 9871, datë 11.2.2008, ku në pikën 1, të nenit 18 të kësaj marrëveshjeje parashikohet: “1. *Palët Kontraktuese marrin përsipër, në mënyrë të ndërsjellë, të dorëzojnë shtetasit e tyre që ndodhen në ndjekje penale nga njëra prej tyre për kryerjen e veprave penale ose që janë shpallur në kërkim për vuajtjen e dënimit apo të një mase shtrënguese, në përputhje me normat dhe kërkesat e Konventës Evropiane mbi Ekstradimin*”. Pra, rezulton se me këtë marrëveshje, shteti shqiptar dhe ai italian marrin përsipër të dorëzojnë në mënyrë të ndërsjellë shtetasit e tyre që janë në ndjekje penale apo shpallur në kërkim për vuajtjen e dënimit apo një mase shtrënguese në shtetet përkatëse. Në këtë marrëveshje nuk rezulton të ketë ndonjë parashikim të detajuar në lidhje me procedurat, kriteret, kushtet për ekstradim, por kanë referuar për zbatim normat e parashikuara në Konventën “Për Ekstradimin”, ku të dyja palët janë nënshkruese të saj, duke u angazhuar për zbatimin e saj.

34. Kolegji vëren se konventa dhe legjislacioni i brendshëm kushtëzojnë miratimin e kërkesës për ekstradimin me plotësimin e një sërë kushteve dhe procedurave nga ana e autoriteteve të shtetit kërkuar, si dhe autoriteteve të shtetit të kërkuar. Kushtet e parashikuara në nenet 489–491 të KPP-së ndërsjellë janë bazuar në parimin e mirëbesimit dhe njohjes së ndërsjellë të akteve të shteteve, të cilat kanë nënshkruar marrëveshje të përbashkëta dhe kanë tradita juridike të ngjashme, duke përbushur detyrimet e së drejtës ndërkombëtare sipas parimit të mirëbesimit mes shteteve, në përputhje me rregullat të parashikuara nga Konventa e Vjenës “Për të Drejtën e Traktateve”, ku Shqipëria ka aderuar me ligjin nr. 8696, datë 23.11.2000. Kolegji Penal në jurisprudencën e tij ka theksuar se, një pjesë e konsiderueshme e dispozitave të kësaj Konvente përbëjnë të drejtë ndërkombëtare zakonore, dhe si të tilla ato janë të detyrueshme për Shqipërinë, në bazë të nenit 5 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (*shih vendimin nr. 00-2017-899 (143), datë 22.11.2017, i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë*). Në këtë kuadër, Kolegji rithekson se interpretimi dhe qëllimi i normave të së drejtës ndërkombëtare, duhet të bëhet në bazë të parimit të mirëbesimit, çka do të thotë se prezumohet një respektim i krahasueshëm dhe ekuivalent i të drejtave dhe lirive themelore të personit midis sistemeve gjyqësore të atyre shteteve, të cilat kanë nënshkruar marrëveshje të përbashkëta, apo që veprojnë e bashkëpunojnë në bazë të parimit

të mirëbesimit dhe njohjes së ndërsjellë të akteve të nxjerra nga organet e tyre përkatëse

35. Në lidhje me parimin e reciprocitetit, Kolegji vlerëson se duhet mbajtur në konsideratë sa parashikon Konventa e Vjenës “Për të drejtën e traktateve” e cila në nenin 20, pika 1 përcakton: “1. *Një rezervë e autorizuar shprehimisht nga një traktat nuk kërkon ndonjë pranim të mëtejshëm nga shtetet kontraktuese dhe organizatat kontraktuese ose sipas rastit nga organizatat kontraktuese, nëse traktati nuk e parashikon kështu*”. Në vijim, neni 23 i kësaj konvente parashikon: “1. *Një rezervë, një pranim i shprehur i një rezerve duhet të formulohet me shkrim dhe t’i komunikohet shteteve dhe organizatave kontraktuese, dhe shteteve dhe organizatave të tjera ndërkombëtare që kanë të drejtën të jenë palë në traktat*.” Nga ana tjetër, Kolegji rithekson se zbatimi i parimit të reciprocitetit është parashikuar në nenin 13 të Protokollit të Katër Shtesë të Konventës “Për Ekstradimin”, ku përcaktohet se, *reciprociteti mund të zbatohet për çdo rezervë të bërë*. Ndërkohë kemi edhe parashikimin në Konventën “Për Ekstradimin”, ku në nenin 26 pika 3, thuhet: *Një palë kontraktuese që ka formuluar një rezervë në lidhje me një dispozitë konventore, nuk mund të pretendojë që një shtet tjetër të aplikojë këtë dispozitë, përveçse në masën në të cilën ajo vetë e ka pranuar*.

36. Nga konfrontimi i përmbajtjes së këtyre dispozitave, rezulton se formulimi i një rezerve në lidhje me një dispozitë konventore duhet t’i komunikohet palëve të tjera, fakt ky që verifikohet në momentin e depozitimit të instrumentit përkatës të ratifikimit apo aderimit në një konventë/ traktat / marrëveshje ndërkombëtare. Konventa “Për Ekstradimin” dhe Protokollit i Katërt i saj kanë parashikuar se pala që ka depozituar një rezervë në lidhje me dispozitën konventore, nuk mund të pretendojë që shtetet e tjera të aplikojnë dispozitën (tashmë me rezervë), përveçse në masën në të cilën ajo vetë e ka pranuar. Parimi i reciprocitetit sipas nenit 13, pika 3 të këtij Protokollit nënkupton se shtetet anëtare mund (termi që përdor protokollit është “mund”, duke e lënë në vullnetin e shtetit anëtar zbatimin apo jo të këtij parimi) të deklarojnë se nuk do të zbatojnë nenin 10, pika 2, në lidhje me afatin e parashkrimit të ndjekjes penale apo dënimit, në raport me Italinë. Kjo do të thotë se, nëse shteti italian refuzon ekstradimin e një shtetasi për jashtë shtetit, sipas rezervës së depozituar nga Italia në momentin e ratifikimit të këtij Protokollit, për veprën penale ku bazohet kërkesa për ekstradim ajo ka



juridiksion dhe zbaton ligjin e saj të brendshëm penal.

37. Por, në ndryshim nga sa ka argumentuar gjykata e apelit, Kolegji vlerëson se zbatimi i parimit të reciprocitetit nuk është një çështje që i përket juridiksionit gjyqësor për ta vendosur. Në marrëdhëniet juridiksionale me jashtë, në veçanti për sa i takon ekstradimit për jashtë dhe nga jashtë vendit, ligjvënësi ka parashikuar (si në shumë vende të tjera) autoritetin dhe rolin e Ministrisë së Drejtësisë në këtë marrëdhënie bashkëpunimi. Kolegji vlerëson se është në diskrecionin e Ministrisë/ministrit të Drejtësisë, si përfaqësues i vullnetit politik që të zbatojë këtë parim (reciprocitetin) në rastet kur e vlerëson atë të nevojshme. Kur autoriteti i huaj paraqet një kërkesë për ekstradim (por edhe çdo kërkesë tjetër në kuadër të marrëdhënieve juridiksionale me jashtë), i drejtohet ministrit të Drejtësisë si autoriteti qendror që disponon nëse kësaj kërkesë i duhet dhënë rrugë apo jo. Pas vlerësimit paraprak të ministrit të Drejtësisë, aktet e autoritetit të huaj i përcillen prokurorisë dhe në vijim i nënshtrohen verifikimit juridiksional të gjykatës, që vlerëson kushtet dhe kërkesat e ligjit për lejimin apo jo të ekstradimit.

38. Ministria e Drejtësisë në procedurat e ekstradimit, ka rol thelbësor duke verifikuar, krahas gjykatës, ekzistencën e kushteve ligjore për lejimin ose jo të ekstradimit. Kolegji Penal, në lidhje me rolin e ministrit të Drejtësisë në këtë proces, si një garanci e interesave të vetë shtetit dhe e vullnetit të tij për të ndjekur autorët e veprave penale, ka theksuar se procedura e ekstradimit pasiv, karakterizohet nga dy faza: 1. faza e garancive juridiksionale, në të cilën gjykatat vlerësojnë plotësimin e kushteve dhe kritereve që legjitimojnë kërkesën për ekstradim pasiv, pra për dorëzimin e personit për të cilin kërkohet ekstradimi; 2. faza administrative, në të cilën, në rast të një vendimi gjyqësor në favor të ekstradimit, ministri i Drejtësisë ka diskrecionin për të vendosur lidhur me pranimin përfundimisht të kërkesës për ekstradim, të paraqitur nga autoritetet gjyqësore të shtetit të huaj, duke vlerësuar sipas rastit oportunitetet politiko-administrative (*shih vendimin nr. 143, datë 22.12.2017, të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë*). Kolegji ka vlerësuar më tej se ministri i Drejtësisë ka kompetenca për të vendosur lidhur me çdo çështje tjetër mbi ekzekutimin që ka lindur, pasi vendimi gjyqësor që ka lejuar ekstradimin ka marrë formë të

prerë, apo çdo çështje që lidhet me dorëzimin e personit për të cilin është lejuar ekstradimi, duke përfshirë edhe tagrin për pezullimin e vendimit, sipas përcaktimeve që parashikon shprehimisht neni 500 i KPP-së.

39. Në këtë drejtim, Kolegji thekson se në zbatim të Konventës së Vjenës për të drejtën e traktateve (ku Shqipëria ka aderuar), ligjvënësi ka miratuar ligjin nr. 43/2016, “Për marrëveshjet ndërkombëtare në RSH”, i cili ka hyrë në fuqi më vonë sesa miratimi i Protokollit të Katër Shtesë nga shteti shqiptar. Ky ligj ka qenë në fuqi në momentin e miratimit dhe paraqitjes së rezervës nga shteti italian, në raport me zbatimin e nenit 10, pika 2 të ndryshuar të Konventës “Për Ekstradimin”. Ligji nr. 43/2016, përcakton se gjen zbatim për të gjitha marrëveshjet ndërkombëtare dypalëshe dhe shumëpalëshe, të lidhura në formë të shkruar, sipas të drejtës ndërkombëtare publike, pavarësisht nga emërtimi i tyre (neni 2 i ligjit). Ky ligj rregullon aspekte të ndryshme të përgatitjes së marrëveshjeve ndërkombëtare, në vijim lidhja/nënshkrimi i tyre, duke përcaktuar edhe autoritetet kompetente apo plotfuqitë, por në veçanti parashikon edhe mënyrën sesi paraqitet një rezervë, deklaratë, pranim, denoncim apo pezullim i marrëveshjeve ndërkombëtare. Konkretisht, në nenin 27, pika 2 të këtij ligji, përcaktohet se Republika e Shqipërisë mund të pranojë, të kundërshtojë ose të tërheqë kundërshtimin e rezervave të një pale tjetër në një marrëveshje ndërkombëtare. Kjo dispozitë parashikon shprehimisht, referuar pikërisht zbatimit të parimit të reciprocitetit në marrëdhëniet ndërkombëtare, se; “*pranimi, kundërshtimi dhe tërheqja e kundërshtimit të rezervave bëhet me ligj, të propozuar nga Këshilli i Ministrave. Iniciativa për miratimin e pranimit, kundërshtimit dhe tërheqja e kundërshtimit të rezervave merret nga ministria kompetente*.” Në rastin konkret, duke pasur në vëmendje rolin që ka në procesin e ekstradimit të shtetasve shqiptarë, Ministria e Drejtësisë nuk rezulton dhe as nuk është verifikuar ndonjë reagim i saj në raport me rezervën e bërë nga Italia në lidhje me nenin 10, pika 2 të Konventës “Për Ekstradimin”, të ndryshuar nga Protokollit i Katërt shtesë i saj, duke zbatuar marrëveshjen dypalëshe mes Italisë dhe Shqipërisë, që parashikon se shtetësia nuk është një kriter ndalues në kuadër të bashkëpunimit mes këtyre dy shteteve. Në fakt, Kolegji nuk verifikon asnjë qëndrim të ndryshëm në



këtë drejtim as nga Italia, referuar akteve dhe jurisprudencës së gjykatave italiane.

40. Në vijim, Kolegji thekson se ligji nr. 43/2016, në nenin 36, të tij parashikon edhe interpretimin e një marrëveshjeje ndërkombëtare kur Republika e Shqipërisë është palë, duke u bazuar në mirëbesimin dhe në përputhje me kuptimin e termave të marrëveshjes, nën dritën e objektit dhe qëllimit të saj. Kjo dispozitë ka parashikuar edhe se, në rastet kur institucioni zbatues i një marrëveshjeje ndërkombëtare nuk është dakord me palën tjetër për mënyrën e interpretimit të dispozitave të kësaj marrëveshjeje, ajo njofton Ministrinë e Punëve të Jashtme, pasi ligji përcakton se mosmarrëveshjet në lidhje me interpretimin e një marrëveshjeje ndërkombëtare zgjidhen me negociata apo me mjete të tjera të zgjidhjes paqësore. Kjo dispozitë citohet nga Kolegji, për të theksuar se në marrëdhëniet juridiksionale me autoritetet e huaja, që ndërthuren me zbatimin e një marrëveshjeje ndërkombëtare, qoftë dypalëshe apo shumëpalëshe, rol kryesor në kuadër të zbatimit të parimit të reciprocitetit ka autoriteti kompetent shtetëror, ai që përfaqëson vullnetin politik dhe që ka marrë pjesë në negociatat për nënshkrimin e një marrëveshjeje konkrete. Në rastin e ekstradimit të shtetasve shqiptarë mbi kërkesën e Republikës së Italisë, nëse do të zbatohet apo jo reciprociteti, në lidhje me kalimin e afateve të parashkrimit të ndjekjes penale apo të dënimit, i takon Ministrisë/ministrit të Drejtësisë të veprojë, duke reaguar në një nga mënyrat e parashikuara në legjislacionin shqiptar. Gjykatat shqiptare verifikojnë kushtet dhe kriteret e parashikuara në ligjin e zbatueshëm në rastin konkret, referuar Kushtetutës, Konventës “Për Ekstradimin” dhe protokolleve të saj shtesë, që janë ratifikuar nga Republika e Shqipërisë (duke pasur në vëmendje edhe rezervat apo deklaratat që Shqipëria ka depozituar së bashku me instrumentet e ratifikimit), KPP-së, KP-së, si dhe ligjit për marrëdhëniet juridiksionale me jashtë. Në dispozitat e akteve ligjore të referuara nuk ka asnjë rregull apo nen që detyron gjykatat të interpretojnë një marrëveshje ndërkombëtare në raport me parimin e reciprocitetit, duke analizuar një rezervë që nuk është kundërshtuar nga Republika e Shqipërisë (autoriteti kompetent).

41. Kolegji vlerëson se, verifikimi i kushteve procedurale, lidhur me lejimin ose jo të ekstradimit të shtetasit shqiptar, përbën një çështje që duhet të analizohet e çmohet rast pas rasti nga ana e gjykatës, ku në arritjen e përfundimeve rëndësi merr dokumentacioni shoqërues i kërkesës për ekstradim i kërkuar nga neni 489 i KPP-së, Konventa “Për Ekstradimin”, si dhe konteksti juridik, apo rrethana të tjera të rastit konkret. Referuar nenit 39, pika 2 të Kushtetutës dhe nenit 11 të Kodit Penal, “ekstradimi mund të lejohet vetëm kur është parashikuar shprehimisht në marrëveshjet ndërkombëtare në të cilat Republika e Shqipërisë është palë”. Në raport me Republikën e Italisë, ekzistojnë këto marrëveshje ndërkombëtare të aplikueshme: Konventa “Për Ekstradimin” e 13 dhjetorit 1957, së bashku me protokollet shtesë,⁷ si dhe Marrëveshja midis Shqipërisë dhe Italisë, si shtesë e Konventës “Për Ekstradimin” e 13 dhjetorit 1957 dhe Konventës Evropiane për Ndihmën Juridike në Çështjet Penale të 20 prillit 1959 (marrëveshja shtesë).⁸ Në këtë vështrim, Kolegji vlerëson se në zbatim të nenit 1, të Protokollit të Katërt shtesë, që ka ndryshuar nenin 10 të Konventës “Për Ekstradimin”, gjykatat shqiptare nuk mund të refuzojnë ekstradimin e shtetasit shqiptar drejt Italisë, me argumentin se është parashkruar ndjekja penale apo dënimi sipas ligjit shqiptar, që është ligji i shtetit të kërkuar. Kjo dispozitë parashikon ndalimin e ekstradimit vetëm në rastin kur ndjekja penale ose ekzekutimi i dënimit është parashkruar në bazë të legjislacionit të palës kërkuese (Italisë).

42. Rrjedhimisht, zbatimi i parimit të reciprocitetit nuk është një kriter detyrues, por vlerësohet rast pas rasti nga autoritetet që kanë tagër për ta bërë këtë vlerësim. Duke qenë se protokollin lejon reciprocitetin si një mundësi mbi rezervat e bëra mbi nenin 10 të konventës, lejimi apo ndalimi i ekstradimit në këtë rast mbetet në vlerësim të shtetit të kërkuar (në rastin konkret të shtetit shqiptar/Ministria e Drejtësisë si organi kompetent i fazës ekzekutimit), nëse do të aplikojë parimin e reciprocitetit për të mos pranuar ekstradimin. Kolegji vlerëson se në vështrim të zbatimit të reciprocitetit, ministri i Drejtësisë ka tagrin dhe

⁷ Ligji nr. 8322, datë 2.4.1998, “Për ratifikimin e Konventës së Këshillit të Evropës për Ekstradimin”.

⁸ Ligji nr. 9871, datë 11.2.2008, “Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Faqe | 20660

Republikës së Italisë, si Shtesë e Konventës Evropiane për Ekstradimin, të 13 dhjetorit 1957 dhe e Konventës Evropiane për Ndihmë Juridike për Çështjet Penale, të 20 prillit 1959”, që ka si qëllim të lehtësojë zbatimin e tyre.



detyrimin të kërkojë informacion apo qëndrimin e autoriteteve kompetente të Italisë, në lidhje me zbatimin e kësaj rezerve në raport me marrëveshjen dypalëshe të lidhur me tyre. Në rastin konkret, ministri i Drejtësisë është autoriteti qendror, i cili ka dhe vullnetin politik mbi lejimin ose jo të ekstradimit të një shtetasi dhe aplikimin ose jo të reciprocitetit, bazuar në marrëdhëniet diplomatike me shtetin kërkuar (Italia në rastin konkret). Ky autoritet del edhe nga kuptimi i nenit 499 të KPP-së, i cili në pikën 1, të saj parashikon se: *Ministria e Drejtësisë disponon për ekstradimin, disponim i cili vjen pasi ministria vibet në dijeni për vendimin e gjykatës që ka pranuar kërkesën për lejimin e ekstradimit për jashtë shtetit.*

43. Në të njëjtën logjikë, Kolegji vlerëson edhe parashikimin e bërë në nenin 9, të ligjit nr. 10193/2009, “Për marrëdhëniet juridiksionale me autoritetet e huaja në çështjet penale” (i ndryshuar), ku përcaktohet: “1. Kërkesa e autoritetit gjyqësor të huaj pranohet nëse përmban garancitë për reciprocitet, të dhëna nga shteti kërkuar, që përfshijnë pritsmërinë që ky shtet të ekzekutojë një kërkesë të ngjashme të drejtuar nga autoritetet gjyqësore vendase. 2. Ministria e Drejtësisë, pavarësisht pikës 1 të këtij neni, mund t’i japë rrugë letërporosive edhe në mungesë të garancive të shprehura për reciprocitet.”. Kjo do të thotë në vlerësim të Kolegjit, se që në momentin e marrjes së një kërkesë për ekstradim, ministri i Drejtësisë, para se t’i japë rrugë kërkesës së bashkëpunimit, duhet të kërkojë këtë garanci nga shteti kërkuar. Gjithsesi, Kolegji rithekson se në praktikën e deritanishme, nuk është verifikuar asnjë rast konkret ku autoritetet italiane të drejtësisë të kenë refuzuar ekstradimin e një shtetasi italian në marrëdhëniet juridiksionale me Shqipërinë, për shkak të rezervës së bërë nga Republika e Italisë në nenin 10, pika 2 të Protokollit të Katërt shtesë të Konventës “Për Ekstradimin”.

44. Kolegji thekson se, mbi të gjitha, parë nga marrëdhëniet ndërkombëtare, reciprociteti është një koncept praktik dhe është veprim ekuivalent, i cili varet nga një veprim ose reagim i një shteti tjetër. Në praktikën ndërkombëtare apo në doktrinë, nuk është trajtuar ndonjë rast i zbatimit të këtij parimi nga autoritetet gjyqësore, në lidhje me interpretimin apo zbatimin e një marrëveshjeje ndërkombëtare të ratifikuar nga shtetet përkatëse, për shkak se vetë miratimi (në vijim nënshkrimi, ratifikim, aderimi, denoncimi) i një marrëveshjeje ndërkombëtare (dypalëshe apo shumëpalëshe) është në vullnetin e dyanshëm të shteteve dhe qeveritë veprojnë në

mënyrë të ndërsjellë. Në këtë aspekt, ky parim që ndërvepron mes shteteve dhe autoriteteve kompetente të ngarkuara në përputhje me vullnetin politik, nuk është një parim që mund apo duhet të analizohet në aspektin juridik, duke theksuar sërish këtu se në procedurat e ekstradimit, trajtimi i parimit të reciprocitetit nuk i takon autoriteteve gjyqësore, të cilat kryejnë vetëm verifikimin e kushteve ligjore pozitive dhe kushteve ndaluese. Vlerësimi mbi zbatimin ose jo të parimit të reciprocitetit bëhet vetëm nga ministri i Drejtësisë në rolin e autoritetit qendror.

45. Duke arsyetuar si më sipër, për sa i përket çështjes së parë të shtruar për njësim, Kolegji arrin në këtë përfundim njësuës: ***Në marrëdhëniet juridiksionale me një shtet që ka vendosur rezervën ligjore në normën ndërkombëtare për moszbatimin e saj për çështje që janë në juridiksionin e atij shteti, parimi i reciprocitetit dhe zbatimi i tij është një kusht që vlerësohet nga ministri i Drejtësisë, si autoriteti kompetent i shtetit të kërkuar. Gjykata vlerëson kushtet për lejimin e ekstradimit në përputhje me marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, me Kodin e Procedurës Penale dhe ligjin për marrëdhëniet juridiksionale me jashtë.***

46. Në lidhje me çështjen e dytë të është shtruar për njësim: “A duhet të pranojë gjykata kërkesën për ekstradimin e shtetasve shqiptarë, në rast se ndjekja penale apo dënimi janë parashkruar sipas ligjit penal shqiptar, drejt një shteti i cili ka vendosur rezervë në normën ndërkombëtare, duke mospranuar kërkesën për ekstradim të shtetasve të tij për shkak se vepra penale ose dënimi është parashkruar sipas ligjit të atij shteti, për çështje që janë në juridiksionin e tij?”, Kolegji vlerëson sa më poshtë vijon:

47. Së pari, Kolegji thekson se në lidhje me kushtet e ekstradimit, neni 491 i KPP-së parashikon se: “Nuk mund të jepet ekstradimi: a) për një veprë me karakter politik ose kur rezulton që ai kërkohet për qëllime politike; b) kur ka arsye të mendohet se personi që kërkohet do t’u nënshtrohet persekutimeve ose diskriminimeve për shkak të racës, fesë, seksit, shtetësisë, gjuhës, bindjeve politike, gjendjes personale a shoqërore ose dënimeve a trajtimeve të egra, çnjerëzore a poshtëruese, ose veprimeve që përbëjnë shkelje të një të drejte themelore të njeriut; c) shfuqizuar; ç) kur ka filluar procedimi ose është gjykuar në Shqipëri edhe pse vepra është kryer jashtë shtetit; d) kur vepra penale nuk parashikohet si e tillë nga legjislacioni shqiptar; dh) kur për



veprën penale është dhënë amnisti nga shteti shqiptar; e) kur personi i kërkuar është shtetas shqiptar dhe nuk ka marrëveshje që të parashikojë ndryshe; ë) kur është parashkruar ndjekja penale ose dënimi sipas ligjit të shtetit të kërkuar; f) kur personi i kërkuar është dënuar në mungesë, me përjashtim të rastit kur shteti kërkuar jep garanci për rishikimin e vendimit.”. Kolegji vë në dukje se parashikimi si kusht ndalues për lejimin e parashkrimit të ndjekjes penale ose dënimit, sipas shkronjës “ë”, të nenit 491 të sipërcituar, është në kundërshtim me përmbajtjen e Protokollit të Katërt shtesë të Konventës “Për Ekstradimin”, ratifikuar nga Republika e Shqipërisë me ligjin nr. 117/2013. Kolegji thekson se KPP-ja ka pësuar ndryshime thelbësore me ligjin nr. 35/2017, e konkretisht para këtyre ndryshimeve, rezulton se në nenin 491, shkronja “g” të këtij Kodi parashikohej (përpara ndryshimeve të bëra me ligjin nr. 35/2017): “...g) kur është parashikuar ndjekja penale ose dënimi sipas ligjit të shtetit që e kërkon.”. Rezulton se me ligjin nr. 35/2017, datë 30.3.2017, neni 491 i KPP-së është ndryshuar ku parashikimi i shkronjës “g” të dispozitës, emërtohet shkronja “ë” dhe formulimi bëhet: “...kur është parashkruar ndjekja penale ose dënimi sipas ligjit të shtetit të kërkuar”.

48. Në kushtet e parashtruara, pikërisht për këtë shkak, Kolegji fillimisht pezulloi gjykimin e kësaj çështjeje, duke e dërguar për shqyrtim në Gjykatën Kushtetuese. Kolegji vlerëson se neni 491, shkronja “ë” i KPP-së, është në kundërshtim me parashikimet konventore, duke ndryshuar kushtin e mospranimit të kërkesës për ekstradim për efekt parashkrimi të ekzekutimit, nga parashikimi i mëparshëm që ishte në përputhje me këto akte ndërkombëtare të miratuara përpara vitit 2017 me referencë ligjin e shtetit kërkuar, në parashikimin e ri që për efekt të parashkrimit referon ligjin material penal të shtetit të kërkuar. Gjykata Kushtetuese, me vendimin nr. 46, datë 12.3.2024 (siç është parashtruar edhe më lart), ka vendosur moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare. Në

marrijen e këtij vendimi, Gjykata Kushtetuese ka theksuar (citim): “... jurisprudenca duhet të ketë vijimësi dhe se sistemi gjyqësor duhet të funksionojë në mënyrë të tillë që të krijohen parakushtet për të krijuar një praktikë gjyqësore uniforme, bazuar edhe në parimet e drejtësisë, të barazisë para ligjit, si dhe në parimin se çështjet e ngjashme (analoge) duhet të zgjidhen në të njëjtën mënyrë. Në këtë këndvështrim merr rëndësi pozicioni dhe roli i Gjykatës së Lartë si gjykatë ligji, e cila, sipas nenit 141 të Kushtetutës, ka për detyrë të kontrollojë mënyrën e zbatimit të ligjit material dhe procedural nga ana e gjykatave më të ulëta në ushtrimin e funksionit të përgjithshëm për të siguruar uniformitetin e interpretimit të normave ligjore nga ana e gjyqtarëve të zakonshëm, përmes përcaktimit të linjave të interpretimit të cilave gjyqtarët duhet t’u përmbahen (shih vendimin nr. 4, datë 23.1.2017, të Gjykatës Kushtetuese).

31. Identifikimi dhe përcaktimi i ligjit të zbatueshëm në çështjen konkrete që parashtrohet për zgjidhje para gjykatave të zakonshme, në përputhje edhe me parimin e hierarkisë së akteve normative, është një çështje që u përket gjykatave të zakonshme. Në këtë kuptim, edhe interpretimi i dispozitave ligjore të zbatueshme për zgjidhjen e një çështjeje konkrete është, gjithashtu, një çështje që i përket juridiksionit të zakonshëm gjyqësor dhe veçanërisht Gjykatës së Lartë, roli i së cilës në këtë drejtim është pikërisht zgjidhja e konflikteve ligjore, unifikimi i vendimmarrjes së gjykatave të zakonshme dhe qëndrueshmëria. ...”.

49. Kolegji në lidhje me identifikimin e ligjit të zbatueshëm në rastin konkret, vlerëson të theksojë se, sipas neneve 116 dhe 122 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë,⁹ marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara janë pjesë e sistemit të brendshëm juridik shqiptar, të detyrueshme dhe të zbatueshme në mënyrë të drejtpërdrejtë, përveç kur zbatimi i saj kërkon nxjerrjen e një ligji. Këto dispozita kushtetuese përcaktojnë se, marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara në hierarkinë e akteve normative në Republikën e Shqipërisë, janë pas Kushtetutës. Në këtë kuptim, në rast mospërputhje ndërmjet marrëveshjes ndërkombëtare të ratifikuar dhe ligjeve apo akteve normative të Këshillit të

⁹Neni 116 i Kushtetutës përcakton: “1. Aktet normative që kanë fuqi në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë janë: a) Kushtetuta; b) marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara; c) ligjet; ç) aktet normative të Këshillit të Ministrave.”.

Neni 122 i Kushtetutës përcakton: “1. Çdo marrëveshje ndërkombëtare e ratifikuar përbën pjesë të sistemit të brendshëm juridik pasi botohet në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë. Ajo zbatohet në mënyrë Faqe | 20662

të drejtpërdrejtë, përveç rasteve kur nuk është e vetëzbatueshme dhe zbatimi i saj kërkon nxjerrjen e një ligji. Ndryshimi, plotësimi dhe shfuqizimi i ligjeve të miratuara me shumicën e të gjithë anëtarëve të Kuvendit, për efekt të ratifikimit të marrëveshjeve ndërkombëtare, bëhet me të njëjtën shumicë.

2. Një marrëveshje ndërkombëtare e ratifikuar me ligj ka epërsi mbi ligjet e vendit që nuk pajtohen me të ...”.



Ministrave, norma ndërkombëtare ka përparësi dhe është e detyrueshme të zbatohet. Në vijim, Kolegji vë në dukje se Gjykata Kushtetuese, në lidhje me rastin konkret dhe institutin e ekstradimit (vendimi i cituar nr. 46, datë 12.3.2024) ka theksuar: “... *burimet e së drejtës që rregullojnë ekstradimin në legjislacionin shqiptar janë Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, marrëveshjet ndërkombëtare shumëpalëshe dhe dypalëshe të ratifikuara, parimet dhe normat e së drejtës ndërkombëtare të pranuar, si dhe dispozitat e KP dhe të KPP. Në këtë kuptim, instituti i ekstradimit, referuar KEE dhe KPP, është një nga format e bashkëpunimit ndërkombëtar dhe ka për qëllim dorëzimin e një personi një shteti të huaj për ekzekutimin e një vendimi me burgim ose të një akti që vërteton procedimin e tij për një veprë penale (shih vendimin nr. 6, datë 16.2.2021, të Gjykatës Kushtetuese). Referuar kuadrit kushtetues të zbatueshëm, neni 39, pika 2, i Kushtetutës ka përcaktuar vetëm disa kushtëzime që lidhen me lejimin e ekstradimit, duke parashikuar se ai mund të lejohet vetëm kur është parashikuar shprehimisht në marrëveshjet ndërkombëtare në të cilat Republika e Shqipërisë është palë dhe vetëm me vendim gjyqësor. Kurse sipas shkrinjës “c”, të nenit 32, të ligjit nr. 10193/2009, përveç kushteve të parashikuara në KP dhe në KPP, ekstradimi i një personi në drejtim të një shteti të huaj lejohet kur ndjekja penale ose ekzekutimi i dënimit penal nuk janë parashikuar sipas legjislacionit të shtetit kërkuës. (...) Republika e Shqipërisë e ka ratifikuar Protokollin e Katërt shtesë të KEE me ligjin nr. 117/2013, i cili ka hyrë në fuqi në datën 1.6.2014, duke mos bërë rezervë për sa i përket nenit 10 të ndryshuar të Konventës për efektet e parashkrimit të ndjekjes penale ose dënimit në procedurat e ekstradimit. Për rrjedhojë, Republika e Shqipërisë ka pranuar në momentin e ratifikimit të këtij protokollit se nuk do të paraqesë si kriter për ndalimin e ekstradimit kalimin e afateve të parashkrimit të ndjekjes penale ose dënimit sipas ligjit penal të saj. (...)”.*

50. Në këtë vështrim, Kolegji vlerëson se dispozita/ligji i zbatueshëm në rastin konkret është pikërisht neni 10 i Konventës “Për Ekstradimin”, i ndryshuar me nenin 1 të Protokollit të Katërt shtesë të kësaj konvente, në zbatim të neneve 116 e 122 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë. Siç është theksuar edhe më lart, ky protokoll është ratifikuar nga Republika e Shqipërisë, e si rrjedhojë është pjesë e legjislacionit të brendshëm shqiptar. Në përputhje me Konventën “Për Ekstradimin” edhe protokollat e saj shtesë, është miratuar edhe ligji nr. 10193/2009, “Për marrëdhëniet juridiksionale me autoritetet e huaja”, (i ndryshuar), i cili në nenin 32 të tij ka parashikuar kushtet e ekstradimit. Kjo dispozitë

parashikon se, përveç kushteve të përcaktuara në KPP, ekstradimi i një personi në drejtim të një shteti të huaj lejohet kur plotësohen edhe kushtet e mëposhtme, ku në shkronjën “c” parashikohet kushti, se: “ndjekja penale ose ekzekutimi i dënimit penal nuk janë parashikuar sipas legjislacionit të shtetit kërkuës”. Kjo dispozitë është në përputhje të plotë me Konventën “Për Ekstradimin” dhe protokollat e saj shtesë.

51. Kolegji, në zbatim të ligjit të zbatueshëm, në lidhje me ekstradimin e shtetasve shqiptarë jashtë vendit, vlerëson se parashkrimi i ndjekjes penale ose i dënimit sipas ligjit shqiptar nuk është kusht ndalues për lejimin e ekstradimit. Por, nga ana tjetër, gjykatat duhet të verifikojnë e analizojnë me kujdes kushtet e tjera për ekstradimin e shtetasve shqiptarë. Në këtë vështrim, merr rëndësi verifikimi i kërkesës dhe akteve bashkëngjitur të paraqitura nga shteti kërkuës, garancitë që kërkojnë nga Konventa “Për Ekstradimin” dhe protokollat e saj shtesë; verifikimi i momentit kur këto akte ndërkombëtare kanë hyrë në fuqi për shtetin kërkuës, palë në këtë konventë dhe protokollat e saj shtesë; si dhe nëse ka marrëveshje dypalëshe me shtetin kërkuës në plotësim të Konventës “Për Ekstradimin”. Në rastin konkret në shqyrtim, Kolegji rithekson se ndërmjet Shqipërisë dhe Italisë është nënshkruar edhe marrëveshja shtesë dypalëshe, e ratifikuar nga shteti shqiptar me ligjin nr. 9871, datë 11.2.2008, por që ka hyrë në fuqi në datën 1.8.2011 (pas ratifikimit edhe nga shteti italian). Në këtë marrëveshje, palët kanë dakordësuar se nuk mund të ngrenë shtetësinë si arsye për refuzimin e dorëzimit, duke marrë përsipër në mënyrë të ndërsjellë që të dorëzojnë shtetasit e tyre që ndodhen në ndjekje penale nga njëra prej tyre për kryerjen e veprave penale, ose që janë shpallur në kërkim për vuajtjen e dënimit apo të një mase shtrënguese, në përputhje me normat dhe kërkesat e Konventës “Për Ekstradimin” (neni 18, pikat 1 dhe 2, i marrëveshjes).

52. Kolegji vlerëson se në shqyrtimin e kërkesave për ekstradimin e shtetasve shqiptarë jashtë shtetit, gjykatat duhet të mbajnë në konsideratë se në përputhje me nenin 39, pika 2, të Kushtetutës, sikurse u përmend më lart, ekstradimi lejohet kur parashikohet shprehimisht në marrëveshjet ndërkombëtare dhe vetëm me vendim gjyqësor. Bazuar në këtë dispozitë kushtetuese, Gjykata Kushtetuese ka çmuar se togfjalëshi “*vetëm me vendim gjyqësor*”, do të thotë se lejimi i ekstradimit vlerësohet



përmes një procesi gjyqësor, i cili në këto raste duhet të përmbushë standardet e procesit të rregullt ligjor, të parashikuara nga neni 42 i Kushtetutës dhe të materializuara në jurisprudencën kushtetuese, përfshirë edhe standardin e arsyetimit të vendimit (*shih vendimin nr. 6/2021 të Gjykatës Kushtetuese*).

53. Në përfundim të kësaj analize, Kolegji vlerëson se lidhur me kërkesën e ekstradimit të paraqitur nga autoriteti i huaj gjyqësor, gjykatat duhet të analizojnë me kujdes instrumentet ligjore të bashkëpunimit gjyqësor që janë të zbatueshme, duke identifikuar saktë ligjin/dispozitën e zbatueshme; kuadrin ligjor shqiptar mbi të cilat mbështetet bashkëpunimi gjyqësor në fushën penale me autoritetet gjyqësore të huaja, pra legjislacionin e brendshëm shqiptar; si dhe verifikimin e ekzistencës së instrumenteve dypalëshe apo shumëpalëshe të bashkëpunimit gjyqësor penal ndërkombëtar, të nënshkruar me shtetin kërkuar. Në lidhje me zbatimin e parimit të reciprocitetit, Kolegji rithekson edhe një herë se një parim i tillë duhet mbajtur në konsideratë dhe duhet zbatuar në momentin e nënshkrimit të marrëveshjeve midis shteteve palë, qofshin këto marrëveshje dypalëshe apo shumëpalëshe. Respektimi në praktikë i këtij parimi është i natyrës politike dhe nuk mund të jetë shkak për moslejimin e ekstradimit nga gjykata, pasi nuk është një kusht apo parim që vlerësohet nga juridiksioni gjyqësor. Sa më sipër, si nga ana procedurale ashtu dhe materiale, Kolegji vlerëson se kur një shtet palë vendos një rezervë, në lidhje me një dispozitë të konventës (kur kjo marrëveshje ndërkombëtare e lejon, siç është rasti i nenit 10 të Protokollit të Katërt shtesë të Konventës “Për Ekstradimin”), i takon autoritetit kompetent që përfaqëson shtetin shqiptar në zhvillimin e bisedimeve në raport me këtë marrëveshje ndërkombëtare që të negociojë, kundërshtojë, pranojë apo të tërheqë kundërshtimin për këtë rezervë. Kolegji çmon se parashkrimi i ekzekutimit të ndjekjes penale ose dënimit është një çështje juridike e cila vlerësohet dhe zbatohet duke pasur në konsideratë ligjin e shtetit kërkuar, në kushtet kur Republika e Shqipërisë nuk ka bërë rezervë në instrumentin ratifikues të Protokollit të Katërt shtesë të Konventës “Për Ekstradimin”.

54. Për sa i përket ligjit të palës kërkuar, kalimi i afatit të parashkrimit është një shkak që sjell refuzimin e kërkesës për ekstradim. Kjo do të thotë se në çdo rast, kur ka dyshime apo kur ky afat nuk

verifikohet nga aktet e paraqitura nga shteti kërkuar, shteti i kërkuar përfshi këtu edhe gjykatën që shqyrton kërkesën, ka detyrimin të shqyrtojë apo të kërkojë informacione shtesë, në lidhje me kalimin apo jo të afatit të parashkrimit. Arsyeja e këtij parashkrimi lidhet me faktin se, shteti kërkuar nuk mund/nuk duhet të kërkojë ekstradimin e një personi, ndjekja ose dënimi i të cilit është i parashkruar sipas ligjit të tij të brendshëm. Shteti kërkuar duhet të sigurojë shtetin e kërkuar me një deklaratë të motivuar, duke specifikuar arsyet për të cilat nuk ka gabim në përllogaritje të afatit të parashkrimit dhe duke përfshirë dispozitat përkatëse të ligjit të tij (*shih nenin 12, paragrafi 2, nënparagrafët “b” dhe “c” të Konventës, i ndryshuar nga protokollin aktual*). Kolegji mbështet qëndrimin e konsoliduar të praktikës gjyqësore, në lidhje me rolin thelbësor që ka gjykata në verifikimin e kushteve procedurale, lidhur me lejimin ose jo të ekstradimit të shtetasve shqiptar. Gjykatat duhet të verifikojnë kushtet ligjore për lejimin ose jo të ekstradimit të një shtetasi shqiptar, rast pas rasti, ku në arritjen e përfundimeve rëndësi merr dokumentacioni shoqërues i kërkesës për ekstradim i kërkuar nga neni 489 i KPP-së, si dhe ligji i zbatueshëm, Konventa “Për Ekstradimin”, si dhe konteksti juridik, apo rrethana të tjera të rastit konkret (*shih vendimin nr. 00-2017-899 (143), datë 22.11.2017, të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë*). Në lidhje me këtë moment të rëndësishëm, Kolegji rithekson edhe faktin se në momentin e nënshkrimit të Konventës “Për Ekstradimin”, Republika e Shqipërisë ka deklaruar se refuzon ekstradimin e shtetasve të vet, me përjashtim të rasteve kur është parashikuar ndryshe në marrëveshjet ndërkombëtare në të cilat Shqipëria është palë kontraktuese (neni 2, i ligjit nr. 8322, datë 2.4.1998, “Për ratifikimin e Konventës së Këshillit të Evropës ‘Për Ekstradimin’ dhe dy Protokollit Shtesë”).

55. Në përfundim të kësaj analize, Kolegji, në lidhje me çështjen e dytë të shtruar për njësim, arrin në këtë përfundim njësoj: ***Gjykata, pranon kërkesën për ekstradimin e shtetasve shqiptar edhe në rast se ndjekja penale dhe dënimi janë parashkruar sipas ligjit penal shqiptar. Gjykata, në përputhje me nenin 122 të Kushtetutës, zbaton nenin 10, paragrafi i dytë, të Konventës Evropiane “Për Ekstradimin”, ndryshuar me Protokollin e Katërt shtesë të kësaj konvente edhe nëse ndonjë nga shtetet palë në këtë***



marrëveshje kanë vendosur rezervë në normën ndërkombëtare.

IV. Në lidhje me zgjidhjen e çështjes konkrete:

56. Lidhur me zgjidhjen e çështjes konkrete, Kolegji vlerëson se vendimi i Gjykatës së Apelit Tiranë është marrë në zbatim të gabuar të ligjit procedural penal dhe për rrjedhojë ky vendim është i cënueshëm. Në rekurs, Prokuroria pranë Gjykatës së Apelit Tiranë ka pretenduar se, gjykata e apelit nuk duhet ta bazonte vendimin e saj në nenin 491, shkronja “ë” të KPP-së, por ajo duhet të linte në fuqi vendimin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, e cila e ka lejuar ekstradimin e të dënuarit Bledar Bedini *alias* Imami nga Republika e Shqipërisë në drejtim të Republikës së Italisë.

57. Në vendim, Gjykata e Apelit Tiranë ka arsyetuar se, meqenëse Republika e Italisë ka bërë rezervë ligjore për nenin 10 të Protokollit të Katër Shtesë të Konventës “Për Ekstradimin”, atëherë gjykata shqiptare, duke u bazuar në parimin e reciprocitetit, parashikuar në nenin 26 të kësaj konvente, duhet të zbatojë ligjin shqiptar në zgjidhjen e çështjes, duke ndryshuar vendimin e gjykatës së shkallës së parë dhe vendosur mospranimin e kërkesës për ekstradimin e të dënuarit. Në zgjidhjen e çështjes gjykata e apelit ka argumentuar se, për shkak të parimit të reciprocitetit, në zbatimin e Konventës “Për Ekstradimin” me Italinë, do të zbatohet neni 10 i kësaj konvente, para ndryshimeve që kjo dispozitë ka pësuar me nenin 1 të Protokollit të Katërt shtesë. Në këto rrethana, gjykata e apelit ka theksuar se gjen zbatim neni 491, shkronja “ë”, i KPP-së, që parashikon si kusht ndalues për ekstradimin rastin kur verifikohet se dënimi është parashikuar sipas ligjit të shtetit të kërkuar, pra sipas ligjit shqiptar.

58. Në vijim të konkluzioneve njësuere të cituara më lart, Kolegji vlerëson të gabuar përfundimin e arritur nga gjykata e apelit. Në radhë të parë, Kolegji vë në dukje se Gjykata e Apelit Tiranë në argumentimin e vendimit bazohet në supozime, për raste të ngjashme kur Italia mund të refuzojë ekstradimin e një shtetasi italian në Shqipëri, për shkak të kalimit të afatit të parashkrimit të ndjekjes penale apo të dënimit. Gjykata e apelit përdor shprehjen “në një rast analog”, ndërkohë që nuk shtjellon më tej se kur mund të verifikohet ky rast analog, e aq më pak të citohet apo referohet një rast konkret. Kolegji tërheq vëmendjen e gjykatës së

apelit, si dhe gjykatave që do shqyrtojnë çështje të ngjashme ekstradimi (jo vetëm me Italinë), se në rastin kur kanë dyshime për afatin e parashkrimit duhet të kërkojnë informacione nëse një fakt i tillë nuk rezulton nga dokumentet bashkëngjitur kërkesës. Në verifikim të dispozitave të zbatueshme në dy vendet përkatëse (Shqipëri dhe Itali), në lidhje me afatin e parashkrimit të ndjekjes penale apo të dënimit, Kolegji vë në dukje se dukshëm afatet e parashikuara nga ligji italian janë më të gjata se ato që parashikohen nga ligji penal shqiptar. Por, problematika nuk është thjesht një çështje e kalimit apo jo të afatit të parashkrimit.

59. Kolegji thekson se, në lidhje me procedurën e ekstradimit të një personi, një nga parimet kryesore që gjen zbatim është parimi *aut dedere aut judicare* (ose dorëzime ose gjykoje). Sipas këtij parimi që vepron në marrëdhëniet juridiksionale me autoritetet e huaja, shteti i kërkuar, të cilit i është paraqitur një kërkesë për ekstradim, duhet ose të procedojë vetë shkelësin e ligjit ose të lejojë ekstradimin e tij në shtetin kërkuar. Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në vijim KEDNJ-ja) nuk përmban asnjë referencë në lidhje me zbatimin e këtij parimi. Ndërkohë, nga ana tjetër, Konventa “Për Ekstradimin” vendos një detyrim për shtetet palë/kontraktuese që të dorëzojnë sipas dispozitave dhe kushteve të përcaktuara në këtë konventë, të gjithë personat e kërkuar nga autoritetet kompetente të një shteti tjetër palë/kontraktues. Në këtë kuptim, në rast se një shtet palë në këtë konventë nuk lejon ekstradimin e një personi, ai duhet të procedojë/të ndjekë penalisht këtë person mbi kërkesën e shtetit tjetër/shtetit kërkuar. Në këtë kuptim, neni 10, pikat 2 dhe 3, të Konventës “Për Ekstradimin”, me përmbajtjen e ndryshuar sipas nenit 1, të Protokollit të Katërt shtesë të kësaj konvente, lejon shtetin e kërkuar të refuzojë zbatimin e pikës 2, të nenit 10 të cituar më lart, kur verifikohen dy kushte: *i.* kërkesa për ekstradim bazohet në veprat penale për të cilat shteti ka juridiksion sipas ligjit të tij penal (pra shteti i kërkuar mund dhe duhet të procedojë penalisht personin që kërkohet të ekstradohet); *ii.* kur legjislacioni i brendshëm i këtij shteti e ndalon shprehimisht ekstradimin kur ndjekja penale ose dënimi i personit të kërkuar do të parashkruhej sipas ligjit të tij. Italia, në momentin e nënshkrimit të Protokollit të Katërt shtesë të Konventës “Për Ekstradimin”, ka bërë rezervën se nuk do të lejojë ekstradimin e shtetasve të tij, në rastin e veprave



penale të parashikuara sipas ligjit italian, për të cilat ka juridiksion. Në jurisprudencën italiane janë verifikuar raste të refuzimit të ekzekutimit të një urdhër arresti në zbatim të një vendimi të marrë nga një autoritet gjyqësor i huaj, por kjo masë është shoqëruar me ekzekutimin e menjëhershëm të këtij dënimi në territorin kombëtar (qëndrime të verifikuara në raport edhe me vendet anëtare të Bashkimit Evropian). Gjykata e apelit nuk ka sqaruar dhe as nuk ka referuar ndonjë interpretim të shprehjes “vepra penale për të cilat shteti i kërkuar ka juridiksion sipas ligjit të tij penal”, i cili është kushti i pranuar nga Italia në momentin që ka bërë rezervën në zbatimin e nenit 10, pika 2 të Konventës “Për Ekstradimin”. Ndërkohë, në lidhje me kushtin e dytë, nuk shfaqet asnjë problematikë, për sa kohë afatet e parashkrimit të ndjekjes penale ose dënimit në ligjin penal italian janë sa dyfishi i afateve të parashikuara në ligjin penal shqiptar. Shqipëria nuk mund të refuzojë ekstradimin e një shtetasi duke përdorur si shkak parashkrimin e ndjekjes penale dhe të dënimit sipas ligjit shqiptar, përderisa nuk ka bërë apo depozituar asnjë rezervë në këtë drejtim.

60. Në vijim të kësaj analize, Kolegji e vlerëson të gabuar përfundimin që ka arritur gjykata e apelit dhe në kundërshtim me nenin 122/2 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, që parashikon: *Një marrëveshje ndërkombëtare e ratifikuar me ligj ka epërsi mbi ligjet e vendit që nuk pajtohen me të*. Gjykata e apelit nuk ka pasur në konsideratë edhe praktikën e konsoliduar të Kolegjit Penal, që në raste të kërkesave për ekstradim të shtetasve shqiptarë për jashtë (veçanërisht me Italinë), ka vlerësuar: i. Së pari, referuar parimeve të përgjithshme në marrëdhëniet juridiksionale me autoritetet e huaja që janë shprehje e vullnetit politik të shtetit, ky vullnet në rastin në shqyrtim është shprehur nga autoriteti i ngarkuar me ligj, ministri i Drejtësisë, me kërkesën (...), për ekstradimin e shtetasit të kërkuar (...) nga Shqipëria për në Itali, kërkesë e cila i është dërguar për ndjekje Prokurorisë së Përgjithshme. (...) Së treti, referuar marrëveshjes dypalëshe të ratifikuar me ligjin nr. 9871/2008, në nenin 18 të saj, “Ekstradimet e shtetasve” parashikohet se “Palët kontraktuese marrin përsipër në mënyrë të ndërsjellë të dorëzojnë shtetasit e tyre ... në përputhje me normat dhe kërkesat e Konventës “Për Ekstradimin”. Pra, dy palët kanë shprehur vullnetin që ekstradimi të realizohet në përputhje me normat dhe kërkesat e konventës, duke kapërcyer barrierat

reciproke të legjislacionit të secilit vend, deri dhe kanë parashikuar se palët nuk mund të ngrenë shtetësinë si arsye për refuzimin e dorëzimit (*shih vendimin nr. 00-2020-473 (4), datë 22.12.2020, i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, vendim në të cilin Kolegji ka interpretuar përse nuk gjen zbatim në atë rast kushti ndalues i parashikuar nga neni 491, pika 1, shkronja “c”, dispozitë që aktualisht është shfuqizuar. Kolegji ka ritheksuar në këtë vendim qëndrimin e konsoliduar edhe më herët të Kolegjit Penal se kushti përkatës i parashikuar në ligjin procedural penal nuk duhet kuptuar si një rrethanë ndaluese për lejimin e ekstradimit, por si një rrethanë që mund të pezullojë ekzekutimin e tij, referuar nenit 500 të KPP*).

61. Kolegji vlerëson të pabazuar edhe argumentimin vijues të gjykatës së apelit se, e njëjta çështje me objekt “njohje vendimi penal të huaj” ndodhet për gjykim në Gjykatën e Lartë. Gjykata e apelit, ndër të tjera, ka çmuar se ka “një përplasje kërkesash dhe vendimesh penale, në lidhje me të dënuarin dhe në kushtet kur për njohjen e vendimit penal të huaj nuk ka një vendim përfundimtar organi i akuzës nuk mund të pretendojë ekzekutimin e ekstradimit pa u njohur vendimi penal i huaj nga gjykimi në Gjykatën e Lartë. (...) Pra, konstatohet se njëkohësisht në gjykatat shqiptare shqyrtohen dhe gjykohen dy kërkesa (njohje vendimi penal të huaj dhe kërkesë për ekstradim) për të njëjtin fakt, ndaj të njëjtut shtetas shqiptar, me të njëjtin shtet kërkuar. Në analizë të sa më lart, gjykata vlerëson se cenohet parimi i mosgjykimit dy herë për të njëjtën vepër penale, që është parashikuar në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë (neni 34 i saj)...”. Në vijim të këtij arsyetimi, gjykata e apelit ka theksuar, se: “në eventualitetin e sipërcituar, të pranimit të kërkesës për ekstradim në kushtet për të njëjtin fakt është refuzuar më parë kërkesa për njohjen e vendimit penal të huaj ndaj shtetasit shqiptar Bledar Bedini *alias* Imami, bie ndesh formalisht edhe me parimin e mosdënimit pa ligj që parashikohet në nenin 7 të KEDNJ-së, si dhe nenin 29 të Kushtetutës shqiptare dhe është pjesë e rëndësishme e procesit të rregullt ligjor, së bashku me parimin e mos dënimit dy herë për të njëjtin fakt (*ne bis in idem*). ... Në këtë kuptim, nuk mund të pranohet kërkesa për ekstradim në kushtet kur për të njëjtin fakt është refuzuar më parë kërkesa për njohjen e vendimit penal të huaj ndaj shtetasit shqiptar, pasi bie ndesh me qëllimin e nenit 29 të Kushtetutës dhe nenit 7 të KEDNJ-së, krijon efektet ekuivalente dhe materiale të një dënimi penal pa ligj, si dhe bie ndesh edhe me parimin e mos



dënimit dy herë për të njëjtin fakt (*ne bis in idem*).”. Gjykata e apelit, përveç sa më lart, ka vlerësuar se në rastin konkret cenohet edhe parimi kushtetues e konventor i sigurisë juridike, pasi referuar kuadrin ligjor të zbatueshëm, shtetasve shqiptarë përfshi edhe të dënuarin, “i cenohet procesi i rregullt ligjor për shkak se ligjvënësi nuk ka respektuar parimin konventor dhe kushtetues të qartësisë, dhe precizitetit të ligjit penal të elaboruar në vijimësi nga GJEDNJ-ja dhe Gjykata Kushtetuese...”.

62. Kolegji vlerëson të gabuar këtë interpretim të gjykatës së apelit dhe jo në përputhje me praktikën gjyqësore jo vetëm të Gjykatës së Lartë, por edhe me qëndrimet e gjykatave shqiptare në shqyrtimin e kërkesave të autoriteteve të huaja për ekstradim. Lidhur me pretendimin për cenimin e parimit të gjësë së gjykuar, Kolegji vlerëson se përfundimi i mësipërm i arritur nga Gjykata e Apelit Tiranë nuk është i saktë dhe për rrjedhojë ai nuk qëndron. Kolegji thekson se shtetasi Bledar Bedini *alias* Imami as nuk është hetuar nga prokuroria shqiptare dhe as nuk është gjykuar nga gjykatat shqiptare për veprat penale të kryera prej tij jashtë territorit shqiptar për të cilat autoritetet gjyqësore italiane kanë kërkuar ekstradimin e tij. Parimi *ne bis in idem*, është trajtuar gjerësisht si nga GJEDNJ-ja, ashtu dhe Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë¹⁰, të cilat kanë mbajtur qëndrimin se, parimi *ne bis in idem* është njohur nga e drejta jonë e brendshme dhe nga e drejta ndërkombëtare penale si një prej të drejtave të njeriut të mbrojtura nga Kushtetuta dhe nga instrumentet kryesore juridike të brendshme e ndërkombëtare që rregullojnë marrëdhëniet në fushën penale, si dhe përgjegjësinë për kundërvajtje. Sipas këtij parimi, “individit nuk mund të ndiqet e nuk mund të gjykohej nga juridiksionet e të njëjtut shtet për një shkelje, për të cilën është shpallur më parë i pafajshëm apo është dënuar në bazë të një vendimi gjyqësor përfundimtar të ligjshëm”.¹¹ Pranimi i parimit të mësipërm në gjykimin dhe vendimmarrjen për një çështje penale kërkon përmbushjen e dy kriterëve që janë, ai i veprës penale “të njëjtë” me të mëparshmen dhe ai i kryerjes së saj “përsëri”. Kriteri “e njëjta veprë” i referohet të njëjtut veprim, sjellje, fakt, veprë penale dhe kualifikim ligjor të tyre, të cilat formojnë bazën

e kësaj veprë dhe për të cilin personi është dënuar apo liruar. Në këtë rast, është fjala kur si sjellja ashtu edhe krimi bëhen për të njëjtat fakte të ndodhura në të njëjtën kohë dhe që cilësohen njëloj nga ligji.

63. Kolegji, referuar interpretimit të cituar më lart, vlerëson se ky parim nuk mund të gjejë zbatim në rastin konkret. Nga aktet rezulton se fillimisht autoritetet italiane kanë përcjellë kërkesën për bashkëpunim me autoritetet shqiptare për njohjen dhe ekzekutimin në Shqipëri të vendimit të dënimit të dhënë në Itali ndaj shtetasit shqiptar Bledar Bedini *alias* Imami. Ky vendim nuk është njohur dhe ekzekutuar në Shqipëri për shkak të kalimit të afatit të parashkrimit të ekzekutimit të dënimit sipas legjislacionit shqiptar. Kolegji vlerëson se, nuk është arritur bashkëpunimi me autoritetet gjyqësore italiane për njohjen dhe konvertimin e vendimit penal, me qëllim vuajtjen e pjesës së mbetur të dënimit nga shtetasi Bledar Bedini *alias* Imami në territorin shqiptar, në zbatim të marrëveshjes “Për transferimin e personave të dënuar” e vitit 2004, e lidhur mes Shqipërisë dhe Italisë. Ky fakt nënkupton se, dënimi i dhënë ndaj këtij shtetasi nga autoritetet gjyqësore italiane nuk është ekzekutuar, për shkak të kriterit ndalues të kalimit të afateve të parashkrimit të ekzekutimit të dënimit sipas legjislacionit shqiptar. Në bazë të nenit 54, shkronja “b”, të ligjit “Për marrëdhëniet juridiksionale me autoritetet e huaja”, ligji i zbatueshëm, përveç kushteve të parashikuara në nenin 514 të KPP-së, vendimi penal i huaj njihet dhe ekzekutohet kur ekzekutimi i vendimit të dënimit, sipas legjislacionit të brendshëm nuk është parashkruar. Në rastet kur ekzekutimi i vendimit të dënimit sipas legjislacionit tonë është parashkruar, siç edhe ka ndodhur në rastin konkret, atëherë vendimi penal i huaj nuk njihet. Mosnjohja në thelb e vendimit të dënimit të dhënë nga gjykatat italiane ndaj shtetasit shqiptar Bledar Bedini *alias* Imami, për shkak të parashkrimit të ekzekutimit të dënimit të huaj, ka vënë në lëvizje autoritetet kompetente italiane, në përdorimin e instrumentit të dytë të bashkëpunimit me Shqipërinë, që është kërkesa për ekstradim, referuar marrëveshjes së ekstradimit mes dy shteteve në plotësim të Konventës së Ekstradimit dhe Protokolleve shtesë.

¹⁰ Vendimi nr. 5, datë 8.3.2005, i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë.

¹¹ Vendimi i datës 14.9.1999, dhoma (Seksioni) i III i Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, ankimet nr. 36855/97 dhe 41731.98.



64. Kolegji thekson se, vendimi i gjykatës shqiptare për njohjen e vendimit penal të huaj, në bazë të vendimit unifikues nr. 154, datë 15.5.2000, të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, nuk është një vendimi i ri themeli, në kuptim të shqyrtimit dhe vlerësimit të provave, në funksion të akuzës së sjellë për gjykim. Siç e përmendëm edhe më lart, vendimi i dënimit të dhënë nga Gjykata e Apelit Milano, Itali, jo vetëm që nuk është njohur dhe nuk është vënë në ekzekutim në Shqipëri, por në zbatim të konkluzioneve unifikuese të Gjykatës së Lartë, vendimi i njohjes dhe konvertimit të dënimit të huaj nuk është një gjykim i mirëfilltë themeli. Kolegji sjell në vëmendje se për natyrën e vendimit të njohjes dhe konvertimit të dënimit të huaj, Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë, në vendimin unifikues nr. 154, datë 15.4.2000, kanë konkluduar, se: *“Sikurse shihet, në të dy rastet kemi të bëjmë me një vendim të autoritetit gjyqësor të shtetit të dënimit, i cili njihet dhe vibet në ekzekutim në shtetin e ekzekutimit në përputhje me procedurat e pranuar nga konventat përkatëse të KPP. Për efekt të njësimi të praktikës gjyqësore, Kolegjet e Bashkuara pranojnë se për të gjykuarin A. H. dhe në çdo rast, vendimi i Gjykatës Shqiptare nuk është një vendim i ri. Për këtë shkak, gjykata shqiptare nuk shqyrton çështjen në themel dhe as nuk verifikon provat e marra nga gjykata e huaj. Ajo verifikon nëse ekzistojnë kushtet për njohjen e vendimit të huaj dhe duhet t’i përgjigjet atij vendimi me një vendim që konverton dënimin e huaj me një dënim të parashikuar nga legjislacioni shqiptar, duke përcaktuar edhe dispozitat përkatëse të cilat aplikohen. E rëndësishme sipas Kolegjeve të Bashkuara është të evidentohet fakti se është vendimi i huaj ai që vibet në ekzekutim nëpërmjet një vendimi njohës të gjykatës shqiptare”*.

65. Në këtë vështrim, Kolegji vlerëson haptazi të pabazuar konkluzionin e gjykatës së apelit për cenimin e parimit *ne bis in idem*, në rastin konkret. Gjithashtu, Kolegji vlerëson se në çështjen objekt gjykimi nuk është vërtetuar se gjendemi as përpara nenit 498/4 të KPP-së, ku parashikohet: *“... Vendimi kundër ekstradimit ndalon dhënien e një vendimi të mëpasshëm në favor të ekstradimit si rezultat i një kërkesë të re të paraqitur për të njëjtat fakte nga i njëjti shtet, përveçse kur kërkesa mbështetet në elemente që nuk kanë qenë vlerësuar nga gjykata...”*. Në rastin konkret, nuk konstatohet që autoritetet shqiptare të drejtësisë të kenë marrë në shqyrtim e aq më pak të kenë disponuar me vendim për ndalimin e ekstradimit të shtetasit Bledar Bedini (përpara paraqitjes së kërkesës objekt shqyrtimi). Rregullimi ligjor i

mësipërm, i ka dhënë garanci subjekteve që i nënshtrohen një procedure ekstradimi, se ky i fundit nuk do të lejohet të zbatohet nëse gjykata e ka shqyrtuar më parë të njëjtën kërkesë ekstradimi dhe ka disponuar me refuzim (*vendim kundër ekstradimit*), me kushtin që kërkesa e re t’i referohet të njëjtit person, të njëjtave fakte dhe të jetë bërë nga i njëjti shtet për të cilin ajo ka disponuar më parë. Duke ju referuar fakteve të sipërcituara ndryshe nga sa është arsyetuar nga gjykata e apelit, Kolegji çmon se në rastin konkret nuk ndodhemi para institutit të gjësë së gjykuar, pasi kërkesa për ekstradim dhe kërkesa për njohjen e vendimit penal të huaj janë dy institute të ndryshme edhe si të tilla gjykimi i njëres kërkesë konkretisht i njohjes së një vendimi penal të huaj nuk mund të përbëjë gjë të gjykuar në lidhje me gjykimin e tjetrës, pra kërkesës për ekstradim ndaj të njëjtit subjekt (individ), për të njëjtin vendim penal të huaj (*të njëjtin qëndrim ka mbajtur Kolegji Penal edhe në raste të tjera, për më tepër shih vendimi nr. 00-2020-473 (4), datë 22.12.2020; vendimi nr. 00-2021-938 (97), datë 16.11.2021*).

66. Në vijim të këtij arsytimi, Kolegji vlerëson se nuk qëndrojnë as argumentet e parashtruara nga gjykata e apelit, në lidhje me cenimin e parimit të mosdënimit pa ligj, referuar nenit 7 të KEDNJ-së, si dhe nenit 29 të Kushtetutës shqiptare apo edhe për cenimin e parimit të sigurisë juridike, si pjesë të rëndësishme të procesit të rregullt gjyqësor. Parimi i ligjshmërisë është sanksionuar në nenin 29, pikat 1 dhe 2, të Kushtetutës: *“1. Askush nuk mund të akuzohet ose të deklarohet fajtor për një vepër penale, e cila nuk konsiderohet e tillë me ligj në kohën e kryerjes së saj (nullum crimen sine lege). 2. Nuk mund të jepet një dënim më i rëndë se ai që ka qenë parashikuar me ligj në kohën e kryerjes së veprës penale (nullum poena sine lege).”* Ky parim është sanksionuar edhe në nenin 2 të KP-së: *“Askush nuk mund të dënohet penalisht për një vepër që më parë nuk është e parashikuar shprehimisht në ligj si krim ose kundërvajtje penale. Askush nuk mund të dënohet me një lloj dhe masë dënimi të paparashikuar në ligj”*. Ky është një nga parimet themelore të së drejtës penale dhe duhet interpretuar e aplikuar në mënyrë të tillë që të sigurojë mbrojtje efektive nga procedimet dhe dënimet arbitrare. GJEDNJ-ja në jurisprudencën e saj ka theksuar se, këto parime frymëzohen nga ideja për sigurinë juridike të qytetarëve: pra duhet të jenë të parashikueshme veprat e kundërligjshme dhe



sanksionet që jepen për to¹². Ligjshmëria e dënimeve, si dhe ajo e veprave penale është kushti themelor për sigurinë dhe lirinë individuale. Për të garantuar sigurinë juridike të qytetarëve duhet që gjithçka që është e dënueshme e po ashtu edhe dënimet të jenë të parashikueshme¹³.

67. Kolegji, në lidhje me procedurën e ekstradimit vë në dukje se GJEDNJ-ja, në çështjen Rrapo kundër Shqipërisë (aplikimi nr. 58555/10, vendim i datës 25.9.2012) ka argumentuar: “...72. Gjykata pohon se në çështjet e ekstradimit, shënimet diplomatike janë mjete standarde për shtetin që bën kërkesën për të dhënë çdo siguri, të cilën, shteti të cilin i është paraqitur kërkesa, e konsideron të nevojshme për të dhënë miratimin e tij për ekstradim. Gjithashtu, ajo pohon se në marrëdhëniet ndërkombëtare, shënimet diplomatike japin idenë e mirëbesimit. Gjykata mendon se në çështjet e ekstradimit, është me vend që të ketë hamendësime dhe jo siguri të plotë rreth një shteti i cili ka paraqitur kërkesën dhe i cili gjithsesi ka një histori të gjatë respekti për demokracinë, të drejtat e njeriut dhe fuqinë e ligjit, dhe i cili ka marrëveshje të gjata ekstradimi me shtetet kontraktuese (shiko Babar Ahmad dhe të tjerët kundër Mbretërisë së Bashkuar (vendim) nr. 24027/07, 11949/08 dhe 36742/08, § 105, 6 korrik 2010)...”.

68. Në zbatim të parimit të ligjshmërisë, Kolegji vlerëson se gjykatat duhet të analizojnë ekzistencën e kushteve që lejojnë ekstradimin, duke analizuar nëse verifikohet ndonjë ndalim ligjor për ekstradimin e shtetasit të kërkuar, në përputhje me përcaktimet e neneve 490 e 491 të KPP-së. Në rastin konkret, Kolegji vlerëson se vendimmarrja e gjykatës së shkallës së parë është në përputhje me kërkesat e nenit 11, të KP-së, nenit 489/1 të KPP-së, si dhe me kushtet e parashikuara në nenin 32, të ligjit nr. 10193, datë 3.12.2009, “Për marrëdhëniet juridiksionale me autoritetet e huaja në çështjet penale, pasi ekstradimi është parashikuar shprehimisht në marrëveshjet ndërkombëtare në të cilat Republika e Shqipërisë është palë. Gjykata e shkallës së parë, me të drejtë, ka arsyetuar se vendimi penal me të cilin është dënuar dhe kërkohet ekstradimi ndaj shtetasit Bledar Bedini, nuk përmban disponime që vijnë në kundërshtim me parimet e rendit juridik të shtetit shqiptar; nuk rezulton që ky person për të njëjtin fakt të jetë proceduar dhe të jetë dhënë ndonjë vendim penal i

formës së prerë në shtetin shqiptar; vendimi është dhënë nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme; nuk ka arsye për të menduar se kanë ndikuar në përfundimin e procesit konsiderata lidhur me racën, fenë apo gjuhën; faktet për të cilat ai është dënuar nga autoritetet italiane të drejtësisë (importim, mbajtje dhe shitje e lëndëve narkotike të llojit kokainë dhe pjesëmarrje në organizatë kriminale me qëllim importimin, mbajtjen dhe shitjen e narkotikëve) parashikohen si vepra penale në legjislacionin shqiptar në kohën kur janë kryer. Veprat penale për të cilat shtetasi shqiptar Bledar Bedini kërkohet nga autoritetet e drejtësisë italiane, gjenden të parashikuara edhe në dispozitat e KP-së të Republikës së Shqipërisë, në nenet 283/a dhe 333/a të këtij Kodi. Nuk ka asnjë hetim apo gjykim të nisur apo të përfunduar nga autoritetet e drejtësisë shqiptare kundër shtetasit Bledar Bedini për këtë vepër penale. Nuk është në fuqi asnjë amnisti e dhënë nga shteti shqiptar për llojin e veprës penale të dyshuar se ka kryer shtetasi Bledar Bedini. Në gjykim nuk është paraqitur asnjë provë sipas të cilës të rezultojë se nëse do të ekstradohet në Itali, ky shtetas do të jetë objekt persekutimi apo diskriminimi për shkak të racës, fesë, seksit, shtetësisë, gjuhës, bindjeve politike, gjendjes personale a shoqërore ose i dënimeve a trajtimeve të egra, çnjerëzore a poshtëruese, ose i veprimeve që përbëjnë shkelje të një të drejte themelore të njeriut.

69. Në përfundim të kësaj analize, Kolegji vlerëson haptazi të pabazuar argumentin e gjykatës së apelit për cenimin e parimit të mosdënimit pa ligj apo të cenimit të parimit të sigurisë juridike. Fakti që Italia ka bërë rezervë ndaj një dispozite të Protokollit të Katërt shtesë të Konventës “Për Ekstradimin”, nuk do të thotë se ligji nuk ekziston, apo që dënimi i dhënë ndaj shtetasit shqiptar nuk është i parashikuar në ligj. Sipas parimit kushtetues të cituar, ligji penal shqiptar parashikon veprën penale dhe dënimin për faktet që i janë atribuuar e për të cilat shtetasi Bledar Bedini është deklaruar fajtor nga gjykata italiane. Pra, sipas parimit të ligjshmërisë formojnë vepër penale vetëm dhe ekskluzivisht faktet shprehimisht të parashikuara nga ligji si të tilla. E në këtë drejtim, ligji penal material shqiptar është i qartë dhe konciz, ashtu sikurse edhe ligji procedural penal

¹² GJEDNJ, çështja S. W. kundër Mbretërisë së Bashkuar/22 nëntor 1995; çështja Kokkinakis kundër Greqisë/25 maj 1993 etj.

¹³ GJEDNJ, çështja Kafkaris kundër Qipros/12 shkurt 2008.



ofron garanci për personin që kërkohet të ekstradohet, në përputhje me parimet e procesit të rregullt ligjor. Kolegji gjen të pabazuar ligjërisht argumentimin e gjykatës së apelit edhe për cenimin e parimit të sigurisë juridike, argument që nuk gjen asnjë mbështetje në Kushtetutë, në ligj apo në jurisprudencën kushtetuese apo atë të Gjykatës së Lartë.

70. Kolegji konstaton se mbrojtësi i personit të kërkuar ka parashtruar edhe pretendimin se shtetasi Bledar Bedini është gjykuar në Itali në mungesë/*in absentia*, ndërkohë që ekstradimi është lejuar nga gjykata e shkallës së parë pa marrë një garanci të shprehur nga ky shtet (Italia) për rigjykimin e tij. Në lidhje me këtë pretendim që sipas mbrojtjes përbën *shkak më vete refuzues të ekstradimit*, mbështetur në nenin 491/f të KPP-së, sipas të cilit: “*Nuk mund të jepet ekstradimi: ... f). kur personi i kërkuar është dënuar në mungesë, me përjashtim të rastit kur shteti kërkuar jep garanci për rishikimin e vendimit*”, Kolegji vlerëson se nuk ka asnjë argumentim konkret nga ana e mbrojtjes përse shtetasit Bledar Bedini nuk do t’i jepet mundësia e rishikimit të vendimit (nëse do të plotësojë kriteret përkatëse ligjore). Në legjislacionin penal të Republikës së Italisë, është parashikuar instituti i rishikimit të vendimeve, neni 630 i Kodit të Procedurës Penale (italian), sikundër është i parashikuar dhe instituti i rivendosjes në afat (parashikuar nga neni 175 i Kodit italian të Procedurës Penale). Për rrjedhojë, ky argumentim është i pabazuar në ligj. Nga ana tjetër, referuar akteve të përcjella nga autoritetet italiane rezulton se shtetasi shqiptar Bledar Bedini gjatë gjykimit të zhvilluar ndaj tij në Itali është mbrojtur nga mbrojtës të zgjedhur prej tij, të cilët kanë ushtruar edhe të drejtën e ankimit ndaj vendimeve të dhëna ndaj tij, në përputhje me tagrat që vetë personi i kërkuar u ka dhënë.

71. Përfundimisht, në lidhje me zgjidhjen e çështjes, Kolegji vlerëson se rekursi i paraqitur nga Prokuroria pranë Gjykatës së Apelit Tiranë përmban shkaqe nga ato që parashikohen në nenin 432 të KPP-së dhe për rrjedhojë ky rekurs duhet të pranohet. Kolegji çmon se disponimi i gjykatës së shkallës së parë është në përputhje me ligjin e zbatueshëm, e si rrjedhojë vlerëson se duhet prishur vendimi i Gjykatës së Apelit Tiranë, duke u lënë në fuqi vendimi i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

PËR KËTO ARSYE,

Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, duke u bazuar në nenin 441, pika 1, shkronja “b”, të Kodit të Procedurës Penale

VENDOSI:

1. Prishjen e vendimit nr. 1242, datë 20.12.2022, të Gjykatës së Apelit Tiranë dhe lënien në fuqi të vendimit nr. 375 akti, datë 14.9.2022, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

2. Ky vendimi i njoftohet Prokurorisë së Përgjithshme.

3. Ky vendim është njësuës dhe dërgohet për botim në Fletoren Zyrtare.

Tiranë, më datë 22.5.2024.

Kryesues (kundër): Ilir Panda

Anëtarë: Sokol Binaj, Medi Bici, Albana Boksi

Anëtar kundër: Sandër Simoni

MENDIM KUNDËR

Ne, gjyqtarët Ilir Panda dhe Sandër Simoni, anëtarë të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, jemi kundër vendimit të shumicës që shqyrtoi çështjen nr. 70003-00296-00-2023 i regj. themeltar, në procedurën e gjykimit njësuës me palë:

KËRKUES: Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë

KUNDËR: Bledar Bedini (Imami)

OBJEKTI: Miratimin e kërkesës për dhënien e pëlqimit për ekstradim nga Shqipëria në Itali të shtetasit shqiptar Bledar Bedini *alias* Bledar Imami.

BAZA LIGJORE: Konventa Evropiane “Për Ekstradimin”, datë 13.12.1957 (ratifikuar me ligjin nr. 8498, datë 10.6.1999) dhe Protokollin e Katërt shtesë të saj, neni 489 e vijues i Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Shqipërisë, si dhe nenet 32 e 33, të ligjit nr. 10193, datë 3.12.2009, “Për marrëdhëniet juridiksionale me autoritetet e huaja në çështjet penale”, i ndryshuar me ligjet nr. 100/2012, datë 18.3.2013 dhe nr. 97/2021, datë 7.7.2021.

1. Në këtë vendim, shumica, në përfundim të gjykimit njësuës mbi çështjet nëse *dubet të zbatohet parimi i reciprocitetit nga gjykatat në marrëdhëniet juridiksionale me një shtet, i cili ka vendosur rezervë ligjore në normën ndërkombëtare për moszbatimin e saj për çështjet që janë në juridiksionin e atij shteti dhe a dubet të pranojë gjykata kërkesën për ekstradimin e shtetasve shqiptarë, në rast se ndjekja penale apo dënimi janë parashikuar sipas ligjit*



penal shqiptar drejt një shteti i cili ka vendosur rezervë në normën ndërkombëtare, duke mospranuar kërkesën për ekstradim të shtetasve të tij për shkak se vepra penale ose dënimi është parashkruar sipas ligjit të atij shteti, për çështje që janë në juridiksionin e tij, arriti në përfundimin njëses se:

- Në marrëdhëniet juridiksionale me një shtet që ka vendosur rezervën ligjore në normën ndërkombëtare për moszbatimin e saj për çështje që janë në juridiksionin e atij shteti, parimi i reciprocitetit dhe zbatimi i tij është një kusht që vlerësohet nga ministri i Drejtësisë, si autoriteti kompetent i shtetit të kërkuar.

- Gjykata vlerëson kushtet për lejimin e ekstradimit, në përputhje me marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, me Kodin e Procedurës Penale dhe ligjin për marrëdhëniet juridiksionale me jashtë. Gjykata, pranon kërkesën për ekstradimin e shtetasve shqiptarë edhe në rast se ndjekja penale dhe dënimi janë parashkruar sipas ligjit penal shqiptar. Gjykata, në përputhje me nenin 122 të Kushtetutës, zbaton nenin 10, paragrafi i dytë, të Konventës Evropiane “Për Ekstradimin”, ndryshuar me Protokollin e Katërt shtesë të kësaj konvente edhe nëse ndonjë nga shtetet palë në këtë marrëveshje ka vendosur rezervë në normën ndërkombëtare.

2. Ne, si gjyqtarë në pakicë, vlerësojmë se interpretimi njëses që ka bërë shumica nuk është në interpretim të drejtë të nenit 26 të Konventës së Këshillit të Evropës për Ekstradimin dhe dy protokolleve shtesë, të ratifikuar me ligjin nr. 8322, datë 2.4.1998, Konventës për të Drejtën e Traktateve e ratifikuar me ligjin nr. 8696, datë 23.11.2000, “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Konventën e Vjenës për të Drejtën e Traktateve”, të neneve 6, 7, 11 të Kodit Penal (në vijim KP), nenit 491, shkronja e) të Kodit të Procedurës Penale (në vijim KPP) dhe nenit 9, të ligjit nr. 10193, datë 3.12.2009, “Për marrëdhëniet juridiksionale me autoritete të huaja në çështjet penale”, në raport me nenin 122 të Kushtetutës, nenin 26 të Konventës së Këshillit të Evropës për Ekstradimin dhe të dy Protokolleve shtesë, ratifikuar me ligjin nr. 8322, datë 2.4.1998, të Kuvendit të Shqipërisë, pika 2, e nenit 10, të Konventës për Ekstradimin, ndryshuar me Protokollin e Katërt shtesë të kësaj Konvente, e ratifikuar me ligjin nr. 117/2013, “Për ratifikimin e Protokollit të Katërt shtesë të Konventës Evropiane të Ekstradimit”, nenit 18 të “Marrëveshjes ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe

Republikës së Italisë, si shtesë e Konventës Evropiane për Ekstradimin, të 13 dhjetorit 1957, që ka si qëllim të lehtësojë zbatimin e tyre”, ratifikuar me ligjin nr. 9871, datë 11.2.2008.

3. Në këtë gjykim njëses çështja për njësim e evidentuar ishte mbi zbatimin e parimit të reciprocitetit në marrëdhëniet juridiksionale të bashkëpunimit gjyqësor me jashtë dhe a është i varur zbatimi i këtij parimi në rastin kur shteti kërkuar i ka vënë rezervë normës konventore, me kusht që ai të mos shtrihet ndaj shtetasve të vet dhe as ndaj veprimit të ligjit të vet juridiksional ndaj shtetasve të huaj, nëse shtrihet kjo rezervë ndaj shtetasve shqiptarë e ndaj të cilëve shteti kërkuar ka juridiksion zbatimin e ligjit të brendshëm të tij në rastin e parashkrimit të ekzekutimit të dënimit penal dhe cila është përparësi në zbatimin e normës: asaj konventore, marrëveshjeve dypalëshe, ligjit të brendshëm në rastin kur kemi rezervë apo deklaram ndaj normës konventore e kur zbatohet parimi i reciprocitetit.

4. Ne, gjyqtarët në pakicë, nuk jemi dakord me konkludimin se në marrëdhëniet juridiksionale me një shtet që ka vendosur rezervën ligjore në normën ndërkombëtare për moszbatimin e saj për çështje që janë në juridiksionin e atij shteti, parimi i reciprocitetit dhe zbatimi i tij është një kusht që vlerësohet nga ministri i Drejtësisë, si autoriteti kompetent i shtetit të kërkuar, pasi ky përfundim përjashton gjykatat në verifikimin e zbatimit të parimit të reciprocitetit në marrëdhëniet juridiksionale me jashtë. Gjithashtu, ne nuk jemi dakord me përfundimin njëses të arritur nga shumica, se Gjykata pranon kërkesën për ekstradimin e shtetasve shqiptarë edhe në rast se ndjekja penale dhe dënimi janë parashkruar sipas ligjit penal shqiptar dhe se gjykata, në përputhje me nenin 122 të Kushtetutës, zbaton nenin 10, paragrafi i dytë, të Konventës Evropiane “Për Ekstradimin”, ndryshuar me Protokollin e Katërt shtesë të kësaj konvente edhe nëse ndonjë nga shtetet palë në këtë marrëveshje kanë vendosur rezervë në normën ndërkombëtare. Një konkluzion i tillë ngushton sferën e veprimit të juridiksionit gjyqësor dhe pamundëson ushtrimin e diskrecionit të gjykatave në mbrojtjen e garancive kushtetuese e procedurale të shtetasve të tyre.

5. Mbi këto sentenca njësuere ne kemi një mendim dhe argumentim tjetër që logjikisht na jep një rezultat krejt tjetër në interpretim të normave konvencionale. Sipas pikës 2, të nenit 39 të



Kushtetutës, ekstradimi mund të lejohet vetëm kur është parashikuar shprehimisht në marrëveshjet ndërkombëtare në të cilat Republika e Shqipërisë është palë dhe vetëm me vendim gjyqësor. Koncepti i institutit të ekstradimit, referuar Konventës Evropiane për Ekstradimin dhe KPP-së, konsiston në një nga format e bashkëpunimit ndërkombëtar dhe ka për qëllim dorëzimin e një personi një shteti të huaj për ekzekutimin e një vendimi me burgim ose të një akti që vërteton procedimin e tij për një veprë penale. Nga përmbajtja e neneve 5, 39 dhe 116 të Kushtetutës, si dhe nenit 10 të KPP-së, burimet e së drejtës që rregullojnë ekstradimin në legjislacionin shqiptar janë Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, marrëveshjet ndërkombëtare shumëpalëshe dhe dypalëshe të ratifikuara, parimet dhe normat e së drejtës ndërkombëtare të pranuar, si dhe dispozitat e KP-së dhe të KPP-së.

6. Me ligjin nr. 8322, datë 2.4.1998, shteti shqiptar ka ratifikuar Konventën Evropiane të Ekstradimit (në vijim Konventa) dhe dy protokollet shtesë të saj. Sipas nenit 10 të kësaj Konvente *“ekstradimi nuk akordohet nëse parashkrimi i aktit ose i dënimit hyn në fuqi qoftë falë legjislacionit të palës që kërkon, qoftë nga ai i palës së kërkuar”*. Protokoll i Katërt shtesë i Konventës Evropiane për Ekstradimin, është ratifikuar me ligjin nr. 117/2013. Në të është ndryshuar neni 10 i saj, duke parashikuar: *“1. Ekstradimi nuk miratohet kur ndjekja penale ose dënimi i personit të kërkuar është parashkruar sipas ligjit të palës kërkuese. 2. Ekstradimi nuk refuzohet për arsye se ndjekja penale ose dënimi i personit të kërkuar do të parashkruhej sipas ligjit të palës së kërkuar”*. Sipas parashikimit të ri të këtij protokoll, merren parasysh ndryshimet që kanë ndodhur sa i përket bashkëpunimit ndërkombëtar në çështjet penale që nga hapja deri në nënshkrimin e Konventës së vitit 1957 dhe veçanërisht dispozita përkatëse e Konventës së 23 tetorit 1996, që ka të bëjë me ekstradimin ndërmjet shteteve anëtare të Bashkimit Evropian (neni 8).

7. Arsyeja e këtij parashikimi ka të bëjë me atë që pala kërkuese nuk duhet të kërkojë ekstradimin e një personi, ndjekja ose dënimi i të cilit është i parashkruar. Pala e kërkuar ka detyrimin të shqyrtojë nëse ka një kalim kohe sipas ligjit të palës kërkuese përpara se të vendosë për ekstradimin. Megjithatë, në mënyrë që të lejojnë palën e kërkuar të përmbushë këtë detyrim, pala kërkuese duhet të sigurojë atë të kërkuar me një deklaratë të motivuar, duke specifikuar arsyet për të cilat nuk ka gabim në

përlllogaritje të afatit të parashkrimit dhe duke përfshirë dispozitat përkatëse të ligjit të tij. Pala e kërkuar duhet të kërkojë informacion për këtë çështje nga vetë Pala kërkuese. Pala kërkuese duhet të japë këtë informacion, së bashku me kërkesën për ekstradim, pa qenë e nevojshme një kërkesë e qartë për këtë qëllim nga pala e kërkuar (*shih nenin 12, paragrafi 2, nënparagrafët “b” dhe “c” të Konventës, ndryshuar nga protokoll i aktual*). Për sa i përket ligjit të palës së kërkuar, paragrafi 2, i nenit 10, të modifikuar, parashikon se kalimi i kohës nuk do të shërbejë si bazë për refuzim në parim. Pala e kërkuar ka juridiksion për veprat përkatëse sipas veprës penale të saj ligji (duhet parë pak ky formulim), legjislacioni i tij vendas e ndalon shprehimisht ekstradimin në rast të parashkrimit. Mundësia për ta bërë këtë kushtëzohet me një rezervë për këtë qëllim, bërë në momentin e nënshkrimit ose gjatë depozitimit të instrumentit të ratifikimit, pranimi, miratimit ose aderimit. Kjo rezervë mund të ketë të bëjë ose me një nga dy nënparagrafët, e paragrafit 2 ose të dyja. Rasti i fundit do të lejonte një palë të bënte një tërheqje të pjesshme të rezervës së saj për refuzimin e nënparagrafit “b”, duke ruajtur si më të kufizuar refuzimin e nënparagrafit “a”. Paragrafi 4, synohet të zbatohet vetëm në lidhje me palët që kanë bërë një rezervë sipas paragrafit 3. Parimi i pasqyruar në këtë dispozitë rrjedh nga Rezoluta (75) 12 e Komitetit të Ministrave për zbatimin praktik të Konventës Evropiane mbi Ekstradimin (*shih Raporti Shpjegues i Protokollit të Katërt shtesë të Konventës Evropiane për Ekstradimin Vjenë, - CETS 212 – Ekstradimi (Protokoll i Katërt) 20.IX.2012*).

8. Ekstradimi karakterizohet nga parimi i reciprocitetit, i shprehur në termat se: shteti i kërkuar jep ekstradimin vetëm në rast se shteti kërkuar, në rrethana të ngjashme ose të njëjta ose me palë të kundërta është i detyruar të bëjë të njëjtën gjë. Parimi i reciprocitetit, përveç garantimit të barazisë në marrëdhëniet ndërkombëtare në çështjet penale, ndihmon dhe në standardizimin e ligjeve mbi këtë temë dhe në favorizimin e zhvillimit të një praktike ekstradimi tërësisht konvencionale. Legjislacioni shqiptar nuk parashikon referencë për parimin ligjor të reciprocitetit si kusht në dhënien e ekstradimit. Neni 11 i Kodit Penal parashikon, se: *“Ekstradimi mund të lejohet vetëm kur është parashikuar shprehimisht në marrëveshjet ndërkombëtare në të cilat Republika e Shqipërisë është palë”*. Konventa është miratuar me ligjin nr. 8322, datë 2.4.1998, ka hyrë në fuqi më 24.4.1998 dhe shteti



shqiptar nuk ka bërë rezervë apo deklarim për nenin 10 të saj. Paragrafi 3 i nenit 26 të Konventës e lejon një palë të zbatojë rregullin e reciprocitetit në lidhje me palën që ka shfaqur rezervën. Neni 26, paragrafi 3 i Konventës Evropiane të Ekstradimit parashikon, se: *“Një shtet kontraktues nuk mund të kërkojë zbatimin e kësaj dispozite nga një shtet tjetër kontraktues, megjithatë, nëse rezerva e tij është e pjesshme ose e kushtëzuar, ai mund të kërkojë zbatimin e kësaj dispozite për aq sa ai vetë e ka pranuar atë.”*

9. Në Kodin shqiptar të Procedurës Penale, në neni 491, shkronja “ë” të tij, parashikohet, se: *“Mospranimi i kërkesës për ekstradim”*: *“Nuk mund të jepet ekstradimi: ... e) kur është parashkruar ndjekja penale ose dënimi sipas ligjit të shtetit të kërkuar,”*. Ligji për marrëdhëniet juridiksionale me jashtë, në nenin 32 shprehet se: *“ekstradimi i një personi në drejtim të një shteti të huaj lejohet kur plotësohen edhe kushtet e mëposhtme ... Ndjekja penale ose ekzekutimi i dënimit penal nuk janë parashkruar sipas legjislacionit të shtetit kërkuar”*. Për sa i përket parashkrimit, sipas legjislacionit penal shqiptar, parashkrimi i ekzekutimit të dënimit nënkupton humbjen e së drejtës së organeve të ngarkuara me ekzekutimin e dënimit për të ekzekutuar vendimin penal të dënimit, nëse nga dita që vendimi ka marrë formë të prerë dhe deri në momentin e ekzekutimit të vendimit ka kaluar koha e caktuar nga ligji. Në kreun VIII të Kodit Penal ligjvënësi ka parashikuar një institut më vete, në lidhje me shuarjen e ndjekjes penale, të dënimeve dhe mosekzekutimin e tyre. Brenda kuadrit të këtij instituti janë përfshirë dispozita të veçanta në lidhje me parashkrimin e ndjekjes penale (neni 66 i Kodit Penal); në lidhje me parashkrimin e ekzekutimit të dënimit (neni 68 i Kodit Penal) dhe shuarjen e dënimit ose, sikurse e ka emërtuar vetë ligjvënësi, rehabilitimin (neni 69 i Kodit Penal). Kreu VIII, me titull *“Shuarja e ndjekjes penale, të dënimeve dhe mosekzekutimi i tyre”*, në nenin 66 të tij, të ndryshuar me ligjin nr. 36, datë 30.3.2017, parashikon se: *“Nuk mund të bëhen ndjekje penale kur nga kryerja e veprës deri në çastin e marrjes së personit si të pandehur kanë kaluar: a) dyzet vjet në rastin e krimeve që parashikojnë dënim me burgim të përjetshëm; b) njëzet vjet për krimet që parashikojnë dënim jo më të ulët se dhjetë vjet burgim ose dënim tjetër më të rëndë; c) dhjetë vjet për krimet që parashikojnë dënim nga pesë gjer në dhjetë vjet burgim; ç) pesë vjet për krimet që parashikojnë dënim gjer në pesë vjet burgim ose gjobë; d) tre vjet për kundërvajtjet penale që parashikojnë dënim gjer në dy vjet burgim; dh) dy vjet për*

kundërvajtjet penale që parashikojnë dënim me gjobë. Veprat penale të kreut II, seksionit I, nenet 76 – 79/c, nuk i nënshtrohen parashkrimit. Neni 67 “Mosparashkrimi i ndjekjes penale” parashikon se: “Nuk i nënshtrohen parashkrimit të ndjekjes penale krimet e luftës dhe ato kundër njerëzimit”. Neni 68 “Parashkrimi i ekzekutimit të dënimit” parashikon se “Vendimi i dënimit nuk ekzekutohet kur nga dita që ka marrë formë të prerë kanë kaluar: a) njëzet vjet për vendimin që përmban dënim pesëmbëdhjetë gjer në njëzetepesë vjet burgim; b) dhjetë vjet për vendimin që përmban dënim pesë gjer në pesëmbëdhjetë vjet burgim; c) pesë vjet për vendime që përmbajnë dënim me burgim gjer në pesë vjet ose dënime të tjera më të lehta”.

10. Me ligjin nr. 117/2013, *“Për ratifikimin e Protokollit të Katërt shtesë të Konventës Evropiane të Ekstradimit”*, Republika e Shqipërisë ka ratifikuar Protokollin e Katërt shtesë të Konventës Evropiane të Ekstradimit. Ky ligj është botuar në Fletoren Zyrtare nr. 61, datë 24.4.2013 dhe ka hyrë në fuqi 15 ditë nga botimi në Fletoren Zyrtare. Në nenin 1, *“Kalimi i afatit”*, të këtij protokolli shtesë, parashikohet se *“Neni 10 i Konventës zëvendësohet me dispozitat e mëposhtme: “Kalimi i afatit 1. Ekstradimi nuk miratohet kur ndjekja penale ose dënimi i personit të kërkuar është parashkruar sipas ligjit të palës kërkuese. 2. Ekstradimi nuk refuzohet për arsye se ndjekja penale ose dënimi i personit të kërkuar do të parashkruhej sipas ligjit të palës së kërkuar. 3. Çdo shtet, në kohën e nënshtërimit ose gjatë depozitimit të instrumentit të tij të ratifikimit, pranimit, miratimit ose aderimit, mund të deklarojë se rezervon të drejtën për të mos zbatuar paragrafin 2: a) Kur kërkesa për ekstradim bazohet në veprat penale për të cilat shteti ka juridiksion sipas ligjit të tij penal; dhe/ ose b) Nëse legjislacioni i tij i brendshëm ndalon shprehimisht ekstradimin kur ndjekja penale ose dënimi i personit të kërkuar do të parashkruhej sipas ligjit të tij. 4. Në përcaktimin nëse ndjekja penale ose dënimi i personit të kërkuar do të parashkruhej sipas ligjit të saj, çdo palë që ka bërë një rezervë sipas paragrafit 3 të këtij neni merr në konsideratë, në përputhje me ligjin e saj, çdo akt ose ngjarje që ka ndodhur në palën kërkuese, në masën që aktet ose ngjarjet e të njëjtës natyrë kanë efektin e ndërprerjes ose pezullimit të parashkrimit në palën e kërkuar.”*

11. Marrëveshja ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Republikës së Italisë, si shtesë e Konventës Evropiane mbi Ekstradimin e 13 dhjetorit 1957 dhe e Konventës Evropiane për Ndihmën e Juridike për çështjet penale, të 20 prillit 1959, që ka si qëllim të lehtësojë zbatimin e tyre, është bërë në shkurt të vitit 2008, duke hyrë në fuqi



në fillim të marsit 2008. Kjo marrëveshje i referohet në mënyrë të veçantë ekstradimit. Në preambulën e saj thuhet se Shqipëria i mbetet deklarimit që ka bërë në depozitim të instrumentit të ratifikimit të Konventës Evropiane për Ekstradimin, ku deklaronte se: *“Shqipëria refuzon ekstradimin e shtetasve të vet, me përjashtim të rasteve kur është parashikuar ndryshe në marrëveshjet ndërkombëtare në të cilat Shqipëria është palë kontraktuese”*. Neni 18, paragrafi 1, i marrëveshjes me Italinë, titulli “Dispozita lidhur me Ekstradimin e shtetasve, thuhet se: *“Palët Kontraktuese marrin përsipër, në mënyrë të ndërsjellë, të dorëzojnë shtetasit e tyre që ndodhen në ndjekje penale nga njëra prej tyre për kryerjen e veprave penale ose që janë shpallur në kërkim për vuajtjen e dënimit apo të një mase shtrënguese, në përputhje me normat dhe kërkesat e Konventës Evropiane mbi Ekstradimin.”*. Marrëveshja në fjalë nuk parashikon rregullim tjetër mbi ekstradimin, duke i qëndruar besnik në këtë aspekt rregullimeve të Konventës dhe sanksionimit të parimit që ekstradimi do të zbatohet në mënyrë të ndërsjellë në mes të dy shteteve në përputhje me rregullimet e Konventës.

12. Republika e Italisë e ka miratuar Protokollin e Katërt shtesë me ligjin nr. 88, datë 24.7.2019, i cili ka hyrë në fuqi në datën 20.8.2019. Në nenin 3, të titulluar “Deklarata dhe Rezerva”, të këtij ligji, ndër të tjera, parashikohet se, në momentin e depozitimit të instrumentit të ratifikimit, qeveria vendos rezervën e parashikuar në paragrafin 3, të nenit 10 të Konventës Evropiane të Ekstradimit, të modifikuar nga neni 1 i Protokollit të Katërt shtesë të Konventës Evropiane të Ekstradimit, bërë në Vjenë, më datë 20 shtator 2012. Shteti italian, kur ka depozituar instrumentin e ratifikimit të këtij protokoll, më datë 30 gusht të vitit 2019, ka depozituar edhe rezervën që të mos aplikojë nenin 10/2 të Konventës për Ekstradimin të amenduar me nenin 1 të Protokollit të Katërt shtesë, në rastet kur kërkesa e ekstradimit është bërë për krime për të cilat shteti italian ka juridiksion sipas ligjit të tij penal.

13. Sipas nenit 13, pika 3, të Protokollit të Katërt shtesë, *“Nuk mund të bëhet asnjë rezervë në lidhje me dispozitat e këtij protokoll, me përjashtim të rezervave të parashikuara në nenin 10, paragrafi 3, neni 21, paragrafi 5 i Konventës së ndryshuar nga ky protokoll dhe neni 6, paragrafi 31, i këtij protokoll. Reciprociteti mund të zbatohet për çdo rezervë të bërë”*. Sa më lart, shteti italian nuk ka paraqitur rezervë për të mos aplikuar nenin 10/2 të Konventës për Ekstradimin, të amenduar me nenin 1 të Protokollit të Katërt shtesë, në rastet kur

legjislacioni i tij i brendshëm ndalon shprehimisht ekstradimin, kur ndjekja penale ose dënimi i personit të kërkuar do të parashkruhej sipas ligjit të tij. Paragrafi 3, i nenit 10 të Konventës së sipërpërmendur, të modifikuar si më lart dhe mbi të cilin shteti italian ka vendosur rezervën, parashikon se çdo shtet, në momentin e nënshkrimit apo të depozitimit të instrumentit të ratifikimit, pranimit, aprovimit ose aderimit, mund të deklarojë se rezervon të drejtën të mos aplikojë paragrafin 2. Në paragrafin 2, parashikohet se, ekstradimi nuk mund të refuzohet duke treguar se ndjekja penale apo dënimi janë parashkruar sipas ligjit të shtetit të kërkuar. Duke vendosur rezervë mbi këtë dispozitë, rrjedh se shteti italian, në rastin kur kërkohet të ekstradohen shtetas të tij, do të refuzojë ekstradimin nëse ndjekja penale apo dënimi janë parashkruar sipas legjislacionit të këtij vendi, pra të shtetit italian.

14. Marrëveshja në fjalë nuk parashikon rregullim tjetër mbi ekstradimin duke i qëndruar besnik në këtë aspekt rregullimeve të Konventës dhe sanksionimit të parimit që ekstradimi do të zbatohet në mënyrë të ndërsjellë në mes të dy shteteve, në përputhje me rregullimet e Konventës. Kjo marrëveshje i referohet në mënyrë të veçantë ekstradimit. Në preambulën e saj thuhet se Shqipëria i mbetet deklarimit që ka bërë në depozitim të instrumentit të ratifikimit të Konventës Evropiane për Ekstradimin ku deklaronte se *“Shqipëria refuzon ekstradimin e shtetasve të vet, me përjashtim të rasteve kur është parashikuar ndryshe në marrëveshjet ndërkombëtare në të cilat Shqipëria është palë kontraktuese”*. Çështja që ka të bëjë me zbatimin e normave të Konventës për Ekstradim lidhet me raportet që krijohen mes Republikës së Italisë dhe asaj të Shqipërisë, për shkak të rezervës së shtetit italian, mbi normën që ndalon refuzimin e ekstradimit mbi argumentin se vepra penale apo dënimi janë parashkruar sipas ligjit italian, për çështje që janë në juridiksionin e atij shteti. Lidhur me zbatimin e parimit të reciprocitetit, evidentohet së pari se prokurorja e apelit nuk përkrahu qëndrimin e gjykatës së shkallës së parë, për zbatimin e tij vetëm në planin politik. Paragrafi 3, i nenit 26 të Konventës e lejon një palë të zbatojë rregullin e reciprocitetit në lidhje me palën që ka shfaqur rezervën.

15. Neni 26, paragrafi 3 i Konventës Evropiane të Ekstradimit parashikon se: *“Një shtet kontraktues nuk mund të kërkojë zbatimin e kësaj dispozite nga një shtet tjetër kontraktues, megjithatë, nëse rezerva e tij është e*



pjeshme ose e kushtëzuar, ai mund të kërkojë zbatimin e kësaj dispozite për aq sa ai vetë e ka pranuar atë.” Në vijim të këtij arsyetimi, Kolegji Penal vlerëson se parimi i reciprocitetit përbën normë të së drejtës, të detyrueshme për t’u zbatuar nga shtetet anëtare të saj. Vetë Konventa është burim i së drejtës dhe gjykata ka detyrimin që ta zbatojë atë, duke garantuar mbi të gjitha respektimin e të drejtave të subjekteve që u nënshtrohen procedurave të ekstradimit. Duke pranuar se parimi i reciprocitetit mes Republikës së Italisë dhe asaj të Shqipërisë, duhet të zbatohet jo vetëm nga ministri i Drejtësisë (qoftë edhe në momentin kur kërkon nëpërmjet prokurorisë që të procedohet me kërkesën e shtetit të huaj që kërkon ekstradimin), por edhe nga gjykata që e shqyrton kërkesën. Referuar këtij parimi të sanksionuar në Konventë, për të bërë një zbatim të drejtë të Konventës, në tërësinë e dispozitave të saj, interpretimi dhe zbatimi i duhur i Konventës Evropiane të Ekstradimit, në raport me shtetin italian, lidhur me parashkrimin e ndjekjes penale apo të dënimit, interpretimi i duhur ligjor do të ishte: shteti shqiptar do të lejojë ekstradimin e shtetasve të tij apo personave të tjerë nga territori i tij ndaj shtetit italian, për aq sa shteti italian e lejon ekstradimin e shtetasve të tij apo personave të tjerë nga territori i tij. Duke qenë se shteti italian mund ta refuzojë ekstradimin në rast se ndjekja penale apo dënimi janë parashkruar (përfshirë këtu dhe ndërprejet, dhe pezullimet sipas legjislacionit të shtetit të kërkuar) sipas legjislacionit të tij, në bazë të parimit të reciprocitetit, të sanksionuar në Konventë edhe shteti shqiptar do ta refuzojë ekstradimin, në rast se ndjekja penale apo dënimi janë parashkruar sipas legjislacionit të shtetit shqiptar.

16. Edhe sa i përket marrëveshjes ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Republikës së Italisë, si shtesë e Konventës Evropiane për Ekstradimin, të 13 dhjetorit 1957 dhe e Konventës Evropiane për ndihmë juridike për çështjet penale, të 20 prillit 1959, që ka si qëllim të lehtësojë zbatimin e tyre, të ratifikuar në legjislacionin shqiptar me ligjin nr. 9871, datë 11.2.2008, në pikën 1, të nenit 18 të kësaj marrëveshjeje, parashikohet se “1. Palët kontraktuese marrin përsipër, në mënyrë të ndërsjellë, të dorëzojnë shtetasit e tyre që ndodhen në ndjekje penale nga njëra prej tyre për kryerjen e veprave penale, ose që janë shpallur në kërkim për vuajtjen e dënimit apo të një mase shtrënguese, në përputhje me normat dhe kërkesat e Konventës Evropiane mbi Ekstradimin.”. Pra, rezulton se me këtë marrëveshje, shtetet nënshkruese i referohen zbatimit të

Konventës Evropiane të Ekstradimit, duke u angazhuar për zbatimin e saj. Kjo Konventë duhet të zbatohet në tërësinë e saj, përfshirë dhe pikën 3, të nenit 26 të saj, që ka të bëjë me parimin e reciprocitetit.

17. Republika e Italisë, si një nga shtetet palë të Konventës Evropiane “Për Ekstradimin”, ka depozituar instrumentin e ratifikimit të Protokollit të Katër shtesë të Konventës Evropiane të Ekstradimit, së bashku me rezervën, në lidhje me nenin 10, paragrafi i tretë, duke rezervuar të drejtën që të mos e aplikojë nenin 10, paragrafi 2, të Konventës “Për Ekstradimin”, të amenduar me nenin 1, të Protokollit të Katërt shtesë, në rastet kur kërkesa e ekstradimit është bërë për krime për të cilat shteti italian ka juridiksion sipas ligjit të tij penal. Sipas nenit 13, pika 3, të Protokollit të Katërt shtesë, “Nuk mund të bëhet asnjë rezervë në lidhje me dispozitat e këtij protokollit, me përjashtim të rezervave, të parashikuara në nenin 10, paragrafi 3, neni 21 paragrafi 5, i Konventës së ndryshuar nga ky protokoll dhe neni 6, paragrafi 31, i këtij protokollit. Reciprociteti mund të zbatohet për çdo rezervë të bërë. Sa më lart, shteti italian ka paraqitur rezervë për të mos aplikuar nenin 10/2 të Konventës “Për Ekstradimin”, të amenduar me nenin 1, të Protokollit të Katërt shtesë, në rastet kur legjislacioni i tij i brendshëm ndalon shprehimisht ekstradimin, kur ndjekja penale ose dënimi i personit të kërkuar do të parashkruhej sipas ligjit të tij. Legjislacioni penal parashikon se ekstradimi karakterizohet nga parimi i reciprocitetit, i shprehur në terma: shteti i kërkuar jep ekstradimin vetëm në rast se shteti kërkuar, në rrethana të ngjashme ose të njëjta ose me palë të kundërta, është i detyruar të bëjë të njëjtën gjë.

18. Parimi i reciprocitetit, si një nga parimet e së drejtës ndërkombëtare publike, ka gjetur sanksionim në nenin 26 të Konventës Evropiane të Ekstradimit. Në pikën 3, të nenit 26 të Konventës parashikohet se “Një palë kontraktuese që ka formuluar një rezervë në lidhje me një dispozitë konventore, nuk mund të pretendojë që një shtet tjetër të aplikojë këtë dispozitë, përveçse në masën në të cilën ajo vetë e ka pranuar.”. Zbatimit të parimit të reciprocitetit i ka qëndruar besnik dhe Marrëveshja ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Republikës së Italisë, e cila, në nenin 18, paragrafi 1, titulli “Dispozita lidhur me Ekstradimin e shtetasve” thuhet se: “Palët kontraktuese marrin përsipër, në mënyrë të ndërsjellë, të dorëzojnë shtetasit e tyre që ndodhen në ndjekje



penale nga njëra prej tyre për kryerjen e veprave penale, ose që janë shpallur në kërkim për vuajtjen e dënimit apo të një mase shtrënguese, në përputhje me normat dhe kërkesat e Konventës Evropiane mbi Ekstradimin.”.

19. Parimi i reciprocitetit, përveç garantimit të barazisë në marrëdhëniet ndërkombëtare në çështjet penale, ndihmon dhe në standardizimin e ligjeve mbi këtë temë të favorizojnë zhvillimin e një praktike ekstradimi konvencionale. Parimi i reciprocitetit, si një nga parimet e së drejtës ndërkombëtare publike, ka gjetur sanksionim në nenin 26 të Konventës Evropiane të Ekstradimit. Në pikën 3, të nenit 26 të Konventës parashikohet se: “Një palë kontraktuese që ka formuluar një rezervë në lidhje me një dispozitë konventore, nuk mund të pretendojë që një shtet tjetër të aplikojë këtë dispozitë, përveçse në masën në të cilën ajo vetë e ka pranuar.”. Zbatimit të parimit të reciprocitetit i ka qëndruar besnik dhe Marrëveshja ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Republikës së Italisë, e cila, në nenin 18, paragrafi 1, titulli “Dispozita lidhur me Ekstradimin e shtetasve”, në të cilën parashikohet se “Palët kontraktuese marrin përsipër, në mënyrë të ndërsjellë, të dorëzojnë shtetasit e tyre që ndodhen në ndjekje penale nga njëra prej tyre për kryerjen e veprave penale ose që janë shpallur në kërkim për vuajtjen e dënimit apo të një mase shtrënguese, në përputhje me normat dhe kërkesat e Konventës Evropiane mbi Ekstradimin. Marrëveshja në fjalë nuk parashikon rregullim tjetër mbi ekstradimin, duke i qëndruar besnik në këtë aspekt rregullimeve të Konventës dhe sanksionimit të parimit që ekstradimi do të zbatohet në mënyrë të ndërsjellë në mes të dy shteteve në përputhje me rregullimet e Konventës. Kjo marrëveshje i referohet në mënyrë të veçantë ekstradimit. Në preambulën e saj thuhet se Shqipëria i mbetet deklarimit që ka bërë në depozitimin e instrumentit të ratifikimit të Konventës Evropiane “Për Ekstradimin” ku deklaronte se, Shqipëria refuzon ekstradimin e shtetasve të vet, me përjashtim të rasteve kur është parashikuar ndryshe në marrëveshjet ndërkombëtare në të cilat Shqipëria është palë kontraktuese.

20. Çështja që ka të bëjë me zbatimin e normave të Konventës “Për Ekstradim”, lidhet me raportet që krijohen mes Republikës së Italisë dhe asaj të Shqipërisë, për shkak të rezervës së shtetit italian, mbi normën që ndalon refuzimin e ekstradimit mbi argumentin se vepra penale apo dënimi janë parashikuar sipas ligjit italian, për çështje që janë në juridiksionin e atij shteti. Lidhur me zbatimin e

parimit të reciprocitetit, evidentohet, së pari, se prokuroria e apelit nuk përkrahu qëndrimin e gjykatës së shkallës së parë, për zbatimin tij vetëm në planin politik. Në vijim të këtij arsyetimi, gjykata vlerëson se parimi i reciprocitetit përbën normë të së drejtës, të detyrueshme për t’u zbatuar nga shtetet anëtare të saj. Vetë konventa është burim i së drejtës dhe gjykata ka detyrimin që ta zbatojë atë, duke garantuar mbi të gjitha respektimin e të drejtave të subjekteve, që u nënshtrohen procedurave të ekstradimit, duke pranuar se parimi i reciprocitetit mes Republikës së Italisë dhe asaj të Shqipërisë duhet të zbatohet jo vetëm nga ministri i Drejtësisë (qoftë edhe në momentin, kur kërkon nëpërmjet prokurorisë që të procedohet me kërkesën e shtetit të huaj që kërkon ekstradimin), por edhe nga gjykata që e shqyrton kërkesën. Referuar këtij parimi të sanksionuar në konventë, për të bërë një zbatim të drejtë të Konventës, në tërësinë e dispozitave të saj, interpretimi dhe zbatimi i duhur i Konventës Evropiane të Ekstradimit, në raport me shtetin italian, lidhur me parashkrimin e ndjekjes penale apo të dënimit, do të ishte: shteti shqiptar do të lejojë ekstradimin e shtetasve të tij apo personave të tjerë nga territori i tij ndaj shtetit italian, për aq sa shteti italian e lejon ekstradimin e shtetasve të tij apo personave të tjerë nga territori i tij. Duke qenë se shteti italian mund ta refuzojë ekstradimin në rast se ndjekja penale apo dënimi janë parashikuar (përfshirë këtu dhe ndërprerjet, dhe pezullimet sipas legjislacionit të shtetit të kërkuar) sipas legjislacionit të tij, në bazë të parimit të reciprocitetit, të sanksionuar në Konventë, edhe shteti shqiptar do ta refuzojë ekstradimin, në rast se ndjekja penale apo dënimi janë parashikuar sipas legjislacionit të shtetit shqiptar, prandaj dhe gjykata e gjen pretendimin e mbrojtjes të drejtë dhe të bazuar në të drejtën ndërkombëtare dhe atë të brendshme. Marrëveshja ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Republikës së Italisë, si shtesë e Konventës Evropiane për Ekstradimin, të 13 dhjetorit 1957 dhe e Konventës Evropiane “Për ndihmë juridike për çështjet penale”, të 20 prillit 1959, që ka si qëllim të lehtësojë zbatimin e tyre, të ratifikuar në legjislacionin shqiptar me ligjin nr. 9871, datë 11.2.2008, në pikën 1, të nenit 18 të kësaj marrëveshjeje, parashikohet se: ... “1. Palët kontraktuese marrin përsipër, në mënyrë të ndërsjellë, të dorëzojnë shtetasit e tyre që ndodhen në ndjekje penale nga njëra prej tyre për kryerjen e veprave penale ose që janë shpallur në kërkim për



vuajtjen e dënimit apo të një mase shtrënguese, në përputhje me normat dhe kërkesat e Konventës Evropiane mbi Ekstradimin”.

21. Pra, rezulton se me këtë marrëveshje shtetet nënshkruese i referohen zbatimit të Konventës Evropiane të Ekstradimit, duke u angazhuar për zbatimin e saj. Kjo Konventë duhet të zbatohet në tërësinë e saj, përfshirë dhe pikën 3, të nenit 26 të saj, që ka të bëjë me parimin e reciprocitetit dhe, bazuar në këtë parim, edhe shteti shqiptar nuk duhet të pranojë ekstradimin e shtetasve të vet për të cilat ka juridiksion, si në rastin konkret. Në KPP, në nenin 491 “Mospranimi i kërkesës për ekstradim”, shkronja “ë”, parashikohet se: “Nuk mund të jepet ekstradimi: ... ë) kur është parashkruar ndjekja penale ose dënimi sipas ligjit të shtetit të kërkuar”. Ligji për marrëdhëniet juridiksionale me jashtë, në nenin 32, parashikon se: “... ekstradimi i një personi në drejtim të një shteti të huaj lejohet kur plotësohen edhe kushtet e mëposhtme: Ndjekja penale ose ekzekutimi i dënimit penal nuk janë parashkruar sipas legjislacionit të shtetit kërkuar.”. Sa më sipër trajtuar, gjykata çmon se vendimi për të cilën kërkohet ekstradimi i shtetasit Bledar Bedini *alias* Bledar Imami është parashkruar, pasi, bazuar në parimin e reciprocitetit, shteti shqiptar nuk duhet të pranojë ekstradimin e shtetasve të vet në të njëjtat kushtet për veprat penale për të cilat ka juridiksion. Duke ju rikthyer rastit konkret nëse është vendi që Republika e Shqipërisë të zbatojë reciprocitetin ndaj shtetit kërkuar, Republikës së Italisë, gjykata e apelit ka vlerësuar se, për sa kohë në një rast analog, Republika e Italisë do të refuzonte zbatimin e paragrafit të dytë, të nenit 10 të Konventës për Ekstradimin (sipas Protokollit të Katërt), është rasti që të zbatohet parimi i reciprocitetit. Në zbatim të nenit 26 të Konventës Evropiane të Ekstradimit, Republika e Italisë nuk mund të kërkojë zbatimin e kësaj dispozite nga një shtet tjetër kontraktues, për sa kohë që ka ratifikuar me rezervë Protokollin e Katërt.

22. Në kushtet e mësipërme, duke mos zbatuar normën e mësipërme konventore, thirret për zbatim ligji i brendshëm, neni 491, shkronja “ë”, i KPP-së, sipas të cilit përbën kusht ndalues për ekstradimin rasti kur është parashkruar dënimi sipas ligjit të shtetit të kërkuar.

23. Duke ju rikthyer çështjes nëse është vendi që Republika e Shqipërisë të zbatojë reciprocitetin ndaj shtetit kërkuar, Republikës së Italisë, ne, gjyqtarët në

pakicë, vlerësojmë se për sa kohë në një rast analog, Republika e Italisë do të refuzonte zbatimin e paragrafit të dytë, të nenit 10 të Konventës për Ekstradimin (sipas Protokollit të Katërt), është rasti që të zbatohet parimi i reciprocitetit. Në zbatim të nenit 26 të Konventës Evropiane të Ekstradimit, Republika e Italisë “nuk mund të kërkojë zbatimin e kësaj dispozite nga një shtet tjetër kontraktues”, për sa kohë që ka miratuar me rezervë Protokollin e Katërt. Në kushtet e mësipërme, duke mos zbatuar normën e mësipërme konventore, thirret për zbatim ligji i brendshëm, neni 491, shkronja “ë”, të Kodit të Procedurës Penale, sipas të cilit përbën kusht ndalues për ekstradimin rasti kur është parashkruar dënimi sipas ligjit të shtetit të kërkuar.

24. Gjatë gjykimit në procedurën e njësimi, Kolegji Penal ju drejtua Gjykatës Kushtetuese me kërkesën për papajtueshmërinë e nenit 491, shkronja “ë”, të KPP-së me pikën 39 /2 të Kushtetutës dhe me nenin 10, paragrafi 2 i Konventës për Ekstradimin sepse përmbajnë një parashikim të ndryshëm nga ai që shteti shqiptar ka pranuar me ratifikimin e kësaj Konventë dhe protokolleve shtesë. Gjykata Kushtetuese, me vendimin nr. 46, datë 12.3.2024, ka vendosur moskalimin e çështjes për shqyrtim duke arsyetuar se: “... i takon kësaj të fundit (Gjykatës së Lartë) që në ushtrim të kompetencës së saj kushtetuese, duke zbatuar parimet kushtetuese që janë të detyrueshme në këtë drejtim, të përcaktojë nëse në rastin konkret dispozitat e Konventës nuk janë të vet zbatueshme dhe, në tej, duke arritur në përfundimin se dispozita e vetme e zbatueshme është shkronja “ë” e nenit 491 të KPP, të përcaktojë se nuk ka asnjë interpretim të saj të papajtueshëm me parimet kushtetuese që gjen zbatim.”.

25. Në vijim të këtij interpretimi të rolit të Gjykatës së Lartë, dhe ne, gjyqtarët në pakicë, mendojmë se në këtë rast Kolegji Penal duhej të kishte arritur në konkluzionin se në këtë rast, duke mos zbatuar normën e mësipërme konventore, paragrafit të dytë, të nenit 10 të Konventës për Ekstradimin (sipas Protokollit të Katërt) dispozita e zbatueshme për zbatim është ligji i brendshëm, neni 491, shkronja “ë”, i KPP-së, sipas të cilit përbën kusht ndalues për ekstradimin rasti kur është parashkruar dënimi sipas ligjit të shtetit të kërkuar.

26. Reciprociteti në të drejtën ndërkombëtare është për të zbatuar detyrime apo për të dhënë një të drejtë në të njëjtën masë të marrë përsipër nga subjekte të tjera në raport me atë shtet nënkupton që një shtet, subjekt i së drejtës ndërkombëtare, nuk



mund të kërkojë nga një subjekt tjetër zbatimin e një detyrimi apo dhënien e një të drejte të cilën vetë ky i fundit nuk e ka marrë përsipër ta zbatojë. Me termin “*rezervë*”, Konventa e Vjenës për të Drejtën e Traktateve nënkupton “Një deklaratë të njëanshme, pavarësisht se si është shprehur apo emërtuar e bërë nga një shtet, në kohën e nënshkrimit, ratifikimit, pranimit, miratimit ose aderimit të një traktati, me anën të cilit ai synon të përjashtojë ose modifikojë efektet ligjore të dispozitave të caktuara të traktatit në zbatimin e tyre në atë shtet” (*shif. Konventa e Vjenës për të Drejtën e Traktateve, ligji nr. 8696, datë 23.11.2000, “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Konventën e Vjenës për të Drejtën e Traktateve*). Rezervat mund të kundërshtohen nga shtetet në rastin kur ato janë të palejueshme sipas nenit 19 të Traktatit. Në të kundërt pranimi i tyre nënkupton që shteti ka rënë dakord me kushtet e zbatimit të marrëveshjes bazuar në atë rezervë.

27. Në rastet kur gjykatat shqiptare hasin në rezerva të vëna nga shtetet e tjera në marrëveshjen ndërkombëtare, të cilat shërbejnë si bazë ligjore për kërkesa të ardhura nga këto shtete drejt gjykatave shqiptare, së pari, gjykata duhet të kontrollojë nëse shteti shqiptar ka depozituar ndonjë kundërshtim ndaj rezervës në fjalë dhe, së dyti, të verifikohet efekti juridik i rezervës në raport me shtetet e tjera kontraktuese të cilat nuk kanë vendosur rezervë.

28. Neni 21(1)(b) i Konventës për të Drejtën e Traktateve sanksionon parimin e proporcionalitetit kundrejt shtetit rezervues, kur parashikon se: “*Në rezervën e bërë në lidhje me një palë tjetër në përputhje me nenin 19, 20, 23 (b) modifikon në të njëjtën masë ato dispozita për palën tjetër lidhur me marrëdhëniet e saj në shtetin rezervues*”. Kjo është në koherencë me atë që parashikon neni 26, paragrafi 3 i Konventës Evropiane të Ekstradimit “*Një shtet kontraktues nuk mund të kërkojë zbatimin e kësaj dispozite nga një shtet tjetër kontraktues, megjithatë, nëse rezerva e tij është e pjesshme ose e kushtëzuar, ai mund të kërkojë zbatimin e kësaj dispozite për aq sa ai vetë e ka pranuar atë*”. Pra, në interpretim të këtyre dispozitave, një rezervë funksionon në mënyrë reciproke ndërmjet shtetit rezervues dhe çdo palë, në mënyrë që të modifikojë traktatin për të dy në marrëdhëniet e tyre të ndërsjella në masën e dispozitave për të cilat vendoset rezerva. Parimi i zbatimit të proporcionalitetit në marrëdhëniet mes shteteve në rastin e rezervave bazohet në “*common sense*”. Kjo nënkupton se, në momentin që rezerva pranohet, kjo mund të invokohet si nga shteti

rezervues ashtu dhe nga çdo shtet tjetër palë në marrëveshjen shumëpalëshe. Rrjedhimisht, shteti rezervues lirohet jo vetëm nga zbatimi i dispozitës që i referohet rezerva, por njëkohësisht humbet të drejtën të kërkojë nga shtetet që kanë pranuar rezervën që të zbatojë dispozitën e traktatit të cilës i referohet rezerva. Nga ana tjetër, shtetet e tjera kontraktuese, gjithashtu, lirohen nga detyrimi për të zbatuar dispozitën që i referohet rezerva, në raportet e tyre me shtetin rezervues.

29. Ne, gjyqtarët në pakicë, vlerësojmë se për pyetjen e parë të shtruar për njësim, përgjigja njëesuese duhej të ishte:

“Gjykatat duhet të zbatojnë parimin e reciprocitetit në marrëdhëniet juridiksionale me një shtet, i cili ka vendosur rezervë ligjore, të pranuar nga shteti shqiptar, në normën ndërkombëtare për moszbatimin e saj për çështjet që janë në juridiksionin e atij shteti.”.

30. Në lidhje me pyetjen e dytë të shtruar për njësim, ajo ka të bëjë me interpretimin e drejtpërdrejtë të nenit 10 të Konventës, i modifikuar me Protokollin e 4, në nenin 1 të tij. Ndryshe nga Konventa, Protokollin e Katërt shtesë akordon imunitet kundrejt ekstradimit vetëm në rastin kur vepra ose dënimi është parashkruar sipas ligjit të palës së kërkuar. Megjithatë, paragrafi 3, i nenit 1 të Protokollit të Katërt shtesë parashikon të drejtën e çdo shteti që të formulojë rezerva. Rezulton se shteti shqiptar as nuk ka përfutur nga e drejta për të formuluar rezerva dhe as nuk ka kundërshtuar ndonjë rezervë të formuluar nga shtete të ndryshme palë në Protokollin e Katërt shtesë. Në këto kushte duhet vendosur reciprociteti *vis-a-vis* me shtete të cilët kanë formuluar rezervë ndaj zbatimit të nenit 1(2) të Protokollit të Katërt shtesë. Në praktikë, efekti i rezervës passjell zbatimin nga ana e gjykatave shqiptare në raport me marrëdhëniet juridiksionale me shtetet rezervuese, të nenit 10 të Konventës, duke konsideruar kështu si kriter refuzues të ekstradimit, parashkrimin e ndjekjes së veprës penale dhe dënimit, si në bazë të legjislacionit të palës së kërkuar ashtu dhe në bazë të atij të palës kërkuese. Ndërkohë, neni 1 i Protokollit vazhdon të jetë operativ në raport me shtetet të cilat nuk kanë formuluar rezervë. Në këtë rast vlen parashikimi i nenit 13(5) të Protokollit të Katërt shtesë, sipas të cilit “reciprociteti mund të zbatohet për çdo rezervë të bërë”. Zbatimi i parimit të reciprocitetit mund të bëhet automatikisht.



31. Pyetja tjetër që shtrohet, ka të bëjë me interpretimin e nenit 491(ë) të KPP-së, i cili parashikon se, si pasojë e ratifikimit të Protokollit të Katërt shtesë, vetëm parashkrimin në bazë të ligjit të shtetit të kërkuar. Pra, a mundet gjykata të refuzojë kërkesën për ekstradim nëse ndjekja penale ose dënimi janë parashkruar sipas legjislacionit të shtetit të kërkuar, në mungesë të një parashikimi të tillë në nenin 491 të KPP. Përgjigja është pozitive, pasi, në bazë të nenit 122(2) të Kushtetutës, marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara me ligj kanë epërsi mbi ligjet e vendit që nuk pajtohen me to. Ato zbatohen në mënyrë të drejtpërdrejtë përveç rasteve kur nuk janë të vetëzbatueshme. Edhe nëse neni 10 i Konventës nuk do të kishte status hierarkik më të lartë se ligjet e vendit, përsëri duhet të zbatohet si pasojë e parimit *lex mitior* (zbatimi i legjislacionit më të favorshëm për të gjykuarin në të drejtën penale). Në bazë të parimit themelor të reciprocitetit, shteti kërkuar nuk ka të drejtë t'i kërkojë shtetit shqiptar zbatimin e nenit 1 të Protokollit të Katërt shtesë. Si rrjedhojë, pranimi nga ana e gjykatave shqiptare të kërkesës për ekstradim të shtetasve shqiptarë do të sillte shkeljen e së drejtës ndërkombëtare dhe penalizmin padrejtësisht si të shtetit shqiptar në arenën ndërkombëtare, ashtu dhe të shtetasve shqiptarë të cilëve ju mohohet një e drejtë e cila i akordohet shtetasve të shtetit rezervues.

32. Sa i përket çështjes nëse Republika e Shqipërisë ka apo jo juridiksion mbi rastin, në kushtet kur çështja është gjykuar me vendim përfundimtar të gjykatës italiane, ne, gjyqtarët në pakicë, arsyetojmë se parimi i mos gjykitimit dy herë për të njëjtën vepër penale është parashikuar në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë (neni 34). Kushtetuta përcakton parimet bazë të së drejtës, ndaj ligjet e tjera, përfshirë Kodin Penal, duhet të përmbajnë norma që pajtohen me të ose zbatimi i tyre do të duhet të kryhet në përputhje me këto parime bazë (shih edhe nenin 1/a të Kodit Penal). Nën këtë frymë edhe neni 6 i Kodit Penal që, ndërsa pranon veprimin e ligjit penal në hapësirë, e shtrin zbatimin edhe për veprat penale që kryhen nga shtetasit shqiptarë jashtë territorit të vendit, por për sa kohë që ndaj tij nuk është dhënë një vendim përfundimtar nga gjykata e huaj, përbën një rregullim që garanton respektimin e këtij parimi. Megjithatë, kjo dispozitë nuk duhet parë dhe lexuar e shkëputur nga normat e tjera të së drejtës penale, që për shtetasit e mësipërm parashikojnë një tjetër regjim të zbatimit të

ligjit, sikurse është ai i njohjes së vendimit penal të huaj. Në nenin 10 të Kodit Penal, parashikohet se vendimet penale të dhëna ndaj shtetasve shqiptarë nga një gjykatë e huaj mund të njihen, brenda kufijve të ligjit shqiptar, në Republikën e Shqipërisë.

33. Këto norma të së drejtës materiale nuk mund të gjejnë zbatim, pa konsideruar edhe organet që ushtrojnë detyrat dhe përgjegjësitë për ndjekjen penale dhe gjykimin penal. Parë në harmoni me njëra-tjetrën, organet e drejtësisë penale shqiptare kanë të drejtën të fillojnë ndjekjen penale, si dhe gjykimin e një shtetasi shqiptar për një vepër të kryer jashtë shtetit, për sa kohë që nuk verifikohet se, për të njëjtin fakt, ai është gjykuar nga gjykatë e huaj me vendim përfundimtar. Dhënia e një vendimi të tillë do të përbënte pengesë që një procedim (hetim apo gjykim) i filluar, të vijonte. Kjo nuk do të thotë se shteti shqiptar pushon së pasuri pushtet dhe juridiksion mbi shtetasin e vet, të dënuar nga gjykata e huaj. Juridiksioni penal, në këtë rast, ushtrohet nëpërmjet procedurës së njohjes së vendimit të gjykatës së huaj, çka do të thotë se mbi shtetasin shqiptar vijon të zbatohet ligji penal shqiptar.

34. Dispozitat e Kodit Penal janë të detyrueshme për t'u zbatuar edhe në këtë procedure, lidhur me respektimin e parimeve, ekzistencës së një fakti penalisht të dënueshëm sipas këtij Kodi apo edhe caktimit të dënimit që duhet të vuhet në Republikën e Shqipërisë. Nisur nga sa më sipër, Kolegji Penal arrin në përfundimin se ushtrimi i juridiksionit penal mbi shtetasit shqiptar që kryejnë vepra penale jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë ushtrohet në dy mënyra: 1. nëpërmjet zbatimit të drejtpërdrejtë të ligjit penal, sipas dispozitave procedurale që rregullojnë ushtrimin e ndjekjes penale dhe gjykitimit penal; 2. Nëpërmjet njohjes së vendimit penal të huaj, në përputhje me dispozitat procedurale penale, që rregullojnë këtë çështje (neni 512 e vijues i Kodit të Procedurës Penale). Referuar normës konventore që përcakton "*parashkrimin e dënimit penal sipas ligjit të shtetit të kërkuar*" për çështje që janë në juridiksionin e tij, për të cilën Italia ka bërë rezervë, kjo rezervë praktikisht do të mbetet pa efekt, nëse do të pranohej se në çdo rast kur dënimi penal është parashkruar në Republikën e Italisë si shtet i kërkuar, ky fundit nuk do të kishte juridiksion dhe, për rrjedhojë, nuk do të shtrohej fare për diskutim çështja e parashkrimit. Në fakt duhet të jetë e kundërta, pasi në parim, një normë duhet të interpretohet dhe zbatohet vetëm kur ajo është e



aftë të sjellë efekte juridike. Çdo qëndrim i ndryshëm do ta linte normën pa zbatim, çka nuk është qëllimi i Konventës.

35. Sa sipër, ne, gjyqtarët e pakicës, vlerësojmë se, për pyetjen e dytë njësuere përgjigja duhet të jetë: “Gjykatat e refuzojnë kërkesën për ekstradimin e shtetasve shqiptarë, në bazë të nenit 10 të Konventës Evropiane për Ekstradimin, duke mospranuar kërkesën për ekstradimin e shtetasve të tij në rast se ndjekja penale apo dënimi janë parashkruar sipas ligjit penal shqiptar, drejt një shteti i cili ka vendosur rezervë në normën ndërkombëtare, për shkak se vepra penale ose dënimi nuk është parashkruar sipas ligjit të atij shteti, për çështje që janë në juridiksionin e tij.”.

Në lidhje me zgjidhjen e çështjes konkrete:

36. Lidhur me zgjidhjen e çështjes konkrete, ne, gjyqtarët në pakicë, e vlerësojmë se është i drejtë vendimi i Gjykatës së Apelit Tiranë për refuzimin e ekstradimit dhe, si i tillë, Kolegji duhej të kishte vendosur sipas përgjigjeve njësuere që kemi argumentuar ne dhe për zgjidhjen e rastit konkret sipas nenit 441, paragrafi 1, shkronja “e” të KPP-së, lënien në fuqi të vendimit të Gjykatës së Apelit Tiranë.

37. Arrihet në këtë konkluzion pasi, në zbatim të pikës 1/b, të nenit 54 të ligjit “Për marrëdhëniet juridiksionale me autoritetet e huaja në çështjet penale”, ekzekutimi i dënimit është parashkruar. Që një vendim penal i huaj të sjellë pasojat që burojnë në pjesën urdhëruese të tij kërkohet, midis të tjerave, që jo vetëm vepra penale që është kryer të jetë njëkohësisht e dënueshme nga legjislacionet penale të shteteve palë në një marrëveshje, por edhe që dënimi të jetë njëkohësisht i ekzekutueshëm dhe jo i parashkruar, si nga shteti kërkues, ashtu dhe nga shteti i kërkuar. Parashkrimin e ekzekutimit të vendimit të dënimit, ligjvënësi e ka parashikuar si rrethanë penguese, jo vetëm për sa i përket ekzekutimit, por edhe njohjes së një vendimi penal të huaj dhe lejimit të ekstradimit. Neni 54 i ligjit “Për marrëdhëniet juridiksionale me autoritetet e huaja në çështjet penale”, i titulluar: Kërkesat për njohjen dhe ekzekutimin e vendimeve penale të huaja, në pikën “b” të tij parashikon se: Përveç kushteve të parashikuara në nenin 514 të KPP-së, vendimi penal i huaj njihet dhe ekzekutohet edhe kur plotësohen kushtet e mëposhtme: b) ekzekutimi i vendimit të dënimit në bazë të legjislacionit të brendshëm nuk

është parashkruar. Për sa i përket parashkrimit të ekzekutimit të një vendimi dënimi, Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë, në nenin 68 të tij, parashikon se vendimi i dënimit nuk ekzekutohet kur nga dita që vendimi ka marrë formë të prerë, kanë kaluar dhjetë vjet për vendimin që përmban dënimin nga pesë gjer në pesëmbëdhjetë vjet burgim.

38. Në rastin konkret, vendimi nr. 10235/2001, datë 9.7.2004, i Gjykatës së Shkallës së Parë Milano, Itali, i ndryshuar pjesërisht me vendimin nr. 2858/2005, datë 13.6.2005, të Gjykatës së Apelit Milano, Itali, i cili është bërë përfundimtar më datë 13.1.2009, të drejtën për t’u ekzekutuar nga organet kompetente të shtetit shqiptar sipas KPP-së të Republikës së Shqipërisë, e ka pasur deri në datën 13.1.2019. Pas datës 13.1.2019, dënimi prej 10 vjetësh burgim konsiderohet i shuar për shkak të parashkrimit të së drejtës për ekzekutimin e vendimit që përmban dënimin e mësipërm.

39. Me vendim gjyqësor të formës së prerë nr. 957, datë 9.7.2019, të Gjykatës së Apelit Tiranë, është konstatuar se ekzekutimi i dënimit të dhënë nga gjykata italiane është parashkruar sipas ligjit shqiptar, ndaj ky fakt përbën arsyen, për të cilën gjykata e apelit ka arritur në përfundimin se vendimi i gjykatës së shkallës së parë është marrë në interpretim dhe zbatim të gabuar të ligjit dhe ekstradimi i shtetasit shqiptar Bledar Bedini *alias* Bledar Imami, nga Republika e Shqipërisë në Republikën e Italisë, nuk duhej të miratohej.

40. Ne, gjyqtarët në pakicë, çmojmë të drejtë arsyetimin e Gjykatës së Apelit, në lidhje me pretendimin e ngritur në ankim dhe në gjykimin në apel të mbrojtjes. Në analizë të këtij pretendimi, gjykata, pasi ka konstatuar se sipas vërtetimit nr. 6330/1 prot., datë 25.11.2022, të Gjykatës së Lartë, ku citohet se, nga verifikimet në sistemin elektronik të menaxhimit të çështjes është në fazë studimi çështja penale nr. 69403-00901-00-2019 akti, datë regjistrimi 30.9.2002, me kërkues Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, me objekt njohjen e vendimit penal të huaj nr. 2858/2005, datë 13.6.2005, të Gjykatës së Apelit Milano, mbi dënimin e shtetasit shqiptar Bledar Imami *alias* Bedini për veprën penale “Trafikim të lëndëve narkotike në bashkëpunim” çmon se ka një përplasje kërkesash dhe vendimesh penale, në lidhje me të dënuarin dhe, në kushtet kur për njohjen e vendimit penal të huaj nuk ka një vendim



përfundimtar, organi i akuzës nuk mund të pretendojë ekzekutimin e ekstradimit pa u njohur vendimi penal i huaj nga gjykimi në Gjykatën Lartë (kjo kërkesë është rrëzuar me vendimin nr. 957, datë 9.7.2019, të Gjykatës së Apelit Tiranë).

41. Për sa kohë ekziston mundësia ligjore që Gjykata e Lartë, mbi bazën e rekursit të prokurorisë mund të ndryshojë vendimin nr. 957, datë 9.7.2019, të Gjykatës së Apelit Tiranë, vlerësohet se kërkesa për njohje vendimi penal ndaj shtetasit shqiptar Bledar Imami *alias* Bedini nuk është shqyrtuar nga një vendim përfundimtar dhe i pandryshueshëm. Në rastin në shqyrtim, rezulton qartë se shteti italian nuk ka paraqitur më herët kërkesën për ekstradim të shtetasit shqiptar Bledar Imami *alias* Bedini, duke zgjedhur të kërkojë njohjen e vendimit dhe dënimit penal në Republikën e Shqipërisë. Kjo ishte kërkesa që u shqyrtua nga gjykata shqiptare dhe që u refuzua. Në atë proces, gjykatës as nuk iu paraqit dhe ajo as nuk shqyrtoi një kërkesë për ekstradim, që të vlerësonte nëse ishte apo jo e pranueshme. Pra, konstatohet se, njëkohësisht, në gjykatat shqiptare shqyrtohen dhe gjykohen dy kërkesa (njohje vendimi penal të huaj dhe kërkesë për ekstradim) për të njëjtin fakt, ndaj të njëjtit shtetas shqiptar, me të njëjtin shtet kërkuar.

42. Në analizë të sa më lartë, ne, gjyqtarët në pakicë, vlerësojmë se cenohet parimi i mos gjykitimit dy herë për të njëjtën veprë penale, që është i parashikuar në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë (neni 34). Kushtetuta përcakton parimet bazë të së drejtës, ndaj ligjet e tjera, përfshirë KP-në, duhet të përmbajnë norma që pajtohen me të ose zbatimi i tyre do të duhet të kryhet në përputhje me këto parime bazë (shih edhe nenin 1/a të KP-së). Nën këtë frymë edhe neni 6 i KP-së që, ndërsa pranon veprimin e ligjit penal në hapësirë, e shtrin zbatimin edhe për veprat penale që kryhen nga shtetasit shqiptarë jashtë territorit të vendit, por për sa kohë që ndaj tij nuk është dhënë një vendim përfundimtar nga gjykata e huaj, përbën një rregullim, që garanton respektimin e këtij parimi. Megjithatë, kjo dispozitë nuk duhet parë dhe lexuar e shkëputur nga normat e tjera të së drejtës penale, që për shtetasit e mësipërm, parashikojnë një tjetër regjim të zbatimit të ligjit, sikurse është ai i njohjes së vendimit penal të huaj.

43. Në nenin 10 të KP-së, parashikohet se vendimet penale të dhëna ndaj shtetasve shqiptarë nga një gjykatë e huaj mund të njihen, brenda kufijve

të ligjit shqiptar, në Republikën e Shqipërisë. Këto norma të së drejtës materiale nuk mund të gjejnë zbatim, pa konsideruar edhe organet që ushtrojnë detyrat dhe përgjegjësitë për ndjekjen penale dhe gjykimin penal. Parë në harmoni me njëra-tjetrën, organet e drejtësisë penale shqiptare kanë të drejtën të fillojnë ndjekjen penale, si dhe gjykimin e një shtetasi shqiptar për një veprë të kryer jashtë shtetit, për sa kohë që nuk verifikohet se, për të njëjtin fakt, ai është gjykuar nga një gjykatë e huaj me vendim përfundimtar. Dhënia e një vendimi të tillë do të përbënte pengesë që një procedim (hetim apo gjykim) i filluar, të vijonte. Kjo nuk do të thotë se shteti shqiptar pushon së pasuri pushtet dhe juridiksionin mbi shtetasin e vet, të dënuar nga gjykata e huaj. Juridiksioni penal, në këtë rast, ushtrohet nëpërmjet procedurës së njohjes së vendimit të gjykatës së huaj, çka do të thotë se mbi shtetasin shqiptar vijon të zbatohet ligji penal shqiptar. Dispozitat e KP-së janë të detyrueshme për t'u zbatuar edhe në këtë procedurë, lidhur me respektimin e parimeve, ekzistencës së një fakti penalisht të dënueshëm sipas këtij Kodi apo edhe caktimit të dënimit që duhet të ekzekutohet në Republikën e Shqipërisë. Nisur nga sa më sipër, Gjykata e Apelit ka arritur në përfundimin se ushtrimi i juridiksionit penal mbi shtetasit shqiptarë që kryejnë vepra penale jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë ushtrohet në dy mënyra: 1. Nëpërmjet zbatimit të drejtpërdrejtë të ligjit penal, sipas dispozitave procedurale që rregullojnë ushtrimin e ndjekjes penale dhe gjykitimit penal; 2. Nëpërmjet njohjes së vendimit penal të huaj, në përputhje me dispozitat procedurale penale, që rregullojnë këtë çështje (nenet 512 e vijues të KPP-së). Si përfundim, Gjykata e Apelit ka vlerësuar se pretendimi i prokurorisë se ligji penal shqiptar nuk mund të zbatohet ndaj shtetasit Bledar Bedini *alias* Bledar Imami, është i pabazuar. Ligji shqiptar penal zbatohet ndaj këtij shtetasi dhe shteti shqiptar ka zgjeruar juridiksion mbi këtë çështje për efekt të kërkesës për njohje.

44. Nga përmbajtja e nenit 512 e vijues të KPP-së, ne vlerësojmë se njohja e vendimit penal të huaj është parakushti themelor në mënyrë që vendimi të prodhojë pasoja juridike në rendin juridik shqiptar. Me njohjen e një vendimi penal të huaj nuk kemi të bëjmë me një vendim të gjykatës shqiptare që vihet në ekzekutim, por me një vendim të një gjykate të huaj që ekzekutohet në përputhje me legjislacionin



shqiptar dhe që është një zgjerim i juridiksionit të autoritetit gjyqësor të huaj në Shqipëri, i cili përfundon mbas njohjes dhe ekzekutimit të tij në Shqipëri (qëndrim i mbajtur edhe nga Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë në vendimin njësuës nr. 154, datë 15.4.2000). Kjo është dhe arsyeja që fillimisht është kërkuar njohja e vendimit të dënimit ndaj shtetasit shqiptar Bledar Imami *alias* Bedini nga ana e autoriteteve gjyqësore italiane.

45. Në eventualitetin e sipërcituar, të pranimit të kërkesës për ekstradim, në kushtet kur për të njëjtin fakt është refuzuar më parë kërkesa për njohjen e vendimit penal të huaj ndaj shtetasit shqiptar Bledar Imami *alias* Bedini, bie ndesh formalisht edhe me parimin e mos dënimit pa ligj që parashikohet në nenin 7 të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut (KEDNJ) dhe në nenin 29 të Kushtetutës Shqiptare, dhe është pjesë e rëndësishme e procesit të rregullt gjyqësor, së bashku me parimin e mos dënimit dy herë për të njëjtin fakt (*ne bis in idem*). Neni 29 i Kushtetutës parashikon se: “1. Askush nuk mund të akuzohet ose të deklarohet fajtor për një veprë penale, e cila nuk konsiderohej e tillë me ligj në kohën e kryerjes së saj, me përjashtim të veprave, të cilat në kohën e kryerjes së tyre, përbënin krime lufte ose krime kundër njerëzimit sipas së drejtës ndërkombëtare. 2. Nuk mund të jepet një dënim më i rëndë se ai që ka qenë parashikuar me ligj në kohën e kryerjes së veprës penale. 3. Ligji penal favorizues ka fuqi prapavepruese”. Ndërkohë, neni 7 i KEDNJ-së parashikon se: “1. Askush nuk mund të dënohet për një veprim ose një mosveprim, që në momentin kur është kryer nuk përbënte veprë penale, sipas të drejtës së brendshme ose ndërkombëtare. Po ashtu, nuk mund të jepet një dënim më i rëndë se ai që ishte i zbatueshëm në momentin kur është kryer vepra penale. 2. Ky nen nuk do të ndikojë mbi gjykimin dhe dënimin e një personi për një veprim ose mosveprim, i cili, në momentin kur është kryer, quhej veprë penale sipas parimeve të përgjithshme të së drejtës, të njohura nga kombet e qytetëruara.”. Në çdo rast, njohja e vendimit penal të huaj është një institut i së drejtës procedurale penale që ka karakterin substancial të dënimit penal, jo vetëm duke pasur parasysh kualifikimin e tij formalisht si të tillë, por edhe duke pasur parasysh kufizimet e mëdha të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut që kufizohen në momentin e njohjes së vendimit penal të huaj nga gjykata shqiptare. Në këtë kuptim, nuk mund të

pranohet kërkesa për ekstradim në kushtet kur për të njëjtin fakt është refuzuar më parë kërkesa për njohjen e vendimit penal të huaj ndaj shtetasit shqiptar, pasi bie ndesh me qëllimin e nenit 29 të Kushtetutës dhe nenit 7 të KEDNJ-së, krijon efektet ekuivalente dhe materiale të një dënimit penal pa ligj, si dhe bie ndesh edhe me parimin e mos dënimit dy herë për të njëjtin fakt (*ne bis in idem*).

Tiranë, më 22.5.2024.

GJYQTAR: Ilir Panda, Sandër Simoni

VENDIM
Nr. 32, datë 23.9.2024

**PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN
E KOMISIONIT KOMBËTAR
RREGULLATOR NR. 6, DATË 22.2.2023,
“PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË
RAJONALE UJËSJELLËS-KANALIZIME
DURRËS”**

Në mbështetje të neneve 13, 14, 16 dhe 17 të ligjit nr. 8102, datë 28.3.1996, “Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”, të ndryshuar (ligji nr. 8102); VKM-së nr. 958, datë 6.5.2009, “Për miratimin e kategorive të licencimit dhe të procedurave për aplikim për licencë” (VKM nr. 958); si dhe vendimit të Komisionit Kombëtar Rregullator nr. 29, datë 8.12.2009, “Për procedurat e dhënies dhe rinovimit të licencave profesionale për subjektet juridike e fizike, që ushtrojnë veprimtari në sektorin e furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”, të ndryshuar (Rregullore e licencimit),

KOMISIONI KOMBËTAR RREGULLATOR,

në mbledhjen e datës 23.9.2024, pasi shqyrtoi çështjen me objekt “Mbi miratimin e vendimit për një ndryshim në vendimin e Komisionit Kombëtar nr. 6, datë 22.2.2023, ‘Për licencimin e Shoqërisë Rajonale Ujësjellës-Kanalizime Durrës’”,

VËREN SE:

1. Shoqëria Rajonale Ujësjellës-Kanalizime Durrës me shkresën nr. 4410 prot. datë 29.8.2024,



me lëndë “Kërkesë për ndryshimin e drejtuesit teknik”; plotësimet me *e-mail*, datë 6.9.2024, me lëndë: “Kthim përgjigje për ndryshimin e të dhënave në licencën e ‘SHRUKD’ sh.a.”, ka paraqitur pranë Entit Rregullator të Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura (ERRU) kërkesën për rinovim të licencës për efekt të ndryshimit të një prej drejtuesve teknikë të shoqërisë të shoqëruar me dokumentacionin sipas përcaktimeve të parashikuara në VKM-në nr. 958, dhe Rregullores së licencimit, të ndryshuar;

2. Komisioni Kombëtar Rregullator (KKRR) pranoi kërkesën e Shoqërisë Rajonale Ujësjiellës-Kanalizime Durrës për rinovim licence për efekt të ndryshimit të një prej drejtuesve teknikë.

3. KKRR-ja ka licencuar Shoqërinë Rajonale Ujësjiellës-Kanalizime Durrës, me vendimin nr. 6, datë 22.2.2023, “Për licencimin e Shoqërinë Rajonale Ujësjiellës-Kanalizime Durrës, me një afat 4-vjeçar, ku shoqëria autorizohet të ofrojë shërbimin e grumbullimit dhe të shpërndarjes së ujit për konsum publik, largimit dhe trajtimit të ujërave të ndotura.

4. Drejtuesi i ri teknik i shoqërisë z. Olsen Kavalli, i cili zëvendëson ish drejtuesin teknik z. Gerald Dautaj, ka diplomë *Bachelor* në inxhinieri elektrike, me profil “Profesional – Energjetikë” në vitin 2011, pranë Universitetit Politeknik të Tiranës. Gjithashtu, disponon diplomë Master shkencor në “Politika dhe administrim”, vitin 2019, Profili Administrim Publik, në Universitetin “Aleksandër Moisiu”, Durrës dhe Master i shkencave në Teknologji Informacioni, vitin 2013, në universitetin jopublik Kristal.

5. ERRU-ja në vlerësimin e kërkesës për ndryshimin e licencës për efekt të ndryshimit të një prej drejtuesve teknikë ka marrë në konsideratë kërkesat e ligjit nr. 8102, të VKM-së nr. 958 dhe të Rregullores së licencimit, të ndryshuar, në mënyrë të veçantë sa i takon garantimit që i licencuari të veprojë në përputhje me kushtet e licencës së tij dhe të mbrojë interesat e konsumatorëve në lidhje me cilësinë, eficiencën, vazhdueshmërinë dhe garancinë e shërbimit referuar eksperiencës mbi 10-vjeçare pranë kësaj shoqërie.

Për gjithë sa më sipër, Komisioni Kombëtar Rregullator, pasi arriti në përfundimin se aplikimi i Shoqërisë Rajonale Ujësjiellës-Kanalizime Durrës plotëson kërkesat ligjore të parashikuara në kuadrin rregullator në fuqi,

VENDOSI:

1. Pika 2(b) e vendimit të KKRR-së nr. 6, datë 22.2.2023, “Për licencimin e Shoqërisë Rajonale Ujësjiellës-Kanalizime Durrës”, ndryshon si më poshtë:

b) Drejtues teknik: z. Olsen Kavalli.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim publikohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYETARE

Ediola Braha

VENDIM

Nr. 35, datë 7.10.2024

PËR MIRATIMIN E PËRQINDJES SË PAGESËS RREGULLATORE VJETORE

Në mbështetje të neneve 2, 10 dhe 22 të ligjit nr. 8102, datë 28.3.1996, “Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe të largimit dhe përpunimit të ujërave të ndotura”, të ndryshuar dhe nenit 9 të “Metodologjisë dhe procedurës për miratimin e tarifave të shërbimeve Ujësjiellës-Kanalizime”, Komisioni Kombëtar Rregullator

VENDOSI:

1. Miratimin e përqindjes së pagesës rregullatore vjetore në masën 0.77% për të gjitha shoqëritë ujësjiellës-kanalizime.

2. Për shoqëritë UK që aplikojnë për nivel të ri tarifor, ky koeficient do të aplikohet mbi të ardhurat vjetore të parashikuara nga aktiviteti i furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura.

3. Për shoqëritë UK që nuk do të aplikojnë për nivel të ri tarifor, ky koeficient do të aplikohet mbi të ardhurat e realizuara të vitit paraardhës.

4. Ngarkohen strukturat e ERRU-së dhe të gjitha shoqëritë UK për zbatimin e këtij vendimi.

5. Vendimi i Komisionit Kombëtar Rregullator nr. 38, datë 5.10.2023, “Për miratimin e përqindjes së pagesës rregullatore”, shfuqizohet.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYETARE

Evis Shurdha

Formati 61x86/8

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2024

Adresa: Rr. "Nikolla Jorga", Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 400 lekë

